

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

P 309 / 10

P 340 / 10

29 prill 2013

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prerë dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

**NË EMËR TË POPULLIT**

Trupi gjykues i Gjykatës Themelore të Prishtinës i përbërë nga kryetari i trupit gjykues të EULEX-it Arkadiusz Sedek, së bashku me gjyqtarin e EULEX-it Dean B. Pineles dhe gjyqtarin vendor Vahid Halili si anëtarë të trupit gjykues dhe me Gemma Eaton si procesmbajtëse,

Në lëndën penale kundër:

**L.D.**

**A.D.**

**D.J.**

**I.R.**

**S.H**

Këta të pesë të pandehur ishin akuzuar me aktakuzën PPS nr. 41/09, e cila ishte paraqitur në gjykatë me 15 tetor 2010;

Dhe

**I.B.**

**S.D.**

Këta të dy të pandehur ishin akuzuar me aktakuzën PPS 107/10, e cila ishte paraqitur në gjykatë me 20 tetor 2010.

Te dy aktakuzat ishin bashkuar në një aktakuzë të vetme me 29 nëntor 2010 dhe ishte konfirmuar në pajtim me nenin 316 (4), Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve me 27 prill 2011.

Aktakuza e vetme pastaj ishte përmirësuar dhe zgjeruar me 22 mars 2013 dhe 17 prill 2013.

Sipas aktakuzës së përmirësuar dhe të zgjeruar, të pandehurit ishin akuzuar me veprat si në vijim, të gjitha sipas versionit të vitit 2004 të Kodit Penal të Kosovës (KPK):

#### **Pika 1**

**Trafikimi me njerëz** në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës, neni 139, i dënueshëm me burgim prej 2 deri në 12 vjet, i kryer në bashkëkryerje, neni 23 i KPK-së **kundër L.D., S.H dhe A.D.**

#### **Pika 2**

**Krim i organizuar**, në shkelje të KPK-së, neni 274, paragrafi 3, i dënueshëm me gjobë deri 500 000 EUR dhe me burgim prej shtatë deri njëzet vite, kundër **L.D.**

#### **Pika 3**

**Krim i organizuar**, në shkelje të KPK-së, neni 274, paragrafi 1, i dënueshëm me gjobë deri 250 000 EUR dhe me burgim prej së paku shtatë viteve, kundër **A.D. dhe S.H.**

#### **Pika 4**

**Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore**, në shkelje të KPK-së, neni 221 paragrafi 1, i dënueshëm me gjobë apo burgim deri në një vit, i kryer në **Bashkëkryerje**, neni 23 i KPK-së kundër **L.D., D.J., I.B., S.D. dhe S.H.**

#### **Pika 5**

**Keqpërdorim i pozitës zyrtare ose autoritetit**, në shkelje të KPK-së, neni 339, paragrafi 1, e dënueshme me burgim prej një deri në tetë vite **kundër D.J.**

#### **Pika 6**

**Keqpërdorim i pozitës zyrtare ose autoritetit**, në shkelje të KPK-së, neni 339 paragrafi 1, e dënueshme me burgim prej një deri në tetë vite **kundër I.RR.**

#### **Pika 7**

**Lëndime të Rënda Trupore**, në kundërshtim me KPK-në, neni 154, paragrafi 2, nënparagrafi 4, e dënueshme me burgim prej 1 viti deri në 10 vite; ose në alternativ, paragrafin 5 i dënueshëm me burgim prej 6 muajve deri në 3 vjet; ose në paragrafin alternativ 1, nënparagrafin 4, i dënueshëm me burgim prej 6 muajve deri në 5 vite e kryer në **Bashkëkryerje**, neni 23 i KPK-së kundër **L.D., S.H, I.B. dhe S.D.**

#### **Pika 8**

**Mashtrim**, në shkelje të KPK-së, neni 261 i dënueshëm me burgim prej 6 muajve deri në 5 vite kundër **L.D. dhe A.D.**

#### **Pika 9**

**Falsifikimi i Dokumenteve**, në shkelje të KPK-së, neni 332, paragrafi 1 i dënueshëm me gjobë apo burgim deri në një vit **kundër L.D. dhe A.D.**

#### **Pika 10**

**Falsifikimi i dokumenteve zyrtare**, në shkelje të KPK-së, neni 348 e dënueshme me burgim prej tre muajve deri tri vite **kundër I.RR..**

Pas mbajtjes së seancës kryesore publike më:

04, 05, 06, 11, 12, 18, 19, 20 dhe 25 tetor 2011;

09, 10, 15, 17, 22, 23, 29 dhe 30 nëntor 2011;

19, 20 dhe 21 dhjetor 2011;

06 dhe 13 shkurt 2012;  
16, 22 dhe 23 mars 2012;  
04 dhe 05 prill 2012;  
10, 18 dhe 24 maj 2012,;  
13, 14, 18, 19, 20 dhe 21 qershor 2012;  
24 korrik 2012;  
4, 6, 7, 11, 13 dhe 25 shtator 2012;  
9 tetor 2012;  
14, 16 dhe 26 nëntor 2012;  
5 dhjetor 2012;  
29 janar 2013;  
11, 12 dhe 26 shkurt 2013;  
01, 08, 22, 27 dhe 29 mars 2013;  
02, 03, 05, 10, 12, 16, 17, 19, 23 dhe 24 prill 2013.

Në prani të:

Prokurorit:

**Jonathan Ratel**, Prokuror i EULEX-it

Të pandehurit:

**L.D.** me avokatin e tij L.D.;  
**A.D.** me avokatin e tij P.D.;  
**I.RR.** avokat e tij F.V.;  
**D.J.** me avokatët e tij I.SH. dhe A.T.;  
**S.H.** me avokatin e tij F.B.;  
**I.B.** me avokatin e tij A.A.; dhe  
**S.D.** me avokatin e tij H.ZH.

Pas shqyrtimit dhe votimit me 24, 25 dhe 26 prill 2013, në pajtim me nenin 383, paragrafin 2, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;

Gjykata shpalli publikisht AKTGJYKIMIN në vijim më 29 prill 2013 në pajtim me nenet 385 dhe 392, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës:

## **AKTGJYKIM**

Pika 1, *Trafikimi me njerëz*

**L.D.** është fajtor për kryerjen e veprës penale të *Trafikimit me Njerëz* në kundërshtim me nenin 139, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), vepër kjo e kryer në *Bashkëkryerje*, neni 23 i KPK-së.

**A.D.** është fajtor për kryerjen e veprës penale të *Trafikimit me Njerëz* në kundërshtim me nenin 139 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) e kryer në *Bashkëkryerje*, neni 23 i KPK-së.

Për shkak se **prokurori** ka provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se :

Me ose rreth 1 janarit 2008 deri 4 nëntor 2008, **L.D.** në cilësinë e kirurgut për transplantim dhe pronar i klinikës Medicus, **A.D.** në cilësinë e drejtorit/menaxherit të klinikës Medicus, **S.H.** në cilësinë e shefit anesteziolog; **Y.S.** (bashkë-kryerësi i akuzuar në lëndë të ndarë) në cilësinë e tij si kirurg i transplantimit, **M.H.**(bashkë-kryerësi i akuzuar në lëndë të ndarë) në cilësinë e rekrutuesit dhe ndihmësit; së bashku me **K.D.** (bashkë-kryerësi i paakuzuar), në cilësinë e tij si kirurg i transplantimit dhe të tjerët kanë rekrutuar, transportuar, transferuar, strehuar dhe kanë pranuar personat nga vendet e jashtme në Kosovë me qëllim të heqjes së organeve të tyre (veshkët) në klinikën Medicus dhe transplantimin e atyre organeve marrësve që kanë qenë në pritje.

**L.D.**, si pronar i Klinikës Medicus ishte përgjegjës për zhvillimin dhe funksionimin e përgjithshëm të Klinikës lidhur me transplantimet ilegale të veshkëve. Ai ishte personalisht i involvuar në shumë operacione për transplantim ilegal të veshkëve të listuara më poshtë.

**A.D.** në cilësinë e drejtorit të klinikës, ishte përgjegjës për aktivitete të numërta dhe të rëndësishme lidhur me operacionet për transplantim ilegal të veshkëve në Klinikën Medicus, duke përfshirë: transferimin e viktimave dhuruese dhe marrësve nga Aeroporti i Prishtinës në Klinikën Medicus dhe kthimin e tyre në aeroport dhe në disa raste ai e ka kryer vet transferin; menaxhimin e të gjitha aktiviteteve logjistike për operacionet e transplantimit , si caktimin dhe sigurimin e disponueshmërisë se mjeteve të nevojshme mjekësore; nënshkrimin dhe ofrimin e ftesave për dhuruesit dhe marrësit për të ndihmuar hyrjen e tyre në Kosovë; asistimin me rregullime financiare dhe ofrimin e faturave për pagesë në disa raste; mbajtjen e kontaktit të afërt me Y.S. lidhur me aranzhimet logjistike dhe angazhimin në aktivitete të tjera në Klinikë, si kontabilitetin. Të gjitha këto aktivitete ishin kryer me qëllim të kryerjes së operacioneve të paligjshme të veshkëve në Klinikën Medicus.

Duke filluar në 2008, persona të shumtë ishin rekrutuar nga vende të jashtme dhe transportuar në Kosovë, ishin transferuar nga aeroporti i Prishtinës në Klinikën Medicus, ishin pranuar në klinikë , dhe pastaj ishin strehuar në klinikë, të gjitha me qëllim të shfrytëzimit të tyre duke ua larguar veshkët e tyre dhe transplantimin e veshkëve të tyre marrësve në pritje. Dhuruesit ishin të gjithë viktimat të keqpërdorimit të gjendjes së tyre të ndjeshme për shkak të gjendjes së tyre shumë të mjerë financiare, dhe në disa raste edhe viktimat të detyrimit, dhe /apo mashtrimit. Veprime të tilla janë në kundërshtim me nenin 139 (1) dhe (8), nënparagrafët 1 dhe 2, KPK.

Në pajtim me nenin 13, nënparagrafi 3 KPK, pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh për qëllim të nenit 139 (1) KPK.

Duke filluar nga marsi 2008 deri në nëntor 2008, heqja e organeve nga dhuruesit në klinikën Medicus dhe transplantimi i atyre organeve tek marrësit në pritje përfshin 24 raste të veçanta, ku secila prej tyre ka përfshirë një dhurues dhe një marrës , siç përshkruhet më poshtë në mënyrë kronologjike (Shënim: rasti 13 përfshin dy raste në të njëjtën ditë).

Shtatë raste kanë përfshirë dhurues të cilët kanë dëshmuar në seancën kryesore dhe ishin dëshmuar të jenë viktimat të keqpërdorimit të pozitës së tyre të ndjeshme , dhe në disa raste viktimat të detyrimit dhe/apo mashtrimit dhe ishin shfrytëzuar duke ua larguar veshkët e tyre në kuptim të nenit 139. Këto janë rastet 3,7,13 (njëra nga dy rastet në atë ditë), 18,21, 22 dhe 23 dhe janë bërë me shkronja italike më poshtë. Edhe pse dhuruesit tjerë nuk ishin lokalizuar

dhe për këtë arsye nuk kanë mundur të dëshmojnë në gjykim, është e arsyeshme të përfundohet se të gjithë dhuruesit e tjerë ishin shfrytëzuar në të njëjtën mënyrë, duke pasur parasysh identitetin e tyre të huaj dhe rrethanat e ngjashme nën të cilat veshkët ishin larguar dhe transplantuar.

- (1) Me **08 mars 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., K.D., L.D., S.H., S.D.** dhe **I.B.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese "T." MP (mbiemri i panjohur), organi (veshka) pastaj është transplantuar tek marrësja F.B.B. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimen dhuruese apo palën e dëmtuar për organin;
- (2) Më **11 maj 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., D.J., L.D., S.H., S.D.** dhe **I.B.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese R. M.P. ,organi ( veshka) pastaj u transplantua tek marrësi O.R. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimen dhuruese apo palën e dëmtuar për organin;
- (3) Më **15 maj 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., K.D., L.D., S.H., S.D.** dhe **I.B.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese Dëshmitari i mbrojtur "W2" . Dëshmitarit të mbrojtur "W2" i ishin premtuar 15.000 dollarë në shkëmbim të veshkës së saj, por ajo ka marrë vetëm 12.000 Dollarë Amerikanë. Dëshmitarja e mbrojtur "W2" ka imigruar në Izrael nga ish-Bashkimi Sovjetik në vitin 2007 dhe ishte në gjendje të keqe financiare. Ajo ishte viktimë e keqpërdorimit të pozitës së saj të ndjeshme financiare dhe viktimë e mashtrimit. Nuk është konstatuar sa ka paguar marrësi "S." MP për këtë transplantim të organit;
- (4) Më **04 qershor 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., D.J., L.D., S.H., S.D.** dhe **I.B.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese M.Y.. Organi ( veshka) i është transplantuar marrësit Dëshmitarit të mbrojtur " T3 " i cili ka paguar 100.000 dollarë për transplantimin e organit. Paratë ishin paguar përmes një " ndërmjetësi " A. Dëshmitari i mbrojtur " T3 " i ka ofruar prova Gjykatës që ai ka bërë pagesën në klinikën Medicus dhe **A.D.** e ka pranuar këtë pagesë drejtpërdrejtë. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimen dhuruese për organin ;
- (5) Më **05 qershor 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., L.D., S.H., S.D.** dhe **I.B.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga një palë të dëmtuar e panjohur, organi ( veshka) i është transplantuar marrësit "S." MP. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimen dhuruese për organin;
- (6) Më **06 qershor 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., D.J., S.H., S.D.** dhe **I.B.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese e panjohur, organi (veshka), pastaj u transplantua tek marrësi Y.D., një shtetas izraelit. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimen dhuruese për organin;
- (7) Më **19 qershor 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., K.D., L.D., S.H., dhe I.B.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese Dëshmitari i mbrojtur " W1 ", organi (veshka), pastaj është transplantuar

*tek marrësi Dëshmitari i mbrojtur "4". Viktima dhuruese mori 12.000 dollarë amerikanë dhe marrësi i organit ka paguar 70.000 euro për organin ( veshkën ) , nëpërmjet një kontakti në Izrael të quajtur " A. " . Dëshmitari i mbrojtur " W1 " kishte shitur veshkën e tij për shkak të vështirësive të mëdha financiare në të cilat ai u gjend dhe ai ishte viktimë e keqpërdorimit të ndjeshmërisë së tij financiare. Ai e kishte pa një shpallje në media që premtonte pagesën prej 12.000 dollarëve amerikanë për dhurimin e veshkës. Viktima dhuruese ka pësuar trauma fizike dhe psikologjike të konsiderueshme dhe gjendja e tij shëndetësore u përkeqësua pas operacionit për shkak të funksionimit jo të mirë të veshkës së tij të mbetur dhe ka pasur komplikime pas operimit;*

- (8) **Më 20 qershor 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., K.D., D.J., S.H., S.D.** dhe **I.B.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese A.M. ,organi ( veshka )pastaj është transplantuar tek marrësi E.K. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktимën dhuruese për organin;
- (9) **Më 02 korrik 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., D.J., R., L.D., S.H., dhe S.D.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese "A." MP, organi (veshka) pastaj është transplantuar tek marrësi dëshmitari i mbrojtur "M2". Dëshmitari i mbrojtur "M2", ka deklaruar se ai ka paguar një shumë totale prej 108,000 dollarëve amerikanë për transplantim të veshkës, nëpërmjet një personi të quajtur "A." , një përfaqësues i kompanisë X në X . Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktимën dhuruese për organin;
- (10) **Më 03 korrik 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., R., L.D., S.H., I.B.** dhe **S.D.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese e panjohur, organi (veshka ),pastaj është transplantuar tek marrësi Dëshmitari i mbrojtur "A1" . Marrësi, dëshmitar i mbrojtur "A1", ka paguar 79,000 euro, nga të cilat 10,000 euro i janë paguar në sikla të reja izraelite (NIS) " A", një përfaqësues i kompanisë X (në shumën rreth 52.000 NIS). Pjesa tjetër është bërë me pagesë të drejtpërdrejtë në klinikën Medicus në Prishtinë nga djali i tij Dëshmitari i mbrojtur "B1" një punonjësi të klinikës pasi që ai kishte qenë i udhëzuar për të bërë këtë nga shoqëruesi Z. i cili kishte shoqëruar të dy Dëshmitarin e mbrojtur "A1" dhe Dëshmitarin e mbrojtur "B1" nga Izraeli. Dëshmitari i mbrojtur "B1", gjithashtu ka marrë një faturë për paratë e paguara në klinikën Medicus. Marrësi ka deklaruar se dhuruesi i panjohur ishte një njeri i ri që fliste në gjuhën ruse. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktимën dhuruese për organin;
- (11) **Më 22 korrik 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., R., L.D., S.H., S.D.** kryen një operacion për heqjen e veshkës të viktimës dhuruese, E.M. , organi ( veshka) pastaj është transplantuar tek marrësi T.S.. S.T. ka deklaruar se ai i ka paguar një shumë totale prej 25,000 euro për transplantim të veshkës **Y.S.**, të cilin ai e kishte gjetur në internet dhe i cili pastaj i ofroi ndihmë për transplantim. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktимën dhuruese për organin;
- (12) **Më 23 korrik 2008** , grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S. , B., L.D., R., S.H.** dhe **S.D.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese A.G., organi (veshka), pastaj u transplantua tek marrësi V.G. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktимën dhuruese për organin;

- (13) **Më 24 korrik 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., L.D., S.H., dhe I.B.** kryen operacionin për heqjen e veshkës nga viktimat dhuruese, A. R. dhe Dëshmitari i mbrojtur "W3" organet e tyre ( veshkat ), pastaj u transplantuan tek marrësit R.F. dhe W.J. . Hetimi ka vërtetuar se të dy operacionet për transplantim të veshkës ndodhën në këtë datë; sidoqoftë prokurori nuk ka mund që ti çiftëzoj viktimat e donatorëve me përfituesit e tyre përkatës. Dëshmitari i mbrojtur "W3", deklaroi se ajo kishte qenë në vështirësi financiare dhe kishte imigruar në X nga ish-XX. Ajo tregoi se asaj i ishin ofruar 10,000 euro nëpërmjet një njoftimi në gazetë , për të ' dhuruar ' një veshkë dhe ajo ishte viktimë e keqpërdorimit të pozitës së saj të ndjeshme financiare. **M.H.** dhe **Y.S.** kishin bërë rregullimet e nevojshme për të dhe 2 gra të tjera për të udhëtuar në Prishtinë për procedurën e largimit të veshkëve. Ajo ishte paguar shumë ekuivalente të 10,000 dollarëve amerikanë në EUR (8100 ose 8200 euro). Një nga marrësit e veshkëve R.F. ka pranuar se ai kishte paguar 80.000 euro për **M.H.** për transplantim të veshkës duke përdorur një shërbim të transferimit të parave (B.) për të bërë pagesën. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimën dhuruese për organin;
- (14) **Më 29 korrik 2008**, grupi i përbërë nga kirurgët dhe anesteziologët **Y.S., L.D., S.H.** dhe **I.B.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktimja dhuruese Y.C., organi ( veshka) pastaj u transplantua tek marrësi B.E. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimën dhuruese për organin;
- (15) **Më 18 gusht 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., K.D., L.D., S.H., S.D.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktimja dhuruese A.A., organi i saj (veshka), pastaj ishte transplantuar tek marrësi Dëshmitari i mbrojtur "M1". Dëshmitari i mbrojtur "M1", ka deklaruar se, për procedurën e transplantimit të veshkës ai kishte paguar një total prej 77.000 euro, nga të cilat 17,000 Euro ndërmjetësuesit të quajtur "A." dhe pjesa e mbetur prej 60.000 euro iu kishte paguar **M.H.** përmes një transferi bankar në llogarinë e këtij të fundit. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimën dhuruese.
- (16) **Më 19 gusht 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., K.D., S.H., S.D.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktimja dhuruese J.S. i njohur edhe si 'Xh.' , organi i tij (veshka), pastaj ishte transplantuar tek marrësi dëshmitari i mbrojtur "A2" . Dëshmitari i mbrojtur "A2", ka deklaruar se ai kishte paguar shumë prej 80.000 NIS një ndërmjetësi të quajtur "A." plus 50.000 euro për **M.H.**, me anë të një transferi bankar . Ai ishte i detyruar t'i nënshtrohet një operacioni për transplantim në klinikën Medicus, nga Y.S., për shkak të faktit se ai ishte shumë i shqetësuar me faktin se nuk kishte asnjë aparat për dializë në klinikë dhe ai u tha që operacioni patjetër ishte opsioni i tij i vetëm në dispozicion për të jetuar. Në kushte të tilla, ndryshimi i mendjes së tij do të kishte paraqitur një kërcënim serioz për jetën e tij. Përveç kësaj, siç e kishte siguruar atë **Y.S.**, paratë që ai kishte paguar do t'i humbnin. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimën dhuruese për organin;
- (17) Gjithashtu **më 19 gusht 2008**, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga **Y.S., K.D., L.D., S.H., S.D.** kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktimja dhuruese V.V., organi i tij (veshka), pastaj u transplantua tek marrësi K.T. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimën dhuruese për

organin;

- (18) *Më 09 shtator 2009, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga Y.S., K.D., S.H. dhe I.B. kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese PM organi i tij (veshka), pastaj është transplantuar tek marrësi B.I.H.. Viktima dhuruese ishte përballur me probleme serioze financiare për shkak të gjendjes së tij familjare dhe ai ishte viktimë e një keqpërdorimi të gjendjes së tij të ndjeshme financiare. Pas një reklame që ai e kishte parë në një faqe interneti ruse , ai kontaktoi një person të panjohur i cili premtoi një pagesë prej 30.000 dollarëve amerikanë për një dhuruar një veshkë. Ai u bind të shkojë në Stamboll për teste të mëtejshme dhe në Stamboll viktima dhuruese takoi Y.S. i cili menaxhoi përgatitjet për një operacion transplantimi në Kosovë. Pas operacionit ai mori 1000 dollarë amerikanë nga vëllai i marrësit personalisht . Dëshmitari i mbrojtur " P.M ", kishte vuajtur shumë pas operacionit dhe ai ndjen keqardhje që kishte rënë dakord që të dhuroj veshkën e tij. Viktima dhuruese kurrë nuk kishte marrë asnjë pagesë për organin e tij ( veshkën) të larguar në klinikën Medicus dhe ai ishte viktimë e mashtrimit;*
- (19) *Më 27 shtator 2008, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga Y.S., L.D., K.D., R., D.J., S.H. dhe S.D. kryen një operacion për largimin e veshkës nga viktima dhuruese M.G. , organi i tij ( veshka), pastaj i është transplantuar marrësit Dëshmitarit të mbrojtur " T2 " . Dëshmitari i mbrojtur marrësi " T2 ", ka deklaruar se ai kishte pasur një transplantim më parë, në vitin 2003 /2004, duke shfrytëzuar shërbimet e M.H., dhe kishte paguar 100,000 dollarë amerikanë në atë kohë. Megjithatë në vitin 2008 ai kishte nevojë për një transplantim të dytë kështu që ai kishte kontaktuar përsëri M.H., nëpërmjet një personi të quajtur A. Dëshmitari i mbrojtur " T2 ", kishte paguar 30.000 NIS tek " A. " dhe pjesën tjetër të parave , që arrijnë në një shumë totale prej 90.000 EUR ai i kishte transferuar nëpërmjet llogarisë së tij bankare tek M.H.. Gruaja e marrësit, Dëshmitari i mbrojtur " T1 ", ka deklaruar se shuma aktuale e paguar për operacionin e dytë për transplantim në vitin 2008 ishte 130.000 euro , e cila ishte transferuar në llogarinë bankare të Kompanisë X në XX . Mjeku i cili e kishte kryer operacionin ishte Y.S. . Provat nuk vërtetojnë nëse ndonjë është bërë pagesa për viktimën dhuruese për organin ;*
- (20) *Më 29 shtator 2008, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga Y.S., D.J., S.H. dhe S.D. kryen një operacion për heqjen e veshkës mbi viktimën dhuruese " R. " MP, organi ( veshkë ) i tij/e saj pastaj i ishte transplantuar marrësit M. N.. Provat nuk vërtetojnë nëse është bërë ndonjë pagesë për viktimën dhuruese për organin;*
- (21) *Më 21 tetor 2008, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga Y.S., D.J., S.H., S.D. kryen një operacion për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese "DS ", me kombësi nga X , organi i tij (veshka),pastaj i ishte transplantuar marrësit D.Z.. Viktima dhuruese ka deklaruar se ai e kishte ndërmarrë këtë procedurë pasi që ai kishte probleme të rënda familjare dhe financiare, si një prind i vetëm dhe ai ishte viktimë e keqpërdorimit të pozitës së tij të ndjeshme financiare. . Ai ishte bindur nga një person i quajtur Y. , kinse ai vet kishte pasur një transplantim të veshkëve si viktimë dhuruese , që të dhurojë veshkën e tij në Kosovë , në këmbim të 20.000 dollarëve amerikanë . Pas kryerjes së operacionit për heqjen e veshkave ai ka marrë vetëm 6000 dollarë amerikanë dhe atij iu kishin premtuar më shumë para vetëm*



nëse ai rekruton "donatorë" tjerë të veshkëve. Pra, ai ishte gjithashtu viktimë e mashtrimit. Në klinikë, ai nuk ishte këshilluar për pasojat e largimit të veshkës dhe ishte detyruar nga A.D. për të nënshkruar letrat e pëlqimit që ai nuk i kuptonte. Hetimi nuk ka mund të përcaktojë shumën e paguara nga ana e marrësit të organit të transplantuar (veshkës);

(22) Më 26 tetor 2008, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga Y.S., K.D., R., L.D., E., S.H., I.B. dhe S.D., kryen një operacion për largimin e veshkës nga viktima dhuruese "AK", organi i tij (veshka), pastaj i ishte transplantuar marrësit R.K. Viktima dhuruese kishte vendosur që të largonte veshkën e tij në mënyrë që të paguante studimet e tij dhe për të ndihmuar babanë e tij të sëmurë dhe ai ishte viktimë e keqpërdorimit të pozitës së tij të ndjeshme financiare. Ai kishte par një shpallje në internet dhe përmes dy ndërmjetësve, J. dhe J. (Y.) atij i ishin ofruar 10.000 euro në këmbim të veshkës së tij. Megjithatë pas operacionit ai kishte marrë vetëm 8000 dollarë amerikanë dhe atij iu premtua pjesa tjetër e parave borxh vetëm pasi ai që ai të ketë rekrutuar 'donatorë' tjerë të veshkëve. Së fundi, ai ishte paguar 500 dollarë nga borxhi i papaguar dhe ishte kërcënuar nga ndërmjetësi i njëjtë J. për të heshtur ose do të vuante pasoja të tmerrshme. Pra, ai ishte gjithashtu viktimë e mashtrimit. Djali i marrësit, Y.K. dëshmoi në gjykatë duke pranuar se babai i tij kishte pasur një operacion për transplantim të veshkës në klinikën në Prishtinë, Kosovë, megjithatë ai nuk e tregoi shumën e parave të paguar për operacionin. Ai përmendi se në ndërkohë babai i tij kishte ndërruar jetë;

(23) Më 31 tetor 2008, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve i përbërë nga Y.S., K.D., L.D., D.J., S.H., I.B. dhe S.D., kanë kryer një operacion për largimin e veshkës tek viktima dhuruese Y.A. organi i tij (veshka) pastaj ishte transplantuar tek marrësi B. SH. Anëtarët e familjes së marrësit, Dëshmitari i mbrojtur "A3" dhe Dëshmitari i mbrojtur "A4" kanë konfirmuar se B.SH. ka paguar 90,000 euro për operacionin e transplantimit të veshkës. Paratë ishin transferuar në llogarinë bankare të M.H. në Turqi. Viktima dhuruese Y.A. ishte rekrutuar në Stamboll nga një ndërmjetës i quajtur I., i cili e kishte siguruar atë se ai do të marrë 20.000 dollarë për veshkën e tij dhe se ai ishte viktimë e keqpërdorimit të pozitës së tij të ndjeshme financiare. Aranzhimet e tij për të udhëtuar në klinikën në Prishtinë u menaxhuan nga M.H.. Pas operacionit dhe në kohën e seancës së veçantë hetuese, asnjëherë viktima dhuruese nuk kishte marrë ndonjë para në këmbim të veshkës së tij dhe për këtë arsye ai ishte viktimë e mashtrimit.

Akuza penale kundër S.H siç përshkruhet në Pikën 1 është ri - kualifikuar sipas nenit 139 paragrafi 4 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) (lehtësimi i pakujdesshëm i veprës penale të trafikimit), dhe bazuar në nenin 2, paragrafi 2, i Kodit Penal të Kosovës (KPK), në lidhje me nenin 389, paragrafi 4, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), **akuza është refuzuar.**

Sepse S.H., si anesteziolog kryesor në Klinikën Medicus, ka ndërvepruar personalisht me shumicën nëse jo me të gjithë donatorët dhe marrësit e përfshirë në 24 operacione të transplantimit të veshkëve gjatë përgatitjes për operacion, dhe prandaj e dinte se ata ishin të gjithë shtetas të huaj. Ky fakt domethënës duhet të ketë ngjallur dyshimin e tij se Klinika ishte e angazhuar në trafikim, dhe duhet të ketë kërkuar informata nga D. në mënyrë që të kuptoj faktet e vërteta. Ai gjithashtu mori pjesë në secilin prej operacioneve, dhe duhet të

ketë njohur se operacionet e transplantimit të veshkëve ishin ilegale në Kosovë , dhe se Klinika nuk kishte asnjë licencë ose autorizim për të kryer këto operacione . Nuk ka asnjë dëshmi se ai në të vërtetë e dinte se trafikimi ishte duke u zhvilluar në Klinikë . Megjithatë , pavarësisht mungesës së tij të njohjes se pasoja të ndalueshme të trafikimit mund të ndodhin nga veprimet e tij , ai duhet të ketë qenë i vetëdijshëm dhe mund të ketë qenë në dijeni të mundësisë të tillë sipas rrethanave dhe sipas karakteristikave të tij personale . Prandaj , ai ka kryer veprën penale të trafikimit me lehtësim nga pakujdesia , si rezultat i lehtësimit të pakujdesshëm sipas nenit 16 (3)KPK.

Sepse, megjithatë, Rishikimi 2013 i Kodit Penal të Kosovës nuk e kriminalizon lehtësimin e pakujdesshëm të trafikimit ,ligji më i favorshëm për kryerësit do të aplikohet , dhe akuza duhet të refuzohet .

Në bazë të nenit 6, neni 11, neni 15 ( 1 ) , neni 23 , neni 274, paragrafi 3 dhe neni 39 , paragrafi 1 dhe 2 i KPK-së, **L.D.** është dënuar me burgim prej 8 (tetë ) vite dhe me gjobë prej 10.000 (dhjetë mijë) euro që do të paguhet jo më shumë se gjashtë muaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Dënimi me burgim është në lidhje me dënimin e shqiptuar në pikën 2.

Në bazë të nenit 6, neni 11, neni 15 ( 1 ) , neni 23 , neni 274, paragrafi 1 , dhe neni 39 , paragrafi 1 dhe 2 i KPK-së , **A.D.** është dënuar me burgim prej shtatë ( 7 ) vite dhe 3 (tre ) muaj dhe gjobë prej 2500 (dy mijë e pesëqind) euro, të cilat duhet të paguhet jo më shumë se gjashtë muaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Dënimi me burgim është në lidhje me dënimin e shqiptuar në pikën 2.

## **Pika 2 , Krimi i Organizuar**

**L.D.** është fajtor për kryerjen e veprës penale të **Krimit të Organizuar** , në kundërshtim me KPK , neni 274 , paragrafi 3.

**Për shkak** se prokurori ka provuar përtej një dyshimi të arsyeshëm se :

Prej ose rreth 1 janar 2008 deri 4 nëntor 2008 në klinikën Medicus , **L.D.** , në cilësinë e tij si kirurg i transplantimit dhe pronar i klinikës Medicus me përgjegjësi të përgjithshme për funksionimin e Klinikës , ka organizuar , themeluar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe drejtuar aktivitetet e grupit të organizuar kriminal që ka ndodhur në Klinikën Medicus . Grupi i organizuar kriminal ishte një grup i strukturuar i përbërë nga tre ose më shumë persona , duke përfshirë **L.D., Y.S. , M.H., A.D., K. D.** dhe të tjerët. Grupi ka ekzistuar për të paktën disa muaj gjatë vitit 2008 , dhe nuk ishte formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë veprë . Grupi u formua me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda në një bazë të vazhdueshme , veçanërisht trafikimit të personave, në kundërshtim me nenin 139 KPK-së , në mënyrë që të marrë , direkt ose indirekt , një përfitim financiar ose material tjetër, me anë të heqjes së organeve ( veshkët ) dhe ti transplantoj tek marrësit të cilët kanë paguar shuma të mëdha parash për veshkët e tyre.

Duke filluar nga marsi 2008 deri në nëntor 2008, heqja e organeve në Klinikën Medicus dhe transplantimi tek marrësit ka përfshirë 24 raste të largimit të organeve dhe transplantimi siç specifikohet në përshkrimin më lart të akuzës së trafikimit në pikën 1 i cili përshkrim është i inkorporuar këtu me referencë. Ky aktivitet ilegal ka ndodhur nën organizimin e përgjithshëm, themelimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e L.D. duke vepruar në marrëveshje me personat e tjerë të përmendur më lart.

**L.D.** dhe grupi i organizuar kriminal kanë fituar dobi pasurore apo përfitime të tjera materiale duke përfshirë pagesa në para të gatshme të kryera drejtpërdrejt në klinikën ME.us, dhe/apo **Y.S.** dhe/ose **M.H.** nga marrësit e organeve (veshkëve) duke përfshirë por duke mos kufizuar në pagesat vijuese me para të gatshme:

- (1) Nga Dëshmitari i mbrojtur "T3" shumën prej 100,000 dollarë amerikan
- (2) Nga Dëshmitari i mbrojtur "T4" shumën prej 70,000 EUR
- (3) Nga Dëshmitari i mbrojtur M2 shumën prej 108,000 dollarë amerikan
- (4) Nga Dëshmitari i mbrojtur A1 shumën prej 79,000 EUR
- (5) Nga T.S. shumën prej 25,000 EUR
- (6) Nga R.F. shumën prej 80,000 EUR
- (7) Nga Dëshmitari i mbrojtur "M1" shumën prej 77,000 EUR
- (8) Nga Dëshmitari i mbrojtur "T2" shumën prej 130,000 EUR
- (9) Nga B.SH. shumën prej 90,000 EUR.

Në bazë të nenit 6, neni 11, neni 15 ( 1 ) , neni 23 , neni 274, paragrafi 3 dhe neni 39 , paragrafi 1 dhe 2 i KPK-së, **L.D.** është dënuar me burgim prej 8 (tetë ) vite dhe me gjobë prej 10.000 (dhjetë mijë) euro që do të paguhet jo më shumë se gjashtë muaj pasi që vendimi të merr formën e prerë. Dënimi me burgim është në lidhje me dënimin për trafikim në pikën 1.

### **Pika 3 , Krimi i Organizuar**

**A.D.** është fajtor për kryerjen e veprës penale të **Krimit të Organizuar** , në kundërshtim me KPK , neni 274 , paragrafi 3.

**Për shkak se**, prokurori ka provuar përtej një dyshimi të arsyeshëm se :

Prej ose rreth 1 janar 2008 deri me 4 nëntor 2008 në klinikën Medicus , **A.D.** , në cilësinë e tij si drejtor/menaxher në klinikën Medicus me qëllim të kryerjes së një apo më shumë krimeve serioze , ka kryer veprën e trafikimit me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 KPK , në mënyrë të vazhdueshme , veçanërisht trafikimit të personave, në kundërshtim me nenin 139 të KPK-së , në mënyrë që të marrë , direkt ose indirekt , një përfitim financiar ose material tjetër , me anë të heqjes së organeve ( veshkët ) dhe ti transplantoj tek marrësit .

**A.D.** dhe grupi i organizuar kriminal kanë fituar dobi pasurore apo përfitime të tjera materiale duke përfshirë pagesa në para të gatshme të kryera drejtpërdrejt në klinikën Medicus, dhe/ose **Y.S.** dhe/ose **M.H.** nga marrësit e organeve (veshkët).

- (1) Nga Dëshmitari i mbrojtur "T3" shumën prej 100,000 dollarë amerikan
- (2) Nga Dëshmitari i mbrojtur "T4" shumën prej 70,000 EUR

- (3) Nga Dëshmitari i mbrojtur M2 shumën prej 108,000 dollarë amerikan
- (4) Nga Dëshmitari i mbrojtur A1 shumën prej 79,000 EUR
- (5) Nga T.S. shumën prej 25,000 EUR
- (6) Nga R.F. shumën prej 80,000 EUR
- (7) Nga Dëshmitari i mbrojtur "M1" shumën prej 77,000 EUR
- (8) Nga Dëshmitari i mbrojtur "T2" shumën prej 130,000 EUR
- (9) Nga B.SH. shumën prej 90,000 EUR.

Në bazë të nenit 6, neni 11, neni 15 ( 1 ) , neni 23 , neni 274, paragrafi 1 , dhe neni 39 , paragrafi 1 dhe 2 i KPK , **A.D.** është dënuar me burgim prej shtatë (7 ) vite dhe 3 (tre ) muaj dhe gjobë prej 2500 (dy mijë e pesëqind) euro, të cilat duhet të paguhen jo më shumë se gjashtë muaj pasi që vendimi të merr formën e prerë. Dënimi me burgim është në lidhje me dënimin për trafikim në pikën 1.

**S.H.** është liruar nga akuza për veprën penale **Krim i Organizuar**, në kundërshtim me nenin 274, paragrafi 1 KPK, i kryer në **Bashkëkryerje**, neni 23.

Sepse në pajtim me nenin 390, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), prokurori nuk ka provuar se i akuzuari ka kryer veprën për të cilën është akuzuar.

#### **Pika 4, Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore,**

Akuza **Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore**, në shkelje të KPK-së, neni 221 paragrafi 1, i dënueshëm me gjobë apo burgim deri në një vit, i kryer në **Bashkëkryerje**, neni 23 i KPK-së kundër **L.D., D.J., I.B., S.D. dhe S.H** refuzohet.

Sepse, sipas nenit 389, paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) në lidhje me nenin 90, paragrafi 1, nën-paragrafi 6 dhe neni 91, paragrafi 6 i KPK-së, ka skaduar periudha e parashkrimit.

#### **Pika 5, Keqpërdorim i pozitës zyrtare ose autoritetit,**

Akuza **Keqpërdorim i pozitës zyrtare ose autoritetit** në shkelje të KPK-së, neni 339, paragrafi 1, kundër **D.J.** është ri-cilësuar si **Keqpërdorim i pozitës zyrtare ose autoritetit** në kundërshtim me nenin 339, paragrafi 3 **është refuzuar.**

**Sepse**, sipas nenit 389, paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) në lidhje me nenin 90, paragrafi 1, nën-paragrafi 6 dhe neni 91, paragrafi 6 i KPK-së, ka skaduar periudha e parashkrimit.

#### **Pika 6, Keqpërdorim i pozitës zyrtare ose autoritetit,**

**Lirohet I.R.R.** nga akuza e keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autoritetit në shkelje të nenit 339 paragrafi 3, KPK,

**Sepse**, sipas nenit 390, paragrafi 1 nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ai është akuzuar.

**Pika 7, Lëndime të Rënda Trupore,**

Në pajtim me nenin 389, paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), akuza a Lëndimeve të Rënda Trupore të KPK-së **refuzohet** kundër **L.D.**

**Sepse**, në pajtim me nenin 389 , paragrafi 4 , ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale , përkatësisht se kjo akuzë përbën një element të trafikimit me njerëz.

**A.D. lirohet** nga akuza e *Lëndimeve të Rënda Trupore në Bashkëkryerje* , neni 154, paragrafi 1 , nënparagrafi 2 , dhe neni 23 , KPK-së ,

**Sepse**, në pajtim me nenin 390 , paragrafi 3 , i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës , nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ai ka qenë i akuzuar.

Akuza penale e *Lëndimeve të Rënda Trupore* kundër **S.H , I.B., S.D.** është kualifikuar sipas nenit 154 , paragrafi 1 , nënparagrafi 2 i KPK-së : shkatërrim ose dobësim i përhershëm dhe i ndjeshëm i një organi vital ose një pjese vitale të trupit të personi tjetër.

**S.H., I.B., S.D.** janë fajtorë për kryerjen e veprës penale të *Lëndimeve të Rënda Trupore* në kundërshtim me KPK , neni 154 , paragrafi 1 , nënparagrafi 2 i KPK-së.

**Për shkak se** prokurori ka provuar përtej një dyshimi të arsyeshëm se ,

Prej 08 mars 2008 deri 4 nëntor 2008 në Klinikën Medicus, **S.H.** në cilësinë e tij si anesteziolog kryesor , **I.B.** në kapacitetin e tij si anesteziolog dhe **S.D.** në kapacitetin e tij si anesteziolog, kanë marrë pjesë me vetëdije në procedurat mjekësore të cilat ishin të paligjshme sipas ligjeve të Kosovës , përkatësisht heqjen e organeve ( veshkët ) për transplantim . Këto heqje të paligjshme të veshkëve kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore mbi viktimat dhuruese, gjegjësisht dhe dobësim të dukshëm dhe të përhershëm të një organi vital .

Personat e mëposhtëm kanë pësuar dëmtime të rënda trupore me heqjen e veshkave të tyre për transplantim . Viktimat 3, 7 , 13 , 19 , 22, 23 dhe 24 kanë paraqitur prova në shqyrtimin gjyqësor , dhe është provuar se ata ishin viktima të heqjes së paligjshme të veshkëve . Personat e tjerë të listuar nuk kanë dëshmuar , por edhe ata ishin viktima të heqjes së paligjshme të veshkëve për transplantim , dhe po ashtu kanë pësuar lëndime të rënda trupore . Çdo pëlqim që viktima ka mundur të ketë dhënë është ligjërisht e parëndësishme , sepse një person nuk mund të japë pëlqimin për një procedurë të paligjshme mjekësore.

- (1) T.” mbiemri i panjohur (MP) me shtetësi të panjohur;
- (2) “R. ” MP me shtetësi të panjohur;
- (3) Dëshmitari i mbrojtur“W2” ;
- (4) M.Y.
- (5) Emri dhe mbiemri i panjohur (EP) MP me shtetësi të panjohur;
- (6) EP MP me shtetësi të panjohur;

- (7) Dëshmitari i mbrojtur "W1" ;
- (8) A.M. me shtetësi të panjohur;
- (9) "A." MP me shtetësi të panjohur;
- (10) EP MP me shtetësi të panjohur;
- (11) E.M.
- (12) A.G.
- (13) A.R.
- (14) Dëshmitari i mbrojtur "W3";
- (15) Y.C.
- (16) A.A.
- (17) J.S. me shtetësi të panjohur;
- (18) V.V.
- (19) Dëshmitari i mbrojtur "PM"
- (20) G. M.
- (21) "R" MP me shtetësi të panjohur ;
- (22) Dëshmitari i mbrojtur "DS"
- (23) Dëshmitari i mbrojtur "AK"
- (24) Y.A.

Në bazë të nenit 6, neni 11, neni 15 ( 2 ) , neni 154 , paragrafi 1 , nënparagrafi 2 i KPK-së, **S.H.** është dënuar me burgim për 3 (tre ) vite ; S.D. dhe I.B. janë dënuar me burgim për 1 ( një) vit.

Në pajtim me nenin 41 , paragrafin 1 , nënparagrafi 1 , artikujt 42 , 43 dhe 44 ( 1 ) , ( 2 ) dhe ( 3 ) të KPK , është aplikuar dënimi me kusht mbi **S.D.** dhe **I.B.** ;dënimi nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit nuk kryejnë ndonjë veprë tjetër penale për periudhën prej 2 (dy) viteve .

#### **Pika 8 , *Mashtrim* ,**

Në bazë të nenit 389 , paragrafi 4 , i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ,akuza ***Mashtrim*** në kundërshtim me nenin 261 , paragrafi 2 i KPK-së kundër **L.D.** dhe **A.D.** **refuzohet.**

Për shkak se kjo akuzë përbën elementin e trafikimit të personave nën pikën 1.

#### **Pika 9 , *Falsifikim i dokumenteve,***

Akuza, ***Falsifikim i dokumenteve*** , në kundërshtim me KPK , neni 332 , paragrafi 1, kundër **L.D.** dhe **A.D.**si një akuzë e veçantë **refuzohet,**

**Sepse,** në pajtim me nenin 389 , paragrafi 4 , të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës , në lidhje me nenin 90 , paragrafi 1 , nënparagrafi 6 dhe neni 91 , paragrafi 6 , i KPK-së, ka skaduar afati i parashkrimit.

#### **Pika 10 , *Falsifikimi i dokumenteve zyrtare* ,**

Akuza ***Falsifikimi i dokumenteve zyrtare*** , në kundërshtim me KPK , neni 348 , paragrafi 1 ,

kundër **I.RR.** është refuzuar,

**Sepse**, në pajtim me nenin 389 , paragrafin 4 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës , në lidhje me nenin 90 , paragrafi 1 , nënparagrafi 5, i KPK-së,afati i parashkrimit ka skaduar .

### **Dënimet plotësuese**

Në bazë të nenit 57 , paragrafi 1 dhe 2 i KPK-së, **L.D.** është i ndaluar nga ushtrimi i profesionit të urologut për periudhën prej 2 ( dy) viteve duke filluar nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në bazë të nenit 57 , paragrafi 1 dhe 2 i KPK-së, **S.H.** është i ndaluar nga ushtrimi i profesioni të anesteziologut për periudhën prej 1 ( një) viti duke filluar nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

### **Kompensimi i pjesshëm**

Në bazë të nenit 112 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK ) palët e dëmtuara vijuese W1 , W2 , W3 , PM , DS , AK dhe Y.A. secili kompensohet pjesërisht për dëmet psikologjike dhe fizike të pësuar gjatë largimit të veshkëve në shumën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) Euro nga **L.D.** dhe **A.D.** që duhet të paguhet jo më shumë se 6 ( gjashtë) muaj duke filluar nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

### **Shpenzimet**

Në pajtim me nenin 100 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK ) do të lëshohet një vendim i veçantë mbi shpenzimet e procedurës.

## **ARSYETIMI**

### **1. Historiku i procedurës – Aktakuza**

Aktivitetet kriminale të pretenduara në aktakuzë u zhvilluan në vitin 2008. Hetimi i këtyre aktiviteteve ka filluar me 4 nëntor 2008. Me 12 nëntor 2008 është lëshuar aktvendimi mbi iniciimin e hetimeve.

Më 15 tetor 2010, ishte ngritur Aktakuza PPS 41/ 09 që akuzonte L.D., A.D. , D.J. , I.RR. dhe S.H. me disa krime. Më 20 Tetor 2010 ishte ngritur Aktakuza PPS 107/10 e cila akuzonte I.B. dhe S.D. me disa krime lidhur me këto . Aktakuzat u bashkuan më 29 nëntor 2010.

Më 14 dhjetor 2010 dhe 6 janar 2011 Gjyqtari i EULEX-it Vitor Pardal mbajti seancën e konfirmimit. Më 31 janar 2011, Gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës nxori një Aktvendim sipas Neneve 154 dhe 316 (5) të KPPK ku ai vendosi se disa prova të caktuara të prokurorisë ishin të papranueshme. Më 27 prill 2011 trupi gjykues prej tre gjyqtarëve vendosi mbi ankesën e parashtruar nga ana e Prokurorit dhe avokatit mbrojtës dhe ka konfirmuar

aktakuzën në tërësi. Duke vepruar kështu, trupi gjykues vendosi se të gjitha provat e kontestuara ishin të pranueshme.

Gjykimi kryesor filloi më 4 tetor 2011. Trupi kryesor i gjykimit ishte i përbërë nga Kryetari i trupit gjykues nga radhët e EULEX-it, gjyqtari Arkadiusz Sedek së bashku me gjyqtarin e EULEX-it Dean Pineles dhe gjyqtarin kosovar Hamdi Ibrahim. Gjyqtari kosovar Hamdi Ibrahim më vonë u zëvendësua nga gjykatësi Vahid Halili më 18.05.2012 kur gjyqtar Ibrahim ishte emëruar si kryetar i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. Gjyqtari Halili ishte familjarizuar plotësisht me lëndën para se të fillojë ushtrimin e funksionit.

Dëshmitarët vijues ishin dëgjuar:

1. Dëshmitari AK 05.10.2011, 06.10.2011, 18.10.2011 .
2. Dëshmitari D.S. 11.10.2011, 12.10.2011.
3. C.B. 12.10. 2011, 13.09.2012, 14.11.2012, 08.03.2013.
4. F.H. 18.10.2011
- 5.F.M. 18.10.2011,19.10.2011
- 6.Z.K. 19.10.2011
- 7.O.K. 19.10.2011
- 8.SH.O. 20.10.2011
- 9.O.M. 20.10.2011
- 10.R.A. 20.10.2011
- 11.B.G. 20.10.2011, 25.10.2011
- 12.S.B.1 25.10.2011
- 13.A.G. 25.10.2011
14. SH.H1 25.10.2011
- 15.A.G. 25.10.2011
- 16.SH.G. 09.11.2011
- 17.B.SH.1 09.11.2011
- 18.F.B. 09.11.2011
- 19.Y.E. 10.11.2011
- 20.SH.M. 10.11.2011
- 21.H.K. 10.11.2011
- 22.A.G. 10.11.2011
- 23.M.M. 15.11.2011
- 24.T.P. 15.11.2011
- 25.D.SH1. 17.11.2011
- 26.E.P. 17.11.2011
- 27.S.H.2 17.11.2011
- 28.N.S. 22.11.2011
- 29.S.D. 22.11.2011
- 30.E.S. 22.11.2011
- 31.A.A.1 29.11.2011
- 32.I.A. 29.11.2011



33.S.XH.	29.11.2011
34.R.D.	29.11.2011
35.T.B.	29.11.2011
36.A.G.	30.11.2011,19.12.2011
37.A.A.1	19.12.2011
38.N.Q.	20.12.2011
39.E.P.	20.12.2011
40.Y.K.	06.02.2012
41.SH.M.	13.02.2012
42. M.G.	16.03.2012
43.T.S.	22.03.2012
44.D.G.	22.03.2012
45.N.H.	23.03.2012
46.R.F.	23.03.2012
47.ZH.ZH.	04.04.2012
48.SH.H3.	05.04.2012
49.A.R.	24.05.2012
50.K.U.	13.06.2012
51.Dëshmitari W1	14.06.2012
52.Dëshmitari W2	14.06.2012
53.Dëshmitari W3	14.06.2012
54.Dëshmitari M1	18.06.2012
55.Dëshmitari M2	18.06.2012
56.Dëshmitari M3	18.06.2012
57.Dëshmitari T1	19.06.2012
58.Dëshmitari T2	19.06.2012
59.Dëshmitari T3	19.06.2012
60.Dëshmitari T4	19.06.2012
61.Dëshmitari A1	20.06.2012
62.Dëshmitari A2	20.06.2012
63.Dëshmitari A3	20.06.2012
64.Dëshmitari A4	20.06.2012
65.Dëshmitari B1	21.06.2012
66.E.D.	24.07.2012
67.F.B.	24.07.2012
68.SH.SH.1	24.07.2012
69. M.K.	04.09.2012
70. D.R.SH.	06.09.2012, 07.09.2012, 26.11.2012
71.D.G.	11.09.2012
72.D.I.	11.09.2012
73.O.V.	25.09.2012
74.J.D.	25.09.2012
75.M.B.	09.10.2012
76. N.H.	16.11.2012

77.M.T.	29.01.2013,12.02.2013,26.02.2013
78.K.D.	11.02.2013
79.Dëshmitari PM	12.02.2013
80.C.B.	08.03.2013
81. B.G.	08.03.2013

Më 3, 5, 10 dhe 12 prill 2013 të pandehurit ishin marr në pyetje. Të pandehurit L.D. dhe A.D. janë mbrojtur në heshtje.

Më 16, 17, 19, 23 dhe 24 prill 2013 Prokuroria, avokatët mbrojtës dhe të pandehurit i kanë paraqitur argumentet përmbyllëse dhe kundërshtimet e tyre.

Pas kësaj Trupi gjykues u tërhoq për të diskutuar dhe më 29 prill, aktgjykimi ishte shpallur në seancën publike të gjykatës.

## **II . Kompetenca e Gjykatës**

Në bazë të nenit 23, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Gjykatat e Qarkut kanë juridiksion për të gjykuar në shkallë të parë veprat penale të dënueshme me burgim prej së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

Kjo kërkesë e juridiksionit është plotësuar në akuzat këtu. Gjithashtu sipas aktakuzës, veprat penale kanë ndodhur në Fushë Kosovë ku gjendet Klinika Medicus dhe ku është bërë transplantimi i veshkëve. Kështu që në bazë të nenit 27 paragrafi 1 i KPPK-së, Gjykata e Qarkut të Prishtinës( tani Gjykata Themelore) ka kompetencë territoriale për ta gjykuar këtë rast. Kështu që, seanca kryesore është mbajtur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri mbi Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199), Gjykata Themelore e Prishtinës mori juridiksionin mbi rastin. Gjithashtu, në përputhje me një vendim nga Gjykata Supreme e cila pajtoi mospërputhjet e caktuara në dispozitat kalimtare të Kodit të ri Penal dhe të Kodit të ri të Procedurës, rasti ka vazhduar të gjykohen sipas Kodeve të mëparshme.

Në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (në tekstin e mëtejme LJ), Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurë penale kanë juridiksion dhe kompetencë për çdo lëndë të hetuar apo ndjekur penalisht nga PSRK-ja. Rasti i tanishëm është i paraqitur nga Prokurori i PSRK-së, prandaj, në përputhje me nenin 4.7 të LJ, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut (tani Gjykata Themelore) ishte i përbërë nga një trup gjykues i përbërë nga dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor.

Më herët në seancën kryesore mbrojtja e kundërshtoi përbërjen e trupit gjykues. Avokatët L.D. dhe A.T. deklaruan se kryetari i trupit gjykues Arkadiusz Sedek kishte marrë pjesë në lëndë në fazën e seancës paraprake duke e zgjatur aktvendimin mbi hetimin dhe kështu duhet të përjashtohet nga gjykimi. Çështja u trajtua nga ushtruesi i kryetarit të

Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it Charles Smith i cili konstatoi se nuk kishte asnjë arsye për diskualifikim, kështu që kërkesa u refuzua.

### **III . Provat materiale**

Provat materiale ishin administruar gjatë seancës kryesore me iniciativën e palëve dhe të trupit gjykues *ex officio* dhe ishin pranuar nga gjykata. Provat e propozuara nga prokurori, të paraqitura në Shtojcën 1, dhe nga avokati mbrojtës në Shtojcën 2. Shtojca 3 përbëhet nga diagrame mjekësore të përgatitura nga mjekët e mjekësisë ligjore C.B. dhe D.S.

#### **A. Kundërshtimet lidhur me administrimin e provave dhe aktvendimet e Gjykatës:**

**1. F.V.**, avokati mbrojtës i I.RR. ka kundërshtuar administrimin e letrës dublikate të datës 12 maj 2008, që supozohet të jetë shkruar, nënshkruar dhe vulosur nga klienti i tij, me bazën se letra origjinale asnjëherë nuk ishte gjetur. Gjykata e ka refuzuar këtë kundërshtim sepse një dublikat i besueshëm është i pranueshëm sipas rregullës së aplikueshme të pranueshmërisë. Për më tepër, gjatë ekzaminimit të tij, I.RR. e ka pranuar se ai e ka shkruar atë letër dhe ai e ka konfirmuar përmbajtjen ashtu siç duket në versionin dublikatë. Prandaj, kundërshtimi ishte refuzuar.

**2. I.SH.**, avokat mbrojtës për D.J., ka kundërshtuar administrimin e të gjitha provave në lidhje me klientin e tij të cilat janë marrë gjatë hetimit me bazën se D.J. në atë kohë kishte imunitet për shkak të punësimit të tij në OSBE. Gjykata ka refuzuar këtë kundërshtim sepse imuniteti i J. i ishte marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për të gjitha qëllimet në lidhje me këtë rast duke përfshirë edhe fazën e hetimit. Gjykata është e mendimit se Sekretari i Përgjithshëm e ka kompetencën ekskluzive në lidhje me këtë. Prandaj, ky trup gjykues nuk ka pasur asnjë kompetencë për të vënë në dyshim vendimin e pavarur dhe sovran të Sekretarit të Përgjithshëm. Prandaj, kundërshtimi ishte refuzuar. Ky argument gjithashtu ishte ngritur si mbrojtje kundër akuzave dhe ngjashëm ishte refuzuar.

**3. A.O.**, zëvendës avokat mbrojtës për L.D., ka kundërshtuar të gjitha dëshmitë kundër klientit të tij me bazën se kontrolli i Klinikës Medicus ishte jo ligjor dhe se të gjitha provat e marra gjatë kontrollit ishin të papranueshme. Më 12 dhjetor 2011 Gjykata ka lëshuar një aktvendim verbal ku deklaroi se kontrolli ishte ligjor. Megjithatë, gjykata e ka rezervuar të drejtën që të rishikoj çështjen në fund të gjykimit dhe këtë e ka bërë në diskutimin e hollësishëm më poshtë me të cilën vërtetohen aktvendimi i mëhershëm. Prandaj, kundërshtimi ishte refuzuar.

**4. L.D.**, mbrojtës i D., gjithashtu kundërshtoi administrimin dhe pranueshmërinë e çdo prove të marrë pas datës së përfundimit të hetimit, të cilën ai e ka deklaruar si datën 12 maj 2009.

Megjithatë, sipas nenit 322, KPPK, palët mund të kërkojnë dëshmitarë të ri ose dëshmitarë ekspert që të ftohen ose të merren dëshmi të reja ndoshta edhe pas caktimit të shqyrtimit kryesor. Kërkesa duhet të mbështetet me arsyetim. Nëse kërkesa refuzohet, ajo mund të përsëritet gjatë shqyrtimit kryesor.

Gjithashtu, sipas nenit 360 (4), palët mund të nxisin që faktet e reja të shikohen dhe dëshmitë e reja të mblidhen deri në fund të shqyrtimit kryesor. Sipas paragrafit (5) trupi gjykues ka

autoritetin për mbledhjen e dëshmive që ajo i konsideron të nevojshme për një vërtetim të drejtë dhe të plotë të rastit.

Të gjitha kërkesat për prova shtesë dhe dëshmitarë bien mbi njëërën prej këtyre kategorive. Në përputhje me rrethanat, kundërshtimi ishte refuzuar. Është e pakontestueshme se shqyrtimi kryesor nuk është thjesht vetëm një administrim i thjeshtë i provave të mbledhura gjatë hetimit; palët kanë të drejtë të propozojnë prova të reja dhe trupi gjykues është i obliguar që të vërtetojë të gjitha aspektet faktike të rastit të cilat mund të përfshijnë mbledhjen e provave ex officio.

**5. Avokatët mbrojtës për L.D., A.D. dhe I.R.R. kanë kundërshtuar administrimin e përmbajtjes së mesazheve SMS të marra nga prokurori prej kompanisë së telekomunikacionit VALA. Gjatë hetimit prokurori i atëhershëm ka lëshuar një urdhër për regjistrimin e thirrjeve telefonike në pajtim me nenin 258 (1), nën-paragrafi 4 i KPPK-së. Urdhri posaçërisht ka përjashtuar informatën në lidhje me përmbajtjen e thirrjeve ose mesazheve.**

Ky urdhër i ishte drejtuar VALA-së e cila i ishte përgjigjur urdhrin duke i ofruar jo vetëm informata të regjistrimit por gjithashtu kishte ofruar informata përmbajtësore në lidhje me disa mesazhe SMS. Gjykata e ka pranuar këtë kundërshtim për shkak se informatat përmbajtësore mund të zbulohen vetëm pas një urdhri të gjyqtarit të procedurës paraprake sipas nenit 258 (2), nën-paragrafi 4, KPPK, dhe kështu dëshmia është e papranueshme sipas nenit 264 (1).

Pasi që prokurori i tanishëm kryesor e ka kuptuar se përmbajtja e shkëmbimit të telekomunikimeve mund të jetë e rëndësishme për rezultatin e gjyimit, ai ka paraqitur kërkesën për të marrë informatat e përmendura. Edhe pse kërkesa ishte pranuar nga trupi gjykues, ofruesit e shërbimeve telefonike IPKO dhe VALA janë përgjigjur se të dhënat e kërkuara nuk janë më në dispozicion për shkak të kalimit të kohës, meqë sipas dispozitave të aplikueshme ligjore në ligjin e telekomunikimeve kompania është e obliguar të i ruaj dhe administrojë kësi të dhëna të ndjeshme vetëm për një kohë të caktuar e cila tashmë ka kaluar.

Kështu, për shkak se zbulimi fillestar i përmbajtjes së informacionit nga Vala nuk ishte autorizuar nga gjyqtari i procedurës paraprake, dhe për shkak se urdhri i mëvonshëm i trupit gjykues nuk mund të përmbushej, trupi gjykues konkludoi se përmbajtja e informacionit ishte e papranueshme, dhe ka lejuar kundërshtimin. Megjithatë, prova e regjistrimit të thirrjeve telefonike është e pranueshme. Prokurori kishte autoritetin për të urdhëruar regjistrimin e bisedave telefonike sipas nenit 258 (1), nënparagrafi 4, KPPK, pa pëlqimin paraprak të gjyqtarit të procedurës paraprake.

#### **IV. Parathënie e përgjithshme**

Ky rast, i cili kryesisht referohet si rasti “Medicus”, përmban akuza për trafikim me njerëz, krim të organizuar, ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore, shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit, lëndime të rënda trupore dhe vepra tjera penale të cilat lidhen me transplantimin ilegal të veshkëve që kanë ndodhë në Klinikën Medicus, me lokacion në Fushë Kosovë në vitin 2008.

## **A. Të pandehurit**

Të gjithë të pandehurit përveç A.D., janë mjekë. L.D. i cili konsiderohet si i pandehuri kryesor, është një urolog i cili profesionin e tij e ka ushtruar në Klinikën Medicus, një klinikë private e shëndetësisë në Fushë Kosovë, e cila ka ofruar edhe shërbime urologjike dhe të kardiologjisë. Tani ai është profesor i mjekësisë në Universitetin e Prishtinës dhe e ushtron profesionin e urologut në Spitalin e Universitetit të Prishtinës. S.H., S.D. dhe I.B. janë anesteziologë të cilën kanë punuar me gjysmë orari në Klinikën Medicus në kohën në fjalë—2008. Në vitin 2008 D.J. ishte mjekë i punësuar në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë(OSBE) në Prishtinë. I.R.R., edhe ai mjek, ishte Ushtrues Detyre i Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë. A.D., i cili është i biri i L.D., me profesion është ekonomist. Ai ishte i punësuar në Klinikën Medicus si menaxher dhe kontabilist dhe në vitin 2008 ai kishte përgjegjësi të rëndësishme të udhëheqjes.

## **B. Mbarëvajtja e gjykimit**

Gjykimi kryesor është mbajtur më 4 tetor 2011 dhe ka përfunduar me shpalljen e aktgjykimit më datën 29 prill 2013, për një periudhë prej pothuajse 19 muajve. Gjatë asaj kohe gjykata ka mbajtur 67 seanca gjyqësore, ka dëgjuar dëshminë e 78 dëshmitarëve të ndryshëm dhe i ka shqyrtuar mijëra faqe të dokumenteve dhe i ka marr parasysh disa mendime dhe raporte të ekspertëve.

## **C. Fushëveprimi ndërkombëtar**

Rasti është i nivelit dhe vëmendjes ndërkombëtare, dhe përfshinë këto shtete: Kanada, Shtetet e Bashkuara, Kazakistan, Bjellorusi, Ukrainë, Federata Ruse, Moldavi, Poloni, Turqi, Izrael, Gjermani, Zvicër dhe Kosovë. Kërkesat për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare të cilat ishin lëshuar nga prokurori dhe gjykata dhe të cilat ishin proceduar nga Ministria e Drejtësisë së Kosovës, ishin përcjellë në këto shtete të huaja nëpërmjet kanaleve diplomatike për paraqitjen e këtyre provave materiale dhe dëshmitarëve si vijon. Kërkesa për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare ishte paraqitur edhe në Këshillin e Evropës, në kërkim të dëshmisë së D.M.

Kërkesat për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare

1. Zvicër, 26 shtator 2011
2. Gjermani, 1 shtator 2011,
3. Kanada ,22 gusht 2011
4. Ukraine, 11 gusht 2011
5. Rusi, 11 gusht 2011
6. Moldavi, 11 gusht 2011,
7. Poloni, 11 gusht 2011, 2 shkurt 2012,
8. SHBA, 17 gusht 2011
9. Turqi ,16 gusht 2011
10. Izrael, 16 gusht 2011, 9 shkurt 2012,

Përveç Moldavisë, Federatës Ruse, Këshillit të Evropës dhe Zvicrës, të gjitha kërkesat kanë qenë në pajtim, si në tërësi ashtu dhe pjesërisht. Në disa instanca bashkëpunimi ka ardhur ngadalë, duke kërkuar përkujtime të përsëritshme nga gjykata, prokurori dhe zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë. Këto kanë shkaktuar vonesa të shumta në gjykim. Në instancat e tjera bashkëpunimi ishte i pjesshëm për shkak të rrezikimit të hetimeve në procedurë apo

gjykimeve që përfshinin aktivitete kriminale të ngjashme në shtetet e kërkuara si në Izrael dhe Turqi apo për ndonjë arsye tjetër.

Moldavia ka refuzuar bashkëpunimin sepse nuk e ka njohur Kosovën. Për një kohë dukej se Federata Ruse do të bashkëpunoj dhe të ofroj dëshminë për dhurues të mundshëm të veshkëve të cilët jetojnë në Rusi, por edhe përkundër përpjekjeve për ndihmë të Zyrës së Prokurorit për Krime të Luftës në Beograd, Serbi, Federata Ruse nuk ka bërë hap përpara. Nga Zvicra ishte kërkuar që të paraqes disa të dhëna bankare, nëse ato kanë ekzistuar por ishte e pamundur të kryhej para përfundimit të seancës kryesore, me sa duket për shkak të ligjeve për fshehtësi të madhe që administrojnë bankat zvicerane. Këshilli i Evropës dhe Zvicra gjithashtu kanë refuzuar që D.M. të jetë i gatshëm si dëshmitar, siç shpjegohet më hollësisht më poshtë.

#### **D. Pamundësia e gjykatës për të marrë dëshmi nga Dëshmitarët e rëndësishëm**

##### **1. Y.S.**

Gjykata e kishte të pamundur të marr dëshminë e Y.S., shtetas i Turqisë i cili ka udhëhequr operacionin në shumicën prej tyre, nëse jo në të gjitha, të transplantimit ilegal të veshkëve që kanë ndodhur në Klinikën Medicus, dhe një pjesëmarrës kryesor në aspektet e trafikimit dhe krimit të organizuar të këtij rasti. S. konsiderohet të jetë një pjesëmarrës kryesor në trafikimin ndërkombëtar të veshkëve të njeriut. Ai ishte ndjekur me aktakuza të ndara në Kosovë dhe tani në Turqi ndiqet për veprimtari të ngjashme joligjore. Ai nuk ka mundur të ekstradohet nga Turqia në Kosovë dhe tani vendndodhja e tij është e pasigurt.

##### **2. K.D.**

Në të njëjtën mënyrë, gjykata e kishte të pamundur të merrte dëshminë e K.M., mjek turk i cili ka lindur në Kosovë por jeton dhe vepron në Turqi. Dëshmitë tregojnë bindshëm se D. në mënyrë aktive ka marrë pjesë në shumë operacione të transplantimit të veshkëve në Klinikën Medicus me S. dhe të tjerët gjatë periudhës në fjalë. Ai gjithashtu është i ndjekur bashkë me S. në Turqi. Fillimisht ai ka pranuar të jap dëshminë përmes video lidhjes por në momentin e fundit kur është rregulluar lidhje përmes videos ai ka refuzuar të bëjë këtë.

##### **3. M.H.**

Gjykata gjithashtu e ka pasur të pamundur të marrë dëshminë e M.H., një qytetar i XX, i cili në mënyrë aktive ka marrë pjesë në aspektet e trafikimit dhe krimit të organizuar në këtë rast. Ai ishte njëri nga personat kryesor përgjegjës për kryerjen e marrëveshjeve financiare dhe logjistike për dhuruesit dhe pranuesit e veshkëve, dhe ai ka luajtur rolin e ndihmësit ose "rregulluesit". Në disa raste ai i ka shoqëruar dhuruesit dhe pranuesit nga Stambolli për Prishtinë dhe kohë pas kohe ishte fizikisht i pranishëm në Klinikën Medicus. Së bashku me S. ai është ndjekur ndaras penalisht në Kosovë dhe tani është nën hetim kriminal në XX. Pas një kohe të shkurtë kur Klinika Medicus ishte bastisur në Nëntor të vitit 2008, H. ka dhënë deklaratën në polici dhe te gjyqtari i procedurës paraprake. Ai ishte lëshuar nga paraburgimi me kushtin që ai të kthehet në Kosovë nëse urdhërohet, por pastaj iku.

##### **4. A.S. dhe M.Z.**

S. dhe Z. janë dy qytetarë nga XX të cilët kanë rekrutuar marrës të mundshëm të veshkëve në XX dhe pastaj i kanë kryer marrëveshjet financiare dhe logjistike për udhëtimin e marrësve

për në Kosovë. Z. gjithashtu ka shoqëruar disa marrës të veshkëve për në Kosovë dhe i ka ndihmuar ata me qëndrim në Kosovë. Që të dy burrat janë nën hetim penal në Izrael.

## 5. Y.K.

Nga ky trup gjykues ishte konfirmuar se K. ka rekrutuar së paku dhuruesin "AK" dhe ka bërë marrëveshjet financiare dhe logjistike për udhëtimin e tij për në Stamboll në udhëtimin e tij të parë për në Kosovë. Siç duket K. ishte gjykuar dhe dënuar në Ukrainë për veprimtari të ngjashme dhe ai po vuan dënimin me burg. Zyra e Prokurorit në Kiev ka bashkëpunuar me kërkesën për Ndhimë Juridike Ndërkombëtare dhe ka rregulluar video lidhjen për dëshmi për K. por K. ka refuzuar të jap dëshminë në atë kohë.

## 6. D.M.

Gjithashtu, fatkeqësisht, gjykata nuk e ka marrë bashkëpunimin me Këshillin e Evropës dhe Zvicrën në lidhje me ftesën për D.M. Për shkak të publicitetit ndërkombëtar që e rrethon Z. M. dhe raportin e tij, trupi gjykues do të adresoj këtë çështje me hollësi më të mëdha.

Më 12 dhjetor 2010, Senatori D.M. nga Zvicra, anëtarë i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, dhe Raportues për Komisionin për Punë Ligjore dhe të Drejta të Njeriut, ka lëshuar një raport me titull "Trajtimi jonjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve të njeriut në Kosovë". Raporti ka bërë akuza të mëdha në lidhje me trafikimin e jashtëligjshëm të organeve të njeriut të kryera nga anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga vera e vitit 1999 e tutje me të burgosur Serb duke qenë dhurues/viktima. Disa figura të njohura tani në Kosovë ishin identifikuar si kryerës të mundshëm. Nuk është nevoja të thuhet por raporti ka shkaktuar një stuhi kontroverse jo vetëm në Kosovë por edhe në mbarë botën.

Raporti ka bërë referenca lidhur me Klinikën Medicus në Prishtinë si më poshtë:

*168. Në vazhdim të hetimit tonë ne kemi zbuluar disa pjesë të informatave që tejkalojnë në një mënyrë të gjeturat e tona që janë raportuar tani. Kjo informatë duket se do të ketë një përshkrim të gjerë, një konspiracion më të kompleks të krimit të organizuar për të gjeneruar organet njerëzore për transplantim të paligjshëm duke përfshirë bashkë-konspirator për së paku në tri vende tjera të huaja përveç Kosovës, që ka zgjatë për më shumë se një dekadë. Në veçanti, ne kemi gjetur një numër të indikacione konvergjente të besueshme se komponenti i trafikimit të organeve nga arrestimet e post-konfliktit të përshkruara në raportin tonë është afërisht i lidhur me rastin e tanishëm të Klinikës Medicus, jo së paku përmes personaliteteve të njohura të shqiptarëve të Kosovës dhe ndërkombëtare që paraqiten si bashkë-konspiratorë. Megjithatë, me respektin për hetimet në procedurë dhe zhvillimet gjyqësore të udhëhequra nga EULEX-i/ Zyra e Prokurorit Special e Kosovë, ne ndihemi të obliguar që në këtë moment të kursehem nga publikimet e të gjeturave tona në lidhje me këtë. E panevojshme të thuhet, ne i inkurajojmë të gjitha shtetet qytetarët e të cilave janë të përfshirë në aktakuzë në lidhje me rastin Medicus që të bëjnë të pamundurën për ndalimin e kësaj dukurie të turpshme dhe të ndihmojnë në sjelljen e orkestruesve dhe bashkë-konspiratorëve para drejtësisë ( është shtuar theksimi).*

Raporti përfundon si më poshtë:

*Sot, qëllimi ynë i vetëm është që të shërbejmë si zëdhënës për këta burra dhe gra nga Kosova, gjithashtu edhe për ata nga Serbia e Shqipëria, të cilët pa marrë parasysh etnitetin e tyre apo*

*besimin fetar, thjeshtë aspirojnë për të vërtetën dhe për një përfundim të mosndëshkimit skandaloz, me dëshirën më të madhe që të ketë mundësi të jetojnë në paqe. E vërteta dhe përgjegjësia janë nevoja absolute nëse duhet të ketë pajtim të sinqertë dhe stabilitet të qëndrueshëm në regjion. Gjatë zhvillimit të misionit tonë ne kemi takuar persona me vlera të mëdha, nga të dyja palët, vendore dhe ndërkombëtare – të cilët luftonin për të tejkaluar indiferencën dhe ndërtojnë një shoqëri më të mirë. Ata meritojnë jo vetëm fjalën tonë të solidaritetit por gjithashtu edhe përkrahjen tonë të plotë dhe aktive (është shtuar theksimi).*

Bazuar në raport, Komisioni i Asamblesë Parlamentare për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut ka miratuar një rezolutë më 16 dhjetor 2010 në Paris, e cila më pas është miratuar nga Asambleja Parlamentare. Rezoluta përmban si vijon:

*5. Veprimtaria kriminale, e cila është zhvilluar nga kaosi që mbizotëron në rajon, me iniciativë të disa udhëheqësive ushtarake të UÇK-së të lidhura me krimin e organizuar, ka vazhduar, megjithëse në forma tjera, deri sot ashtu siç demonstrohet nga hetimit që kryer nga Misioni i Unionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në lidhje me Klinikën Medicus në Prishtinë.*

Rezoluta ka bërë rekomandime për veprimet në fjalë që të adresohen akuzat dhe të luten shtetet anëtare dhe ato vëzhguese:

*19.6.1 që t'i përgjigjen pa vonesë kërkesës për bashkëpunim juridik që ishte adresuar atyre nga EULEX-i dhe autoritetet Serbe në kornizë të hetimeve të tyre aktuale në lidhje me krimet e luftës dhe trafikimit të organeve; përgjigja e vonuar për këtë kërkesë është e pakuptueshme dhe e pa tolerueshme duke pasur parasysh rëndësinë dhe urgjencën e bashkëpunimit ndërkombëtarë për t'u marrë me probleme të krimit kaq serioz dhe të rrezikshëm.*

Me këtë ecuri në mendje, kryetari i trupit gjykues në gjykimin e Medicus në fillim të qershorit 2012 ka kërkuar që përmes kanaleve formale diplomatike, që Këshilli i Evropës dhe autoritetet Zvicerane të mundësojnë që Z. M. të dëshmojë përmes video lidhjes në gjykimin Medicus më 3 shtator 2012. Ishte mendimi i trupit gjykues se kërkesa e tij do të pranohet pa vështirësi në ndriçim të deklaratave të Z. M. në lidhje me rëndësinë e së vërtetës dhe përgjegjësinë gjithashtu edhe si përmbajtja e këshillës gjithëpërfshirëse në paragrafin 19.6.1 të rezolutës së cituar më lart.

Megjithatë, optimizmi i trupit gjykues dëshmoi të jetë i gabuar. Përmes letrës për Kryetarin e trupit gjykues nga Presidenti i Këshillit të Evropës, , të datës 10 korrik 2012, kryetari i trupit gjykues ishte informuar se kërkesa e tij ishte referuar te Komisioni për Rregullat e Procedurës, imunitetin dhe çështje institucionale për të marrë mendimin ligjor. Pastaj letra përmbledh mendimin e Komisionit që ka rezultuar nga takimi i tij i datës 27 qershor 2012. Në thelb, komisioni ka ardhur në përfundim se Z. M. gëzon imunitet sipas nenit 14 të Marrëveshjes së Përgjithshme për Privilegje dhe Imunitet të Këshillit të Evropës të datës 2 shtator 1949, e cila thotë:

*Përfaqësuesit e asamblesë Konsultative (Parlamentare) dhe zëvendësit e tyre duhet të kenë imunitet nga të gjitha marrjet në pyetje dhe nga të gjitha arrestimet dhe të gjitha procedurat ligjore në kuptim të fjalëve të folura apo në formë të votës nga ata në ushtrim të funksionit të tyre.*

Siç shpjegohet në letrën e Presidentit, Komisioni mendon se,



*Imuniteti i dhënë sipas nenit 14 të marrëveshjes së përgjithshme është i obligueshëm para gjykatës; është përgjegjësi e gjykatës me juridiksion (në këtë rast Gjykata e Qarkut në Prishtinë) që të pranoj se Z. M. gëzon imunitet të plotë që e ka ndaj lidhjes direkte dhe të dukshme me funksionin e tij parlamentar, për mendimet ose vërejtjet që janë shprehur apo mund të paraqiten në të ardhmen në lidhje me gjykimin në vazhdim.*

Pastaj përgjigja e Presidentit përfundon se,

*Në ndriçim të asaj të cekur më lart, Asambleja Parlamentare nuk ka autoritet që Z. M. të i heq imunitetin parlamentar në kuptim të nenit 14 të Marrëveshjes së Përgjithshme. Prandaj nuk është në pozitë që të përgjigjet në mënyrë të favorshme kërkesës të bërë me 24 prill 2012 [sic] të bërë nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë.*

Pastaj me 27 korrik 2012, gjykata në Prishtinë ka pranuar një përgjigje nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë, ku thuhet se

*Sipas letrës të datës 17 korrik 2012, Zyra Federale e Drejtësisë nuk ka mundësi të plotësoj kërkesën bazuar në vendimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës se imunitetit parlamentar i Z. D.M. nuk mund të hiqet. Kështu, Z. M. nuk e ka pranuar ftesën për të dhënë dëshminë më 3 shtator 2012 (apo edhe pas kësaj kohe).*

Trupi gjykues ka njohuri mbi konceptin ligjor të imunitetit dhe këtë e respekton shumë në raste të duhura. Sidoqoftë, ky nuk duket të jetë rast i tillë. Ekziston një mospërputhje e dukshme dhe e theksueshme në mes të deklaratës në raportin e Z. M. dhe rezolutës së lëshuar nga Asambleja Parlamentare kur bën deklaratat shumë të mëdha në lidhje me të vërtetën, përgjegjësinë, bashkëpunimin dhe natyrën e turpshme të trafikimit të paligjshëm të organeve dhe pozitës formaliste të marrë nga Këshilli; kur i jepet mundësia për të ndihmuar në funksionin e kërkimit të së vërtetës në jetën e vërtetë, gjykimi në procedurë i cili pretendon një trafikim të tillë, Z. M. dhe Këshilli i Evropës shpejt janë tërhequr prapa petkut të imunitetit.

Gjithashtu, kërkesa e qëllimshme për imunitet absolut mbështetet plotësisht në nenin 14 të Marrëveshjes së Përgjithshme. Përderisa trupi gjykues nuk shpreh të ketë ekspertizë speciale në fushën e privilegjeve dhe imuniteteve të zyrtarëve të Këshillit të Evropës dhe ngurron të kundërshtojë aktvendimet e Këshillit të Evropës, nuk mund të mos i vërej dispozitat e nenit 19 të së njëjtës Marrëveshje të Përgjithshme, të cilat nuk referohen askund në letrën e Presidentit, dhe e cila në pjesën përkatëse deklaron si më poshtë:

*Sekretari i Përgjithshëm duhet të ketë të drejtën dhe detyrë të heq imunitetin e çdo zyrtari në secilin rast kur, me mendimin e tij, imuniteti do të pengonte zhvillimin e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykim në interes të Këshillit të Evropës.*

Do të dukej se kjo dispozitë e heqje dorë ka mundur te aplikohet në kërkesën nga Kryetari i trupit gjykues në rastin Medicus. Nëse Z. M., siç deklaroi, di për “indikacione konvergjente të besueshme se komponenti i trafikimit të organeve të arrestimeve të post-konfliktit të përshkruara në raportin tonë është afërisht i lidhur me rastin e tanishëm të Klinikës Medicus...” atëherë dëshmia e tij ka mundur të kontribuoj në mënyrë domethënëse në vërtetimin e së vërtetës pa dëmtoar interesat e Këshillit të Evropës.

Përderisa rasti Medicus është përmyllur tani pa përfitimin e dëshmisë së Z. M., trupi gjykues mundet vetëm të shpresoj se Këshilli do të ri-mendoj pozitën e vet nëse një dëshmi e tillë kërkohet në ndonjë gjykim tjetër në të ardhmen në lidhje me akuzat e raportit të Z. M.

## **V. Ligjshmëria e Kontrollit së Klinikës Medicus**

Gjatë fazës së konfirmimit të aktakuzës, pranueshmëria e dëshmive të konfiskuara gjatë kontrollit në Klinikën Medicus, e cila filloi më 4 nëntor 2008 dhe ka vazhduar deri më 11 nëntor, ishte kundërshtuar me bazat se kontrolli ishte kryer pa urdhër gjyqësor, pa urdhër verbal e as me shkrim, në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Kosovës dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës

Në fund, dëshmitë ishin vlerësuar si të pranueshme në fazën e konfirmimit pas një ankese në trupin gjykues prej tre gjyqtarëve. Sidoqoftë, kërkesa ishte ripërtërirë nga L.S., avokat mbrojtës për L.D., ne parashtresën me shkrim në gjykatë të paraqitur më 29 shtator 2011. Nëse dëshmitë e konfiskuara në Klinikë ishin të pranueshme apo jo ishin shikuar nga të gjitha palët si të rëndësishme, sepse pa këto dëshmi prokuroria me siguri nuk do të mund të vazhdonte me aktakuzë. Kështu, gjykata dhe të gjitha palët janë pajtuar se kjo çështje do të adresohet në fillim të seancës kryesore, me aktvendim të cilin gjykata do të lëshonte menjëherë.

Pastaj gjykata ka marrë dëshminë prej një numri të madh të dëshmitarëve të cilët kishin njohuri në lidhje me rrethanat që kanë përcjellë kontrollin dhe kanë shqyrtuar disa raporte të rëndësishme të cilat ishin shkruar gjatë procesit të kontrollit apo menjëherë pas atij. Pas dëshmisë së L.D. dhe avokatit mbrojtës për I.RR., F.V., kanë paraqitur parashtresën me shkrim duke argumentuar se kontrolli ishte joligjor dhe prandaj dëshmia e konfiskuar gjatë kontrollit është e papranueshme.

Trupi gjykues ka lëshuar një aktvendim verbal më 19 dhjetor 2011 ku ka deklaruar se dëshmitë janë të pranueshme<sup>1</sup> por ka rezervuar të drejtën për të shqyrtuar çështjen në përfundim të rastit. Për shkak të rëndësisë së kësaj çështjeje, ky aktgjykim lëndën e pasqyron menjëherë në hollësi si më poshtë.

Dëshmitarët e poshtëshënuar kanë dëshmuar në lidhje me kontrollin e Klinikës Medicus:<sup>2</sup>

1. F.H., procesverbali 18 tetor 2011, faqe 4-13
2. F.M. procesverbali 18 tetor, faqe 13-35, dhe 19 tetor, faqe 3-13
3. Z.K. procesverbali 19 tetor, faqe 14-25
4. O.K. procesverbali 19 tetor, faqe 26-35
5. SH.O. procesverbali 20 tetor, faqe 2-5
6. O.M. procesverbali 20 tetor, faqe 5-18

---

<sup>1</sup> Aktvendimi këtu mbetet në përputhje me aktvendimin verbal

<sup>2</sup> Disa prej dëshmitarëve gjithashtu kanë ofruar dëshmi në aspekte tjera për rastin; dëshmia e tyre nuk ishte patjetër e kufizuar në lidhje me kontrollin.

7. R.A. procesverbali, faqe 19-37
8. S.B. procesverbali 25 tetor, faqe 2-10
9. A.G. procesverbali 25 tetor, faqe 12-18
10. SH.H., procesverbali 215 tetor, faqe 25-35.
11. SH.G., procesverbali 9 nëntor 2011, faqe 2-6
12. B.SH. procesverbali 9 nëntor, faqe 6-11
13. F.B. procesverbali 9 nëntor, faqe 15-20
14. H.K. procesverbali 10 nëntor, faqe 29-41
15. M.M. , procesverbali 15 nëntor, faqe 2-10
16. T.P., procesverbali 15 nëntor, faqe 11-24
17. S.H., procesverbali 17 nëntor 2011, 15-19
- 18.N.S., procesverbali 22 nëntor 2011, faqe 2-9
19. S.C. procesverbali 22 nëntor 2011, faqe 10-16
20. A.A, procesverbali 29 nëntor 2011, faqe, 17-19, 22-29
21. I.A., procesverbal 29 nëntor 2011, faqe 8-22
22. S.XH. procesverbali 29 nëntor 2011, faqe 23-26
23. E.P. Polic në Aeroport, procesverbali 20 dhjetor 2011, faqe 10-15
24. H.SH., procesverbali 5 prill, faqe [ ].

Gjendja faktike më poshtë rrjedh nga dëshmitë e këtyre dëshmitarëve gjatë seancës kryesore. Gjykata nuk beson se është e nevojshme që të përmbledh dëshmitë e secilit dëshmitar. Në vend të kësaj gjykata ka bërë referenca në pjesët e rëndësishme të dëshmive të dëshmitarëve kyç në lidhje me këtë çështje. Gjykata është e mendimit se faktet vendimtare nuk kontestohen; më saktë, është konkluzioni ligjor që tërhiqet nga faktet që përbëjnë kontestin.

#### **A. Hetimi fillestar i Policisë**

Para kontrollit së Klinikës Medicus të datës 4 nëntor 2008, informatat prej inteligjencës kanë filluar të zhvillohen në lidhje me veprimtarinë dyshuese që shfaqej në Aeroportin e Prishtinës në lidhje me qytetarët e huaj që hynin në vend për trajtim mjekësor në Klinikën Medicus. Fillimisht informata nuk ishte e definuar dhe thjesht ishin përcjellë në Policinë e Kosovës nga Policia Kufitare në Aeroport. Përfundimisht, në muajin tetor 2008, F.M. nga Njësi kundër Trafikimit Njerëzor ishte caktuar si hetues kryesor.

Së pari ai kishte bërë një vizitë në klinikë për të parë ku ishte lokacioni. Gjatë vizitë ai ka takuar L.D. dhe T.P. M. ka kërkuar dokumentacionin e licencimit dhe nga D. ishte njoftuar se ende nuk e kanë atë leje por se do të sjellët më vonë. Kjo ishte vizita e vetme e M. në klinikë para datës 4 nëntor.

M. gjithashtu në disa raste ka vizituar aeroportin për të u takuar me Policinë Kufitare dhe të njoftohej vetë me dokumentet në lidhje me hyrjet e këtyre të huajve. Ai kishte mundur të i shihte kopjet e pasaportave gjithashtu edhe letër garancitë apo ftesat të lëshuara nga Medicus të cilat ishin dorëzuar paraprakisht te qytetarët e huaj të cilit vizitonin Klinikën. Më 3 nëntor ai ka vërejt se shumica e letër garancive ishin lëshuar për dy persona të cilët kishin hyrë në Kosovë para disa ditëve. Njëri ishte një burrë i ri turk që quhej Y.A.; tjetri ishte një Izrael më i vjetër i quajtur B.SH..

Në mëngjesin e datës 4 nëntor M. është kthyer në aeroport për hetime të mëtutjeshme. Ai ka kuptuar se Y.A. kishte një biletë të hapur për t'u kthyer në Turqi përmes Turkish Airlines. Nga një rastësi e thjeshtë ai në terminal i ka vërejt një grup prej 3 – 4 persona të cilit nuk dukeshin të jenë qytetar të Kosovës dhe njërin prej tyre e ka njohur si Y.A.. Ata të tjerët nuk i ka njohur por më vonë ka kuptuar se njëri ishte M.H., tjetri ishte "E." (shqiptim fonetik) dhe i treti ishte djali i B.SH..

M. kishte vëzhguar A. dhe H. duke shkruar te sporteli i Turkish Airlines dhe dukej se ata po bënë aranzhimin e fluturimit për të lëshuar Kosovën. H. dhe të tjerët pastaj dolën jashtë terminalit kurse A. po drejtohej tek kontrolli i pasaportave. Sapo A. mbërriti tek sporteli i kontrollit të pasaportave, M. kishte mundësinë të krahasonte kopjen e pasaportës të cilën ai tashmë e kishte me pasaportën e paraqitur nga A. dhe ato përputheshin.

A., i cili dukej i shqetësuar dhe i zbehur, pastaj u shoqërua për në dhomën e intervistave dhe ishte marrë në pyetje nga M. përmes përkthyesit. A. thjesht tha se dëshironte të shkoj në shtëpi. M. ka bërë një kontrollë trupore vizuale dhe ka parë një prerje rreth 20centimetra në belin e A. M. ka kontaktuar me mjekun kujdestar të aeroportit i cili e ka kontrolluar dhe ka vërtetuar se prerja ishte në lidhje me operacion të veshkës, duke dhënë vendin e prerjes së trupit të A. Pastaj M. ka dyshuar se operacioni ishte kryer në Medicus. A. ishte transportuar nga M. në Stacionin e Policisë dhe ata kanë arritur diku rreth orës 13.00. Pastaj A. e ka pranuar se e ka hequr veshkën në Medicus dhe se në Kosovë ai ishte sjellë nga M.H.. Gjithashtu A. ka thënë se pranuesi i veshkës ishte ende në klinikë. Pastaj A. ishte lënë nën kujdesin e njësitit për viktimë të veçanta nga Ministria e Drejtësisë. Për shkak të gjendjes së tij mjekësore në rrezik ai ishte shtrirë në Spitalin Universitar.

M. ka njoftuar zyrtarët e tjerë policor për të shkuar në Klinikën Medicus dhe të siguroj vendin e ngjarjes të cilën ai e ka konsideruar të jetë vendi i krimit. Pastaj ai ka shkuar në spitalin e Prishtinës dhe ka arrestuar D. , pas së cilës ai ka shkuar në klinikë duke ardhur diku rreth 15.00-15.30. derisa ishte në klinikë, e cila ishte siguruar siç ishte udhëzuar me rreth 20-25 oficer, ai ka vërtetuar se është e nevojshme të kryhet një kontroll. Për shkak të ndjeshmërisë së rastit ai ka kontaktuar prokurorin publik kujdestar, O.M. dhe ka kërkuar nga ai që të paraqitet në vendin e ngjarjes i cili ka ardhur diku rreth orës 16:00-16:30.

Në këtë pikë dëshmitë e dëshmitarëve ndryshojnë edhe pse mospërputhjet nuk janë vendimtare për çështjen në atë kohë, përkatësisht nëse urdhri gjyqësor ishte lëshuar ndonjëherë për kontroll. M. ka pohuar se kontrolli nuk ka filluar derisa ka ardhur prokurori M. dhe se M. e ka autorizuar kontrollin pasi që ka kontaktuar me Kryeprokurorin publik,

O.K. M. ka pohuar se kontrolli tashmë kishte filluar kur ai ka arritur dhe se ai asnjëherë nuk e ka autorizuar kontrollin meqë ai nuk kishte autoritet ta bënte atë – vetëm gjyqtari mund të autorizoj një kontroll.

Çka është e qartë nga dëshmia, megjithatë është se nuk është lëshuar asnjë urdhër gjyqësor për kontroll, e as gjyqtari nuk ishte kontaktuar ndonjëherë nga policia apo prokurori për të marrë një urdhër, qoftë edhe urdhër verbal apo me shkrim, edhe pse kishte një sistem kujdestarie për gjyqtarët e procedurës paraprake, siç është demonstruar nga ekspertët nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor menjëherë më poshtë.<sup>3</sup> Gjithashtu çka është e qartë është ajo se asnjë person me pozitë për të vepruar ashtu nuk ka lejuar kontrollin dhe se nuk ka pasur dëshmitarë të caktuar të cilët e kanë mbikëqyrur kontrollin.

## **B. Dëshmitë kyçe në lidhje me kontrollin**

Kur oficeri M. ishte marrë në pyetje në shqyrtimin gjyqësor nga prokurori i PSRK-së në lidhje me atë nëse ai kishte kërkuar leje nga gjyqtari i procedurës paraprake, ai ishte përgjigjur:

*Jo, sepse Prokurori Publik duhet ta marr atë veprim. Kontakti jonë është me Prokurorin Publik dhe jo me gjyqtarin. Ne i përmbahemi urdhrin të Prokurorit Publik.*

4

Kryeprokurori Publik, O.K., ka mohuar të ketë qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes dhe ka kaluar përgjegjësinë për kontaktimin e gjyqtarit te Prokurori Publik, në këtë rast O.M. Kur në shqyrtimin gjyqësor është pyetur nga anëtari i trupit gjykues se pse nuk është kontaktuar gjyqtari i procedurës paraprake, së paku për urdhër verbal, ai është përgjigjur:

*Ai [gjyqtari] është dashur të njoftohej dhe unë nuk kam njohuri në lidhje me këtë meqë kjo bie mbi fushëveprimin e Prokurorit Publik.*<sup>5</sup>

Pastaj kur është pyetur se kur është dashur të kontaktohet gjyqtari, ai ka thënë:

*Në momentin kur ka kërkesë për kontroll nga policia.*<sup>6</sup>

Në anën tjetër, O.M , ka sugjeruar që kontrolli ishte arsyetuar pa ndonjë urdhër sepse kontrolli është kryer në ne hapësira publike dhe për shkak të urgjencës së situatës. Gjatë dëshmisë së tij në shqyrtimin gjyqësor, ai ka ofruar shpjegim më të gjerë mbi ligjin që mbikëqyr kontrollin si më poshtë:

*Unë mendoj se policia – dhe se ka pasur një diskutim se ata kanë hyrë pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake por sipas nenit 242 paragrafi 4 i KPP të Kosovës, policia ka të drejtë që të bastisë hapësirat publike pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake ose nëse efektiviteti i kontrollit duket se do të dëmtohet nëse [nuk] kryhet menjëherë dhe pa lajmërim. Natyrisht se kontrolli duhet të kryhet pa lajmërim kur duhet të kryhet në vende publike. Unë konsideroj se policia ka vepruar drejt duke hyrë në lokale dhe kryre kontrollin. Këtu ka pasur*

<sup>3</sup> Këto ekstrakte nga procesverbali është menduar të jenë vetëm përfaqësime. Ato nuk përbëjnë një katalog të plotë të të gjitha referencave të kësaj çështjeje. Megjithatë, ekstraktet me saktësi reflektojnë totalin e situatës.

<sup>4</sup> Procesverbali, 18 tetor 2011, faqe 30.

<sup>5</sup> Procesverbali, 19 tetor 2011, page 34

<sup>6</sup> Id.

*pyetje në lidhje me dhuruesin, pranuesin dhe doktorin, të gjithë ata kanë qenë të huaj. Po të ishte shtyrë kontrolli për një ditë tjetër atëherë efekti i kontrollit do të dështonte në lidhje me klinikën.<sup>7</sup>*

Sipas M., përgjegjësia për kontaktimin e gjyqtarit, duke pretenduar se një kontakt i tillë nevojitej, ka mbetur në polici. Kur është pyetur nga Kryetari i trupit gjykues se nëse prokurori ose policia e kishin përgjegjësinë për të kërkuar leje verbale nga gjyqtari i procedurë paraprake, ai është përgjigjur:

*Unë besoj se ishte përgjegjësi e policisë që të thërras kur ata kanë shkuar te vendi i ngjarjes. Kjo gjithmonë është praktikuar që kur unë kam shkuar në disa vende të ngjarjes, unë kam marrë numrin e telefonit të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe ia kam dhënë zyrtarit policor përgjegjës, i cili pastaj e ka thirr gjyqtarin e procedurës paraprake.<sup>8</sup>*

S.B. ishte gjyqtar kujdestar i procedurës paraprake më datën 4 nëntor dhe në atë ditë punonte në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ai ka dëshmuar se njoftimi i parë në lidhje me kontrollin ishte pasi ai është kthyer shtëpi:

*Aq sa më kujtohet, po e theksoj edhe një herë; nuk e di se kur është kryer kontrolli. Kur unë shkova në shtëpi kam dëgjuar në lajme dhe aty është përmendur se janë arrestuar disa persona në Medicus. Informata e parë që unë e kam marrë është nga TV.<sup>9</sup>*

B.ka vazhduar të dëshmoj se prokurori publik kujdestar e ka pasur një zyre në katin sipër zyrës së tij në Gjykatën e Qarkut dhe se prokurori e ka pasur numrin e telefonit të gjyqtarit.<sup>10</sup> Kur S.B. ka mësuar në lidhje me rastin ai e ka kuptuar se ka konflikt të interesit, dhe Kryetari i Gjykatës së Qarkut pastaj e ka caktuar SH.H. si gjyqtar të procedurës paraprake. Më pas H. ka udhëhequr seancën për caktimin e paraburgimit më datën 7 nëntor. Gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ai ishte pyetur nëse ai kishte pranuar ndonjëherë kërkesë për të autorizuar kontrollin e Klinikës Medicus. Ai është përgjigjur:

*Jo, sepse një kërkesë e tillë duhet të paraqitet para seancës për caktimin e paraburgimit.<sup>11</sup>*

Sidoqoftë, përveç mungesës të urdhrin gjyqësor dhe opinioneve të ndryshme në lidhje me atë nëse ishte e nevojshme apo jo të kontaktohet gjyqtari, dhe nëse po nga kush, kontrolli ka filluar diku rreth orës 16:00-16:30 dhe ka zgjatur për disa orë, pastaj ka vazhduar në ditët në vijim.

### **C. Dëshmia në lidhje me pajtimin**

Ekspertët e poshtëshënuar nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor adresojnë çështjen nëse ndonjë anëtar i autorizuar i personelit të Klinikës Medicus ishte pajtuar me kontrollin.<sup>12</sup> Sipas nenit 245, paragrafi 1, nënparagrafi 1, pajtimi është njëri nga përjashtimet në kërkesën për

<sup>7</sup> Procesverbali, 20 tetor 2011, faqe 17

<sup>8</sup> Id.

<sup>9</sup> procesverbali, 25 tetor 2011, faqe 5

<sup>10</sup> Id., faqe 8-9

<sup>11</sup> Id., faqe 30

<sup>12</sup> Këto ekstrakte nga procesverbali është menduar të jenë vetëm përfaqësime. Ato nuk përbëjnë një katalog të plotë të të gjitha referencave të kësaj çështjeje. Megjithatë, ekstraktet me saktësi reflektojnë totalin e situatës.

urdhër gjyqësor para hetimit. Nga fragmentet më poshtë është e qartë se asnjë pajtim nuk iu është dhënë policisë.

Gjatë kontrollit disa anëtarë të personelit të Klinikës Medicus ishin të pranishëm në ndërtesë edhe pse D., i cili ishte arrestuar më herët, nuk ishte në klinikë. Sipas M.M., radiolog, i cili në klinikë punonte me gjysmë orari, ai së bashku me T.P. , N.S., A.A. dhe pastruesen ishin të pranishëm. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor janë pyetur nëse ndonjëri nga ata ishin lejuar të përcjellin policinë aty, M. ka deklaruar:

*Jo. Ata na kanë urdhëruar të ulemi dhe mos të flasim. Sjellja e tyre ishte e vrazhdë, ata kanë hyrë nëpër dhoma ashtu si ishin, me çizme dhe nuk na lënin të bëjmë asgjë. Më e keqja ishte se nuk kishim ide se çfarë po ndodhte. Askush nuk na ka shpjeguar. Në orën 6 kanë ardhur kamerat dhe ka filluar shfaqja. T. ishte marrë në atë mënyrë që nuk mund ta përshkruaj, para kamerave dhe tjerët u futën në veturat e tjera dhe u dërguan në stacionin policor.<sup>13</sup>*

Gjatë dëshmisë së P. në gjykim, ai ishte pyetur nëse ai apo personeli tjetër ishin lejuar të shoqëronin policinë derisa ata bastisnin ndërtesën dhe ai u përgjigj negativisht.<sup>14</sup> Kur u pyet nëse ndokush prej stafit ka dhenë pëlqimin për kontroll, ai u përgjigj:

*“Ata nuk na kanë pyetur fare”.<sup>15</sup>*

Ai thotë se përfundimisht pas rreth tri orëve kanë ardhur kamerat dhe ai ishte arrestuar.<sup>16</sup>

Sipas N.S. teknik medicinal i cili punonte me gjysmë orari në Klinikë, ai në klinikë ka ardhur për të filluar ndërrimin e tij diku rreth orës 15:00. Ai dhe T. ishin lejuar ty hyjnë vetëm pasi i kishin treguar ID-të e tyre. Dëshmitari ka deklaruar:

*Dua vetëm të sqaroj. Neve na u kërkuan ID dhe pastaj na lejuan të hyjmë në korridorin e katit të parë, unë dhe T. Ata na urdhëruan të ulemi dhe t'i fikim telefonat dhe mos të lëvizim nga karriget. Për afro gjysmë ore ata nuk na kanë lejuar të shkojmë as në tualet dhe askush nuk na ka thënë asgjë. Të gjitha që ne i kemi parë ishin njerëzit me uniforma që vazhdimisht lëviznin lart e poshtë. Askush nuk na ka pyetur derisa na kanë dërguar në stacionin policor rreth orës 8 ose 9 të mbrëmjes.<sup>17</sup>*

Pastaj ai ishte pyetur se kush nga personeli përveç tij dhe T. ishin në Klinikë, dhe ai ka identifikuar S.H., S.C. dhe M.. Kur ai u pyet nëse të gjithë kanë qëndruar në vendin e njëjtë, ai tha:

*Po, ne ishim në vendin e njëjtë dhe ata na urdhëruan të mos lëvizim nga karriget. Zyrtari Policor me zërin e ashpër na ka thënë të mos lëvizim.<sup>18</sup>*

Kur ai u pyet nëse ndokush ka lejuar pëlqimin për kontroll, ai u përgjigj:

<sup>13</sup> Procesverbali 15 nëntor 2011, faqe 7

<sup>14</sup> Id., faqe 17

<sup>15</sup> Id.

<sup>16</sup> Id.

<sup>17</sup> Procesverbali 22 nëntor 2011, faqe 5

<sup>18</sup> Id., faqe 7

*Jo, askush nuk na ka pyetur asgjë. Zyrtari Policor i cili qëndronte me ne duhej të pyeste një tjetër polic nëse ne mundemi të shkojmë në tualet i cili ishte 2 m larg.*<sup>19</sup>

Kur ai u pyet nëse ndonjëri prej policëve ka kërkuar prej ndonjërit prej personelit që të jetë dëshmitarë gjatë kontrollit, ai tha jo.<sup>20</sup>

S.C., pastruese, ka konfirmuar se asnjëri që ishte i pranishëm në Klinikë nuk ishte pyetur për pëlqimin e kontrollit. Ajo gjithashtu ka dëshmuar se as A.D. e as L.D. nuk kanë ardhur në klinikë.<sup>21</sup>

Në një kohë gjatë kontrollit në vendin e ngjarjes me veturë ka ardhur A.D.. Ai ka paraqitur disa dokumente te oficeri i mjekësisë ligjore të cilat ishin kërkuar nga oficeri M. kur ai në fillim e kishte vizituar klinikën para disa ditëve. Më pas A. ishte arrestuar bashkë me P.<sup>22</sup>

#### **D. Dëshmia në lidhje me praninë e dy dëshmitarëve**

Ekstraktet nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më poshtë adresojnë çështjen e pranisë apo mungesës së dy dëshmitarëve gjatë kontrollit e cila është kërkesë e nevojshme<sup>23</sup>.

Gjatë dëshmisë së tij në shqyrtimin gjyqësor, F.H., i cili ishte Drejtor i Njësitit kundër Krimin të Organizuar dhe i cili kishte shkuar te vendi i ngjarjes, ishte pyetur nëse ai ka vënë re praninë e dy dëshmitarëve të rritur gjatë kohës së kontrollit. Ai ka thënë se këtë pyetje duhet të ia adresoni drejtpërdrejt hetuesve, por ka vazhduar:

*E di se sipas KPPK-së kjo kërkohet dhe e di së në atë kohë këto kishin prioritet dhe jam i sigurt se hetuesi e ka pasur parasysh.*<sup>24</sup>

Ai ka shtuar:

*Është rutinë që hetuesit të kenë dy dëshmitarë të pranishëm gjatë kohës së kontrollit. Unë nuk i kam parë shkresat e dosjes. Ju mund ti shihni shkresat e dosjes. Por unë personalisht nuk i kam parë.*<sup>25</sup>

Kur u pyet nëse dy dëshmitarë ishin të pranishëm gjatë kontrollit, M. dëshmoi:

*“Aty kishte dëshmitarë të pranishëm. Personeli që punonte aty. T.P.vetë ishte aty i pranishëm. Në klinikën e L.D. kishte personel të pranishëm të cilët kanë vëzhguar dhe kanë përcjellë”.*<sup>26</sup>

Ai ka vazhduar:

*Në një kohë gjatë kontrollit ata ishin larguar anash në korridor dhe pastaj nga ata është kërkuar që të shkojnë në vendet e tyre të punës ku ata zakonisht e kryejnë detyrën dhe ku*

<sup>19</sup> Id.

<sup>20</sup> Id., faqe 8

<sup>21</sup> Id., faqe 15

<sup>22</sup> Procesverbali 18 tetor 2011, faqe 34

<sup>23</sup> Këto ekstrakte nga procesverbale kanë për qëllim të jenë vetëm për përfaqësim. Ato nuk përbëjnë një katalog të plotë të gjitha referencave lidhur me këtë temë në procesverbal. Sidoqoftë, ekstraktet në mënyrë të saktë reflektojnë situatën e plotë.

<sup>24</sup> Procesverbali 18 tetor 2011, faqe 10

<sup>25</sup> Id.

<sup>26</sup> Id., faqe 34



*zakonisht janë obligimet e tyre. Personat e fundit që kanë lëshuar vendin e ngjarjes ishin personat e arrestuar dhe dëshmitarët dhe A.D. [,], askush nuk ka mbetur mbrapa.*<sup>27</sup>

Nga dëshmia e këtyre dëshmitarëve është e qartë se kërkesa për praninë e dy dëshmitarëve të rritur, të cilët duhet të udhëzohen për të vëzhguar nga afër se si kryhet kontrolli dhe të informohen për të drejtat e tyre për të bërë vërejtje në procesverbal, nuk është bërë dhe në fakt ajo është injoruar thjesht. Personeli i Klinikës ishte urdhëruar që të qëndrojnë në dhoma të caktuara dhe thjesht të kryejnë aktivitetet e tyre zyrtare, kështu që nuk kishte asnjë mundësi për ndonjërin prej tyre të vëzhgojnë veprimet e kryera gjatë kerkimit dhe të paraqesin ndonjë kundërshtim që mund të jetë i duhur.

### **E. Roli i Inspektorëve të Shëndetësisë**

Gjatë vendosjes lidhur me ligjshmërinë e kontrollit është me rëndësi të kuptohet jo vetëm roli i policisë por edhe roli i inspektorëve shëndetësorë nga Ministria e Shëndetësisë të cilët kanë autoritet ligjor të pavarur për të hyrë, inspektuar dhe kontrolluar institucionet shëndetësore dhe të konfiskojnë dëshmi. Dëshmia e dëshmitarëve kryesor bashkë me dëshmitë materiale relevante e bëjnë të qartë se inspektorët shëndetësorë kanë luajtur një rol të plotë në kontrollin fillestar të Klinikës Medicus më 4 nëntor 2008 dhe gjatë ditëve në vijim.

F. M., oficer hetues udhëheqës, gjatë marrjes direkte në pyetje nga prokurori i PSRK-së në shqyrtimin gjyqësor, ishte pyetur nëse ai ka kontaktuar agjencitë e tjera para se të filloj kontrolli. Ai është përgjigjur:

*Unë i kam njoftuar të gjitha njësitë e tjera të cilat kam menduar se janë të rëndësishme. Njësitë e shëndetësisë, meqë ne kemi bashkëpunim të ngushtë me inspektorët shëndetësor sepse me ta kishim edhe raste të tjera. Unë e kam njoftuar kryeinspektorin shëndetësor Z.K.. Unë i kam thirr ata sepse kjo ishte një lloj procedure sepse kështu kemi vepruar kur kemi pasur një çështje shëndetësore dhe ata ishin personat që na drejtuan ne dhe unë kam dashur që ata të vijnë këtu dhe na tregojnë se çfarë të bëjmë”.*<sup>28</sup>

Z.K., kryeinspektor i shëndetësisë, ka dëshmuar në shqyrtimin gjyqësor se nuk është e pazakontë të pranohet kërkesë nga policia për ndihmë. Pastaj prokurori i PSRK-së e ka pyetur, “A është e drejtë të thuhet se policia i referohet inspektorëve shëndetësorë në lidhje me çështje mjekësore ose shëndetësore ? Në këtë pyetje K. është përgjigjur me po.”<sup>29</sup>

Kur është pyetur se çfarë ka bërë pasi ka pranuar kërkesën nga policia, K. ka thënë:

*“I kam dërguar dy inspektor. Një grua dhe një burrë, burri quhej SH.O. dhe nuk më kujtohet nëse ajo gruaja quhej A.M. apo D.SH.D..”*<sup>30</sup>

Kur është pyetur të përshkruaj veprimin e parë të bërë gjatë kontrollit përveç grumbullimit të personelit, M. ka thënë:

*Gjatë kontrollit me sy, doktori i mjekësisë ligjore, A.G. i cili ishte gjithashtu i pranishëm dhe kryeinspektori i shëndetësisë dhe disa zyrtarë të tjerë shëndetësor që gjithashtu ishin të pranishëm...”*<sup>31</sup>

<sup>27</sup> Id., faqe 34-35

<sup>28</sup> Procesverbali, 18 tetor 2011, faqe 23.

<sup>29</sup> Procesverbali, 19 tetor 2011, faqe 15

<sup>30</sup> Id

*“Në katin e tretë, ekipi hetues e ka shikuar një pacient të gjinisë mashkullore i cili shtrihej në shtrat. Mjeku i mjekësisë ligjore e ka pyetur atë pse gjendej aty dhe ai është përgjigjur se ka pasur një intervenim në veshkën e tij. Pastaj ekipi ka besuar se ishte kryer një transplantim”*<sup>32</sup>

Prokurori i PSRK-së pyeti për emrin e atij. M. u përgjigj si më poshtë:

*“B.SH.. Pastaj ne kemi kryer një kontroll më të hollësishëm nga njësi i mjekësisë ligjore të SHPK-së në bashkëpunim me inspektorët shëndetësorë. Janë bërë disa fotografime dhe është gjetur përshkrimi manual i objekteve dhe ishte pozita [sic]. Nuk ishte e nevojshme të vazhdohej kontrolli më në atë natë sepse filloi të errësohej”.*<sup>33</sup>

Kur është pyetur se kush saktësisht e kryente kontrollin, M. u përgjigj:

*“Kontrolli me sy ishte kryer nga unë, mbikëqyrësit e mi, Prokurorët Publik, njësi i mjekësisë ligjore dhe inspektorët shëndetësor. Kontrolli i hollësishëm ishte kryer nga njësi i mjekësisë ligjore në lidhje me mbledhjen e dëshmive por ata kanë komunikuar me ne gjatë gjithë kohës për të parë nëse artikujt ishin të nevojshëm për hetimin”.*<sup>34</sup>

Sipas M. dhe dëshmitarëve tjerë në gjykim, bashkëpunimi në mes të policisë dhe inspektorëve shëndetësor ka vazhduar gjatë mbrëmjes së 4 nëntorit kur ishte mbajtur mbledhja në stacionin policor ku merrnin pjesë M., Kryeprokurori Publik, Kryeinspektori Shëndetësor, Mjeku Ligjor dhe të tjerët. Qëllimi ishte diskutimi i veprimeve që ata duhet të ndërmarin me që po e trajtonim viktimën i cili kishte deklaruar se i ishte hequr veshka. Ata gjithashtu kishin një pacient i cili kishte pranuar se në trupin e tij i ishte transplantuar një veshkë.<sup>35</sup>

Ky ishte rasti i parë i këtij lloji që ata kishin hetuar. Kur është pyetur se çfarë ishte diskutuar në takim. M. ka deklaruar:

*Diskutimi ishte në lidhje me interpretimin e veprës penale. Inspektorët e shëndetësisë e kanë sjellë ligjin mbi shëndetësinë dhe do të lexonin të gjitha dispozitat dhe t'i interpretojnë ato pastaj dhe përshkrimi i këtyre ligjeve në lidhje me klinikat private dhe transplantimi i mundshëm i ndërmarrë. Mjeku ligjor ishte i obliguar të konfirmoj mundësinë e transplantimit të tillë të jetë kryer në ato kushte të klinikës.*<sup>36</sup>

Përfundimisht ishte vendosur se kishte dyshim të bazuar sipas nenit 139 të Kodit Penal të Kosovës, Trafikim, dhe Prokurori Publik ka lëshuar një urdhër arrest për personat tashmë të ndaluar.<sup>37</sup>

Në ndërkohë ishin marrë vendime në lidhje me trajtimin e B.SH., pranuesi i veshkës. Ai ishte dërguar në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës pas vendimit të Kryeinspektorit [shëndetësor] dhe Mjekut Ligjor se jeta e tij mund të jetë në rrezik.<sup>38</sup> Ashtu siç doli, Spitali

<sup>31</sup> Procesverbali, 18 tetor 2011, faqe 24

<sup>32</sup> Id.

<sup>33</sup> Id., faqe 25

<sup>34</sup> Id.

<sup>35</sup> Id.

<sup>36</sup> Id., faqe 27

<sup>37</sup> Id., faqe 28

<sup>38</sup> Id.

Universitar nuk ka mundur të plotësoj nevojat e trajtimit për SH. dhe ishte vendosur që ai të kthehej në Klinikën Medicus, nën kujdesin e D.

Në lidhje me natyrën e kontrollit në vazhdimësi pas datës 4 nëntor, M. ka dëshmuar,

*Pas [kontrollit] të datës 4 nëntor, kontrollet kanë vazhduar deri më datën 11. Policia e mjekësisë ligjore kanë vazhduar kontrollin së bashku me ekspertin(tët) shëndetësor nga Ministria e Shëndetësisë.<sup>39</sup>*

## **F. Raportet në lidhje me kontrollin**

Raportet e llojllojshme që ishin përgatitur gjatë kontrollit konfirmojnë se kontrolli ishte bashkëpunim i përbashkët në mes të policisë dhe inspektorëve shëndetësor dhe se inspektorët shëndetësor kanë vepruar nën autoritetin e disa ligjeve që e administrojnë shëndetësinë.

Në raportin e tij për A.G., Ministër i Shëndetësisë, i datës 6 nëntor 2008, Kryeinspektori Shëndetësor, Z.K., ka thënë:

*“Inspektimi është i bazuar në Ligjin për Shëndetësi 2004/4, neni 101, 102.1, 118.1 [,] Ligjin për Inspektoratin Shëndetësor nr. 02/L-38 neni 1, 2, 6, dhe 7 dhe Ligji mbi Veprimtari Private 2004/50, nenet, 25.1, 26.1, 28.1...”<sup>40</sup>.*

Në kallëzimin e tij penal për Prokurorin Publik të Qarkut të datës 7 nëntor 2008, F. M., hetuesi kryesor, ka deklaruar në pjesën e nënvizuar si Arsyetim:

*Bazuar në ekzaminimin e mjekësisë ligjore të kryer nga inspektorë shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë, ekspertëve farmaceutik të Ministrisë së Shëndetësisë dhe atyre nga njësitë e mjekësisë ligjore të Policisë së Kosovës, të cilët ende po punojnë në vendin e ngjarjes, po dyshohet se është kryer transplantimi i veshkëve në mënyrë joligjore dhe në kushte profesionale të papërshtatshme në Klinikën Medicus dhe se kjo klinikë nuk posedon leje nga Ministria e Shëndetësisë.”<sup>41</sup>*

Në Raportin e tij të kontrollit në vend të ngjarjes, të datës 10 nëntor 2008, Kapiteni M.S., teknik përgjegjës për Njësitin e Mjekësisë Ligjore, ka deklaruar:

*Në vendin e ngjarjes kemi arritur rreth orës 14:35[4 nëntor]. Aty jemi takuar me hetuesit e DKKO-së Njësitit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore të udhëhequr nga toger R.A., i cili na ka njoftuar se hetues përgjegjës për këtë rast është F. M. Në vendin e ngjarjes të pranishëm ishin Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë O.M., inspektori i shëndetësisë SH.O. dhe A.M. nga Ministria e Shëndetësisë dhe Patologu i mjekësisë ligjore A.G..<sup>42</sup>*

Në pjesën e këtij raporti të shënjuar “Aktivitet e kryera me 04.11.2008,” S. ka shkruar:

*Siç ishte kërkuar nga hetuesit, detyrë e jona ishte t'i dokumentojmë të gjitha veprimet të marra në këtë klinikë, llojin e barnave të përdorura, hapësirat e punës, të fotografojmë*

<sup>39</sup> Procesverbali 18 tetor 2011, faqe 35

<sup>40</sup> Raport i veçantë nga Z.K. për Ministrin e Shëndetësisë, data 6 nëntor 2008, faqe 1 versioni anglisht

<sup>41</sup> Kallëzimi penal, F.M., data 10 nëntor 2008, faqe 2 versioni anglisht

<sup>42</sup> Raporti mbi kontrollin e vendit të ngjarjes, M.S., data 10 nëntor 2008, faqe 1 versioni anglisht

*pajisjet e përdorura dhe të gjenden të gjitha dokumentet relevante për hetim të mëtutjeshëm në këtë rast.*

*Përveç ekipit nga Njësi i Vendit të Krimit të Departamentit të Mjekësisë Ligjore, ekipi i dokumentimit ka përfshirë edhe këta: :*

- 1) A.B.—hetuese, DKKO-SHTQNJ*
- 2) B.GJ.—Kryeinspektor, Inspektorati Farmaceutik, Ministria e Shëndetësisë*
- 3) R.M.—Inspektor, Inspektorati Farmaceutik, Ministria e Shëndetësisë*
- 4) SH.H.— Inspektor, Inspektorati Farmaceutik, Ministria e Shëndetësisë*
- 5) L.F.— Inspektor, Inspektorati Farmaceutik, Ministria e Shëndetësisë*
- 6) SH.V.— Inspektor, Inspektorati Farmaceutik, Ministria e Shëndetësisë*
- 7) A.G.—Patolog i mjekësisë ligjore*
- 8) SH.O.—Inspektor, Ministria e shëndetësisë*
- 9) A.M.— Inspektor, Ministria e shëndetësisë*
- 10) A.J.—Ekspert i TI të mjekësisë ligjore, DKKO”<sup>43</sup>*

Për shkak të numrit të madh të medimenteve, hetuesit dhe inspektorët kanë ardhur në klinikë, inspektorët farmaceutik kanë ofruar ndihmë praktike dhe teknike e nevojshme për të kuptuar natyrën e saktë të veprimtarive mjekësore të kryera në klinikë. Inspektorët farmaceutik dhe ata shëndetësor, punojnë brenda Ministrisë së Shëndetësisë dhe ushtrojnë autoritet të njëkohshëm. Nuk ka ndonjë dallim në mes të inspektorëve farmaceutik dhe inspektorëve shëndetësorë. Shih nenin 6 d të Ligjit për Inspektoratin Shëndetësor i cili liston medikamentet si një nga përgjegjësitë e inspektorëve shëndetësorë.

Pas përshkrimit të aktiviteteve të ekipit me 4 nëntor, raporti i S. vazhdon:

*Rreth orës 17:45 të së njëjtës datë ne kemi pezulluar aktivitetin tonë në klinikë për të rifilluar ditën tjetër, 05/11/2008 në ora 10:30. Rreth orës 10:30 ne jemi takuar me toger R.A., Shef i Njësitit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe inspektorët nga Inspektorati Farmaceutik, Ministria e Shëndetësisë: B.GJ., R.M. dhe SH.H.. Ekipi nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore, Njësi i Vendit të Ngjarjes, i përbërë nga kapiteni M.S. dhe teknikët e krimit F.A. dhe H.SH. Fillimisht ne kemi hartuar planet për dokumentimin e përbashkët për veprimet e përbashkëta në këtë vend.<sup>44</sup>*

Pas regjistrimit të të gjitha dokumenteve mjekësore, të dhënat e pacientit, departamentet dhe pajisjet mjekësore të identifikuar gjatë kontrollit të datës 5 nëntor, raporti thotë:

*Të gjitha këto janë konfiskuar nga Inspektorati i Farmacisë në Ministrinë e Shëndetësisë.<sup>45</sup>*

Në “Aktivitet e kryera më 06.11.2008,” raporti vazhdon:

*Rreth orës 11:05 të po kësaj dite ne kemi vazhduar me kontrollin e mëtutjeshëm në këtë klinikë, duke vazhduar me katin e dytë ku ne e kemi identifikuar me “C”. Laboratori i klinikës ishte i vendosur në këtë kat. Inspektori i farmacisë B.GJ. së bashku me Specialistin e kriminologjisë/teknikun H.SH. kemi shkuar në katin e parë i emëruar me “B” në dhomën të identifikuar me numrin 12 si dhoma e operacioneve dhe janë marrë medikamentet e skaduara*

<sup>43</sup> Id., faqe 2

<sup>44</sup> Id., faqe 4

<sup>45</sup> Id., faqe 7

nga kompleti i kirurgjisë të cilat në dëshmi ishin identifikuar si E# 12.1. Këto medikamente janë kontrolluar dhe regjistruar më vonë janë konfiskuar nga inspektorët e farmacisë. Gjithashtu, inspektorët farmaceutik i kanë marrë të gjitha mE.amentet tjera, të cilat sipas tyre nuk kanë afat të skadencës ose në njëfarë mënyre kanë pasur arsye të jenë në klinikë.<sup>46</sup>

Nën “Aktivitetet e kryera më 07.11.2008,” në raport shkruan:

*Rreth orës 11:00 Tekniku i kriminalistikës F.A. së bashku me Inspektorët Farmaceutik dhe inspektorin e shëndetësisë Z.K. kanë vazhduar aktivitetet në klinikë.<sup>47</sup>*

Nën “Aktivitetet e kryera më 10.11.2008,<sup>48</sup>” në raport shkruan:

*“më 10.11.2008 rreth orës 13:15 teknikët e kriminalistikës, rreshteri S.V. dhe H.SH. ishin dërguar në Klinikën Medicus për të ndihmuar Inspektorët Farmaceutik dhe ata të shëndetësisë nga Ministria e Shëndetësisë gjatë procesit të pranimit-dorëzimit të mE.amenteve të konfiskuara...”<sup>49</sup>*

## **G. Dispozitat relevante të Kushtetutës së Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)**

Dispozita përkatëse e Kushtetutës së Kosovës e thotë këtë:

### **Neni 36, E drejta e Privatësisë**

1. [...]
2. *Kontrollet e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.*

Dispozitat zbatuese të KPPK-së që drejtojnë kontrollin dhe konfiskimin gjenden në Kapitullin XXVIII: VEPRIMET HETIMORE, Neni 5, Kontrolli dhe Konfiskimi i përkohshëm, nenet 240-253.

## **H. Analiza**

Prokurori së pari argumenton se dispozitat zbatuese në KPPK thjeshtë nuk zbatohen në këtë rast për shkak të dispozitave të nenit 201 (1) dhe (2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ceken në pjesën përkatëse si më poshtë:

*(1) Kur ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer një vepër penale që ndiqet sipas detyrës, policia detyrohet goftë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit publik, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të përcaktuar vendndodhjen e kryerësit, të ndalojë kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, të gjejë dhe të ruajë gjurmët dhe*

<sup>46</sup> Id.

<sup>47</sup> Id., faqe 8

<sup>48</sup> Nuk ka ndonjë të dhënë në raport për datën 8 dhe 9 nëntor të cilat ishin ditë të vikendit.

<sup>49</sup> Raporti për kontrollin e vendit të ngjarjes., faqe 9

*provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurë penale.*

*(2) Për të kryer detyrat nga paragrafi 1 i këtij neni policia ka autorizim:*

...

*6) Të kontrollojë në praninë e personit përgjegjës objektet e veçanta dhe lokalet e organeve publike dhe të shqyrtojë dokumentet e veçanta që u përkasin atyre;*

*7) Të konfiskojë sendet të cilat duhet të merren sipas Kodit të Përkohshëm Penal, ose që mund të shërbejnë si prova në procedurë penale*

Së pari, prokurori debaton se neni 201 qëndron në vete dhe nuk është modifikuar apo kufizuar me dispozitën e nenit 240 e më tutje. Me fjalë të tjera, policia e ka autoritetin të kontrolloj vende dhe konfiskoj objekte pavarësisht dispozitave specifike që përcaktojnë kontrollin dhe konfiskimin. Gjykata nuk pajtohet me këtë rresht të arsytimit. Fillimisht, duhet të theksohet se paragrafi 6 i referohet ndërtesave dhe lokaleve publike. Klinika Medicus ishte institucion privat i kujdesit shëndetësor dhe jo një vend publik, dhe kështu që nga kushtet e tij paragrafi 6 nuk aplikohet. Fakti që klinika ka ofruar shërbim publik për pacientët dhe ishte e obliguar të respektoj ligjin për shëndetësi me të gjitha sanksionet dhe ndalesat nuk e ka ndryshuar ekzistencën ligjore nga institucioni privat në atë publik.

Për më shumë, për të pranuar interpretimin e zgjeruar të prokurorit do të thoshte se neni 36, paragrafi 2 i Kushtetutës së Kosovës, gjithashtu edhe dispozitat e hollësishme të kapitullit XXVIII, neni 5 i KPPK-së, janë të padobishme dhe të dizajnuara për të mbrojtur të drejtën e rëndësishme të privatësisë të qytetarëve të Kosovës. Gjykata nuk dëshiron të hedh poshtë kaq lehtë këto mbrojtje të rëndësishme. Prandaj, ky argument duhet të refuzohet.

Prokurori gjithashtu paraqet një argument bazuar në nenin 245, i cili nxjerr përjashtimet në kërkesat e urdhrin për kontroll:

*(1) Kur është e domosdoshme dhe në masë të nevojshme, policia mund të hyjë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojë kontrollin pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake nëse:*

*1) Personi përkatës me dije dhe me vullnet pajtohet me kontrollin;*

*2) Personi thërret për ndihmë;*

*3) Kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes;*

*4) Arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë e kërkojnë një veprim të tillë ose*

*5) Personi kundër të cilit është lëshuar urdhër arrest nga gjykata gjendet në shtëpi apo në lokale të tjera.*

Dispozitat e vetme të nenit 245 (1) të cilat mund të arsyetojnë kontrollin pa urdhër për kontroll në këtë rast janë nën-paragrafi 1 (pëlqimi), 3 (kryerësi është kapur në vepër), dhe 4 (siguria e popullatës).

Megjithatë, nuk ka ndonjë pretendim të qëndrueshëm se ky ishte një kontroll me pëlqim siç dëshmohet nga ekstraktet e procesverbaleve të cituara më lart. Ka dëshmi se anëtarët e personelit mjekësor në Klinikë ishin të pranishëm por rrethanat mohojnë ndonjë kërkesë për pëlqim. Gjithashtu, personat e vetëm të cilët qartë kishin autoritet për të dhënë pëlqimin ishin L.D., T. dhe A.D.. L.D. nuk ishte i pranishëm kurse T. ishte jo-bashkëpunues. A.D. ishte paraqitur te vendi i ngjarjes porse kontrolli tashmë kishte filluar.

Nuk ka as pretendim të qëndrueshëm se kryerësi ishte kapur në vepër që do të duhej të arrestohej pas ndjekjes. Përderisa policia kanë mundur të dyshojnë apo shpresojnë se ata do të mund të kapnin dikë në vepër të transplantimit të veshkës, ky nuk ishte rasti, dhe në asnjë rast nuk kishte ndonjë ndjekje. Ekziston një pretendim se H. dhe S. kanë mundur të ikin nga klinika në një kohë, por ky është spekulim i thjeshtë.

Pohimi më i arsyeshëm dhe ajo në të cilën kryesisht është mbështetur prokurori është se kontrolli është kryer nga shqetësimi për sigurinë e personave. Faktet relevante, të përshkuara më lart, tregojnë se djali i ri turk, Y.A., ka ofruar informata të rëndësishme gjatë mesditës të datës 4 nëntor te inspektori M. – posaçërisht se ai e kishte të hequr veshkën në Medicus në një kohë shumë të afërt. Kjo ishte një dëshmi e rëndësishme se në Medicus po kryhej veprimtaria e paligjshme, dhe menjëherë ka kërkuar veprimin e policisë. Deri në këtë fazë nuk kishte asnjë dëshmi relevante se transplantimi apo ndonjë veprimtari tjetër joligjore atje po kryhej. Kjo dëshmi e re e ka shtyrë hetuesin policor M. që të urdhëroj që rreth orës 13:00 të sigurohet vendi i ngjarjes dhe të mobilizohet një operacion kontrolli i cili menjëherë ka rezultuar rreth orës 16:00-16:30, përafërsisht rreth tri orëve më vonë.

Siç u përmend më herët, neni 245, paragrafi(1), nënparagrafi 4, lejon policinë të hyjë në lokale pa urdhrin e askujt “nëse është e nevojshme dhe për aq sa është e nevojshme” nëse “arsyet për mbrojtjen e njerëzve...e kërkojnë një veprim të tillë.”

Sidoqoftë, paragrafi 3 i po të njëjtit nen 245 trajton situata të ngjashme:

*“Përbashkësisht, në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontrollit nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave, ose rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, policia gjyqësore mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes verbale nga gjyqtari i procedurës paraprake. (është shtuar theksimi).*

Të dyja neni 245 (1) paragrafi 4 dhe neni 245 (3), merren praktikisht me të njëjtin shqetësim: sigurinë e njerëzve, dhe rrezikun për jetën ose shëndetin e njerëzve. Njëri lejon hyrjen pa urdhër; tjetri kërkon urdhër verbal. Për këtë arsye është e nevojshme të mundohemi ti bashkërendojmë këto dispozita.

Paragrafi 1 i nenit 245 duhet të interpretohet që të merret me situatat unike që po ndodhin për momentin—krahas shqetësimeve të sigurisë, gjithashtu përfshinë thirrjen për ndihmë, ndjekjen imediate, dhe nevojën për të hyrë për të bërë arrestime. Me fjalë tjera, situatat që kërkojnë veprime të menjëhershme. Këto situata duhet të jenë në kontrast me situatat e mundshme të sigurisë të cilat nuk kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme. Me fjalë tjera, mund të ketë shkallë të ndryshme të urgjencës që implikojnë dispozita të ndryshme të nenit 245. E tëra varet nga faktet e rastit në veçanti.

Situata Medicus bie në kategorinë e dytë- neni 245 (3). Vetë policia nuk e pa të nevojshme hyrjen e menjëhershme në klinikë, dhe ndërmoi disa hapa para se të ndërhyjë. M. kontaktoi me eprorin e tij dhe kërkoi praninë e një numri të madh të policisë në klinikë rreth orës 13:00. Disa oficerë u mobilizuan dhe erdhën në vendin e ngjarjes. Ata pastaj morën në kontroll

vendin e ngjarjes dhe e rrethuan objektin. M. po ashtu kontaktoi me agjenci të ndryshme, përfshirë inspektorë të shëndetësisë, dhe të gjithë u nisën për tek vendi i ngjarjes para se të fillonte bastisja. Vetë M. nuk kishte arritur tek vendi i ngjarjes deri rreth orës 15:00-15:30, duke vazhduar me arrestimin e L.D., dhe bastisja nuk filloi deri rreth orës 16:00-16:30, përafërsisht tri orë pasi që M. kontaktoi për herë të parë eprorin e tij.

Duke pasur parasysh këtë sekuencë të ngjarjeve, ishte e qartë se këto nuk ishin rrethana që do të shmangnin kërkimin e marrjes së lejes verbale nga gjyqtari i procedurës paraprake. Trupi gjykues vëren se situata rrodhi gjatë disa orëve gjatë ditës së punës dhe nuk do duhej të kishte ndonjë shqetësim lidhur me faktin se a do të gjendej ndonjë gjyqtar. Në fakt, prokurorët ishin në ndërtesën e njëjtë, dhe përveç kësaj ishin në dijeni rreth numrave të telefonit të gjyqtarëve në gjendje kujdestarie.

Trupi gjykues është gjithashtu i mendimit se situata në klinikë bie në fushëveprimin e nenit 243 (2), i cili thotë:

*“Gjatë kontrollit të personit, shtëpisë ose lokaleve të tjera kërkohet të jenë të pranishëm dy persona të rritur si dëshmitarë. Para fillimit të kontrollit, dëshmitarët paralajmërohen që me kujdes të vëzhgojnë zbatimin e kontrollit dhe njoftohen mbi të drejtën e tyre për të bërë vërejtje, nëse kanë, për përmbajtjen e procesverbalit të kontrollit para se të nënshkruhet.”*

Siç u theksua më lartë, është e qartë se asnjë person nuk ishte i pranishëm si dëshmitar. Megjithatë, ekziston një përjashtim për këtë kërkesë, në nenin 245 (4), i cili thotë:

*“Përjashtimisht, kontrolli mund të zbatohet pa praninë e dëshmitarëve nëse prania e tyre nuk mund të sigurohet menjëherë dhe vonesa e fillimit të kontrollit do të ishte e rrezikshme. Arsyet për zbatimin e kontrollit pa praninë e dëshmitarëve shënohen në procesverbal.”*

Nën rrethanat e këtij rasti, nuk zbatohet ky përjashtim. Kishte kohë të mjaftueshme për të aranzhuar praninë e dy dëshmitarëve. Për më tepër, nuk ka arsye për zbatimin e kontrollit pa përmendur dy dëshmitarët në procesverbal. Në të vërtetë, nuk kishte referencë të kësaj kërkesë në asnjë nga raportet e policisë.

Sikur mos të ishte involvimi i drejtpërdrejt dhe substancial i Inspektoratit të Shëndetësisë siç diskutohet menjëherë më poshtë, provat e konfiskuara gjatë kontrollit do të deklaroheshin të papranueshme sipas nenit 246, KPPK, i cili thotë:

*Provat e mbledhura nëpërmjet kontrollit janë të papranueshme nëse:*

*1) Kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi;*

*...5) Personat, prania e të cilëve është e detyrueshme, nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kontrollit (neni 243, paragrafët 1 dhe 2 të këtij Kodi).*



Ekziston edhe një kërkesë sipas nenit 245, paragrafi 6, për paraqitjen e raportit të kontrollit, nëse kontrolli është kryer pa urdhër me shkrim:

*Nëse policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor ajo brenda afatit prej dymbëdhjetë orësh lidhur me këtë i dërgon raport prokurorit publik dhe gjyqtarit të procedurës paraprake nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar i procedurës paraprake.*

Avokati mbrojtës V. argumentoi se kjo dispozitë ishte shkelur dhe se kjo shkelje përbën një arsye tjetër për deklarimin e provës si të papranueshme.

Siç vërehet, Oficeri M. ngriti kallëzim penal me 7 nëntor. Megjithatë, R.A., në përgjigje ndaj pyetjes së F.V., avokatit mbrojtës të I.R.R., tha se një kallëzim penal dallon nga një raport i kontrollit. ( Procesverbal, 20 tetor, faqe 37). Gjithashtu, kapiten S. ka paraqitur një raport me 10 nëntor . Duket se asnjëri nga raportet nuk i plotëson kërkesat e nenit 243 (7). Megjithatë, mungesa e një raporti të kontrollit nuk është bazë për papranueshmërinë sipas nenit 246 të KPPK-së.

## **H. Ligjet përkatëse të shëndetësisë**

Zbatueshmëria e dispozitave të shtjelluara më lartë të KPPK-së, që udhëheqin kontrollet nga autoritetet zbatuese të ligjit megjithatë nuk janë zgjedhje e çështjes, duke marr parasysh autoritetin e pavarur ligjor të inspektorëve të shëndetësisë nga Ministria e Shëndetësisë.

Së pari, si çështje faktike, është e qartë se inspektorët e shëndetësisë/farmacisë nga Ministria e Shëndetësisë kanë luajtur rol kyç, nëse jo dominues, gjatë kontrollit. Kjo është reflektuar në dëshminë e dëshmitarëve dhe raporteve të ndryshme, siç përshkruhet më lartë.

Autoriteti i këtyre inspektorëve që ekziston në ligjet relevante të shëndetësisë së Kosovës është jashtëzakonisht i gjerë. Këtu kemi ndërthurje dhe përmbledhje të tre ligjeve.<sup>50</sup> Këta janë ligjet në të cilët është mbështetur Z.K., kryeinspektori i shëndetësisë, në raportin e tij të cekur më lartë.

### **1. Ligji i Kosovës për shëndetësi 2004/4 i pajis ata me autoritetin si vijon:**

Neni 46: Nuk lejon veprimtarinë private shëndetësore, përfshirë transplantimin e organeve njerëzore.

Neni 101.2: Të gjitha institucionet shëndetësore do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes profesionale, të brendshme dhe të jashtme.

Neni 102.1: Mbikëqyrja e jashtme profesionale zbatohet nga ana e inspektoratit shëndetësor

---

<sup>50</sup> Gjuha është parafrazuar dhe nuk është fjalë për fjalë.

Neni 110.1: Transplantimi i organeve bëhet vetëm në institucionin shëndetësor të autorizuar për këtë qëllim nga Ministria e Shëndetësisë.

## **2. Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi, adreson të mëposhtmet:**

Neni 26.1: Mbikëqyrja e jashtme profesionale bëhet nga Inspektorati Shëndetësor, përveç tjerave.

Neni 27.1: Të gjitha dokumentet duhet të jenë në dispozicion të zyrtarit për mbikëqyrje.

Neni 27.2: Gjatë mbikëqyrjes, zyrtarit mbikëqyrës duhet t'i lejohej qasje e lirë në të gjitha hapësirat.

Neni 28.1: Do të zbatohen dispozita disiplinore dhe ndëshkimore të përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës si dhe ligjet e tjera përkatëse.

Neni 28.2: Në rast se mbikëqyrësi konstaton se është kryer një vepër penale (krim), ai/ajo është i detyruar që menjëherë të parashtojë kërkesën për fillimin e procedurës para organit kompetent.

## **3. Ligji për Inspektoratin Shëndetësor parashikon:**

Neni 1.1: Inspektorati Shëndetësor ushtron mbikëqyrjen e jashtme profesionale në institucionet shëndetësore sipas nenit 102.1 të Ligjit të Shëndetësisë.

Neni 1.4: Mbikëqyrja e punës së institucioneve shëndetësore nënkupton marrjen e të gjitha masave inspektuese të parapara me këtë Ligj.

Neni 2.4: Njofton Ministrinë e Shëndetësisë, institucionet dhe organet kompetente për punën e paligjshme në institucionet shëndetësore.

Neni 3.6: Inspektorati bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e tij edhe me agjenci tjera të ndryshme, përfshirë Shërbimin Policor të Kosovës.

Neni 6 d dhe f: Inspektorët kryejnë monitorimin e përshkrimit dhe përdorimit të barnave dhe datat e skadimit, dhe të mirëmbajtjes së dokumenteve mjekësore dhe provave si dhe formave tjera të raportimit.

Neni 7.1: inspektorët kanë qasje të lirë.

Neni 7.2: Inspektorët hyjnë lirshëm në çdo kohë dhe në çdo vend pune brenda institucionit.

Neni 7.4: Inspektorët bëjnë inspektimin dhe hulumtimin e domosdoshëm për mbledhjen e provave që konsiderohen të rëndësishme për të siguruar se dispozitat ligjore nga ana e institucioneve shëndetësore janë duke u zbatuar.

Neni 7.7: Inspektorët bëjnë kontrollimin e të gjitha librave dhe dokumentet.

Neni 7.9: Inspektorët kanë autorizim të kopjojnë dokumente dhe t'i konfiskojnë në raste nevojë të dëshmisë.

Neni 7.14: Inspektorët parashetrojnë fletëdenoncim për shkelje të rënda të Ligjit për ngritjen e procedurës penale në gjykatën kompetente.

Këto ligje të ndryshme janë të gjera dhe i japin autoritet të gjerë inspektorëve shëndetësor në mbikëqyrjen e tyre dhe monitorimin e objekteve të kujdesit shëndetësor. Inspektorët janë të autorizuar të hyjnë në objekte shëndetësore në çdo kohë, pa paralajmërim, dhe të inspektojnë objektet në tërësi. Ata gjithashtu janë të autorizuar të sekuestrojnë dokumente dhe prova tjera materiale të cilat mund të jenë relevante për përgjegjësitë e tyre. Dhe me rëndësi është që nuk ka asnjë kërkesë për inspektorët e shëndetësisë që të marrin urdhër gjyqësorë para se të hyjnë dhe të bëjnë kontrollin e objektit, si dhe sekuestrimin e provave.

Ligjet shëndetësore, natyrisht, që kanë qëllim të ndryshëm nga ligjet që rregullojnë mirësjelljen e policisë, kryesisht për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e personave që shfrytëzojnë institucionet e kujdesit shëndetësor, dhe duke u siguruar se institucionet veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme. Përderisa funksioni i inspektorëve të shëndetësisë nuk është për zbatimin e ligjit, është e rëndësishme të thuhet se në raste të duhura, kërkohet nga ta të bashkëpunojnë dhe koordinojnë me policinë, siç është e përcaktuar në nenin 3.6 të Ligjit për Inspektoratin Shëndetësor, siç u përmend më lartë. Përveç kësaj, neni 197, i KPPK-së, vë një detyrim të ngjashëm:

*(1) Të gjitha organet publike detyrohen t'i paraqesin veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare për të cilat janë informuar ose për të cilat kanë marrë dijeni në ndonjë mënyrë tjetër.*

*(2) Me rastin e paraqitjes së kallëzimit penal organet publike nga paragrafi 1 i këtij neni paraqesin provat që i dinë dhe ndërmarrin masa për t'i ruajtur gjurmët e veprës penale, sendet mbi të cilat ose me ndihmën e të cilave është kryer vepra penale dhe provat tjera.*

Kështu, aktivitetet e inspektorëve shëndetësor në kryerjen e kontrollit, në konfiskimin e provave dhe në bashkëpunim me policinë në këtë rast, janë paraparë në mënyrë të qartë brenda mandatit të tyre me statut.

Lidhur me provat e konfiskuara, informacionin e marr pas shpalosjes së situatës, sikur faktin se Y.A. ia kishte dhuruar veshkën, dhe se B.SH. e kishte marr veshkën, gjithçka që ishte konfiskuar nga inspektorët e shëndetësisë dhe policia kishte një lidhje me çështjet shëndetësore legjitime. Për shembull, të dhënat e mbledhura nga kompjuterët dhe librat e protokollit mund të zbulojnë dhurues dhe marrës të tjerë të cilit kishin nevojë për vazhdim të kujdesit shëndetësor. Si një shembull tjetër, barërat e konfiskuara mund të demonstrojnë llojet e procedurave që janë kryer në klinikë, si transplantimi i organeve.

## **I. Konkluzione lidhur me kontrollin**

Nën rrethanat specifike të këtij rasti, policia kishte kohë të mjaftueshme për të kontaktuar gjykatësin për së paku një urdhër verbal për kontroll. Dështimi i tyre për ta bërë këtë gjë nuk gjen kurrfarë justifikimi në faktet relevante. Gjithashtu, mungesa e dy dëshmitarëve të rritur nuk është e justifikueshme, pasi që policia po ashtu ka pasur kohë të mjaftueshme për të siguruar praninë e tyre. Prandaj, po mos të përfshiheshin shumë afër inspektorët shëndetësor, prova e konfiskuara në Klinikë do të ishin të papranueshme. Megjithatë, aktivitetet e kryera nga inspektorët e shëndetësisë nën autoritetin e tyre të gjerë ishin të ligjshme, dhe në fakt me mandat, dhe të gjitha provat e marra prej tyre në bashkëpunim me policinë janë të pranueshme.

Prandaj, propozimi i avokatit mbrojtës për t'i deklaruar si të papranueshme provat e sekuestruara gjatë kontrollit të Klinikës Medicus, refuzohet si i pabazuar.

## **VI. Autorizimi ose jo autorizimi i Klinikës Medicus për të kryer operacione të transplantimit të veshkëve.**

Fakti nëse Klinika Medicus ka qenë e licencuar si duhet apo e autorizuar për të kryer transplantime të veshkëve është i rëndësishëm për këtë rast. Edhe pse disa nga akuzat lidhur me këtë janë refuzuar për arsye të periudhës së parashkrimit, është ende e nevojshme të shqyrtohet kjo çështje në detaje sepse kjo ndikon në aspekte të tjera të rëndësishme të këtij rasti. Në fakt, është pretenduar nga avokati mbrojtës i L.D. dhe A.D. se një licencë ose autorizim ishte lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, ose së paku ata e kishin një besim të arsyeshëm se leja apo autorizimi ishte lëshuar.

Dëshmitarët e mëposhtëm kanë dhënë dëshmi relevante:

1. A.G., procesverbali i datës 30 nëntor 2011, faqe 4-26, dhe 19 dhjetor 2011, faqe 2-15
2. A.K., , procesverbali i datës 19 dhjetor 2011, faqe 16-33
3. SH.M. procesverbali i datës 13 shkurt 2012, faqe 2-23
4. N.H. procesverbali i datës 23 mars 2012, faqe 2-16
5. M.B., procesverbali i datës 9 tetor 2012, faqe 2-25.

### **A. Ligjet relevante të shëndetësisë**

Me 19 shkurt 2004, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Shëndetësi në Kosovë, nr. 2004/4. Ky ligj është referuar më lartë në diskutimin rreth ligjshmërisë së kontrollit të klinikës Medicus. Është e dobishme të kujtojmë se neni 46 thotë se,

*Veprimtaria private shëndetësore nuk lejohet në këto lëmi:*

*d) Marrja, ruajtja [,] transporti dhe transplantimi i indeve dhe organeve njerëzore përveç se në raste të autotransplantimit*

Neni 110 parashikon që,

*110.1 Transplantimi i organeve dhe i indeve bëhet vetëm në institucionin shëndetësor të autorizuar për këtë qëllim nga Ministria e Shëndetësisë.*

*100.3. Dispozitat lidhur me largimin ose transplantimin e organeve dhe/ose indeve, përcaktohen me ligj të veçantë.*

Me 27 shtator 2004, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 2004/50, **Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi**, i cili gjithashtu ishte referuar më lartë. Pas luftës, objektet e kujdesit shëndetësor kanë vepruar pa licencë, dhe ky ligj, për herë të parë, parasheh licencimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor në sektorin privat, në nenin 2, dhe licencimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor në nenin 4.

Neni 2.1 thekson se,

*Profesionisti i kujdesit shëndetësor, mund të ushtrojë veprimtarinë shëndetësore në sektorin privat të Kosovës, nëse:*

*a). Ai/ajo është profesionist i licensuar i shëndetësisë.*

Neni 4.3 parasheh që,

*Institucionet private të kujdesit shëndetësor nuk do të ushtrojnë veprimtari shëndetësore nëse nuk kanë licencën e lëshuar nga Bordi [për Licencim].*

Neni 5 përcakton Detyrimet e Institucionit. Në veçanti, neni 5.2 parasheh që,

*Veprimtaria private shëndetësore nuk lejohet në fushat e përcaktuara me nenin 45 [kështu; duhet të jetë neni 46] të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.*

Ligji po ashtu ka themeluar Bordin për licencim të institucioneve të kujdesit privat shëndetësor (neni 9), dhe përcaktoi përbërjen, menaxhimin dhe mandatin e bordit në nenet në vijim. Për më tepër, ligji krijoi procedurat për aplikim për lejimin apo refuzimin e dhënies së licencës (neni 20, dhe në vijim.).

Neni 29.2 parasheh që,

*Për qëllimet e zbatimit të këtij Ligji, Ministria [e Shëndetësisë] duhet të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore.*

Në ushtrimin e autoritetit të vet sipas nenit 29.2 (në mesin e autoriteteve tjera), Ministria e Shëndetësisë lëshoi “Udhëzimin Administrativ 08/2007 për shërbim spitalor në Kosovë ” që hyn në fuqi në vitin 2007. Ky udhëzim përcaktoi, për herë të parë të gjitha kërkesat për krijimin e llojeve të ndryshme të shërbimeve spitalore (p.sh., kardiologji, urologji). Deri në këtë kohë, asnjë licencë nuk i është dhënë ndonjë objekti të kujdesit privat shëndetësor nga Ministria e Shëndetësisë.

## **I. Zhvillimi dhe Evoluimi i Klinikës Medicus: Kronologjia e ngjarjeve**

Dëshmitë e dëshmitarëve të listuar më lart dhe provat materiale shfaqin gjendjen faktike vijuese:

M.B. u takua për herë të parë me L.D. kur ky i fundit po kryente studimet mjekësore post-universitare , si student në shkëmbim. B. e kuptoi se D. ishte kirurg i shkathtë dhe kolegë i besueshëm. Pasi që L.D. u kthye në Prishtinë, ata kontaktuan kohë pas kohe. Kur shpërtheu lufta në Kosovë, B. e ftoi L.D. dhe familjen e tij në Berlin, ku dhe shkuan dhe qëndruan për gjashtë muaj. Kur L.D. u kthye në Prishtinë, B. ia bleu atij një veturë të përdorur, dhe i dha pajisje mjekësore që të fillojë praktikën e tij, të cilën ai e nisi.

Një aplikim për regjistrimin e biznesit ishte dorëzuar nga D. në zyrën e përkohshme të Regjistrimit të Biznesit të UNMIK-ut me 09.06. 2000 për “ Ordinancën Urologjike ‘Medicus" (numri i aplikimit 1902560) . Sipas Regjistrimit të Organizatave të Biznesit dhe Emrave Tregtar “Ordinanca Urologjike ‘Medicus", me numër të regjistrimit 80126301 ishte regjistruar si një biznes më 18 gusht 2000. Aktiviteti i saj kryesor u rendit si Aktivitete të praktikës mjekësore ( 8512 ) . Aktivitete të tjera të listuara ishin Aktivitete të tjera të shëndetit të njeriut ( 8514 ) dhe shitje me pakicë të produkteve mjekësore dhe ortopedike. (5232) .

B. dhe D. mbetën në kontakt , dhe B. ra dakord që të investojë në një klinikë të re që D. donte të zhvillonte, e cila atëherë ishte në fazën e ndërtimit dhe e cila do të bëhej objekt fizik i Klinikës Medicus në Fushë Kosovë .

Në katin përdhësë të Klinikës ishte njësia e urologjisë . D. dhe B. diskutuan për krijimin e një shërbimi shtesë në katin e parë , që përfshinte dializë dhe transplantime të veshkëve por B. gjatë disa diskutimeve mbi këtë temë kundërshtoi me forcë transplantimin e veshkëve për shkak të kujdesit të dobët post- kirurgjik në Kosovë. Pastaj të dy ranë dakord të krijojnë një njësi të kardiologjisë në katin e parë .

Në vitin 2004 , ata formuan një kompani, qëllimi i të cilit ishte për të aktivizuar klinikën e kardiologjisë , dhe ata të dy ishin aksionarë. Plani ishte që mjekët gjermanë do të punojnë në klinikë , së bashku me mjekët vendorë.

Më 22 tetor 2004, Klinika Medicus u regjistrua me emrin zyrtar-N.P.M Klinika për Kardiokirurgji "Medicus" me numrin e regjistrimit të biznesit:70199987. Bashkëpunëtorët e radhitur në regjistrim ishin L.D. dhe M.B. Aktiviteti zyrtar i klinikës u përcaktuar si: aktivitetet i praktikës Mjekësore (8512) dhe Aktivitete të Tjera për Shëndetësinë e Njeriut (8514).

Në shkurt 2005 M.B. e autorizon Avokatin F.B. për të nënshkruar dhe vërtetuar në emër të tij dhe në mungesë të tij shitjen/blerjen e katit të parë të ndërtesës (Medicus) në Fushë Kosovë. Shitësi ishte L.D. dhe blerësi ishte B. Çmimi i blerjes ishte 110.000,00€. Marrëveshja u finalizua përmes kontratës më 14 mars 2005.

Më 20 qershor 2005 Drejtori i Klinikës Medicus L.D. ka kërkuar nga Bordi për Licencim pranë Ministrisë së Shëndetësisë licencë për kardiokirurgun V.K. për të punuar në Klinikën Gjermane për Kirurgji Kardiake "Medicus" në rast të nevojës.

Angazhimi i B. ishte ekskluzivisht në klinikën e kardiologjisë në katin e parë, dhe ai nuk kishte lidhje me njësinë e urologjisë në katin për dhese. Në total, B. kishte investuar 450.000 në 500.000 euro në klinikën e kardiologjisë dhe pronën përreth. Me kalimin e kohës, B. vazhdoi të jetë pronari i Klinikës së Kardiologjisë në katin e parë, ndërsa pronësia e klinikës së urologjisë mbeti tek D.

Më 20 qershor 2005, L.D. ka kërkuar nga Bordi për Licencim në Ministrinë e Shëndetësisë për një licencë për kardiokirurgji për prof. V.K. për të punuar në "Klinikën Gjermane të kardiokirurgjisë "Medicus" në rast nevoje.

Më 19 gusht 2005 numri i regjistrimit të biznesit 70293202 ishte regjistruar si "NPM Klinika e Kardiokirurgjisë "Medicus". Si pronar ishte regjistruar M.E.B. . Aktivitetet primare ishin të shënuara si Aktivitete të Praktikës Mjekësore (8512) dhe aktivitete të tjera të cilat ishin Aktivitete për Shëndetin e Njeriut (8514) dhe shitja me Shumicë e mallrave farmaceutike (5146). L.D. ishte regjistruar si pjesëmarrës i autorizuar.

Më 10 dhjetor 2007 "Klinika e urologjisë "Medicus " e kishte dorëzuar një kërkesë për një licencë në fushën e urologjisë, e cila ishte refuzuar për shkak të "mungesave të mëdha" ndër të tjera për shkak të mungesës së specifikuar të aktiviteteve të Institucionit Shëndetësor Privat.

Më 13 Dhjetor 2007 Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë Vendimin 10/630/77. Bazuar në raportin e inspektimit lidhur me klinikën Medicus, U.H. ishte gjobitur me 500€ për shkelje të Udhëzimit Administrativ në lidhje me licencimin e përkohshëm të rezidentëve profesionistëve shëndetësor jo kosovar, i cili ua ndalon këtyre të fundit kryerjen e aktiviteteve shëndetësore pa u pajisur me licencë sipas legjislacionit në fuqi.

Në të njëjtën datë, Ministria e Shëndetësisë gjithashtu lëshoi një tjetër Vendim me nr. 10/62877me të cilin Klinika Medicus u gjobit me 3000 € për shkelje të Ligjeve të aplikueshme të shëndetësi dhe udhëzimeve administrative që ndalojnë kryerjen e veprimtarive të kardiokirurgjisë në ambientet e punës derisa klinika ta merr një licencë në këtë fushë të mjekësisë.

Më 21 dhjetor 2007, një kërkesë është bërë për J.S. për t'u licencuar si një profesionist jo- kosovar i Shëndetësisë . D. kishte qenë i interesuar në kryerjen e transplantimeve të veshkëve qysh në ditët e diskutimeve të tij të hershme me B. rreth konfigurimit të duhur të Klinikës Medicus . Në vitin 2005 apo 2006 , L.D. pyeti për të bërë një lidhje me një kirurg për transplantim në një konferencë në Stamboll. S. përfundimisht kontaktoi D., dhe ata ranë dakord për të bashkëpunuar në Klinikën Medicus .

Më 9 janar 2008, nën- komisioni për Bordin Qendror për Licencimin e Mjekëve në Ministrinë e Shëndetësisë zhvilloi një takim në të cilin është konstatuar se J.S. , Specialist i Kirurgjisë së Përgjithshme , dhe U.H. , specialist për kardiovaskulari dhe kirurgji torakale plotësuan kushtet për licencim. Nën- komisioni rekomandoi dhënien e certifikatave - licencave për të dy mjekët. Në një vendim të së njëjtës datë ,Bordi Qendror lejoi angazhimin e përkohshëm të dy mjekëve . Në vendim është përmendur se të gjitha kushtet ishin plotësuar me përjashtim të njërës për licencimin e vet institucionit shëndetësor.

Më 10 janar 2008, një kërkesë zyrtare në emër të Klinikës Medicus për licencë të urologjisë ishte paraqitur pranë Ministrisë së Shëndetësisë. Kjo licencë ishte kërkuar për katin e parë apo përdhese të Klinikës Medicus. Pagesa e aplikimit për licencë prej 3,000€ ishte bërë nga klinika si dhe të gjitha dokumentet e nevojshme qenë dorëzuar. Sidoqoftë nuk ka asnjë provë se kjo licencë ishte lëshuar ndonjëherë.

Më 17 janar 2008, një kontratë e Punësimit u nënshkrua ndërmjet Y.S. dhe "Medicus" (L.D.). Kushtet e punësimit përcaktonin që S. do të punojë në pozitën Kirurg i Përgjithshëm - Operacione lidhur me transplantime të veshkëve dhe të organeve të tjera. Vendi i punës u caktua si klinika Urologjike Medicus, dhe data e fillimit të punës ishte 17 janar 2008.

Në mars 2008, I.RR., njëri prej të pandehurve, u emërua nga ministri i Shëndetësisë, A.G. si ushtrues detyre i Sekretarit Permanent në Ministrinë e Shëndetësisë. Sekretari i Përhershëm është shërbyes kryesor civil brenda Ministrisë. RR. ishte edhe Kryetar i Bordit të Licencimit.

Më 8 mars 2008, u zhvillua një transplantim i veshkëve në Medicus. Një person i quajtur "T." kishte dhuruar një veshkë për "F.B.B."

Për shkak se licencat fillestare për S. dhe H. ishin vetëm të përkohshme, D. paraqiti një kërkesë me shkrim në Ministrinë e Shëndetësisë me 20 mars 2008, duke kërkuar një vazhdim të licencave. Vazhdimi ishte lejuar me vendimin e Bordit Qendror.

Më 2 maj 2008, A.D. i shkroi I.RR. dhe A.G. në Ministrinë e Shëndetësisë duke kërkuar aprovimin për transplantim të veshkëve në Klinikën Medicus, duke pretenduar se Spitali i Specializuar Spitali "Medicus" plotëson të gjitha kushtet e nevojshme në lidhje me këtë aktivitet kirurgjikal, duke përfshirë stafin e specializuar për këtë qëllim. Ai përfshiu një "projekt zhvillimi" që përshkruante kapacitetet e klinikës në këtë drejtim. Letra është e datës 2 qershor 2008, por data e saktë është 2 maj 2008 bazuar në numrin e protokollit dhe vulën.

Më 7 maj 2008, Bordi për licencim të institucioneve të kujdesit shëndetësor privat në Ministrinë e Shëndetësisë lëshoi një licencë për institucionin e kujdesit shëndetësor privat në Spitalin special për kardiokirurgji "Medicus" nr.05/1 e cila ishte e vlefshme për 5 vjet deri më 6 maj 2013, dhe i nënshtrohej konfirmimit vjetor. Vendimi dhe licenca janë dhënë për B. dhe Klinikën Medicus.Kjo ishte licenca e parë e këtij lloji e lëshuar nga Bordi.



Licenca ishte dokument dallues në një letër të madhësisë A4 dhe shkruante si vijon:

*Republika e Kosovës  
Qeveria  
Ministria e Shëndetësisë  
LICENCË  
Institucion Shëndetësor Privat  
Spital Special kardiologjie "Medicus"  
M. (E.) B., Pronar  
05/01, Nr. i licencës  
07/05/2008, data e lëshimit  
Vendi, Fushë Kosovë,  
Zona Industriale p/n, Adresa e Institucionit*

*Kryesues i Bordit  
I.RR.*

*Ministër i Shëndetësisë  
A.G.*

Më 12 maj 2008, I.RR. si Kryetar i Bordit për Licencimin e Institucioneve Private dhe u.d. i Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë ka lëshuar një letër për z. A.D. me titull "Konfirmimi i miratimit të licencës për shërbimet Urologjike". Letra është përgjigje për kërkesën e dorëzuar më 2 qershor 2008 nga A.D.. Përgjigja e letrës së datës 12 maj 2008 shkruan si vijon:

*I nderuar z. L. D.*

*Ju informojmë se bazuar në kërkesën e juaj të datës 02/06/2008 [pra; duhet të jetë 02/05/2008] me numër të protokollit 05/2432, pas shqyrtimit të Bordit të Ministrisë së Shëndetësisë për Licencim të Institucioneve private shëndetësore, në parim mundësia është miratuar për një spital special të licencuar- Medicus, për të kryer po ashtu edhe shërbime të urologjisë brenda shërbimeve në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm dhe bazuar në shtojcën e UA 8/2007 që rregullon transplantimin e organeve nga dhuruesit e gjallë.*

Me kërkesën e datës 24 korrik 2008, Spitalit Medicus iu kërkua për të dërguar një raport në Ministrinë e Shëndetësisë në lidhje me aktivitetet në fushën e shërbimeve invazive kardiokirurgjike dhe shërbimeve kardiake.

Me 31 korrik 2008 L.D. i raporton Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me punën e klinikës së Kardiokirurgjisë. Në raportin e tij, ai përsëri iu referua kërkesës së mëhershme zyrtare me shkrim që i ishte dorëzuar Ministrisë lidhur me transplantimet e veshkëve në klinikën Medicus. Ai theksoi se ata kishin "investuar shumë në pajisjet e nevojshme për të kryer transplantime të veshkëve" dhe se ai shpresonte se "pacientët tanë do të trajtohen në vendin tonë nga ana e profesionistëve vendorë; kjo do të kursente një shumë të mjeteve të tyre, si edhe mjete nga buxheti i shtetit tonë".

Më 21 gusht 2008 I.RR. u përgjigj në letrën/raportin. Ai kishte bashkangjitur projekt legjislacionin që merrej me transplantime të organeve dhe komentet e kërkuara me propozim. Ministria ka qenë duke hulumtuar legjislacione të mundshme për të rregulluar transplantimet bazuar në praktikat më të mira evropiane dhe për të adresuar ndikimin e madh në buxhetin e shtetit të krijuar nga dializa. Sidoqoftë, ai nuk e kishte autorizuar ndonjë aktivitet të transplantimit.

### **C. Rëndësia e letrës së datës 12 maj 2008**

Letra e datës 12 maj 2008 pati rëndësi të madhe gjatë gjyqimit. Është e rëndësishme në lidhje me disa nga akuzat kundër I.RR., dhe është e rëndësishme në lidhje me mbrojtjen e paraqitur nga L.D. dhe A.D. se Medicusi në fakt kishte marrë një licencë apo autorizim për transplantimet e organeve, ose të paktën që ata kishin një besim të arsyeshëm se një licencë ose autorizim ishte lëshuar. (Megjithatë, edhe në qoftë se një licencë ose autorizim të ishte lëshuar, ky fakt nuk do të ndikonte në akuzat e trafikimit dhe krimit të organizuar.)

Letra është e shkruar me mbishkrim të Ministrisë së Shëndetësisë, e nënshkruar nga RR. dhe përmban një vulë, por letra nuk është protokolluar në arkiv të Ministrisë dhe nuk ekziston asnjë e dhënë zyrtare për këtë letër. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për ndonjë veprim të Bordit lidhur me aplikimin për licencë të urologjisë. Në të vërtetë, del se asnjëherë nuk ka pasur aplikacion formal për licencë të urologjisë.

RR. e ka shpjeguar në deklaratën e tij para prokurorit dhe gjatë marrjes në pyetje në gjykim, se letra ishte një korrespondencë e zakonshme—një përgjigje e përkohshme për L. D. ku informohet se Klinika në parim kishte marrë miratimin për transplantim të veshkëve, në rast se, dikur në të ardhmen, transplantimet e veshkëve janë të autorizuar në Kosovë përmes legjislacionit të veçantë, i cili në atë kohë po hulumtohej nga Ministria.

Kjo letër formon bazën për dy pikat e akuzës kundër I.RR.: pika 6, keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit; dhe pika 9, falsifikimi i dokumenteve zyrtare. Prokurori ka ndërtuar një teori konspiracioni sipas së cilës RR., me urdhër, apo nga presioni nga SH.M. dhe A.G., ia ka lëshuar këtë dokument shokut të tij, L.D. në Medicus, në mënyrë që të sigurojë “mbulesë” për kryerje të transplantimeve ilegale të veshkëve. Në vazhdim të formulimit të dokumentit, prokurori vë në pah faktin se dokumenti nuk është protokolluar në Ministri, ashtu siç duhej, prandaj për këtë arsye ka mundur të jetë lëshuar me qëllime joligjore në mendje.

Teoria e prokurorit nuk përbën shqyrtim të hollësishëm bazuar në provat e paraqitura në këtë gjykim.

Së pari, është e qartë nga forma e dokumentit se ai nuk përbente një licencë. Forma e saktë e licencës është ilustruar më lartë, dhe haptazi shihet se ky dokument nuk ishte licencë dhe nuk mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme si licencë. Kjo është posaçërisht e vërtetë lidhur

me faktin se një licencë në formë të duhur është lëshuar për klinikën e kardiologjisë Medicus vetëm para disa ditëve.

Është po ashtu e qartë nga teksti i dokumentit se kjo nuk ishte as licencë e as autorizim për të kryer transplantime të veshkëve. Teksti, që ndoshta i formuluar dobët, flet për mundësinë në parim, dhe i referohet saktësisht legjislacionit të zbatueshëm që rregullon transplantimin e organeve. Kjo mund të nënkuptojë nenin 46 të Ligjit të Shëndetësisë që parandalon transplantimin e veshkëve në klinika private.

Në të vërtetë, L.D. dhe A.D. asnjëherë nuk e kuptuan se dokumenti ishte licencë, autorizim ose "mbulesë" për aktivitetet e tyre. Përderisa ata mund të pretendojnë ndryshe, dokumenti, në fakt, asnjëherë nuk është përdorur si i tillë. Asnjë nga dhuruesit dhe marrësit e veshkëve nuk kanë dëshmuar se e kanë parë këtë dokument. Njëri apo dy nga marrësit të cilët iu referuan dokumentit si autorizim po i referoheshin licencës së lëshuar për S. në janar 2008 për të kryer operacione, dhe jo për dokumentin e datës 12 maj 2008.

Gjithashtu, në një korrespondencë të mëvonshme me ministrinë, L.D. ankohet për mos përgjigjen e ministrisë ndaj kërkesës së tij për autorizim. Në raportin e tij drejtuar ministrisë rreth klinikës së kardiologjisë i datës 4 gusht 2008, ai kthen vëmendjen e tij në kërkesën e tij të mëparshme nga Medicus ku kërkon miratimin për të kryer transplantime të veshkëve, dhe e lut ministrin dhe sekretarin permanent të veprojnë në favor të kërkesës së tij në interes të klinikës, duke pasur parasysh investimet financiare që ishin bërë, dhe në interes të qytetarëve të Kosovës dhe të buxhetit të shtetit. Nëse Medicus veçse e kishte këtë "mbulesë" nga ministria, ky përgjërëm i zjarrtë do të kishte qenë plotësisht i panevojshëm.

I.R.R. u përgjigj me 21 gusht 2008, dhe iu referuar draft legjislacionit që po merrej në konsideratë, dhe kërkoi komente. Ishte e qartë, siç ishte në dokumentin e 12 majit 2008, se transplantimet e veshkëve nuk ishin autorizuar, edhe pse çështja është adresuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Prandaj, gjykata pranon shpjegimin e I.R.R. se dokumenti i datës 12 maj 2008 ishte thjesht një njoftim këshillues për atë se nëse një legjislacion i posaçëm autorizues do të miratohej në të ardhmen, klinika "në parim" do të lejohej të kryente transplantime të veshkëve. Dokumenti, nga qëllimi i vet, nuk ishte licencë apo autorizim; nuk kishte për qëllim të ishte licencë apo autorizim; nuk është kuptuar nga Medicus të jetë licencë apo autorizim; dhe nuk është përdorur si licencë apo autorizim. Ky dokument nuk siguron asnjë autorizim dhe ishte vetëm i natyrës informuese.

Gjithashtu, megjithëse dokumenti duhet të ketë pasur numër protokollit dhe i regjistruar në arkiv, kjo ka qenë detyrë krejtësisht administrative dhe jo përgjegjësi e sekretarit permanent. Në kohën kur ministria po merrej me 200 apo më shumë aplikime për licencë, është e pabesueshme se si ky hap administrativ është neglizhuar. Gjykata pranon shpjegimin e I.R.R. se ai nuk e ka anashkaluar me qëllim procedurën e protokollit për të fshehur dokumentin.

Është po ashtu pikëpamje e gjykatës se dokumenti i datës 12 maj 2008 nuk ishte dokument i falsifikuar zyrtar. Prokurori vë theksin në titullin e lëndës që i referohet konfirmimit të një licence të urologjisë, përmbajtja e dokumentit nuk lë asnjë dyshim se është synuar ndonjë licencë apo autorizim. Dokumenti ka mundur të jetë formuluar më qartë, por nuk përmban informacione false, si dhe nuk ka mungesë të informacioneve esenciale.

Ishte thjesht një reagim i sjellshëm për interesim nga A.D., dhe nuk kishte asnjë pasojë ligjore. Edhe nëse ka mund të argumentohet se dokumenti duhet të përmbante deklarata definitive se transplantimet janë ilegale sipas nenit 46 të Ligjit të Shëndetësisë, prokurori ka dështuar të vërtetojë ndonjë qellim ilegal nga ana e I.R.R. Prokuroria ka tendencë për të lexuar këtë korrespondencë lidhur me imejllin e adresuar nga L.D. te M.B., por lë anash atë se shkëmbimi i imejllave ka ndodhur në mars 2008, kështu në atë kohë L. D. nuk ka pasur asnjë dokument/autorizim që e ka lejuar klinikën e tij të kryej shërbime të transplantimit të veshkëve.

Prandaj, Gjykata konkludon se letra nuk ka ofruar një licencë apo autorizim për të kryer transplantimet e organeve, dhe nuk mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme të ketë bërë këtë. Kështu, të gjitha transplantimet e veshkëve të kryera në klinikën Medicus janë bërë në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, dhe ishin të paligjshme. Gjithashtu, është e qartë se L.D. dhe A.D. e kanë ditur se transplantimet ishin të paligjshme. Përveç kësaj, pavarësisht nga statusi i kufizimit, nuk ka përgjegjësi penale nga ana e I.R.R.

## **VII. Transplantimet e veshkëve në klinikën Medicus në vitin 2008**

Çështja kryesore në këtë rast është nëse ka pasur transplantime të veshkëve në klinikën Medicus, dhe nëse po, nga kush, dhe nëse ato transplantime përbënin trafikim të njerëzve dhe krim të organizuar. Në mënyrë që të vërtetohet trafikimi, prokuroria duhet të vërtetojë se dhuruesit e veshkëve ishin shfrytëzuar, dhe për të vërtetuar krimin e organizuar, prokuroria duhet të vërtetojë se trafikimi ka ndodhur përmes veprimtarisë së një grupi të strukturuar kriminal. Gjykata po ashtu duhet të përcaktonte nëse nxjerrja e veshkëve përbënte lëndim të rënda trupore. Gjatë përcaktimit të këtyre çështjeve, gjykata vlerësojë një numër të madh të provave, përfshirë por jo e kufizuar, dëshmi të dëshmitarëve të gjallë, dhuruesve, marrësve dhe tjerëve; prova materiale; korrespondencave me imejlla; incizimin e telefonatave; të dhënave financiare; të dhënave mjekësore dhe ekspertizës; dhe analizave të gjera forenzike.

Mes dëshmitarëve ishin gjashtë persona të cilët dëshmuar si dhurues të veshkëve në seancën kryesore. Dhuruesit ishin dy femra dhe katër meshkuj. Gjykata morri parasysh edhe dëshminë e dhuruesit të shtatë, Y.A., nga Turqia, i cili ishte marr në pyetje në një seancë të posaçme dëgjimore me 17 nëntor 2008 para gjyqtarit të procedurës paraprake. Përkundër përpjekjeve të kujdesshme të autoriteteve turke, A. nuk ka mundur të gjendet për shqyrtimin kryesor.

Dëshmitarët përfshinë edhe nëntë persona të cilët dëshmuar si marrës të veshkëve në seancën kryesore, të gjithë ishin meshkuj dhe të gjithë ishin nga Izraeli, përveç tre prej tyre që ishin nga Polonia, Gjermani dhe Kanada, përkatësisht. Gjykata po ashtu dëgjoj dëshmitë e disa të

afërmëve të dy viktimave marrës të veshkëve të cilët patën njohuri direkt nga klinika Medicus për transplantime të veshkëve. Kështu që, numri i marrësve nën konsideratë është njëmbëdhjetë; numri i dëshmitarëve është 13.

Për shkak të rëndësisë së dëshmisë së dhuruesve dhe marrësve të veshkëve lidhur me çështjen kryesore të rastit, dëshmia e secilit dëshmitar është përmbledhur menjëherë më poshtë. Gjykata gjeti se dëshmitë e dhuruesve dhe marrësve, ishin mjaft të qëndrueshme, të besueshme dhe bindëse. Ngjarjet e tyre ishin shumë të ngjashme lidhur me rekrutimin, aranzhimet financiare, udhëtimin, operacionin dhe detaje tjera të rëndësishme, që tregojnë besueshmërinë e dëshmisë.

#### **A. Përmbledhje e dëshmive të dhuruesve të veshkëve në radhitje kronologjike sipas datës së operacionit nga më i hershmi deri te i fundit**

1. " W2" dëshmoi në gjuhën ruse me video lidhje nga Izraeli me 14 qershor 2012.

Dëshmitari W2, e lindur në njërin nga ish Republikat Sovjetike. Ajo imigroi në Izrael në vitin 2007, ku punonte si punëtore në lavanderi. Ajo iu përgjigj një shpalljeje në një gazetë në gjuhën ruse ku kërkohej një dhurues i veshkës. Ajo u shoqërua në objektin për kryerjen e analizave nga një person me emrin D. Ai ia shpjegoi se ajo do të marrë \$15,000. Më vonë i tha asaj se ishte një marrës potencial me të njëjtin grup të gjakut. Pastaj ajo dhe D. shkuan në Stamboll, dhe me ose rreth datës 14 maj 2008 me udhëtimin e parë shkuan për në Prishtinë. Në aeroport ata u takuan me një person që me sa duket ishte i kombësisë turke që fliste hebraishte. Kishte gjatësi mesatare, me shtat të duhur, dhe rreth 50-55 vjeç. Të nesërmen ajo shkoi vetë me fluturim në Prishtinë. Në aeroport ajo u takua nga dy të rinj që mbanin shenja. Atë e vozitën deri në klinikë që ishte 15-20 minuta larg.

Kur mbërriti në klinikë, ajo iu nënshtrua analizave tjera mjekësore, dhe u takua me mjekun që do ta kryente operacionin. Ishte thatanik, jo shumë i gjatë, dhe rreth 50 vjeç. Ajo po ashtu u takua edhe me marrësin, të cilin ajo e shpjegoi si një djalë i ri turk. Para operacionit, ajo nënshkroi një dokument në gjuhën ruse ku thuhej se nuk kishte asnjë kundërshtim apo ankesë. Ajo qëndroi në spital për pesë ditë dhe kishte vetëm një perde që e ndante nga marrësi.

Pas pesë dite, të dy u kthyen në Stamboll, bashkë me të afërmit dhe kirurgun. Ajo nuk nënshkroi asnjë letër para se të largohej nga klinika, dhe nuk kishte marrë asnjë dokument. Kur u kthye në Tel Aviv ajo takoi D. , i cili e pagoi shumën ekuivalente të vetëm \$12,000 në euro. Pagesa u bë në kesh, dhe u bë në veturën e tij. Ajo nuk ndihej mirë, dhe nuk diskutoi për pagesën më të vogël. Ajo kaloi natën në hotel dhe duhej ta ndërronte fashën shpesh pasi që prerja nuk ishte në gjendje të mirë. Mëngjesin e së nesërmen ajo u kthye në Moskë.

Gjatë dëshmisë, ajo e njohu ndërtesën e klinikës nga një fotografi, por nuk ishte në gjendje t'i identifikonte tetë individët të përshkruar në koleksionin e fotove.

Tani, ajo ka probleme urinare, dhe rreth një muaj para se të dëshmoj, ajo kishte shkuar te mjeku i cili i kishte përshkruar antibiotikë. Dëshmitarja iu përgjigj shpalljes për shkak të gjendjes së vështirë financiare. Ajo kujdeset për djalin dhe vajzën e saj me aftësi të kufizuara, përderisa burri i saj kujdeset për nënën e tij të sëmurë. Ajo nuk flet mirë hebraisht dhe kishte vështirësi të gjente punë në Izrael, por i nevojiteshin para shtesë për shkak të problemeve psikologjike të vajzës së saj. Ajo kishte borxhe rreth 20,000 sikla të ri, apo rreth 4,000 euro. Ajo e kishte marr vesh nga interneti se personat paguhent më shumë se sa që ka marr ajo për një veshke—jo më pak se 150,000 euro. Ajo kërkon kompensim nga gjykata.

2. “W1” dëshmoi në hebraishte përmes video lidhjes nga Izraeli me 14 qershor 2012.

W1 dëshiron të paraqes padi për kompensim në shumën prej 100,000 euros. Tani jeton në Izrael. Ai iu përgjigj një shpalljeje në një gazetë në gjuhën ruse në Izrael në vitin 2008 rreth 3-4 muaj para operacionit të tij, ku kërkohet një dhurues i veshkës për \$12,000. Së pari ai ngurroi të bëjë telefonatën, por në fund e bëri për shkak të problemeve financiare. Ai i kishte borxh disa bankave, dhe kishte borxh 30,000 Sikla (përafërsisht 6,240 euro). Nëna e tij ishte e varur nga ai, dhe nuk kishte askënd tjetër. Ekziston një urdhër arresti për të në gjykatë civile për shkak të borxhit të tij.

Ai thirri një numër izraelit, dhe personi me të cilin bisedoi, fliste rusisht. Ky person e dërgoi atë për analiza të gjakut në Izrael. Ata folën 6-7 herë së bashku. Pas analizave të gjakut, ai nuk e pa më atë. Ai u takua me një person tjetër i cili fliste rusisht rrjedhshëm. Ai shqetësohej për operacionin, dhe ky personi ia shpjegoi se operacioni do të linte vetëm një shenjë të vogël, dhe se ai do të jetë në gjendje t’i bëjë të gjitha si zakonisht përfshirë edhe punë fizike. Ata folën edhe për paratë.

Ai pastaj priti 1-2 muaj para se të merr telefonatën nga e cila u informua se u gjend një person që përputhej. W1 ishte i shqetësuar për operacionin dhe nëse po bënte gjënë e duhur, por vendosi të vazhdoj, edhe pse i kishin thënë se mund të tërhiqet nëse donte. Ai po ashtu shqetësohej edhe për gjendjen se a ishte legale, dhe i kishin thënë se ishte legale, dhe se nuk kishte asnjë arsye për shqetësim.

Ai kaloi një natë në hotel në Tel Aviv, dhe pastaj në mëngjesin e së nesërme u nis për në Stamboll me një person tjetër. Ishte qershor 2008 rreth 18-21. Të gjitha aranzhimet ishin bërë nga dikush tjetër, dhe pa asnjë shpenzim nga ai. Kur arritën në Stamboll, ata u takuan me dy persona në një veturë. Njëri ishte tullac rreth 50 vjeç, i trashë, jo shumë i gjatë, ndoshta 1,75 metra, i cili fliste hebraisht dhe kishte syze të diellit Armani. Personi i dytë ishte më i ri, dhe dukej të ishte ndihmës. Ata vozitën për në hotelin ku A.O. dhe bashkudhëtari i tij kaluan natën. Herët në mëngjes W1 ofroi edhe një mostër të gjakut, dhe iu tha se do të shkonte në Prishtinë. Në aeroport ai e pa përsëri personin me syze të diellit, i cili i tha se operacioni nuk do të ishte problem sepse ai ishte djalë me shëndet të mirë.

Atij i thanë që tek kontrolli i pasaportave të përgjigjet se ishte duke i vizituar të afërmit, por askush nuk e pyeti. Atij nuk iu dha asnjë letër para se të hynte në Kosovë. Ai pastaj u dërgua

në spital, së bashku me marrësin dhe gruan e tij, që e kuptoj të kenë qenë në të njëjtin aeroplan. Kur mbërriti, ai ishte shumë nervoz, dhe i tërë trupi i tij po dridhej dhe po djersiste. Atij iu tha të nënshkruante një dokument i cili ishte në gjuhën angleze dhe se edhe shpjegimi gojor ishte në gjuhën angleze, por anglishtja e tij nuk është e mirë. Megjithatë, ishte e qartë për të se dokumenti ishte lidhur me operacionin dhe se ai po jepte pëlqimin e tij. Ai beson se personi që jepte shpjegimin ishte mjeku i cili e kishte kryer operacionin—i shkurtë, thatanik, me mustaqe apo mjekër me maje, dhe me syze. Atij nuk iu dha kopje e dokumentit të cilin e nënshkroi. Ai i tha mjekut se kishte hëngër diçka në aeroplan, dhe se nuk ishte mirë. Megjithatë, ai u përgatit për operacion. Ai ishte i shtrirë afër marrësit i cili ishte 55-60 vjeçar. Nuk i kujtohet emri i tij, por ishte nga Izraeli.

Pas operacionit ai përjetoi një dhimbje të rëndë aty ku ishte kryer operacioni. Ai tregoi para gjykatës një shenjë në anën e majtë. Mjeku i cili fliste hebraisht vinte çdo ditë ta vizitonte marrësin. Ai qëndroi në spital për pesë ditë, dhe se e kishte parë kirurgun rregullisht përderisa ishte në shërim dhe para se të lëshoj nga aty. Ai vazhdimisht pyeste nëse gjithçka ishte në rregull, i thoshin se po, mirëpo ai kishte një ndjenjë se nuk ishte çdo gjë në rregull. Dy persona që flisnin anglisht e vozitën deri në aeroport, por nuk e di kombësinë e tyre. Pas kthimit në Izrael, ai u takua me personin i cili verifikoi nëse operacioni ishte kryer duke e shikuar prerjen. Pastaj shkuan në një banjo, ku personi tjetër llogariti 7,800 euro që ishin ekuivalent me çmimin e marrëveshjes prej \$12,000.

Pasi u kthye në Izrael pas disa javësh, gjaku filloi t'i rrjedh nga prerja. Ai shkoi në klinikë ku ua tregoi shenjën si dhe që ia kishte dhënë një veshke një të afërmi të tij, që nuk ishte e vërtetë. Ai u dërgua në dhomën emergjente për analiza, dhe iu tha se kishte hematomë. Gjaku vazhdoi t'i rrjedh nga plaga pasi që e lëshuan nga spitali. Ai u kthye në spital ku mjeku i tha se ka mundur të ketë pasur komplikime gjatë operacionit, dhe se nuk është dashur të ishte ashtu, dhe se ai ka mund të ketë humbur një litër gjak gjatë asaj jave. Ai ishte nën vëzhgim mjekësorë, dhe se duhet të shkonte çdo tre muaj për analiza, përfshirë analizat për veshkën që ende e ka. Atij i është thënë se nuk mund të angazhohet në punë fizike në të ardhmen, e kundërta e asaj që i ishte thënë nga rekrutuesit e tij. Ai ka kufizime kur lëviz në anën e majtë, dhe sipas mjekut do të kalojnë vite deri sa të shërohet dhe nevojitet vëzhgim i vazhdueshëm.

Në fund të marrjes në pyetje, prokurori ia tregoi disa fotografi të klinikës Medicus, dhe të objektit, dhe disa nga dhomat ju duken të njohura. Ai pa një foto e cila i dukej sikur mjeku i cili e kishte kryer operacionin, por nuk ishte në gjendje të identifikonte asnjë tjetër në fotot e tjera përveç fotos së personit i cili dukej sikur personi me syze dielli Armani.

Pasi u largua nga Medicusi, ai morri dokumentin e lëshimit i cili ka emrin Medicus në të, si dhe numrin e telefonit, emrin e tij dhe një vulë, e cila ndodhet në policinë izraelite. Ai nuk ka bërë asnjë kërkesë për sigurim në Izrael. Gjatë shtjellimit të dokumentit të cilin e nënshkroi në klinikë, ai tha se askush nuk ia kishte shpjeguar pasojat. Ata kanë folur me të, por nuk i kanë shpjeguar asgjë. Nga sa ka kuptuar, në dokument thuhej se ai po i nënshtrohej një operacioni me pëlqimin e tij, dhe se askush nuk e kishte detyruar t'i nënshtrohej operacionit.

Ata po ashtu e panë se ai ishte tepër i shqetësuar, dhe nuk u ndalën. Mjeku që i diskutoi këto me të ishte ai tullaci i shkurtë, me syze dhe me mjekër me maje.

Gjatë diskutimit të mëtutjeshëm, ai tha se ata duhej t'i kishin shpjeguar pasojat. Ata thanë se çdo gjë do të shkonte mirë, por ky është hospitalizuar për një javë, dhe se duhet të jetë në mbikëqyrje mjekësore për tërë jetën. Ata po ashtu panë se edhe veshka tjetër nuk i funksionon siç duhet. Ai e konsideron vetën si viktimë, pasi që ishte gati fëmijë, ishte vetëm 20 vjeç, dhe se nuk e dinte saktësisht se çfarë po bënte. Asnjë shumë parash nuk ia vlen asaj që ka përjetuar, me komplikimet dhe pasigurisë rreth së ardhmes.

Kur është pyetur nëse mund të identifikonte L.D., ai u ngrit në këmbë dhe iu afrua kamerës, dëshmitari tha se nuk mund ta identifikonte atë.

### 3. "W3" dëshmoi përmes video lidhjes nga Izraeli me 14 qershor 2012.

W3 gjatë kohës së dëshmisë së saj jetonte në Izrael ku ka jetuar për gjashtë vite. Ajo erdhi në Izrael për të fituar para për ta mbështetur vajzën e saj të 10 vjeçare të cilën e ka lënë në Rusi me babin e vajzës. Ajo u martua pas gjysmë viti pasi erdhi në Izrael, pastaj fitoi ca para dhe u kthye në Rusi, ku transferoi vajzën e saj nga babi tek motra e saj. Në Izrael ajo kishte një banesë të cilën duhej ta mbante, si dhe ta mbështeste vajzën e saj. Ajo kishte borxhe pasi që duhej ta mirëmbante banesën.

Një ditë në Izrael ajo e vuri re shpalljen në gazetën në gjuhën ruse për dhurim të veshkës, me një pagesë ta lartë. Ajo nuk thirri menjëherë, por vajza e saj e thirri, dhe e pyeti nëse mund të vinte në Izrael. W3 pastaj thirri, dhe u takua me një djalë të bukur dhe të ri, të cilin ajo më vonë e identifikoi në një rresht fotosh, me emrin S. apo D., por nuk i kujtohet. Ajo u pyet nëse kishte shëndet të mirë, pastaj përmendi 10,000 [valuta nuk u tha], por i tha asaj të mos flas me askënd, edhe pse nuk kishte thënë se pse. Ai i tha asaj ta mendoj situatën dhe më pas ta njoftojë.

Ai thirri më vonë dhe pyeti nëse ajo kishte vendosur. Ai e njoftoi me dikë që kishte kryer operacionin dhe i cili tha se gjendja e tij ishte e mirë. Pas takimit, djaloshi i ri e thirri përsëri dhe i tha se do të rezervojë biletat, dhe se ajo vendosi të shkoj. Ajo u informua se operacioni do të bëhej në Kosovë në një vend të mirë nga një mjek izraelit apo profesor. Me 21 korrik 2008, ajo shkoi me aeroplan në Stamboll me dy femrat të tjera. Djaloshi nuk i shoqëroi ato. Në Stamboll ato u takuan me një njeri tullac, i cili u prezantua si M., dhe i cili i voziti deri te hoteli. Në hotel ajo ia dha një mostër gjaku për analiza, siç bënë edhe ato dy femrat e tjera. Ditën tjetër ato shkuan me aeroplan në Kosovë. M. i shoqëroi ato në aeroplan. Ajo e kuptoi më vonë se marrësi dhe gruaja e tij—një çift nga SHBA—ishin po ashtu në aeroplan.

Ata u vonuan në doganë derisa zyrtarët bënë disa telefonata. Ato paraqiten ftesat që iu ishin dhënë nga M. në Stamboll. Letra ishte në një zarf të thjeshtë në letër të bardhë. Teksti ishte në rusisht, dhe me sa duket edhe në anglisht. Shkruante se po shkonin me aeroplan për kontroll mjekësor tek një klinikë e caktuar. Nuk i kujtohet pjesa lartë, por që ishte një numër dhe adresë. Zyrtarët e doganës ia kthyen dokumentet dhe i liruan.



Pastaj u takuan me vozitësin i cili i shpiu tek klinika e cila ishte së paku një orë larg. M. duhet të ketë qenë në veturën tjetër. Ata arritën tek ndërtesa me dy- ose tri kate. Aty brenda atyre iu bë një ultrazë nga një mjek i cili e kreu operacionin ditën e nesërme. Nga ato gjithashtu u kërkua që të nënshkruanin një dokument. Ajo lexoi dokumentin i cili ishte në rusisht. Thuhej se ishte një proces vullnetar, dhe ajo u pajtua me atë. Asnjë nuk e shpjegoi se çfarë po ndodhte me saktësi, pasojat e operacionit dhe sa do të zgjaste. Ata vetëm ju dhanë një stilolaps dhe letër për të nënshkruar. Asaj i kujtohet se ishte M. që ia dha letrën.

Pas operacionit ajo u takua me marrësin, një njeri në moshë të 60- tave. Ajo beson se ishte një shtetas amerikan, por ka mundur ta ketë pasur pasaportën e kuqe si të sajën. Ata nuk kanë mundur të bashkëbisedojnë meqë nuk kishin gjuhën e njëjtë. Pas tri dite, tri femrat fluturuan me aeroplan për në Stamboll. Në aeroport, M. iu dha atyre nga 8100 apo 8200 euro, ekuivalent me \$10,000. Ato kaluan natën në një hotel në Stamboll. M. ua morri pasaportat, çka i shkaktonte frikë. Ajo frikësohej shumë edhe në Prishtinë, dhe është dashur t'i jepej një injeksion me qetësues për ta qetësuar para operacionit, e cili ishte përshkruar nga mjeku që ishte thananik, i shkurtë, tullac dhe që kishte syze.

Nga dëshmitarja u kërkua t'i shikojë disa fotografi. Ajo nuk i kishte syzet me vete, por besoi se dy fotot paraqisnin klinikën në Prishtinë. Ajo e njohu dhomën e operacioneve në foto. Ajo po ashtu ishte në gjendje t'i identifikojë fotot e mjekut në klinikë (Y.S.) dhe M., përkatësisht. Ajo mundi ta identifikojë personin me fanellë të zezë si M.H.. Ai ishte personi që ua kishte marr pasaportat, i kishte shoqëruar për në Prishtinë dhe ua kishte dhënë paratë.

Duke diskutuar për gjendjen aktuale shëndetësore të saj, dëshmitarja e pranon se jeton gjithnjë në frikë për shëndetin e saj. Ajo ka dhimbje në atë anë dhe pret se duhet të bëjë kontrolle të tërësishme. Pas operacionit ajo pati dhimbje për tre ose katër muaj. Shenja është rreth 12 cm.

Dëshmitarja ka thënë përsëri gjatë gjykimit se mjekët në Prishtinë nuk ia kishin shpjeguar rrezikun e heqjes së veshkës; dëshmitarja u përball me një stres të pabesueshëm gjatë kohës në klinikë. Ajo frikësohej se edhe po të thoshte "jo" nuk dua, operacioni do të bëhej përkundër vullnetit të sa pasi që qëllimi i vetëm ishte të fitoheshin para . Në vazhdim, ajo tha se e kuptoi se ishte përfshirë me mafien. Kur është pyetur se pse nuk u tërhoq kur ishte në Izrael, nëse ka besuar se kishte të bënte me mafinë, ajo tha, "Ju lutem kuptojeni, ekzistojnë vështirësi të ndryshme [pra] situata[,],financiare dhe vështirësi lidhur me transferimin e vajzës me mua. Jo gjithçka është e qartë dhe e thjeshtë".

Kur u pyet nga trupi gjykues nëse policët e kishin pyetur se pse po shkonte në Kosovë, ajo tha se Moshe i kishte udhëzuar ato të thonë se po shkojnë në klinikë për të kryer kontrolle. Policia nuk i pyeti fare, dhe ato thanë në përgjithësi se po shkonin për të kryer kontrolle.

#### 4. "P.M." Dëshmitari dëshmoi përmes video lidhjes nga Ukraina me 12 shkurt 2013.

P.M. gjatë kohës së dëshmisë së saj ende jetonte në atë vend. Në vitin 2008, ai kishte stres akut financiar për shkak të gjendjes së tij familjare. Ai kishte problem shumë serioz me vendin e banimit për familjen e tij dhe nuk mundej të paguante qiranë. Dy fëmijët e tij jetonin me babin e tij ndërsa ai jetonte me nënën. Ai duhej t'ia lëshonte banesën dy kushërinjve të tij.

Ai e pa njoftimin në internet për një veshkë. Ai e dërgoi numrin e tij dhe mori një telefonatë nga një njeri i cili tha se mund ta ndihmojë. Ai nuk mundi të thoshte se nga ishte numri, se nga ku ishte ai person. Personi u prezantua por tani nuk i kujtohet nëse emri i tij ishte J., ose J. [Y.]. Ky person i tha se nëse ishte i interesuar ata mund të flisnin përsëri. Ai personi thirri përsëri më vonë, dhe i dërgoi P.M. një biletë elektronike dhe se do të takoheshin në Stamboll. Ai asnjëherë nuk u takua më këtë person. Atij i është thënë se pas operacionit ai do t'i merrte \$30,000.

Ai shkoi me aeroplan për në Stamboll disa ditë para shtatorit 2008. Disa ditë para fluturimit ai bëri analiza të gjakut dhe i mori rezultatet me vete. Në Stamboll u takua me një turk i cili e shoqëroi për në hotel ku u takua me dy persona që flisnin rusisht. Ata i shpjeguan se çfarë do të ndodh dhe kur do të shkonte për në Kosovë. Ata i thanë se pas operacionit çdo gjë do të ishte në rregull dhe se ai do të merrte kompensimin e tij. Atij iu dha një letër që ai mendon se ishte thirrje për të shkuar në klinikë për kontroll të gjendjes fizike. Njëri nga ata persona ia morri gjakun dhe tha se i duhej për ekspertizë të tyre. Ai nuk e pa kurrë më atë person pasi u largua për në aeroport.

Pas arritjes në Prishtinë, ai e tregoi një letër tek pika e kontrollit në kufi. Ai u pyet për qëllimin e udhëtimit, dhe ai u shpjegoi atyre se kishte ardhur për arsye shëndetësore. Ai pastaj e takoi një person me pamje të zakonshme që mbante një letër me emrin e tij në të, që tha se ishte taksist dhe se do ta voziste atë deri në klinikë, për rreth 20 minuta. Ishte një ndërtesë me dy- apo tri kate me ndërtime që ishin në proces rreth asaj ndërtese. P.M.-së iu tregua një fotografi e cili dukej si i njëjti vend.

Në klinikë ai u takua me persona me uniformë të mjekut. Pas kthimit në mbrëmje, ai u vendos në një sektor tjetër të klinikës deri kur u ftua për tu takuar me personin që do ta kryente operacionin. Mjeku ishte rreth 50 vjeç. Pas gjysmë viti më vonë e pa fotografinë e këtij personi në internet dhe e kuptoi se ishte nga Turqia, dhe se ju kujtua që kishte mjekër dhe flokë të shkurtra. Në klinikë ai personi fliste anglisht. Ata u takuan në një zyre në katin e parë.

Pastaj profesor doktori e mori atë për ta njoftuar me marrësin e veshkës së tij. Ajo ishte afër sektorit të tij, dhe vëllai i saj ishte aty gjithashtu. Atyre u ishte thënë se operacioni do të fillojë pas disa orëve. Ai mendon se ajo ishte nga Izraeli. Ai foli me të dhe me vëllain e saj para dhe pas operacionit, dhe se flisnin pak rusisht. Ajo urgjentisht kishte nevojë për veshke. Pas operacionit, ata e falënderuan atë gjatë gjithë kohës. Vëllai i saj ia dha \$1,000 kesh, por i

tha mos t'i tregojë askujt. Atij nuk i kujtohet emri i vëllait të saj, dhe as i asaj. Ai nuk ishte në gjendje ta konfirmonte njëqind për qind se emri ishte B.I.H. kur u përmend ky emër.

Përgatitja për operacion zgjati një orë dhe pastaj atë e kishin vënë drejt në anestezion. Atij i kujtohet se profesor doktori ishte i pranishëm dhe një tjetër doktor apo infermier mashkull. Në klinikë kishte qëndruar tre ditë dhe një mjek apo infermier mashkull ishte kujdesur për të. Edhe femra pranuese ishte në dhomë por ato ishin të ndara. Atij i kujtohet një dokument që thoshte se ai dhe gruaja ishin kushërinj dhe se ai dëshironte ta dhuronte veshkën me dëshirën e tij.

P.M nuk kishte marr kurrë kompensim për veshkën e tij. Profesor doktori i kishte thënë se do të takohej kur ai të kthehej në Stamboll por askush nuk ishte atje për ta paguar atë. Natën e kishte kaluar në një hotel që ishte rezervuar për të, pastaj të nesërmen kishte fluturuar në shtëpi. Ndjehej i dobët, por përndryshe normal. Megjithatë ai ka disa probleme shëndetësore. Nuk mund t'i ha disa produkte sepse ato e bëjnë trupin e tij të punojë më shumë por nëse vepron kështu i ulet shtypja e gjakut.

Kur ishte kthyer në shtëpi, ishte përpjekur ta gjente personin që e kishte kontaktuar së pari, për t'i marr parat e tij. Gjitha përpjekjet e tij ishin pa sukses. Gjatë kësaj kohe e kishte parë një letër rreshtim për doktorin, që ish një profesor i njohur turk. Nuk i kujtohet nëse ai quhej Y.S. Nuk ishte në gjendje ta identifikoj një fotografi të S. kur iu kërkua ta identifikoj personin në albumin e fotove.

Ai dëshiron të bëj një padi për kompensim në vlerë prej 50.000€. Nuk posedon ndonjë dokument mjekësor sepse nuk ka qenë te mjeku për vite të tëra. Ishte veshka e majtë dhe ai e shpaloji varrën e prerjes. Pas kthimit në Ukrainë kishte bërë një bisedë telefonike me pranuesin e veshkës. Ajo nuk e kishte numrin e telefonit të doktorit. Një muaj më vonë kishte folur me vëlluan e saj i cili kishte thënë se gjendja e motrës së tij ishte keqësuar. Nuk kishin bërë komunikime tjera dhe nuk ishte përmendur fakti që ai nuk ishte paguar.

Askush nuk e kishte detyruar me dhunë të bëj diçka kundër dëshirës. Kishte vepruar kështu shkak i rrethanave personale gjegjësisht kolapsit financiar për çka tash shpreh keqardhje të thellë. Aso kohe në vitin 2008 kishte nevojë të vepronte ashtu për ta përmirësuar situatën në familjen e tij.

Ai nuk ishte paraqitur kurrë para këshillit etik në klinikë në Prishtinë. Ishte vetëm profesor doktori i cili i kishte kërkuar ta nënshkruaj një letër. Vëllau i gruas i kishte thënë se kishin shpenzuar shumë para për operacion por nuk kishte cekur shumë.

##### 5. "D. S" ka dhënë dëshmi personalisht para kolegjit me 11 e 12 tetor 2011.

D.S. Ai kishte vijuar shkollën e lartë të ndërtimtarisë. Megjithëse gjatë tri viteve nga 2005 deri në 2008 kishte punuar, paratë i kishin mjaftuar sa për tu ushqyer vetë dhe vajzën. Ishte zhytur në borxhe të mëdha, për shembull, për banesë dhe në vitin 2008 e kishte humbur punën sepse kompania ku punonte kishte falimentuar. E kishin kompensuar me një shumë të vogël parash që nuk mjaftonte të jetohej për kohë të gjatë. Si pasojë e krizës gjithmbarshme ekonomike në vitin 2008 ai kishte probleme shumë serioze aq sa nuk kishte as para për të blerë qumësht dhe bukë. Po ashtu nuk ishte e mundur as të gjente punë. Aso kohe sipas një vendimi të gjykatës ai kishte 2.500\$ borxh. E kishte shumë të vështirë ta ushqej vetën dhe

vajzën. Ajo kishte filluar të shkojë në shkollë, klasën e parë, dhe prandaj përveç borxheve kishte shpenzime tjera për rroba të vajzës dhe për shkollë.

Duke kërkuar punë përmes internetit, ai hasi një faqe interneti që bënte fjalë për dhurimin e veshakëve. D.S. e kishte lënë numrin e telefonit. Aty nuk përmendej ndonjë çmim por kishte shumë njoftime dhe lajmërimë, dhe shumat prej 80.000 deri në 150.000 dollarë përmendeshin. Pak ditë mbasi kishte lënë numrin e vet, kishte pranuar një telefonatë nga një person që u prezantua si Y. Ai fliste një rusishtë të rrjedhshme dhe i kishte thënë D. S. se edhe ai vetë ishte dhurues dhe kishte marrë 20.000\$. D.S. ishte i interesuar dhe katër a pesë ditë më vonë kishte pranuar një telefonatë nga një person që u prezantua si E. i kishte shpjeguar se mund t'i ndihmonte për të udhëtuar, bileta dhe aranzhimet financiare. D. S. kishte nevojë për ca kohë të mendohej dhe E. i kishte thënë se do ta thirrte pas pak dite. Ani pse ishte një vendim i vështirë, D.S. kishte vendosur të pranonte.

D.S. shqetësohej shumë se kjo nuk do ishte shumë mirë për të, por pak ditë më vonë kur E. e kishte thirrur ai ishte pajtuar. E. e kishte siguruar se do t'ia paguanin të gjitha parat e premtuara: 20.000 dollarë amerikan. Kur e kishte diskutuar çështjen e dhurimit të veshkës me Y. dhe E. ai nuk iu kishte thënë atyre se ishte në gjendje të rëndë financiare. Në Stamboll, kishte diskutuar me E. dhe i kishte thënë se jetonte me bijën e tij dhe se i duheshin para ta rris, por ata se kishin diskutuar faktin që ky kishte humbur punën. E. ia kishte dhënë një numër telefoni dhe i kishte thënë ta dërgoj një SMS me numrin e pasaportës së tij. Numri nga i cili thërriste E. ishte i padukshëm. E. gjithashtu i kishte thënë D.S. t'i sillte dokumentet mjekësore në Stamboll për të vërtetuar se ai nuk kishte sëmundje si Hepatitis apo Sidën.

Me 18 tetor, E. e kishte thirr dhe i kishte thënë të shkoj në aeroport dhe të afrohet tek Turkish airline ku do t'ia lëshonin një biletë elektronike. Në Stamboll dikush do ta priste me emrin e tij të shkruar në një copë letër. E. do të mbërrinte vonë. Në Stamboll do ta priste dikush siç u tha. Personi ishte ose me shtetësi turke ose arabe. Nuk ishte i gjatë dhe ishte me trup të plotë. Ata shkuan në kafene dhe ngrënë në mëngjes. Rreth një orë e gjysmë apo ashtu diçka, dy të rinjë ishin afruar dhe njëri ishte prezantuar si E. Ai e kishte prezantuar personin e dytë si vëllau i tij më i vogli.

Pas operacionit kur E. ishte takuar me D.S. në Stamboll, D.S. e kishte pyetur E. se kush ishte personi që e kishte takuar në aeroport, E. kishte qeshur pak dhe i kishte treguar pseudonimin: "Y.A.". Pas pak një person me origjinë turke apo arabe kishte ardhur në dhomë dhe D.S. kishte dhënë një mostër gjaku. Më vonë atë mbrëmje, E. i kishte thënë D.S. se të nesërmen do të fluturonte për Prishtinë dhe se do të shoqërohej nga një femër.

Të nesërmen në mëngjes në recepcion të hotelit ishte vëllai i vogël i E., dy femra dhe një i moshuar me prejardhje arabe. Asnjëri nuk i prezantoi me emra por E. bëri me gisht nga njëra femër dhe tha se ajo do ta shoqëroj atë në Prishtinë. Ai kishte thënë se pasi të kryhej operacioni ajo do ta paguante atë. E. ia kishte dhënë një zarf të mbyllur dhe i kishte thënë nëse e pyesin pse po shkonte në Prishtinë, ai duhej tua jepte zarfin policisë.

Kur kishin arritur në Prishtinë, të dy femrat dhe personi me shtetësi arabe kaluan të parët nëpër kontrollin e pasaportave. Kur D.S. ua kishte dhënë pasaportën policisë ata kishin filluar ta pyesin diçka por ai nuk kishte kuptuar se për çfarë po pyesnin. I kishin thënë të largohej anash dhe pak minuta më vonë atyre iu kishte afruar një femër që fliste rusisht.

Gruaja i kishte thënë atij se policia donte ta di qëllimin e vizitës së tij. Ai u tregoi policëve zarfin nga E.. Pasi kishin lexuar dokumentin policët kishin filluar të flasim me emocione mes veti. Gruaja pak e kuptonte bisedën por e kishte këshilluar të mos shkonte në atë spital se kishte një emër të keq. Pastaj ajo përktheu për të se ai nuk do të lejohej ta kalonte kufirin dhe se do të kthehej për në Stamboll. Ajo kishte shkuar dhe se kishte parë më. Asnjëri nuk i kishte shpjeguar as si kishte dhënë ndonjë arsye. Policia ia kishte futur dokumentet në një zarf dhe e kishin përcjellë te aeroplani. Dokumentet ia kishin dhënë stjuardesës. Ai ishte kthyer në Stamboll me të njëjtin aeroplan me të cilin kishte ardhur. Me të mbërritur në Stamboll stafi i aeroportit e kishte takuar. Ia kishin marrë dokumentet dhe përcjellë nëpër kontrollin e pasaportave ku ia kishin vulosur pasaportën dhe e kishin liruar.

Pastaj E. e kishte thirrur në telefon dhe i kishte thënë se “Y.A. pas pak do ta takonte. “Y.A.” kishte ardhur dhe bashkë kishin shkuar te vendi i biletave. Ai i kishte blerë D.S. një biletë të re për Prishtinë dhe një biletë kthyesë për Stamboll. Ai i kishte thënë D.S. se të nesërmen herët në mëngjes ky personi do ta përcillte në aeroport. Më pas E. e kishte thirrur dhe i kishte thënë të mos flas me askënd, se nuk duhej të dal nga hoteli dhe se nuk do të kishte ndonjë problem. Të nesërmen në mëngjes një tjetër person e kishte marrë dhe e kishte përcjellë në kontrollin e pasaportave. Në Prishtinë kur e kishte treguar pasaportën e kishin lejuar të kaloj pa asnjë problem.

Kur po dilte nga ndërtesa e aeroportit e kishte takuar atë femrën që kishte qenë me të në aeroplan gjatë udhëtimit të parë. Dy persona të rinj e shoqëronin. Ata mbase ishin shqiptar ose serb. Ata vozitën për 10-15 minuta. Kur kishin arritur në klinikë aty kishte një shenjë që shkruante Klinika Medicus.

Kishin hyrë në katin e dytë ku ishte takuar me një infermier me trup të plotë, i përkatësisë shqiptare dhe kokë tullace. Pasi kishte ndërruar rrobat infermieri e kishte dërguar në një dhomë tjetër ku kishte parë disa njerëz me të cilët kishte fluturuar në Prishtinë herën e parë – të dy femrat dhe i moshuari që ishte shtrirë në krevat. D.S. e kishte kuptuar se ai do të ishte marrësi i veshkës së tij. Më vonë D.S. dëgjoi se ky person quhej ‘D. Infermieri e kishte dërguar te një shtrat aty afër dhe aty i kishin marrë gjak.

Pastaj pas disa analizave D.S. ishte përcjellë në sallën e operimit ku ai e kishte humbur vetëdijen pas një injeksioni. Kur ishte zgjuar kishte ndjerë një dhimbje shumë të madhe në anën e majtë. Pranë tij kishte qenë shtrirë, “D.”

Disa herë gjatë bisedës me E. ai i kishte thënë D.S. se intervenimi kirurgjik ishte krejt ligjor. Ky ishte një vlerësim i rëndësishëm për D.S. Një ditë para kthimit të tij, e njëjta grua që e kishte përcjellë gjatë fluturimit kishte ardhur dhe i kishte thënë se ajo do të kthehej me aeroplan të nesërmen dhe ia kishte dhënë një zarf të mbyllur. D.S. e kishte parë se brenda ishin 6.000\$ në bankënotë prej 100\$ të vjetra dhe të reja. D.S. kishte filluar të brengosej.

Ai kishte kaluar gjithsejtë 4 ditë në klinikë dhe kishte dalë ditën e pestë. Njëri nga personat që e kishte marrë nga aeroporti D.S. e kishte dërguar prapë në aeroport dhe kishte qëndruar atje derisa ai duhej të hynte në kontrollin e pasaportave. Pastaj D.S. kishte marrë aeroplanin për Stamboll. Pas ardhjes së tij në Stamboll, e kishte marrë një telefonatë nga E. i cili i kishte thënë se do ta takonte.

I pyetur se gjatë udhëtimit të dytë në Prishtinë a e kishin pyetur në kontrollin e pasaportës për vulën e dëbimit në pasaportë, i ishte përgjigjur se askush se kishte pyetur. Çdo gjë ishte bërë

shpejt dhe pa bërë pyetje. Ai si kishte treguar askujt në aeroport qëllimin e vizitës dhe nuk i kishte treguar askujt asnjë dokument gjatë vizitës së dytë.

Nga Stambolli ishte nisur me datën 25. Gjëja e fundit që i kishte thënë E. ishte se pjesën tjetër të parave do t'ia paguanin më vonë. Ai i kishte sugjeruar D.S. se mund të fitonte para nëse do mund të gjente dhurues tjerë. Ai kishte thënë se do ta paguanin 500\$ për person. Ai nuk kishte thënë se kush janë 'ata', por e kishte thënë në shumës. E. i kishte thënë D.S. se do t'ia bartnin në formë elektronike paratë së shpejti. Ai kishte përpjekur ta qetësoj për para duke i thënë 'mos u merakos për këtë'. Ai i kishte thënë se nuk do të ishte keq aspak nëse ai do të mund të gjente disa njerëz tjerë. D.S. kurrë s'i kishte marrë pjesën tjetër të parave nga E. apo dikush tjetër.

Pasi D.S. kishte mbërritur në shtëpi, ai kishte marrë një telefonatë nga E. cili e kishte pyetur se si po ndihej dhe si ishte udhëtimi kthyes. Ajo ishte pikërisht ditën pas arritjes. D.S. kishte thënë se çdo gjë ishte mirë, por se kishte një dhimbje anash.

D.S. kishte pranuar një telefonatë nga policia vendore diku 2 deri në 3 ditë pas kthimit. Ata donin të dinin për qëllimin e vizitës së tij në Kosovë. E. i kishte tërhequr vërejtjen dhe i kishte thënë të mos flas, të mos i thotë dikujt për gjithë ngjarjen. Ai i kishte thënë të mos përmend emrin e tij assesi dhe ta shlyej numrin e telefonit të tij nga telefoni i tij. D.S. nuk kishte vepruar kështu.

Ai u kishte shpjeguar atyre se qëllimi i vizitës së tij në Kosovë ishte të kontrolloj gjendjen e zemrës çka nuk është e vërtetë, por ai ishte frikësuar nga ajo që kishte thënë E.. Atë çka kishte thënë E. ai e kishte marrë si paralajmërim dhe si kërcënim. E. i kishte thënë të gënjej dhe të mos ia tregoj ngjarjen askujt, ku kishte qenë, me kë kishte folur, kë kishte takuar, dhe gjithmonë e kishte kërcënuar duke i thënë 'më mënyrë që të mos kesh ndonjë problem'. Kjo përbënte ndryshim komplet të sjelljes së E. prej para operacionit kur ai ishte shumë i sjellshëm dhe i dobishëm.

Në policinë vendore ai kishte gënjyer dhe pasi kishte dhënë deklaratën, ata e kishin lëshuar. E kishte nënshkruar një vërejtje shpjeguese duke thënë se qëllimi i vizitës së tij në Kosovë ishte të kontrolloj zemrën gjë që nuk ishte e vërtetë. Përmbajtja e saj ishte me shkrim të dorës. Një a dy ditë pas kësaj, ai kishte marrë një tjetër telefonatë nga E. I kishte thënë t'i thoshte vazhdimisht gjërat e njëjta si më parë nëse e thërrasin prapë në polici. Ai po ashtu e kishte paralajmëruar se në rastin më të keq nëse ai thoshte diçka që nuk duhet, ai do të kishte problem të madh dhe jo vetëm ai. D.S. e kishte kuptuar këtë si problem edhe për familjen e tij.. D.S. nuk e dinte si merrte vesh E. që ai kishte qenë në polici.Pas kësaj bisede telefonike me E., D.S. ishte përpjekur të analizoj çdo gjë që kishte ndodhur dhe më në fund ishte bindur se kërcënimi dhe paralajmërimi i E. ishte shumë serioz.

D.S. e kishte kuptuar se jeta e tij dhe jeta e bijës së tij mund të ishte në rrezik prandaj kishte vendosur të ndërroj vendbanimin, në maj 2009 ai ishte vendosur në një shtet tjetër me paratë që kishte fituar në Prishtinë. Pastaj s'kishte pasur kontakte me këtë person as me ndonjë person të lidhur me këtë çështje.

D.S. gjatë marrjes në pyetje ishte përballur me fotografi. Ai i kishte identifikuar disa foto të klinikës Medicus, edhe brenda edhe jashtë, si dhe disa foto të kartelave shëndetësore dhe pako që ishin vendosur në frigorifer. Mjeku i parë që ai e kishte parë kur kishte arritur në klinikën Medicus ishte shtathollë, që mbante syze të vogla, i moshës mesatare 40-50,

ndoshta edhe më i vjetër, tullac, me prejardhje turke apo arabe, por D.S. nuk e dinte se në çfarë gjuhe po fliste mjeku. D.S. e kishte njohur por kishte theksuar se ai nuk kishte qenë në sallën e gjyqimit. Ai gjithnjë hynte në dhomë me mantel mjekësore. Ai e dinte si të gjendej aty. E dinte se ku ishin barërat, dhe u jepte udhëzime infermierëve meshkuj çfarë të bënin dhe ata e pasonin udhëzimin e tij. Shihej qartë se nuk ishte hera e parë që ishte aty. Ky mjek ia kishte bërë D.S. një ultrazë dhe besonte se aty kishte edhe një mjek tjetër por nuk mund ta shihte se ai ishte ulur me shpinë prej tyre. Po ashtu mjeku ia kishte kontrolluar rezultatet e analizave që i kishte bërë më parë. Ky mjek ishte përfshirë në operimin e tij. D.S. kishte vërejtur se ai ishte dërguar në sallën e operacionit, se ky mjek ishte aty por fytyrën e kishte të mbuluar me maskë. D.S. e kishte njohur atë, sepse ishte mjeku të cilën e kishte parë më së shpeshti, në krahasim me të tjerët. Pasi që mjeku vinte në klinikë disa herë pas operimit të D.S., ai mendonte se ky mjek luante një rol të rëndësishëm. Ai po ashtu mendonte se ai po kontrollonte gjendjen e ‘D.

Sa për ‘D., D.S. nuk kishte folur me të. Ai mendonte se ishte nga Izraeli. Ai dukej shumë i sëmurë. Aso kohe ai nuk ia kishte ditur emrin atij mjeku por tash e din se ai e kishte emrin Y. Ai po ashtu kishte parë mjekë të tjerë dhe staf mjekësor në klinikë. Kur dy gratë flisnin midis tyre, ai e kishte kuptuar nga biseda e tyre se ato po përmendin diçka si S. or C. Ai nuk kishte kuptuar shumë dhe nuk dinte se çfarë ishte përmbajtja e bisedës së tyre. Doktorin nr .2 ishte 40-50 vjeç dhe me përkatësi Evropiane. Kishte flokë ngjyrë të çelë dhe pa qime në fytyrë. Doktorin 2 ishte diku 165-175 cm dhe diku 70-80 kg. Ai kishte të veshur mantelin e njëjtë mjekësore. D.S. e kuptonte se ai nuk ishte për herë të parë në klinikë. Ai fliste me infermierët meshkuj dhe sillej lirshëm. Doktorin nr. 3 ishte femër, gjatësi mesatare 160-168 cm ndoshta, flokë të gjata deri në supe, fytyrë të rrumbullakët, sy të bukur të mëdhenj, edhe ajo kishte veshur rrobe të njëjta mjekësore. Ajo ishte e heshtur por ishte e pranishme ditën e operacionit në sallë me një maskë. Ajo ishte diku midis 28-35 vite. D.S. mendonte se ishte vendase nga pamja e saj.

Dëshmitarët D.S. i kishin kërkuar të shikonte rreth sallës së gjyqimit se mos shihte dikë që e njihnte. Ai e njohu personin që mbante këmbë të bardhë me të zezë të cilin e kishte parë në klinikë. Ai ia kishte dhënë disa letra t’i nënshkruante para operacionit. D.S. po ashtu e kishte njohur personin me xhakët me ngjyrë kafe në të mbyllët dhe mendonte se e kishte parë në klinikë. Gjykata e identifikoi personin me këmbë të bardhë e zi si A.D. dhe personi i dytë si L.D. Personat e tjerë D.S. nuk i njohu.

D.S. e kishte parë A.D. ditë e operimit me 21 tetor. Ai i kishte dhënë disa letra për t’i nënshkruar dhe i kishte kërkuar t’i nënshkruaj. A.D. kishte provuar t’i shpjegoj se e gjithë ajo ishte ligjore, se nuk kishte problem. A.D. kishte provuar t’i shpjegoi se dokumentet thoshin se D. supozohej të ishte kushëri i tij dhe D.S. po ia dhuronte veshkën e vet. Por, D. s’kishte qenë kurrë kushëri i tij dhe D.S. e kishte parë atje për herë të parë. D.S. e kishte kuptuar shumë qartë çfarë i kishin shpjeguar lidhur me dokumente. Ata kishin dashur të bënin të dukej sikur DS po ia dhuronte veshkën të afërmit të tij.

A.D. kishte ardhur duke mbajtur disa letra dhe pastaj ishte larguar me to. D.S. s’kishte pasur mundësi t’i lexonte dokumentet sepse A.D. kishte kaluar shpejt prej faqes në faqe para tij dhe i kishte kërkuar D.S. t’i nënshkruante dhe ky i kishte nënshkruar. Pastaj D.S. ishte dërguar në sallën e operimit. Dokumentet ishin në gjuhën angleze, të përkthyer shumë dobët në rusisht. Ai s’kishte mundur ta lexoj as kuptoj çfarë ishte e shkruar. Ai i kishte nënshkruar duke ditur se nuk është e vërtetë pasi D. nuk ishte i afërm i tij. Por thelbin e asaj që po

ndodhte nga pikëpamja ligjore ai se kuptonte aspak. Megjithatë, së pari herë edhe E. dhe gruaja të cilën e kishte takuar në fillim, para operimit, i kishin thënë se ishte i ligjshëm.

D.S. e kishte parë L.D. në klinikë ditën e operimit të veshur me uniformë kirurgjike. Fotografitë ia kishte treguar prokurori publik por ai e njohu vetëm doktor Y.

D.S. i kishte treguar gjykatës një vrragë në anën e djathtë afërsisht bri me bërryllin, që shkonte pak lartë dhe në shpinë. Varra ishte diku 20 cm e gjatë. Shëndeti i tij gjatë kohës së dëshmisë nuk është siç ka qenë. Për shkak të operacionit gjendja e tij shëndetësore nuk e lejon ta jetoj jetën ashtu si dëshiron ai për shembull ai është i kufizuar në përdorimin e disa produkteve ushqimore dhe ka disa kufizime fizike.

Duke pasur parasysh gjithë situatën dhe faktin se ai kishte shumë probleme si pasojë e kësaj dhe faktit që e kishin gënjyer, ai dëshiron të kërkoj kompensim për dëmtim moral dhe fizik që kishte pësuar. Tani ai ka shumë vështirësi në jetë dhe i frikohet së ardhmes. Prandaj, ai po kërkon kompensim veçanërisht duke pasur parasysh se këta njerëz kishin përfituar shumë nga shëndeti i njerëzve të tjerë. Kjo ishte arritur me gënjeshtër dhe veprimeve të paligjshme. Ai dëshiron që drejtësia të vihet në vend: 100.000 \$ kompensim.

6. “**A.K.**” ka dhënë dëshminë para trupit gjykues me 5,6 dhe 18 tetor 201.

A.K. Problemi i tij kishte filluar në vitin 2008. Kishte probleme me studimet sepse nuk kishte mjaft para dhe nuk mund të paguante për studime. Për secilin semestër duhej të paguante nga 600€. Përveç kësaj, kishte edhe shpenzime sepse jetonte ndaras nga familja në banesë. Ishte bashkë me një dashnore por ishin ndarë në atë vit. Atë kohë në gusht kishte një punë por e kishte ndërprerë sepse kompania kishte falimentuar. Pasi kishte ndërpre punën kishte marrë ndihmë nga babai por babai i tij kishte pësuar një sulm në zemër dhe s’kishte mundësi t’i ndihmonte më. A.K. ishte përpjekur të mos krijoj borxhe sepse nuk dinte si t’i kthej prapa. Pasi babai ishte sëmurë s’kishte pasur mundësi t’i ndihmoj më A.K, por A.K. tash duhet ta ndihmonte atë pasi babai kishte nevojë për trajtime speciale mjekësore dhe nuk mund të punonte. Babai kishte qenë shumë sëmurë dhe do të vdiste pa trajtim mjekësor.

A.K. ishte në një marrëdhënie por ishin ndarë – ajo e kishte braktisur. Ishte ndjerë shumë i depresionuar, i vetmuar dhe pa ndihmë ose përkrahje. Iu ishte dikur si periudha më e errët në jetën e tij. Kishte gjurmuar internetin ku kishte parë një bord mjekësor rus me një mesazh për tu bërë dhurues i veshkës në shkëmbim të parave. Nuk i kujtohet adresa e internetit por ishte diçka sikur si blog mjekësor në gjuhën ruse dhe në domen rus (.ru). Kishte parë 3 a 4 faqe të tilla. Disa ishin në anglishte. Faqet e internetit, kujton ai, shkruanin se dikush mund të ndihmoj financiarisht për dhurimin e veshkës.

I kishte dërguar një e-mail personit që kishte postuar informatën dhe e kishte pyetur për detaje për atë se si mund të ndihmoj. Të nesërmen personi i kishte dërguar një e-mail ku pyeste se a dëshironte A.K. të dhuroj veshkën dhe i kishte propozuar se do të paguhej 10.000€. Personi ishte prezantuar si Y. A.K. kishte shkëmbyer me të tre e-maila. Ai ceku disa arsye për dhurim – por motivin kryesor e kishte t’i ndihmoj të tjerët dhe babain e vet. Ai s’i kishte shpjeguar të gjitha rrethanat financiare por kishte cekur babanë e tij dhe trajtimin e tij mjekësor.

Një ditë A.K. u kontaktua përmes telefonit nga një numër i paidentifikuar nga një person që u prezantua si J. (Y.) i cili kishte thënë se A.K. duhej të përgatitej për të bërë disa analiza si analizën e grupit të gjakut, Hepatitis B, HIV dhe ultrazë. Këto analiza ishin bërë në klinikën



shtetërore ku shërbimet ishin falas. I pyetur për kohën, A.K. kishte shpjeguar se e kishte parë njoftimin diku me 10 shtator dhe kishte marrë rezultatin e analizave diku kah fundi i shtatorit 2008.

Afërsisht pas dy javëve A.K. i kishte dërguar analizat dhe J. e kishte thirrur në telefon, i kishte thënë se do t'i dërgoj biletat dhe se operacioni ishte organizuar. Kjo ishte hera e parë që A.K. kishte mësuar se do të fluturoj nga Minsk në Stamboll prej nga në Prishtinë. Ai do të fluturonte me Turkish Airlines. S'kishte marrë asnjë para. A.K. e kishte pyetur Y. se a ishte ligjore kjo dhe me vonë e kishte pyetur J. për të. J. i kishte thënë se në Kosovë është legale. Më parë kur kishte shikuar në internet, e kishte kuptuar se transplantimi i veshkëve nuk ishte ligjor në shumë vende. Me 25 tetor A.K. kishte fluturuar në Stamboll. Në aeroport ai e kishte takuar një person që ishte prezantuar si J. J. ishte bashkë me një person të cilin e prezantoi si vëllai i tij me emrin D. A.K. dha një përshkrim fizik të dy personave dhe tha se do të jetë në gjendje ti identifikoj ata.

Gjatë vozitjes deri në hotel J. i kishte folur D. në një gjuhë tjetër. A.K. mendon se ishte hebraishte. Në hotel J. kishte shkuar te receptionisti. A.K. e kishte parë pasaportën e tij që shkruante "Shteti i Izraelit". Në hotel kishte ardhur një person që dukej si mjek me mantel të bardhë. Me vete kishte instrumente mjekësore dhe e kishte marrë një mostër gjaku. Në mëngjes kishin shkuar me taksì normal nga hoteli në aeroport. Në aeroport J. i kishte thënë A.K. se do të udhëtonte vetëm në Prishtinë dhe i kishte dhënë një kartë biznesi "Klinika Medicus". Dikush do ta takonte në aeroport dhe nëse do ta pyeste dikush në doganë në Prishtinë ai duhej të thoshte se po shkonte për rentgen mjekësor për probleme urinare në klinikën Medicus. AK e kishte pyetur J. se a ishte e ligjshme ajo çfarë po bënin ata, ai kishte thënë se në Kosovë ishte e ligjshme por nuk kishin nevojë ta tërhiqnin vëmendjen.

Ai beson se fluturimi ishte me 26 tetor me Turkish Airline për Prishtinë. Gjatë udhëtimit nuk e kishte njohur askënd por më vonë kishte takuar njerëz me të cilët kishte qenë në aeroplan. Kur A.K. kishte arritur në aeroport, një doganier ia kishte shikuar pasaportën dhe pastaj e kishte dërguar në zyrën aty afër. E kishin pyetur për qëllimin e vizitës dhe ky ishte përgjigjur se po shkonte në klinikën Medicus për probleme urinare. Ata i kishin marrë pasaportën dhe kartën e biznesit dhe i kishin kërkuar A.K. të priste jashtë zyrës dhe pastaj e kishin mbyllur derën. A.K. kishte parë se zyrtari kishte bërë një telefonatë që kishte zgjatur nja 2-3 minuta por s'kishte dëgjuar çka ishte thënë apo kë e kishte thirrur. Pastaj zyrtari i kishte bërë një kopje të pasaportës dhe i kishte thënë të kaloj. Po ashtu ia kishte dhënë edhe kartelën e Medicusit.

Kur ishte larguar nga aeroporti një person iu kishte afruar dhe e kishte pyetur se a ishte ky për në klinikën Medicus. Ata vozitën për 30-40 minuta dhe kishin arritur në klinikë. Ata kishin shkuar në katin e dytë dhe mjeku kishte pyetur se a ishte ky AK dhe pastaj kishte thënë se duhej bërë një ultrazë. Kjo ishte bërë në katin e dytë në kabinet. Doktorin kishte kryer ultrazërin e pastaj i kishte kërkuar A.K. t'i nënshkruaj letrat. Doktorin i kishte thënë se duhej t'i nënshkruante, se operimi do të ishte ligjor dhe ai duhej të pajtohej. A.K. s'i kishte lexuar letrat para se t'i nënshkruante. Ishin dy kopje që duhej të nënshkruheshin. Njëra në anglishte dhe tjetra në një gjuhë tjetër. Ai i kishte shikuar shpejt e shpejt letrat por s'i kishte lexuar. I kujtohet se diçka ishte përmendur për rregulloren UN-së. Ai di të lexoj anglisht andaj ka mundur t'i lexoj kopjen, por s'kishte pasur kohë sepse mjeku i kishte thënë: "nënshkruaj". Kishte vetëm dhjetë minuta që kishte mbërritë në klinikë. A.K. fliste me mjekun në anglisht: ai nuk ishte në dijeni nëse mjeku e dinte se ky dinte të lexoj në gjuhën angleze. Doktorin nuk e kishte pyetur por vetëm kishte bërë me gisht ku AK duhej të nënshkruaj. Ai nuk e dinte nëse

dokumentet ishin të ngjashëm në dy gjuhët. AK tash e di emrin e mjekut të parë dhe tha se ai quhej Y.S.

Pas afro 20-30 minuta një staf mjekësor i kishte thënë t'i heq të gjitha rrobat dhe të hipte në një tavolinë lëvizëse. Pastaj një infermier ia kishte dhënë një injeksion. Nja 10 minuta ma vonë e kishin vënë në tavolinë përmes një korridorit në një dhomë të madhe që ai mendonte se ishte sallë operacioni. Në dhomë një mjek ia kishte dhënë edhe një tjetër injeksion dhe pas 5-7 minutash e kishte zënë gjumi. Në dhomë ishin afro 4 persona. Një nga personat ishte S. Atij i kujtohen dy mjekë dhe dy staf mjekësorë.

Më tej i kujtohej se ishte zgjuar gjatë natës, se kishte dhimbje në vendin e operimit dhe kishte kërkuar ujë dhe një staf mjekësor i kishte dhënë, më pas kishte rënë në gjumë prapë. Në mëngjes ishte zgjuar diku rreth orës 09:00 – 10:00. Prapë kishte kërkuar ujë dhe stafi mjekësor i kishte dhënë. Stafi mjekësor i kishte thënë se çdo gjë ishte mirë, se ai duhej të rrinte në shtrat. S. kishte ardhur ta shikojë çdo mëngjes të shihte se a ishte mirë. Doktorin i kishte kontrolluar temperaturën dhe kishte biseduar me disa staf mjekësorë. A.K. i kishin dhënë tableta ndoshta 3-4 herë në ditë.

Mëngjesin e parë kur ishte ngritur pas operimit pranë shtratit të tij ishte i shtrirë një i moshuar. Ditën e tretë plaku që nuk fliste shumë kishte thënë se ishte mirënjohës që A.K. ishte dhurues i tij. Ata flisnin anglisht me njëri-tjetrin. Ky person ishte nja 60-70 vjeç. Ai ishte izraelit por jetonte në Nju Jork dhe kishte një biznes në Nju Jork. Më vonë personi kishte disa vizitorë – një njeri me një grua. Njeriu ishte afro 40-45 vjeç kurse gruaja kishte diku 38-40 vite. Ata ishin të afërmit e personit të moshuar.

Normalisht afër dhomës kishte dy staf mjekësorë dhe ai kishte parë tri a katër herë doktorin tjetër që ishte në sallën e operimit. A.K. mendonte se i kishte parë gjithsej 3 mjekë në klinikë. Dy ditë pas operimit e kishte takuar J. prapë. Në mëngjes kur ishte zgjuar, J. po qëndronte afër shtratit të tij. J. e kishte pyetur për gjendjen dhe i kishte thënë se i kishte lënë paratë në çantën e AK. J. kishte shkuar por kishte thënë se do të takoheshin kur A.K. të shkojë në Stamboll përsëri. Pasi kishte shkuar ai, A.K. kishte shikuar në çantë dhe kishte gjetur një zarf me para brenda në të. Kishte 8.000\$ në të, të gjitha kryesisht në bankënota të reja prej 100\$. A.K. e mori zarfin dhe e fshehu në këpucën e tij. Kur u pyet nëse ai e kishte diskutuar çështjen e pagesës me të tjerët përveç me Y., A.K. tha se kishte folur lidhur me to me marrësin. Marrësi e kishte pyetur A.K. nëse ai kishte marrë paratë apo jo. A.K. nuk e dinte nëse ndonjëri nga stafi mjekësor apo mjeku kishin parë që paratë ishin futur në çantë. Ai foli me ta lidhur me gjendjen e tij mjekësore.

Kur kishte arritur në klinikë kishte katër njerëz ulur jashtë kabinetit. A.K. e kishte kuptuar kur i kishte parë gjithë këta persona në dhomë se ata kishin qenë në aeroplanin e njëjtë. Ata ishin plaku, të dy të afërmit e tij, edhe një person tjetër të cilin e kishte parë dy herë gjatë qëndrimit të tij në klinikë. Herën e parë e kishte takuar atë person kur kishte mbërritur aty, herën tjetër kur ishte dalë. Ai nuk e di se çfarë po bënte ai person në klinikë. A e përshkroi personin të ishte 1.60 cm ose më i shkurtër. Nga dukja dukej si izraelit. Kishte diku 50-55 vjeç. Dukej se kishte shumë besim në vete dhe ishte veshur mirë. Kur A.K. po përgatitej të shkojë në aeroport ai kishte pasur një bisedë 5 minutëshe me këtë person. A.K. tash ia di emrin atij personi. Atë e kishte parë në media dhe në artikujt e lajmeve nga faqe të ndryshme të internetit nja 8-10 muaj pasi kishin bërë bisedën me të. A.K. mendon se ky person kishte lidhje me operimin e tij dhe transportin. Personi quhej M.H. A.K. kujton se M.H. kishte qenë në të njëjtin fluturim nga Stambolli në Prishtinë.

Me 31 tetor në mëngjes mjeku i kishte thënë A.K. t'i bënte plaçkat gati. Mjeku i kishte dhënë A.K. një letër që duhej si një letër me vulën e klinikës Medicus në të por ishte e shkruar në një gjuhë të cilën A.K. nuk e kuptonte. I kishte thënë nëse do të kishte problem me doganën duhej t'ia tregonte këtë letër. Kur kishte ardhur vetura kishte shkuar në aeroport, e kishte kaluar doganën pa problem, ka hipur në aeroplan dhe është nisur për në Stamboll. Të nesërmen ishte nisur për Minsk. J. kishte thënë se do ta takonte A.K. në Stamboll, por nuk ishin takuar. Qëllimi i takimit ishte që ai t'ia jepte A.K. edhe 2000\$.

Nuk kishte kërkuar kujdes mjekësor shtesë. Kishte bërë analiza dhe teste në klinikën lokale dy herë pas operacionit dhe sipas mjekut të klinikës ai ishte shumë mirë. Ata i kishin tërhequr vërejtjen se ai kishte një veshkë dhe se nuk duhej të pinte shumë lëngje as të bëj shumë ushtrime por nuk kishte nevojë për trajtim të veçantë.

Diku një javë pas kthimit të tij në shtëpi J. e kishte thirrur. J. kishte thënë se kishte qenë i zënë dhe prandaj s'kishte mundur ta takoj në Stamboll dhe do t'i dërgoj paratë brenda pak javëve. Javën tjetër ata kishin folur prapë dhe i kishte thënë se do t'ia jepte pjesën tjetër të parave, por A.K. duhej të gjente një tjetër person që dëshiron ta dhuroj veshkën. J. i kishte thënë se do t'ia jap 2000\$ që i kishte borxh plus 1000\$ për çdo person që A.K. e rekruton. Nuk kishte dashur probleme me ligjin dhe prandaj e kishte refuzuar. Kishin pasur dhe disa biseda por pozita e A.K. nuk kishte ndryshuar. Ai nuk donte të merrte para për të rekrutuar njerëz. J. e kishte kontaktuar A.K. diku 5-6 herë pas operimit. A.K. s'kishte bërë kurrë ndonjë përpjekje pozitive për të rekrutuar njerëz.

Pas bisedës së tretë J. i kishte thënë se do t'ia dërgonte disa para. Paratë ia kishte dërguar përmes Western Union dhe kishte dërguar emrin, mbiemrin dhe kodin e identifikimit. Këso mënyre A.K. e di, mbiemrin e J.. Quket J. K. (K.) nga Izraeli. Ai ia kishte dërguar 500\$ nga zyra e afërt e Western Union. Tri ditë pas pagesës J. e kishte thirrur në telefon dhe i kishte thënë se kishte dërguar paratë për shpenzime dhe se akoma po priste të rekrutoheshin njerëz të tjerë. A.K. kishte refuzuar përsëri dhe bisedën tjetër i kishte thënë A.K. të mos shkoj në polici dhe nëse e kontaktonte dikush të mos flas asgjë. Po ashtu i kishte thënë se 'ka duar të gjata' dhe mund ta mbërrij A.K. kudo. Këtë A.K. e kishte marrë si kërcënim për jetë dhe shëndet. Në bisedën e fundit J. i kishte thënë A.K. 'nëse shkon në polici mund të zhdokesh'. Biseda e fundit ishte zhvilluar diku 5-6 muaj pas operacionit.

Një vit pas operimit në vjeshtë 2009 A.K. ishte kontaktuar nga një polic i Bjellorusisë. E kishin thirrur A.K. në zyrën e tyre ku e kishin pyetur se ku kishte qenë në vitin 2008 nga 25 tetor deri më 1 nëntor. Ata i kishin thënë se i kishin letrat nga klinika Medicus dhe e dinin se çka kishte bërë në klinikë. E kishin pyetur për 12 orë. Ai nuk u kishte treguar gjithë të vërtetën kurse ata mundoheshin ta nxisnin duke thënë se ai kishte rekrutuar njerëz. Një tjetër takim kishte pasur nga policia e Bjellorusisë. I kishin bërë pyetjet e njëjta dhe i kishin treguar disa fotografi. I kishin kërkuar ta kontaktoj J. të cilin e thirri por ai nuk ishte përgjigjur. Ai i kishte njohur J. dhe D. në një album të fotove. Policia kishte thënë se ata ishin dy persona të cilët po mundoheshin t'i gjejnë dhe se e kishin kontaktuar Interpolin. Biseda e tretë me policinë ishte zhvilluar në janar-shkurt 2011. Gjatë takimit ata i treguan foto përsëri – foto të ndryshme por personat e njëjtë – J. dhe D. përsëri. Në fund policia i kishte thënë se J. dhe D. dhe persona tjerë ishin arrestuar në Ukrainë. A.K. nuk ishte kontaktuar nga policia e Ukrainës, Bjellorusisë apo Interpoli që atëherë.

Gjatë dëshmisë së tij para trupit gjykues, i ishin treguar disa foto të bëra gjatë bastisjes së klinikës Medicus. Ai e kishte përshkruar ndërtesën me dy kate dhe një kulm trekëndësh. Përjashta kishte një shenjë që shkruante “Medicus Clinic”. A.K. e njohu klinikën Medicus, ku e kishte pasur operacionin nga disa foto.

A.K. pastaj ishte pyetur se a njohte ndonjë person në gjykatë. Ai i kishte shikuar të gjithë të dyshuarit. Personin e parë që e kishte njohur ishte L.D. Ky ishte doktori i dytë që kishte parë në klinikë. Atëherë kishte të veshur një këmishë të bardhë dhe pantollë të gjelbër. Pas operimit A.K. e kishte parë atë 3 a 4 herë. Po ashtu e kishte parë duke folur me staf mjekësor. E kishte parë njëherë para operacionit në sallën e operacionit me mantelin e mjekut dhe pas pak e kishte vendosur një maskë. Ai po zhvillonte bisedë me doktor S. Biseda ishte zhvilluar në anglishte por ai kishte dëgjuar vetëm disa fjalë sepse ishte nën ndikim të anestezionit. Doktorët bëheshin gati për operacion. Ata të dy vishën dorëzat dhe i vunë maskat.

Ditën e dytë A.K. e kishte parë doktorin L.D. kur kishte ardhur në dhomë nga dera e prapme. Ai po fliste me stafin mjekësor që ishin në dhomë. A.K. nuk e di se çfarë lloji bisede ishte zhvilluar sepse nuk e ka kuptuar gjuhën. Pastaj ai e kishte parë doktorin L. pas disa ditësh – ditën e tretë a të katërt pas operacionit. Atëherë L. D. ishte me S. Ata po flisnin në gjuhën angleze. L.D. e kishte pyetur S. për gjendjen e A.K.-së dhe si ishte trajtuar. S. kishte thënë se A.K. kishte temperaturë normale dhe stafi mjekësor i kishin dhënë disa hapa. A.K. shpjegoi se doktor S. e kishte kontrolluar çdo mëngjes dhe nganjëherë edhe në mbrëmje. Ai e kishte parë L.D. prapë ditën para se të dilte nga klinika. Atë ditë e kishte parë dy herë, në mëngjes dhe pas dite e kishte parë edhe në lajme kur ishte mbyllur klinika Medicus. Ai e njohu L.D. në gjykatore.

A.K. pastaj e njohu A.D. që ishte shoferi që e kishte sjellë atë nga aeroporti i Prishtinës në klinikën Medicus. Kur kishin arritur në klinikë doktori e kishte thirrur A.K. në kabinet të vet në katin e dytë dhe A.D. kishte shkuar te M.H. dhe ata kishin filluar bisedë në katin e dytë të klinikës. A.K. e kishte parë A.D. ditën e fundit kur e kishte dërguar në aeroport. A.K. nuk njohu persona tjerë në gjykatore.

Ai e njohu Y.S. në fotot e treguara si dhe një foto të stafit mjekësor. Gjykata theksoi se ai quhet SH.H. A.K. identifikoi një foto të L.D. . Një foto tjetër ishte gjithashtu e njërit nga stafi mjekësor. Gjykata theksoi se ky person quhet B. SH.

Ai e përshkroi shëndetin e tij tani si përgjithësisht MIRË, por një herë a dy herë në muaj ai ndjen dhimbje në vendin e operimit kur pi shumë lëngje – çdo lloj të lëngjeve. Është më i lodhur se para operimit dhe ka dhimbje herë pas here.

Ai kërkon kompensim prej 60.000€ si kompensim për dhimbje dhe dëmtim moral e fizik sepse iu deshtë ta braktis banesën e tashme. Ai ka humbur kontaktin me familjen dhe iu deshtë t’i ndërpres studimet dhe ta braktis punën. Dëshmitari A.K. e kishte treguar varrën e tij dhe gjyqtari kishte vërejtur “ se kishte një varrë në anën e majtë të dëshmitarit” në bark. Duket se është 8 inç e gjatë, që i bie, 15-20 centimetër”.

## 7. Y.A.

Y.A. dëshmoi në një seancë të jashtëzakonshme hetimore sipas nenit 238, KPPK, me 17 nëntor 2008. Gjatë seancës ishin të pranishëm E.SH., B.SH., M.SH., M.H., L.D., T.P. dhe I.RR., që të gjithë të dyshuar dhe avokati mbrojtës i tyre. Prokurori publik ishte i pranishëm

dhe seanca u zhvillua para gjyqtarit ndërkombëtar të procedurës paraprake. Vendndodhja e A. nuk dihet sipas autoriteteve turke që janë kontaktuar me një kërkesë për ndihmë ndërkombëtare gjatë seancës kryesore dhe prokurorisë gjatë hetimeve. Kështu, deklarata e Y.A. është e pranueshme si dëshmi, bazuar në nenin 368 (1) paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale.

Y.A. Kishte ardhur në Kosovë ta dhuroj veshkën në shkëmbim për 20.000\$ të cilat do të duhej t'i merrte kur kishte ardhur në aeroportin e Stambollit të cilat ai nuk i kishte marrë. Atij fillimisht iu kishte afuar një person me emrin I. i cili kishte thënë se mund ta dhuroj veshkën në Kosovë pasi në Turqi kjo nuk është e ligjshme dhe mund t'i marrë 20.000\$. I. i kishte ndihmuar ta siguronte një pasaportë dhe ia kishte marrë mostrën e gjakut për ta krahasuar me gjakun e pranuesit që përputheshin. Y. nuk ia di mbiemrin, adresën ose numrin e telefonit të I. Ata ishin takuar në park jashtë Stambollit. Y. kishte fluturuar nga Stambolli në Prishtinë me 30 tetor 2008 sipas biletës. I. e kishte blerë biletën. A. ishte shoqëruar nga një person të cilin ai e njohu në seancë – M.H.– të cilin e kishte takuar në aeroport në Stamboll. Ata nuk ishin ulur së bashku. Në Prishtinë, Y. u kishte thënë zyrtarëve të imigracionit se kishte ardhur për trajtim.

Nga aeroporti në klinikë Medicus kishte shkuar me një person tjetër të cilin se kishte parë në seancë. Me këtë personin tjetër i kishte njoftuar M.H.. Në klinikë, ishte vendosur në një dhomë. Edhe pranuesi ishte vendosur në të njëjtë dhomë. Y. e njohu pranuesin si personi me emrin B.SH. i cili ishte prezent në seancë si i dyshuar i supozuar. Operacioni u krye të nesërmen. Në seancë Y. nuk njohu ndonjë mjek apo persona tjerë që ishin të pranishëm në operacion, sepse nuk u kishte kushtuar vëmendje dhe pastaj kishte humbur vetëdijen. Ai besonte se operacioni ishte i ligjshëm, prandaj nuk brengosej. Por, ai ishte në gjendje të identifikoj kushërinjtë e pranuesit në seancë – M.SH dhe E.SH.

Në seancë, Y. -it i ishin treguar fotografi të personave, dhe ai kishte njohur S. të cilin e kishte parë në klinikë, M.H. të cilin e kishte identifikuar në seancë, dhe I.RR. dhe T.P. , por nuk i kujtohej kur dhe ku i kishte parë. Sa i përket S. , Y. nuk mbante mend nëse ishte ai njëri nga mjekët që e kishte operuar por ai kishte ardhur në dhomën e tij pas operimit që ta shoh gjendjen e tij. Ai e kishte hequr veshkën e majtë dhe nuk kishte ndonjë problem.

Personi i njëjtë e kishte dërguar në aeroport. Ai kishte qenë me M.SH. dhe M.H. H. ia kishte dhënë biletën kthyesë. Në pikën e parë të kontrollit në aeroport, kishte një problem me biletën e tij dhe ai dhe M.H. kishin shkuar në Turkish Airlines ta zgjedhin problemin. Pastaj ai e kaloi kontrollën e parë por ishte ndalur nga policia në kontrollën e dytë të cilët e kishin pyetur pse kishte ardhur në Kosovë. Y. u kishte treguar një ftesë lidhur me operimin, dhe kishte thënë ishte në spital dhe kishte hequr një veshkë.

Y. nuk e dinte se a do t'i merrte ndonjëherë paratë kur të kthehej në Stamboll. Ai nuk e dinte kush ishte pronari ose menagjeri i klinikës. Ai nuk ishte kërcënuar nga I. që ta heqë veshkën dhe e kishte dhënë veshkën vullnetarisht. Por, ai llogarit vetën viktimitë sepse ai s'i kishte marrë paratë që i ishin premtuar. M.H.s'kishte folur kurrë me të për marrëveshjen financiare lidhur me veshkën e tij.

Para operacionit dhe sa ishte me vetëdije, Y. kishte nënshkruar një deklaratë në gjuhën turke të cilën e kishte kuptuar, që thoshte se ai dëshiron t'ia dhuroj veshkën një personit tjetër. Ia kanë dhënë një dokument pas operacionit me emrin Medicus në të që nuk ishte në gjuhën turke dhe të cilin ai nuk e kishte kuptuar, të cilën ua kishte dhënë policisë në aeroport.

## **B. Përmbledhje e dëshmisë së pranuesve të veshkës dhe të afërmeve në rend kronologjik me datë të operimit nga më e hershme deri te më e fundit.**

### **1. "T3" ka dhënë dëshminë me video lidhje nga Izraeli me 19 qershor 2012**

T3 Kishte vuajtur nga diabeti dhe në vitin 2007 kishte filluar të vuaj nga funksionimi i përkeqësuar i veshkës. Doktorin i kishte thënë se duhej t'i nënshtrohej dializës gjë të cilin ai e kishte refuzuar, pasi kishte qenë dëshmitar gjatë përvojës së babait të tij. Ai kishte filluar të pyes për transplantim të veshkës dhe kishte folur me shokë e të afërm. Pastaj e kishte takuar një grua në Turqi e cila kishte pasur një transplantim të suksesshëm dhe ajo ia kishte rekomanduar Y.S.

Pastaj atë e kishte kontaktuar 'A.' i cili kishte thënë se mund ta kontaktoj Y.S. A. i kishte shpjeguar se ai do të aranzhonte që T3 të shkonte në Evropë për transplantim me Y.S. A. i kishte treguar dhe çmimin. T3 kishte dëshirë të bënte çka do të siguronte një transplantim. Kjo do të kushtonte 100.000\$, dhe T3 duhej të paguante disa shekel (monedha e Izraelit) menjëherë, të cilat ai i kishte paguar me pare në dorë dhe të tjerat më vonë. A. kishte thirrur pak më vonë dhe e kishte njoftuar T3 se do të fluturonte për në Turqi në një datë të caktuar. Në atë kohë kishte gjendje shumë të rëndë sa i përket shëndetit. T3 nuk kishte pasur kontakt me Y.S. para se të fluturoj në Stamboll, ani pse më vonë i kishte thënë policisë se kishte pasur kontakt direkt me doktorin. Ai kishte gënjyer policinë dhe nuk dëshironte t'u tregonte për A. sepse dëshironte t'i ruaj njerëzit që ia kishin kthyer jetën. T3 kishte fluturuar nga Tel Avivi në Stamboll dhe kishte me vete 100.000\$, minus shekelet që i kishte paguar në Izrael. Parat i bartte në një çantë parash të lidhur në brez. Në Tel Aviv e kishte kaluar sigurimin pa problem dhe kishte hyrë në Turqi pa problem. Gjatë udhëtimit ishte shoqëruar nga 'Z.' që ishte në kontakt me njerëzit në Stamboll. T3 shoqërohej edhe nga gruaja e tij dhe djali.

Në hotel atij i ishin bërë më shumë analiza të gjakut që ia kishte kryer një person që kishte ardhur në emër të Y.S. dhe i kishin thënë se analizat janë për të provuar përputhjen. Në hotel ishte edhe një person me emrin 'Y.', por ai s'kishte bërë asnjë pyetje për të. Të nesërmen kishte udhëtuar në Prishtinë. Ai kishte shkuar të marr një shishe ujë dhe kur ishte kthyer i kishin thënë nuk bën të pi ujë sepse do të operohej atë mbrëmje. Më vonë e kishte mësuar se ky person ishte Y.S., i cili mund të ketë qenë në të njëjtin fluturim por ky nuk e kishte ditur.

Pas pak dy xhipa kishin ardhur dhe T3, gruaja e tij dhe djali hipën në njërin dhe ishin dërguar në klinikë. Shoferi ishte një djalë shumë i ri, për të cilin më vonë e kishte mësuar se ishte djali i menaxherit të klinikës. Udhëtimi zgjati 15-20 minuta. Në klinikë, ai ishte ndërruar në veshje të spitalit. I pyetur nga prokurori se ku ishin paratë, ai kishte thënë se ia kishte dhënë Z. në hotel në Turqi. Kjo ndryshonte nga deklaratat e tij dhënë policisë ku kishte thënë se ia kishte dhënë Y.S. Ai kishte gënjyer policinë për ta mbrojtur A. dhe Z. dhe deklaratat e tij në polici ishte e rrejshme.

T3 kishte komunikuar me infermiere në klinikë të cilat ia kishin shpjeguar se procedura do të ishte atë natë. Atij s'i kujtohet nëse kishte parë Y.S. para operimit. Ai kishte bërë më shumë analiza përfshirë edhe EKG, mendon ai. Ai i kishte parë dy persona që mund të kenë qenë dhurues të mundshëm, por ai se kishte vijuar çështjen më tej. Rreth orës 10:00 pasdite ia kishin dhënë një injeksion dhe ishte dërguar në sallën e operimit. Ai e kishte parë Y.S., mjekët tjerë dhe infermierët, si edhe një person tjetër në një tavolinë tjetër operuese. Nuk e dinte se a ishte ai person femër a mashkull. Ai beson se ata flisnin në gjuhën angleze.

Pas operimit, personi me emrin Y. kishte ardhur në dhomën e njëjtë një ditë a dy më vonë dhe ata ishin të ndarë nga një ekran i madh. Ajo ishte gjithashtu marrëse. Ai kishte mësuar gjithashtu se në spital gjendej edhe një marrës-një person i moshuar nga Turqia. Ai nuk kishte vërejtur ndonjë dhurues të organeve. Pas pesë ose gjashtë ditësh me tu lëshuar nga klinika, ai kishte pranuar disa dokumente nga Y.S., të cilat përfshinin një listë me analiza për t'u zhvilluar pastaj nga mjeku i tij në Izrael. Ai ishte kthyer nga aeroporti i Prishtinës me një veturë të tipit Jeep, të cilën e voziste shoferi i njëjtë dhe pastaj u kthye në Stamboll.

Në gjykimin kryesor, prokurori ballafaqoi T3 me disa foto. Ai e kishte identifikuar Y.S. -in në një foto. Nuk i kujtohet nëse kishte nënshkruar ndonjë dokument në klinikë. T3 nuk ishte në gjendje të identifikonte A.D. para video-kamerës si shofer prej dhe në aeroport.

T3 është 57 vjeçar dhe kishte filluar të ankohej lidhur me një dhimbje në veshkë në moshën 45 vjeçare. Ai punon në një biznes importues, dhe tani punon në orar të plotë pa asnjë problem. Ai do të kishte vdekur po mos ta transplantonte veshkën. Nuk e konsideron veten si palë e dëmtuar. Ai nuk do të ndiqte penalisht të pandehurit; përkundrazi do t'iu kishte dhënë medalje. Bashkëshortja dhe i biri e kishin vizituar çdo ditë por nuk kishin pasur kontakte me dhuruesin.

2. "T4" ka dëshmuar përmes një video lidhje në gjuhën hebraike nga Izraeli më 19 qershor 2012.

T4. Në vitin 2007, T4 kishte filluar të ankohej për dhimbjet në të dy veshkat. Atij mjeku i kishte thënë se duhet t'i nënshtrohej dializës, të cilës i ishte nënshtruar për një periudhë afro 5 muajore në një spital të Izraelit. Atij i kishin thënë se do t'i duhej ta bënte një transplantim të veshkës dhe se më sa largu 2 deri në 3 vite. Në vitin 2008, ai kishte vënë kontakte me një person të quajtur A. , dhe ata ishin takuar në një kafene ku ata e kishin biseduar mundësinë e transplantimit të veshkës në shtetin e Kosovës. Çmimi ishte 70.000€ në të holla të gatshme të cilat do t'i paguante në dy këste, njërin këst në valutën Shekel dhe tjetrin në Euro. Atij i ishte lëshuar një faturë për pagesën e këstit të parë por jo edhe për të dytin.

Pastaj ai kishte fluturuar nga Tel Aviv në Stamboll me bashkëshorten dhe Z . Në Stamboll ai shkoi te klinika e Y.S. ku i kreu analizat e gjakut. Të nesërmen ai kishte fluturuar për në Prishtinë me bashkëshorten e tij . Atij nuk i ishte parashtruar ndonjë pyetje tek kontrolli i pasaportave. Nuk i kujtohet nëse e kish takuar dhuruesin të aeroporti. Pas 10-15 minutash kishin arritur te Klinika.

Me të arritur në klinikë ai kishte ndërruar veshjen dhe ishte dërguar në sallën e operimit pasi i kishte kryer edhe disa analiza të gjakut. Ai aty e njeh Y.S. -in dhe kishin qenë edhe 4 ose 5 anëtarë tjerë të stafit kirurgjik të cilët nuk i kishte njohur. Pas operacionit ishte ndjerë mirë, derisa kishte qëndruar aty edhe nja 5-6 ditë gjatë të cilës periudhë ai ishte vizituar nga Y.S. Ka qenë edhe një grua turke pak sa e shtyrë në moshë në klinikë, e cila ishte marrëse. Në aeroportin e Tel Avivit ai kishte pranuar disa dokumente nga Z. i cili i kishte thënë se ishin nga Kosova. T4 kishte dokumentet para tij gjersa dëshmonte. Njëri ishte i titulluar Raporti Mjekësor. Raporti i ishte lexuar dëshmitarit në gjuhën Hebraike. Ishte një referencë për Komisionin Etik dhe pajtimin. T3 kurrë nuk ishte paraqitur para ndonjë Komisioni Etik për ta kryer transplantimin e veshkës.

Në njërin nga dokumentet ishte një logo e spitalit Medicus. Në faqen e dytë ishte nënshkrimi i L.D. Njëri nga dokumentet ishte Formulari i transplantimit të veshkës i datës 19 qershor

2008 i cili i ishte lexuar dëshmitarit në gjuhën hebraike. Dokumenti përfshinte një deklaratë që dhuruesi kishte kaluar nëpër një intervistë dhe ku ishte pajtuar për transplantim. Dëshmitari përsëri e mohon të jetë paraqitur ndonjëherë para ndonjë të ashtuquajtur Komision Etik ose që dikush ta ketë biseduar me të natyrën e transplantimit. T3 gjithashtu e kishte pranë vetes edhe dokumentin e quajtur "Akt i Dhurimit" i datës 19 qershor 2008 e cila ishte lexuar në gjuhën hebraike. Nënshkrimi i tij nuk gjendej në atë dokument, e as diçka që ishte shkruar me shkrim dore. Sidoqoftë ishte një vulë e noterit. Ai ia kishte dhënë dokumentet policisë izraelite me rastin e marrjes në pyetje. Këto janë dokumentet që ai i kishte pranuar nga Z. në aeroportin Ben Gurion të Tel Avivit.

T4 i ishin paraqitur disa foto. Ai mundi ta njihte kliniken ku ishte operuar për transplantim. Sidoqoftë, ai nuk mundi ta njihte asnjë nga ata që iu treguan në foto. Nga T4 u kërkua nëse e dinte emrin e personit i cili e kishte dhuruar veshkën por ai e nuk ia dinte. Për të emri A.O. nuk tingëllonte si emër i njohur, dhe se të njëjtin nuk e kishte takuar në aeroportin e Prishtinës. Atë e vizitonte bashkëshortja çdo ditë dhe se as ajo nuk kishte kontaktuar me dhuruesin.

3. "M2" kishte dëshmuar përmes video lidhjes nga Izraeli më datën 18 qershor 2012.

M2 ka filluar të ndjej dhimbje në veshka në vitin 1998 gjë e cila sa kishte ardhur e ishte përkeqësuar me kalimin e kohës. Në vitin 2007 situata kishte filluar të bëhej kritike dhe i ishte nënshtruar dializës 3 herë në javë nga 5-6 orë secilën herë. Ishte e tmerrshme. Ai pastaj kishte filluar të kërkonte ndonjë mundësi të vinte deri të transplantimi. Ai ishte regjistruar për transplantim në Izrael por ka qenë lista e pritjes shumë e gjatë dhe kurrë nuk e kishte kontaktuar askush. Disa kushërinj në Ukrainë kishin shprehur vullnetin të ia dhuronin veshkën por ata ishin refuzuar në Izrael.

Ai pastaj kishte shkuar në kompaninë Etgar në Tel Aviv, ku kishte aranzhuar transplantimin jashtë shtetit. Personi kontaktues quhej A. Personat të cilët i ishin nënshtruar dializës e kishin pasur të njohur numrin e tij te telefonit. Ai e kishte marr në telefon A.-in dhe se ky i fundit i kishte thënë se një transplantim mund të aranzhohet. A. i kishte treguar për analizat të cilat duhej t'i nënshtrohej dhe çmimin prej 100.000 dollarë amerikanë. Në fakt çmimi doli të ishte më i shtrenjtë 108, 000 dollarë amerikanë pasi që çmimi i paraprak ishte për transplantim në Filipine, por se atje nuk ishte më e mundur. M2 kishte kryer 5-6 pagesa, disa në Shekel dhe disa tjera në dollarë amerikan. Ai ka pranuar faturat për këtë punë. Ai u ka besuar kompanisë dhe personit A., dhe ishte i vendosur për tu bërë operacion, dhe kështu e lidh një kontratë për pagesë.

Ky proces kishte filluar në mesin e vitit 2007 edhe në 2008. Ai qëndroi në kontakt me A. dhe kishte prituri deri sa ta thërrisnin për të fluturuar. Ai gjithashtu kishte takuar Z. i cili e kishte shoqëruar deri në Kosovë. Z. kishte qenë gjithashtu përfaqësues i kompanisë Etgar . Kah fundi i qershorit ose në fillim të korrikut 2008, ai kishte fluturuar me aeroplanin Turkish Airlines për në Stamboll bashkë me bashkëshorten vet dhe Z., si dhe z. F., i cili ishte një shok dhe i biri i tij.

Ata kanë qëndruar një natë në Stamboll. Ditën e nesërme ata kaluan Bosforin dhe shkuan në një klinikë për testim. Aty për herë të parë e takon Y.S. Atij i ishte thënë se gjasat për transplantim janë shumë të mira dhe i kishin dëshiruar sukses. Ata nuk kishin biseduar rreth detajeve të operacionit apo të dhuruesit. Të nesërmen janë nisur me aeroplan për në Prishtinë.



Në Izrael, para nisjes për Stamboll, A. i ka dhënë disa dokumente M2 duke përfshirë edhe ftesën për t'iu nënshtruar disa analizave mjekësore në klinikën Medicus. Megjithëse, ky nuk kishte qenë qëllimi i udhëtimit; ai ishte nisur për t'iu nënshtruar transplantimit të veshkës. A. i kishte thënë se ndoshta duhet për ta paraqitur letrën në kufi. Letra ishte shkruar në letër me mbishkrim të Medicus. Në aeroportin e Prishtinës ishte prezantuar si turist dhe nuk kishte përmendur kurrfarë transplantimi organesh. Nuk kishte qenë i brengosur për ligjshmërinë e transplantimit dhe nuk i kishte shkuar në mendje.

Ata kishin takuar dy veturat me të cilat pastaj ishin nisur në drejtim të klinikes, në një udhëtim prej 30 minutash. Pasi mbërritën aty, ai u desh t'iu nënshkruaj disa dokumente, dhe ai i kishte nënshkruar ato pa i lexuar. Me atë rast i kishin thënë se ky është një pajtim për t'iu nënshtruar transplantimit. Z. ia kishte shpjeguar se çfarë po ndodhte. z. F. ishte atje për të njëjtin qëllim. Ai pa personel të ndryshëm mjekësor, infermier dhe infermiere dhe se klinika i kishte lënë përshtypje të mirë. Ai e kishte parë Y.S.-in para operimit por nuk kishte biseduar me të. Z. përkthente për të si të bëhej gati për operacion. Para operacionit ia kishin dhënë një injeksion dhe se pranë Y.S. kishin qenë edhe tre anëtar nga personeli mjekësor dhe në sallën e operacionit kishin qenë edhe nja 2-3 persona tjerë.

Pas operimit, infermieret ishin përkujdesur për shëndetin e tij gjatë tërë kohës. Më vonë ai e kishte parë Y.S.dhe kishin folur pak në anglisht. Pasi që M2 kishte gjuhën ruse si gjuhë amtare, në klinikë askush nuk e kishte ditur gjuhën ruse, pak a shumë ishin marr vesh në gjuhën serbe. Ai kishte parë gjithashtu dy persona tjerë burra e grua të cilët flisnin gjuhën ruse të cilët është e mundur të kenë qenë dhuruesë të moshës 50 gjegjësisht 25 vjeçare. Ai nuk e di se cili prej tyre ka qenë dhuruesi. Ata nuk kishin qenë kushërinj të tij, ai nuk kishte mësuar emrin e tij, dhe ai nuk e di nëse ata i kishin marr të hollat.

Ai ishte shtrirë në spital për 4-5 ditë dhe ishte lëshuar nga klinika më 15 korrik. E kishte parë Y.S. -in së paku 3 herë, i cili e ekzaminonte dhe e pyeste. Ai kishte pranuar disa dokumente deri sa po kthehej, të cilat i kishte dorëzuar në një spital në Izrael. Gjithashtu, Y.S. ia kishte dhënë disa ilaçe dhe udhëzime të përdorimit. Pasi kthimit në Izrael nuk kishte pasur komplikime, përveç zëvendësimit të një ilaçi. M2 nuk kishte vënë në pikëpyetje ligjshmërinë e transplantimit. Ai kishte pranuar disa dokumente ku thuhej se kishte qenë ligjor dhe spitali ishte i autorizuar. Ai kishte marr disa dokumente me vete derisa po jepte dëshminë. Njëri dokument kishte datë 09 janar 2008- vendim i Ministrisë së Shëndetësisë ta emëroj përkohësisht Y.S. si mjek i përgjithshëm (bashkë me një mjek tjetër). M2 i ishin paraqitur disa foto. Ai e njohu klinikën Medicus dhe Y.S. -in, por jo edhe tjerët. M2 ka sigurim mjekësor dhe se i kishte dorëzuar ato në një proces ligjor me kompaninë e sigurimeve. Ai kishte marr një kompensim të pjesshëm.

4. "M3" Bashkëshortja e "M2". Ajo kishte dhënë dëshminë e saj përmes video-lidhjes nga Izraeli me 16 qershor 2012.)

Në vitin 2007-08, para operacionit të bashkëshortit, ai i ishte nënshtruar dializës 3 herë në javë dhe secilën herë nga gjashtë orë dhe kishte qenë shumë e vështirë për të. Në Izrael nuk mund të kishte transplantim të veshkëve. Ajo kishte udhëtuar me të prej Tel Aviv-Stamboll, pastaj për në Kosovë me qëllim të transplantimit të veshkës. Ajo qëndroi në hotelin Victory në Prishtinë më 2 korrik, dhe u kthye në Stamboll me 8 korrik.

Asaj ia kishin treguar një foto e cila dukej si klinika në të cilën kishte qenë bashkëshorti i saj. Ajo ishte takuar me Y.S.në klinikë nga personi i kompanisë i cili i kishte shoqëruar ata, M.Z.,

dhe e kishte parë Y.S. dy a tri herë por nuk kishte folur me të. Asaj i ishin treguar fotografitë, në një rën prej të cilave personi aty dukej si doktori-pa flokë dhe i dobët- por nuk i kishte njohur të tjerët.

Ajo kishte udhëtuar për në Prishtinë me bashkëshortin, Z. dhe familjen e F. Ajo nuk ka qenë aty kur bashkëshorti i saj i kishte paguar mjetet atij, dhe se nuk e di nëse kjo ka qenë para apo pas operacionit.

5. “A1” kishte dëshmuar përmes video-lidhjes nga Izraeli më 20 qershor 2012).

A1 kishte pasur disa probleme shëndetësore gjatë viteve 2007-08. Mjekët i kishin thënë se veshkët e tij ishin duke e humbur funksionin. Ata i kishin kryer disa analiza dhe kishin caktuar se atij i nevojitej dializa dhe transplantimi. Ai ishte munduar të gjej gjithqysh transplantimin e veshkëve. Pas një periudhe kohore ai kishte kontaktuar A. in në qershor 2008. Ata kishin biseduar për transplantim. A1 i kishte thënë A. it se e donte këtë transplantim dhe ishte i gatshëm t’i paguante të hollat. A. i tregoi shumën e të hollave A1-së e cila ishte 79.000€. Ata nuk kishin bërë pazar rreth shumës. A1 i kishte paguar 10.000€ A.it apo kompanisë së tij. Ai pranoi një faturë me datën 23 korrik. A1 kishte paguar 69.000 EUR në Spital para operacionit.

Në fund të qershorit, para operacionit, A. erdhi në shtëpinë e A1 dhe nënshkroi një marrëveshje për tërë procesin. A. tha, gjithashtu, se operacioni do të bëhej kah fundi i muajit korrik dhe Y.S. do ta kryente operacionin. A1 nga Aeroporti Ben Gerion u largua më 1 korrik dhe shkoi në Stamboll. Në atë fluturim, ishte një person i cili shkoi për ta bërë transplantimin. Ai udhëtoi me gruan e tij dhe A1 ishte me djalin e tij. Atje ishte një njeri nga Kompania Etgar, Z. Personi tjetër i cili po e bënte transplantimin, quhej L.SH.

Askush nuk i kishte shpjeguar lidhur me rreziqet nga transplantimi i bërë jashtë Izraelit. Nuk ka rëndësi fare, sikur mos të ndodhte operacioni, A1 tani do të ishte i vdekur. Në Izrael, atij kurrë nuk do ti transplantohesh veshka në moshën 72 vjeçare.

Në Stamboll, Z. i dërgoi ata në hotel dhe që ti bëj analizat e gjakut. Të nesërmen në mëngjes, ata shkuan në Aeroportin e Stambollit dhe pastaj fluturuan për në Prishtinë. Atje, askush nuk u kishte dhënë ndonjë dokument. Në kontrollimin e pasaportave askush nuk i pyeti asgjë. Atyre u ishte thënë se, nëse dikush i pyet, ata do duhej t’u thoshin atyre se destinacioni i tyre ishte spitali. Ata nuk ishin këshilluar që të thoshin transplantim të veshkëve apo diç tjetër por vetëm trajtim mjekësor.

Pas arritjes në aeroport, ka arritur një makinë, ata kanë hyrë në makinë dhe kanë shkuar në spital. L. do ta kishte operacionin i pari dhe atij iu tha që të agjëronte. A1 u bë operacion të nesërmen pasi që kishte arritur në Prishtinë.

A1 takoi Y.S. -in në klinikë para operacionit. Kur e pyetën se nëse A1 ia kishte bërë pagesën drejtpërdrejt Y.S. -it në klinikë, ai është përgjigjur se ai e kishte paguar spitalin. Në fakt nuk ishte ai por djali i tij i cili i kishte dhënë paratë. Djali i tij i barte të hollat (69,000 Euro) në

“kesh”. A1 nuk ishte i përfshirë në pagesë por djali i tij. Fatura për pagesën e 69.000€ i ishte dorëzuar atij nga A.i apo Z.

Gjatë operacionit A1 kishte parë shumë njerëz. Ai kishte qëndruar në klinikë 7 ditë pas operacionit. Djali i tij ishte aty gjatë tërë ditës dhe natën kishte shkuar për të fjetur në hotel. Gjatë asaj kohe, ai e kishte parë Y.S. -in për çdo ditë, dy herë në ditë, ai i shikonte të dhënat dhe i jepte atij këshilla. A1-it nuk i kujtohet të kishte parë mjekë tjerë gjatë kësaj kohe, por ai nuk beson të kishte parë. Trajtimi në Klinikën Medicus ishte i shkëlqyer. A1 kurrë nuk ka takuar ndonjë person apo persona, të cilët i kishin dhuruar organet e tyre. Ai nuk e kishte pyetur Y.S. -in apo dikë tjetër se kush ishte dhuruesi. Ai nuk ishte i interesuar. Djali i tij nuk kishte ndonjë kontakt me personin i cili e kishte dhënë veshkën gjatë kohës gjersa ai ishte në klinikë. Ai nuk ishte në dijeni se personi i cili i ka dhënë veshkën quhej M.N.

A1-it iu prezantuan ca foto dhe ai është pyetur nëse ai e njohte dikë nga ato. A1 bëri me gisht në klinikën ku ishin ata. Atij iu treguan ca foto të personave dhe ai mendonte se e njohte Y.S. -in dhe askë tjetër. Prokurori Publik iu referua disa dokumenteve dhe e pyeti A1-in lidhur me “Formularin Verifikues të Transplantimit të Veshkës”, të datës 02/07/08. Atij nuk i kujtohet kjo por mendon se ishte dorëshkrimi i tij por se nuk ishte i sigurt për këtë. Ai nuk din anglisht. Në formularin-akti i dhurimit A1 pastaj konfirmoi se ai ishte dorëshkrimi i tij. Atje kishte dy nënshkrime: një nga dhuruesi dhe një nga pranuesi. A1 kishte konfirmuar se po e njohte dokumentin. Nënshkrimi i tij është në anën e djathtë. Këtë dokument ai e kishte nënshkruar në Prishtinë më 2 korrik 2008. Atij i kujtohet ta kishte bërë këtë dhe e shikon nënshkrimin e tij. Kur ai e kishte shkruar këtë dokument, djali i tij kishte qenë me të dhe, meqë ai kupton anglisht, ai ia kishte shpjeguar përmbajtjen.

Ai kishte pesë dokumente të cilat i dorëzoi në polici. Njëri ishte Akti i Dhurimit, të cilin e kishte nënshkruar sa ishte në Kosovë. Z. ishte i pranishëm bashkë me djalin e A1. Mbase dhuruesi ishte i pranishëm, por A1 nuk ishte i sigurt. Ai nuk e kishte parë se kur e kishte nënshkruar pala tjetër. Aktin origjinal të Dhurimit, ai e kishte marrë në klinikë në Kosovë. Ai këtë e kishte marrë në recepcion. Ai këtë nuk e kishte marrë kur ishte lëshuar nga klinika, por kur ishte pranuar.

A1 nuk e sheh vetën si palë e dëmtuar; përkundrazi ai e fitoi jetën.

6. " **B1**". I biri i A1 . Ai dëshmoi përmes video lidhjes nga Izraeli me 21 qershor 2012.

B1 e kishte shoqëruar babanë e tij në një udhëtim për në Kosovë. Para udhëtimit në Kosovë, babai i tij kishte dëmtim të veshkëve dhe funksionim shumë të dobët të tyre. Babai i tij ka eksploruar mundësinë për transplantimin e veshkës në Izrael, gjersa B1 punonte jashtë vendit. Ata u munduan të gjejnë zgjidhje për këtë problem por, meqë në Izrael nuk kishte mundësi reale për transplantim të një organi, ata filluan që të kërkonin jashtë vendit, në tjera vende, për mundësinë e një transplantimi.

B1 dhe babai i tij kishin takuar A.-in dhe Z. -in në një qendër tregtare disa ditë para se të shkonte në Kosovë ku ata iu kishin dhënë hollësira lidhur me udhëtimin e tyre në Kosovë. Gjithashtu i pranishëm ishte edhe një çift tjetër me mbiemrin SH. Ata fluturuan diku në fund të qershorit apo në fillim të korrikut 2008. Ai kishte fluturuar me babanë e tij nga Aeroporti i Ben-Gurion dhe drejt në Stamboll. Në këtë fluturim kishin qenë babai i tij, Z., SH. dhe bashkëshortja e tij. Z. ishte përgjegjës për të gjitha çështjet teknike, siç janë ato të vendosjes në hotel, fluturimet, transportet, etj.

Pagesën e kishte bërë babai i tij. Babai i tij kishte paguar rreth 75,000-80,000 euro, një pjesë ishte paguar në Izrael A.it dhe një pjesë ishte paguar në spital në Kosovë. Në Stamboll, Z. i dërgoi ata në një hotel afër aeroportit dhe pastaj e dërgoi babanë e B1 dhe z. SH. për disa analiza mjekësore.

Mëngjesin tjetër ata shkuan në aeroport dhe u nisën për Kosovë. Askush nuk i dha atij ndonjë dokument. Ai nuk u kishte thënë asgjë oficerëve gjatë kontrollimit të pasaportave lidhur me qëllimin e vizitës së tyre apo nuk iu kishte treguar ndonjë dokument. Ata donin vetëm ta shikonin pasaportën e tij.

Kur dolën nga aeroporti, dikush i hipi në makinë dhe i dërgoi në spital menjëherë. Shkuarja nga aeroporti deri në spital u kishte marrë kohë prej 20–30 minuta. Ata arritën në spital, e cila ishte një ndërtesë prej dy apo tre katesh dhe kishin hipur në katin e dytë, ku kishin takuar personel mjekësor. Në katin e dytë babanë e tij e kishin dërguar në një dhomë për pacientë gjersa Z. dhe B1 shkuan për ti dhënë paratë në spital. Këto ishin para të gatshme në mes 50,000 – 60,000 euro. Atij nuk i kujtohet personi të cilit i kishte dhënë paratë në spital. Ai e kishte marrë një dëshmi për paratë e dhëna në spital, por nuk i kujtohet nëse këtë e kishte marrë menjëherë apo pasi që e kishin lëshuar spitalin.

B1 ia tregojnë dokumentin me shenjen “811”. Ai konfirmoi se në të shkruan “F., Y.” dhe aty mund të shihej shuma prej 69,000 eurosh. I pyetur se nëse ishte e mundur që ai zarfin me paratë t’ia kishte dhënë Z., ai qartësoi se ai kishte qenë bashkë me Z. por me sa i kujtohet B1-it, ai paratë i’a kishte dhënë dikujt në spital.

Operacioni ishte bërë ditën pasi që ata kishin arritur. B1 qëndroi atë natë në hotel dhe babai i tij ishte bërë operacion të nesërmen. Ai e kishte parë babanë e tij të nesërmen pas operacionit. B1 takoi mjekun i cili duhej ta bënte operacion babanë e tij në spital. Ai kishte ardhur nja dy herë për ta vizituar babanë e B1 para operacionit. Ai e kishte parë mjekun nja dy herë, posaçërisht pas operacionit, meqë ai po e trajtonte dhe kontrollonte babanë e tij. Ai kishte biseduar me mjekun mbase një herë dhe e kishte pyetur si kishte rrjedhur operacioni por ai ishte shumë, shumë i ftohtë. ‘Nëse doni të bëni pyetje, e keni personelin mjekësor, e keni Z. dhe ata mund t’i pyetni’.

Pas operacionit, babai i tij qëndroi në spital për afro 5-6 ditë. Babai i B1 ishte trajtuar nga personeli mjekësor dhe çdo ditë po ndihej pak më mirë. Pas dy ditësh, filloi të ecte nga pak

dhe të merrte shumë ilaçe dhe tableta. B1 pati mundësi ta shihte z. SH. pas operacionit. Edhe ai ishte mirë.

B1 e kishte parë një person apo persona të cilët, ai besonte të ishin dhurues. Ai ata i kishte parë dy ditë pas operacionit. Edhe ata pranonin tretman. Njëri ishte një burrë, mbase, 30-40 vjeçar. B1 nuk kishte biseduar me të. Ai nuk e dinte se nga cili vend ai person kishte ardhur, por mendon se ai fliste pak rusisht dhe pak anglisht. B1 mendonte se ai mund të ishte diku nga Evropa Lindore. Pos këtij njeriu, ai e kishte parë edhe një dhurues organi, një grua. Ajo ishte rreth 25 – 30 vjeçare. Ai nuk kishte pasur rast ta dëgjonte këtë grua duke folur. Por, sipas mendimit tij, edhe ajo ishte diku nga ai vend. B1 kishte kuptuar se ai ishte njeriu i cili i kishte dhënë veshkën babait tij. Babai i tij dhe SH. ishin në spital në të njëjtën kohë dhe ishin lëshuar bashkë. Ata u larguan nga spitali me makinë. Z. ishte kthyer me ta bashkë deri në Tel Aviv.

Prokurori Publik i tregon B1 ca foto dhe ai e njohu spitalin. Atij iu treguan disa foto të personave por ai nuk e njohu askënd prej tyre.

Ai kurrë nuk ishte dalë ndonjëherë para Komitetit Etik. Me sa i kujtohet as babai i tij nuk ka dalë.

Prokurori Publik i kishte treguar B1 dokumentin me titull ‘Formulari për Lejimin e Transplantimit të Veshkës’. Në dokument B1 e kishte parë emrin e babait të tij, por ai nuk ishte shkrimi i babait të tij e as nënshkrimi i tij. Prokurori Publik i tregon një dokument tjetër: “Akti i Dhurimit”. B1 sheh emrin e babait të tij, por jo edhe dorëshkrimin e tij. Ka një gabim në emër pasi një “e” po mungon në emrin F.. Mirëpo, në fund të dokumentit, ai e njohu nënshkrimin në anën e djathtë nën fjalët ‘nënshkrimi i marrësit’ i cili dukej si nënshkrimi i babait të tij. Nënshkrimin në anën e majtë ai nuk e njeh. Ai kurrë më parë nuk e kishte parë dokumentin “Akti i Dhurimit”. Prokurori Publik i tregon “Faturën 097, Etgar”. B1 kurrë nuk e kishte parë këtë dokument më parë.

B1 tha se çdokush me probleme të veshkëve e njeh emrin e profesorit Z.SH.. Kur është pyetur nëse kishte dëgjuar për emra tjerë, qoftë në Tel Aviv, në shtyp apo ndryshe, si: SH. apo Y.S. ai sqaroi se Y.S. ishte mjeku i cili e kishte bërë operacionin babanë e tij. Z. e kishte njoftuar me të në Kosovë dhe i kishte thënë se ky është Y.S.

I ballafaquar me faktin që babai i tij kishte thënë se ai kishte marrë disa dokumente, përfshirë këtu edhe dëshminë e pranuar në Izrael nga Z. ose nga A. i pas kthimit, B1 tha se babai i tij me gjasë kishte pranuar diçka. Sidoqoftë mesa i kujtohet B1-it ai e kishte pranuar dëshminë e të hollave në spital. Mbase babai i tij kishte marrë një dëshmi për atë që i kishte paguar A. në Izrael.

7. **T.S.** ka dëshmuar përmes video lidhjes nga Polonia me 22 mars 2012.

T.S. Në vitin 2008, ai kishte udhëtuar për transplantim të veshkës për në Kosovë. Para se të vinte në Kosovë, ai kishte përjetuar një hospitalizim prej katër vitesh dhe një trajtim serioz për shëndetin e tij. 99 % e veshkëve të tija nuk funksiononin dhe atij i nevojitej një transplantim i veshkës. 3 vjet ai kishte qenë nën dializë, ku kishte shkuar çdo të dytën ditë, nga pesë orë në ditë. Nevoja e tij, për një transplantim të veshkës, ishte bërë urgjente dhe ai kishte filluar që, përmes internetit, të hulumtojë mundësinë për një transplantim jashtë Polonisë. Ai kishte gjetur se ekzistonin mundësi të shumta. Kushdo që të kërkojë në internet, do të gjejë shumë vende si Malaysia dhe vende tjera Aziatike, apo shtete tjera jashtë Evropës.

Ai gjeti në internet një spital në Berlin, Gjermani dhe ata i thanë se ekzistonte një mundësi për trajtim. Ai pastaj kishte marrë një ftesë nga një mjek në Turqi, Y.S. Në prill ose maj i vitit 2008 ai kishte udhëtuar drejtë nga Varshava në Stamboll dhe shkoi në zyrën e Y.S. ku pati disa analiza mjekësore. Atë e kishte këshilluar Y.S. që të priste për rezultatet e analizave dhe ai u kthye në Varshavë ku priti dy apo tre muaj.

Në korrik të vitit 2008, ai përsëri udhëtoi për në Stamboll. Ai ishte vendosur në një hotel dhe ishte në kontakt me Y.S. Ndërkohë, ai e bënte dializën. Ai kishte marrë një biletë aeroplani dhe shoferi e kishte dërguar atë në aeroport. Gjendja e tij shëndetësore po keqësohej, ashtu që nuk po i kujtohej data. Atij nuk i kujtohet se me cilën vijë ajrore kishte udhëtuar për në Kosovë. Në atë kohë, ai ishte në ambulancë për dializë. Y.S. kishte udhëtuar me të për Kosovë, Ai kishte fluturuar direkt nga Stambolli në Kosovë. Në aeroport po i priste një makinë me të cilën u dërguan në klinikë. Në ndërtesë nuk ekzistonte ndonjë emër. Aty ishte vetëm një ndërtesë dhe brenda ishte klinika. Atij nuk i kujtohet se sa larg ishte kjo nga aeroporti. Ai në Kosovë udhëtoj bashkë me të birin.

Në klinikë ai ishte në gjendje të keqe por i kujtohet se i atij ishte dashur ta nënshkruante dokumentacionin në dy apo tre gjuhë. Ai flet anglisht, polonisht dhe gjermanisht. Dokumentacioni ishte në anglisht. Para se ti nënshkruante ato, ai e kishte lexuar dokumentacionin. Atij vërtetë nuk i kujtohet se çfarë kishte brenda letrave. Aty ishte një person i cili kishte thënë se gjithçka ishte në pajtim me rregulloret por ai nuk mund ta përshkruaj këtë person në hollësi, meqë kjo kishte ndodhur katër vite më parë. Sidoqoftë, personi kishte flokë të shkurtër me ngjyrë të zezë dhe ishte rreth 40 apo 50 vjeçar. Ai ishte nga Evropa; ngjyra e lëkurës së tij ishte bukur e zezë por ai ishte një kaukazian i bardhë. Kishte shumë letra të cilat ai i kishte nënshkruar. Me sa i kujtohet atij, në njërin prej dokumenteve thuhej se transplantimi është për arsye altruiste. Ishte një klauzolë e cila thoshte se ky ishte transplantim i ligjshëm dhe në përputhje me sistemin ligjor të Kosovës.

Ai vetëm i ka nënshkruar këto dokumente dhe i ka kthyer prapa.

Ai nuk është i sigurt nëse mund ta identifikonte personin i cili i kishte thënë për ti nënshkruar dokumentet. I pyetur për ta identifikuar ndonjë person nga të pranishmit në gjykatore, si staf i klinikës Medicus, ky dëshmitar nuk ka mundur ta njoh askënd. Ai nuk e di nëse personat të cilët e kishin dorëzuar dokumentin për ta nënshkruar ai ishin udhëheqës në klinikë. Ai person

kishte thënë: “Unë jam përfaqësuesi dhe, për të qenë gjithçka në pajtim me ligjin, ju duhet ti nënshkruani këto dokumente”.

S. ishte në klinikë një apo dy orë para se të fillonte operacioni i transplantimit të veshkëve . Mjeku që e kryeti operacionin ishte Y.S. Y. ishte i pranishëm pas operacionit dhe tha se operacioni kishte shkuar mirë. S. ishte në Kosovë për afro 10 ditë dhe pastaj ka fluturuar për Stamboll me djalin e tij. Ai nuk e din se kush ishte dhuruesi i veshkës.

Çmimi i operacionit tij në Kosovë ishte paguar në dy këste. Para se të shkonte ai i kishte paguar Y.S. 10,000 € dhe kësti i dytë ishte 15,000 € të paguara në Kosovë në klinikë para operacionit. Këtë shumë parash ai ia kishte dhënë Y.S. -it. E tërë shuma e parave, për të gjitha shërbimet, që ai ia kishte dhënë Y.S.-it, ishte 25,000 €. S. iu kishin treguar ca foto dhe ai mendoi se njëra e shfaqte Y.S.-i apo dikush që i ndihmonte atij. Atij iu kishin treguar ca foto të klinikës por ai nuk e njohu atë.

Gjersa ai ishte në klinikë në Kosovë, trajtimi i tij ishte i mirë. Mjekët dhe infermieret ishin profesionalë në kuptimin se si e trajtonin atë.

8. **R.F.** ka dëshmuar përmes video-lidhjes nga Kanada më 23 mars 2012.

R.F.ka thënë se në vitin 2008 nuk kishte qenë mirë me shëndet dhe ai kishte dëmtim të madh të veshkëve. Para vitit 2008, veshkët e tia po funksiononin afro 10%. Gjendja e tyre po keqësohej. Para vitit 2008, ai kishte pasur problem me veshkët e tij për 8 vite. Ai kishte sqaruar se po kërkonte ndonjë burim jashtë Kanadasë, meqë sipas listës, do duhej të priste 10-12 vjet. Mjeku në Kanada e ka dekurajuar atë për të shkuar jashtë vendit sepse nuk do të mund të ishin të sigurt për kualitetin e trajtimit përtej-oqeanik dhe, në vend të kësaj, ai atë e inkurajon që të shkojë në dializë.

Pavarësisht nga kjo, ai filloj të eksploronte mundësinë për një transplantim jashtë vendit. Ai ka biseduar me të gjithë të njohurit e tij që ai kishte jashtë. Ai kishte dëgjuar nga disa të afërm të tij në Izrael dhe kishte rënë në kontakt me një person i cili i kishte thënë se ai mund ta kishte një shans për një transplantim dhe se kishte mundësi për ta gjetur dhuruesin. Ata të dy kanë komunikuar përmes telefonit dhe internetit. Atij nuk i kujtohet e-mail adresa por emri i tij ishte M.H..

M.H. kishte sqaruar si të kryhej kjo procedurë. R.F., tanimë, i kishte analizat e kërkuara nga M.H. dhe përmes e-mail-it, analizat ia kishte dërguar M.H.-it për ti shqyrtuar. M.H.e kishte këshilluar atë se çmimi i operacionit ishte 80.000 €.

Pas dy javësh, ai kishte marrë përgjigje nga H. i cili tha se ai kishte gjetur një rast për transplantim. Ai nuk i kishte thënë se kush dhe ku ishte ky person. Ai i tha F. se brenda ca ditësh ai do mund të udhëtonte dhe të bëhej operacion. Planet ishin të shkohej në Turqi dhe ti bënte analizat përfundimtare të gjakut dhe pastaj të vazhdohej për në Kosovë. F. pagoi për udhëtimin deri në Turqi dhe, pastaj, M.H. pagoi udhëtimin nga Turqia në Kosovë.

Para se të shkonte në Turqi, R.F. bëri një transferim telefonik të të hollave për M.H. duke përdorur sistemin bankar të quajtur Bendix. Ai nuk i kishte bërë ndonjë pagesë tjetër M.H.-it apo ndonjë personi tjetër. Ai nuk kishte marrë ndonjë dëshmi nga ndokush për shumën e paguar prej 80,000 eurosh.

Ai kishte udhëtuar prej Torontos në Stamboll më 22-23 korrik 2008. Bashkë me të kishte udhëtuar edhe bashkëshortja e tij. Me të arritur në Aeroportin e Stambollit, ai ishte takuar me M.H. Ata shkuan në një hotel të cilin R.F. e kishte rezervuar paraprakisht në afërsi me aeroportin ku kishin qëndruar gjatë asaj nate. Në ditën e arritjes, M.H.e kishte siguruar një person i cili ia kishte marrë pak gjak për ti bërë analizat përfundimtare të gjakut.

Të nesërmen, ata fluturuan nga Stambolli për në Kosovë. Ai, gruaja e tij, M.H. dhe gruaja e tij, dy zonja, të cilat flisnin rusisht, dhe një çift që donte të bënte një transplantim, kanë fluturuar me Turkish Airlines. Ata ishin gjithsej 8 persona. Në Aeroportin e Prishtinës, kaloi doganën me pasaportë kanadeze, pa ndonjë incident. Atij nuk i ishte dhënë ndonjë dokument udhëtimi apo ndonjë letër tjetër. Në aeroport ata i kishin hipur në dy makina private dhe i kishin dërguar në klinikë. Në klinikë u kërkua nga R.F.të plotësonte disa formularë nga kirurgu i cili e paraqiti veten si Y.S. Ai i nënshkroi formularët . Ato ishin në gjuhën angleze dhe në gjuhën vendore. Ai i lexoi formularët para se ti nënshkruante. Formulari thoshte kryesisht se ai i kuptonte përgjegjësitë e operacionit.

Ai nuk kishte pasur kontakt të drejtpërdrejt me dy gratë ruse por ato ishin në klinikë për të dhuruar organet e tyre. R.F. beson se ai e kishte marrë njërin nga ato organe. Ruset ishin përafërsisht të moshës së mesme, rreth 30-40 vjeçare. Pas operacionit, ai i kishte parë të dy femrat ruse përsëri. Ato po ecnin nëpër korridor. Ishte kjo dita e tretë pas operacionit. Ato dukeshin mirë.

Gjatë shërimit të tij, ai e kishte parë Y. i cili ishte shumë inkurajues dhe tha se shenjat e transplantimit ishin pozitive. Ai dhomën e ndante bashkë me zotërinë gjerman W.J. Komunikimi ishte i pamundur sepse R.F. nuk fliste gjermanisht dhe gjermani nuk fliste anglisht. Ai e lëshoi spitalin ditën e pestë dhe u kthye në Kanada.

Prokurori Publik e kishte ballafaquar R.F. me disa foto. Në foton e parë ishte klinika në të cilën ishte kryer operacioni në vitin 2008. Sa për fotot që paraqitnin disa persona, dëshmitari ka vërejtur se në foton numër një mund të ishte S. , por ai nuk i kishte njohur të tjerët.

Dëshmitari e kishte njohur një dokument me titull “Raporti i Medicus-it të Kosovës”. Dokumenti fillon “R.F. bashkë me dhuruesin e tij, kanë kërkuar nga klinika për tu operuar”. Ai atë dokument e kishte marrë nga Y.S. kur ai e kishte lëshuar klinikën. R.F.e kishte pyetur Y.S. -in nëse ai do ta merrte ndonjë dokument nga klinika që mjeku i tij në Kanada të mund ta shihte dhe Y.S. i kishte thënë “po, ju mund ta merrni atë dhe t’ia tregoni mjekut tuaj në vendin tuaj”. Dokumentin e kishte nënshkruar L.D. R.F. -it i ishte i njohur emri. Para se të udhëtonte për në Kosovë, ai kishte marrë informacion nga Ministria e Shëndetësisë në



Kosovë se klinika ishte e licencuar për të bërë transplantime dhe se Y.S. ishte zgjedhur si një kirurg në këtë lëmi. Dokumenti në krye kishte një emblemë të UNMIK-ut dhe në anën e djathtë, aty është edhe një emblemë e Ministrisë së Shëndetësisë së Qeverisë së Kosovës. Ai këtë dokument e kishte marrë nga M.H., pas pyetjes së tij lidhur me cilësinë e klinikës dhe nëse klinika ishte e autorizuar për të bërë operacion. Aty ishte emri i udhëheqësit apo drejtorit të klinikës L.D. dhe kishte emrin e Y.S. i cili ishte i angazhuar nga klinika për të kryer operacione. Ai nuk kishte pasur të bënte asgjë me ndonjë person me emrin L.D. gjatë qëndrimit të tij në Klinikën Medicus.

Ai beson se transplantimi ishte për arsye altruiste. Ai nuk din nëse dhuruesi kishte marrë ndonjë pagesë, çfarëdo qofte ajo, për dhurimin e veshkës. Ai nuk u kishte dhënë fare para për dhurimin e veshkës dhe çfarëdo qoftë tjetër as femrave ruse. Ai nuk e din nëse ato ishin paguar për këtë. Ata nuk ishin shokë, të njohur apo pjesëtarë të familjes. Ai kurrë nuk kishte pasur kontakt me Komitetin Etik në Medicus. Ai vetëm e kishte nënshkruar një formular.

9. “M1” kishte dëshmuar përmes video lidhjes nga Izraeli me 18 qershor 2012.

Ai kishte thënë se në vitin 2008 kishte përjetuar dështim të veshkëve. Mjekët atij i kishin thënë se veshkët e tija nuk po funksiononin dhe se ai duhej ti nënshtrohej një transplantimi të veshkës apo dializës. Në Izrael, nuk kishte në dispozicion ndonjë transplantim, sepse atje nuk kishte pjesëtarë të familjes për të dhuruar një veshkë. Atë kohë, opsionet e tija ishin ose të bënte dializë pesë herë në javë ose të vdiste. Ai nuk kishte hulumtuar shumë sepse A., i cili e përfaqësonte Kompaninë Etgar, ishte kontakti i tij i parë. Kjo ishte një firmë konsulente. A. erdhi në shtëpinë e tij dhe i tha atij se një transplantim mund të bëhej në Kosovë për 77.000 €. Ai tha se transplantimin do ta bënte Y.S. -i. Në atë kohë, M1 nuk e njihte mjekun. Pajesa ishte ndarë. Pjesa e parë prej 17,000 €, i ishte paguar A.-it në para të gatshme.

Më vonë kur A.i e thirri ai i kishte thënë M1 për të paguar pjesën e mbetur prej 50.000 € në llogarinë bankare në Stamboll. M1 nuk e di e kujt ishte llogaria bankare pasi që ai nuk kishte marrë ndonjë emër por vetëm një numër të llogarisë. Në fakt llogaria i takonte M.H. Paratë u transferuan nga llogaria bankare e M1.

A. i dha gjithashtu M1-it një numër telefoni të H. ( M1 besonte se emri ishte A. , një shqiptim fonetik i H.). Ata kontaktuan me telefon dhe kjo ishte e vetmja herë që ai kishte pasur kontakt me M.H.. M1 e kishte mësuar llogarinë e saktë bankare në Stamboll përmes telefonit, kur personi kishte thënë *“Emri im është H., kjo është llogaria ime ku duhet transferuar këto para”*. M1 nuk është i sigurt nëse ai kishte thënë M. dhe ai mendon se ai kishte thënë se emri i tij ishte A. Ata udhëtuan nga Tel Avivi për në Stamboll. Në Stamboll Z. e kishte dërguar atë për ti bërë analizat e gjakut në një klinikë të vogël. Atje ishte Y.S. -i dhe një infermiere. Kjo ishte hera e parë që ai e kishte parë Y.S. -in dhe ai i kishte treguar se ai ishte kirurgu. Ai nuk i kishte folur shumë lidhur me procedurën e operacionit.

Të nesërmen ata fluturuan për në Prishtinë. Në fluturim ishin bashkëshortja e tij dhe një çift tjetër i cili gjithashtu shkoi për transplantim. Ishte A2. M1 i kishte me vete djalin dhe gruan e

tij. Kur ata ateruan në Prishtinë ata shkuan menjëherë në Klinikën Medicus. Pas përgatitjes prej 15-30 minutave, M1 hyri drejt në operacion. Ai e pa Z.n në klinikë por nuk mund të kujtohet nëse ka parë ndonjë mjek aty. Atij nuk i kujtohet të ketë nënshkruar ndonjë dokument para hyrjes në operacion. M1 supozon se Y.S.e kishte bërë operimin por ai e pa atë në klinikë vetëm pas operacionit.

M1 u zgjua në dhomën e kujdesit intensiv. Z. ishte pranë tij. Ishte ora 04.00 e mëngjesit. Ai ndjente ca dhimbje. Kur u zgjua prapë Y.S. ishte aty dhe aty gjithashtu ishin edhe mjekë të tjerë, ndoshta urolog. Ai kontrollohej nga ata dy ose tri herë. Ata flisnin Anglisht. M1 u fokusua në Y.S. pasi që ai ishte kirurgu.

Para se të hynte në operim atij iu ishte thënë se dhuruesja ishte femër. Ai e pa atë pas operacionit. Ai nuk foli me të sepse ajo nuk ishte në të njëjtën dhomë me të por ajo ecte andej pari. Prej letrës që ai mori pasi që ishte liruar ai e di se ajo është rreth 29-30 vjeçare. Ai e mori letrën nga Z.. Ishte letër e shtypur ku në krye të saj e kishte emrin e spitalit Medicus. Vajza nuk fliste Anglisht dhe M1 nuk e di se prej nga ishte ajo por ai mendon se ajo ishte nga Evropa lindore. Pasi që ishte e vetmja femër andej, ai e kuptoi se ajo ishte dhuruesja. Vajza e re e lëshoi spitalin 3-4 ditë para se të dilnin ata. Sipas formularit që ai e pranoi, emri i saj ishte A. M1 nuk e dinte nëse A. ishte paguar ose çfarë ishte marrëveshja e tyre. Atij iu ofrua një trajtim i shkëlqyer. Ai qëndroi nëntë ditë.

Gjatë qëndrimit të tij në Klinikën Medicus në Kosovë, ai kurrë nuk u paraqit përballë një komisioni etik para ose pas operacionit. Kur ai ishte liruar nga Medicus, ai mori një letër lëshimi që përshkruante saktë procesin, duke përfshirë dhuruesin dhe marrësin e transplantimit. Ai pranoi dy formularë të tjerë por ai nuk e din se çfarë ishte e shkruar në to.

Ishte marrësi i tretë i cili arriti drejt në Klinikën Medicus. Ai arriti në natën e njëjtë kur edhe ata arritën, ndoshta më vonë se ata. Ai arriti me gruan e tij. Ata jetojnë në Izrael. Emri i tij është K. M1 nuk e di se kush ishin dhuruesit për A2 dhe burri i tretë nga Izraeli. Të tri operacionet ishin kryer natën e njëjtë.

Ata të gjithë dolën së bashku. Ata morën një taksì ose kombi nga Klinika Medicus për në aeroport të Prishtinës. Ata ishin K., A2 dhe gruaja e tij, M1 dhe gruaja e tij dhe djali i tij Z. Y.S. nuk ishte me ta. Ata fluturuan në Stamboll dhe të nesërmen të tjerët fluturuan për Izrael.

Kur u pyet nëse kishte nënshkruar ndonjë formular në Klinikën Medicus, M1 tha se e kishte parë nënshkrimin e tij në një formular por nuk mund të tregoj me siguri nëse ai ishte i tij. Atij nuk i kujtohet saktësisht se cili dokument ishte ky. Ishte një formular ku shihej emri D.I. Ai ia dha dokumentet policisë.

Prokurori publik i tregoi dëshmitarit disa fotografi. Dëshmitari identifikoi dy foto si spitali Medicus nga kënde të ndryshme. Atij gjithashtu iu ishin treguar fotografitë e personave dhe ai e njohu Y.S. por nuk i njohu personat e tjerë. Prokurori Publik ia tregoi M1 gjithashtu dokumentin të cilin e pranoi si vërtetim. Ai e mori atë në Izrael nga A. shtatë ditë pasi që u kthye nga spitali. M1 i kishte thënë A. se atij i nevojitej vërtetimi për ta paditur kompaninë e sigurimeve. Në vërtetim dukej shuma prej 65.000 euro. M1 ia dha A. 17,000 në para të gatshme, kështu që të gjitha janë 77,000. Në dokumentin e mëposhtëm shuma thotë “transplantim i veshkës”.

Prokurori publik ia tregoi dëshmitarit dokumentin e titulluar “Komisioni i etikës”. Dëshmitari konfirmoi atë se ai e pa dokumentin por nuk e kishte lexuar atë. Ai e mori dokumentin kur u lirua nga spitali nga Z. në Kosovë para se të ktheheshin prapa. Dokumenti, “Akti i dhurimit” iu ishte treguar M1. Nënshkrimi ishte i ngjashëm me të tijin. Ai mezi ishte gjallë në atë kohë. Ai nënshkroi çdo gjë në klinikë vetëm që ta kishte operimin. Ai nuk e di me siguri nëse ai është nënshkrimi i tij. Ai nuk i lexoi dokumentet para se ti nënshkruante ato dhe se ai nuk e kishte ditur çfarë po nënshkruante.

10. “A2” dëshmoi me anë të video lidhjes nga Izraeli me 20 Qershor 2012.

Në vitin 2007-2008, A2 kishte probleme serioze me shëndetin e tij. Ai vuante nga dështimi gjenetik i veshkës. Ai filloi dializën me 10 Korrik 2008 në Spitalin Belason, në Tel Aviv. Ishte e tmerrshme, dhe vazhdoi pak më shumë se një muaj. Pothuajse e tërë familja e tij vuan nga sëmundja dhe nuk kishte mundësi të transplantimit të organit nga një familjar. Babai i tij ishte në dializë. Nëna e tij kishte vdekur nga sëmundja e veshkës kur kishte qenë 45 vjeçe.

Ekzistonte mundësia e transplantimit në Letoni. Atij i duhej të shkonte në Gusht të vitit 2008. Mundësia për të shkuar në Letoni ishte zgjidhje e mirë. Ai kontrolloi gjithçka lidhur me të por ai duhej të priste në Letoni rreth 4 muajsh për ta gjetur një dhurues të veshkës.

Rreth asaj kohe ai mori një telefonatë nga A. A2 nuk e kishte njohur atë apo si e kontaktoi atë. A2 kishte folur me A. dhe më vonë me Z. dhe dëgjoi se ai mund të fitonte një veshkë me operacion për një javë gjë që ishte shumë e rëndësishme pasi që babai i tij nuk e kishte ditur që ai ishte i sëmurë dhe vëllai i tij dhe motra e tij kishin sëmundjen e njëjtë. Babai qëndronte me A2. Ai ishte shumë i sëmurë dhe i moshuar dhe A2 ishte kujdesur për të kështu që është me rëndësi që ai e kishte kryer shpejt. Ai nuk kishte dashur ta shqetësonte dhe hidhëronte babanë në atë kohë.

A. dhe Z. erdhën në shtëpinë e tij dhe biseduan me të. Ishte hera e parë që A2 e kishte parë Z. A2 dëgjoi nga ata se ata ishin të lidhur me profesorët nga Belason, duke përfshirë Doktor SH. dhe A2 insistoi që ta takonte atë për të parë nëse çdo gjë ishte në rregull me dhuruesit dhe spitalin. Ai e takoi Prof. SH. se paku për dy orë. A2 pyeti për spitalin dhe dhuruesit dhe SH. tha se ai i kishte parë analizat mjekësore të dhuruesit. Prof. SH. tha se ai kishte punuar me Y.S. për 10-20 vite në Belason, në Izrael. A2 kishte mbledhur informata nga Prof. SH., A. dhe Z. dhe ishte i kënaqur, përndryshe ai nuk do të hynte në operim.

Ai i pagoi të gjitha paratë në Tel Aviv duke i dhënë A. it një çek dhe mori vërtetimin për rreth 80,000 shekels. A. i dha atij detajet e numrit të bankës ku ai i transferoi paratë tjera. Më vonë ai e kuptoi se ishte llogaria bankare e M.H. por kur e kishte paguar nuk e kishte ditur këtë. Ai vetëm e mori letrën, e dërgoi me faks në bankë për ti transferuar paratë të shkruara në letër në detaje. Atij nuk i bëhej vonë se ku po shkonin paratë dhe nuk e kishte vërejtur numrin IBAN ose prefiksin. Ai nuk e din emrin e bankës pranuese. A2 kishte problem me kujtesën por atij i kujtohet transferimi që ishte 50,000 euro dhe ai pagoi në Izrael 80,000 Shekel. Ai kishte një vërtetim nga Kosova për 70.000 euro. Ai e bëri pagesën për 80,000 Shekel dhe 50,000 euro transferim para se të largohej nga Tel Aviv.

Rreth një-dy javë pasi që ai e kishte parë SH. ai mori fluturimin në aeroportin Ben Gurion dhe shkoi drejt në Stamboll. Ai shkoi së bashku me gruan e tij. Çdo gjë ishte e aranzhuar nga Z. dhe A.. Derisa po shkonte për fluturim ai dëgjoi Y.D. duke thënë se ai e do të kishte

operacionin e njëjtë në Kosovë. Ata biseduan. D. ishte me djalin e tij A. dhe me gruan e tij gjithashtu.

Kur ata arritën në aeroport të Stambollit, A2 e pa Z. Në hotel në Stamboll ai e pa vetëm D. Y., familjen e tij dhe njerëzit në hotel. Atij iu dhanë shumë letra për ti nënshkruar në hotel. Ai nënshkroi gjithçka çfarë i tha Z. Ai nuk është i sigurt se cilat dokumente kanë qenë. Ai kishte bërë ca analiza në Klinikën e Y.S.në Stamboll. Z. i mori ato në taksi dhe mjeku i bëri analizat e gjakut. Kur u pyet nëse i kujtohet takimi kur një marrës tjetër i quajtur K. A2 shpjegoi se për të parën herë ai e takoi K. ishte në Kosovë ku K. arriti një ditë pas tij.

Mëngjesin tjetër ata fluturuan nga Stambolli për në Prishtinë. Në kontrollin e pasaportave dhe doganave në aeroportin e Prishtinës nuk ndodhi ndonjë gjë e veçantë. Atij nuk i kujtohet nëse ndokush kishte pyetur, por atij i ishte dashur të përgjigjej se ata kishin ardhur ta vizitonin Kosovën nëse pyeteshin.

Ai nuk kishte diskutuar me Z. në lidhje me aparatën e dializës në klinikë në Kosovë sepse ishte shumë vonë për të diskutuar këtë në Kosovë. Ai kishte diskutuar me Prof. SH. më herët në Izrael. Ishte një çështje sepse ishte një ndër kushtet e tij për operacion. Ai dëshiroi të bënte një dializë para operacionit që të vijë në operacion në gjendje të mirë dhe nëse diçka do të shkonte keq dhe atij do ti duhej të qëndronte për më shumë se 2-3 ditë. Kur A2 arriti në klinikë Y.S. i bëri edhe një analizë gjaku dhe kur A2 insistoi ai kuptoi se atje nuk kishte aparat të tillë.

A2 ishte i frikësuar sepse nuk kishte aparat dialize dhe nganjëherë pas operacionit njerëzit kanë nevojë për dializë. Ai u ankua tek Y.S.në lidhje me mungesën e instrumentit të dializës në klinikë para operacionit dhe Y.S.tha, “ Ti nuk më pëlqen. Mund të shkosh në shtëpi”. Ai e pyeti Y.S. nëse ata e kishin bërë analizën e urinës së dhuruesit që të shohin nëse kishte gjak në urinë. Y.S.tha: “A jeni ju mjek? Kush ju tha se ju nevojitet analiza e urinës, nuk është e nevojshme”.

Mjekut nuk i pëlqente A2, dhe mendonte se ai ishte problematik. Marrëdhënia e tij me Y.S. u prish deri në pikën kur Y.S. tha “Unë nuk do t’ju operoj dhe juve nuk do t’ju kthehen paratë “.Ai ishte shumë i hutuar se cilin vendim ta merr- të qëndroj për operacion ose të kthehet në Izrael. Ai vendosi për t’iu nënshtruar operacionit. Vetëm Y.S.dhe ai ishin të pranishëm gjatë bisedës. Kishte probleme gjatë operacionit dhe Y.S. mëtha “E shikon, nuk është dashur t’ju operoja”.

A2 insistoi tek Z. që të njihet me dhuruesin dhe ta vizitoj atë. A2 e takoi dhuruesin dhe ai ishte diku 40-41 vjeçar, dukej njeri i shëndetshëm dhe njeri i lumtur, njeri normal gjë që ishte e rëndësishme për A2. Ata folën vetëm me sy dhe nuk kishin në të vërtetë ndonjë bisedë. Ai dukej të ishte nga Rusia por A2 ishte i sigurt saktësisht.

Pas operacionit A2 pa një numër prej tre dhuruesve. Njëra ishte femër dhe dy meshkuj nga Rusia por ai nuk është i sigurt saktësisht. Duke biseduar me dhuruesit askush nuk fliste për paratë. A2 mendoi se ishte e vështirë të besohej se ata nuk i kishin marr paratë edhe pse atij i kishte thënë Z. dhe A. se ata nuk po merrnin para.

A2 pyeti nëse kishte ndonjë ligj në Kosovë që ai duhej të ishte në dijeni dha ata i thanë se jo. Para se ai të vendoste të bënte operacionin ai e pyeti A. nëse ishte ndonjë problem me ligjin në Kosovë dhe nëse ishte ndonjë mundësi që ai të arrestohej. Ata e lënë të kuptonte se është

në rregull , ai ishte një shtet i ri dhe se askush nuk duhet ta dijë për shkak të pranisë Evropiane dhe Amerikane këtu në Kosovë. A. dhe Z. i thanë atij se ata janë të lidhur me njerëz dhe mjekë të duhur në Kosovë dhe ajo është e lejueshme dhe se ai do ti merr të gjitha letrat e Komisionit Etik. Në gjendjen e tij ishte e lehtë dhe e përshtatshme të besohej çfarë ai dëshironte të besonte.

I tërë udhëtimi ishte 7-8 ditë, ishin rreth 4-5 ditë pas operacionit. Kur ai u largua nga Klinika Medicus ai u largua duke ecur dhe ishte në gjendje të mirë.

Kur u kthye në Tel Aviv ai mori ca dokumente. Ai nuk është i sigurt nëse ishin nga Z. ose A. por dokumentet përfshinin raportin mjekësor të Y.S.

Prokurori publik ia tregoi dëshmitarit ca foto. Fotoja e parë është Klinika Medicus të cilën e njohu A2 e njohu. Në dy fotot pasuese ai e njohu Y.S. in. Në fotot e tjera ai mendon se e njeh A. Atë të cilën mund ta kujtoj është Z. Ai nuk i njeh të tjerat. Atij i tregohet një foto e personit të cilin ai mendon se mund të jetë një foto e mjekëve por nuk është i sigurt. A2 sqaron se përveç Y.S .ai ka pa të tjerët për një kohë të shkurtër dhe ai ka qenë nën ndikimin e shumë barërave.

Transplantimi ishte bërë me datën 19 Gusht 2008. Ai nuk është shfaqur në asnjë moment para Komisionit Etik në spital. A. dhe Z. i thanë atij se ai nuk ishte dashur që të shfaqej përpara Komisionit Etik.

A2 i kishte sjellë dy vërtetime zyrtare me vete. Njëra është nga Klinika Medicus dhe shuma e përgjithshme është 70,000 euro. Data është 21 Gusht 2008. Numri i referencës është "Transplantim i veshkës". A2 e mori vërtetimin zyrtar nga A. Ai mendon se ishte me postë pasi që ai ishte kthyer nga operacioni. Ai mendon se mori raportet mjekësore në të njëjtën kohë kur edhe e ka marrë faturën. Ai nuk mori dokumente tjera.

Ai kishte komplikime mjekësore pas operacionit. Y.S. i tha atij se ai kishte një refuzim të veshkës se re dhe se jeta e tij është në rrezik prej saj. Gjate natës atij iu desh të operohej edhe njëherë dhe operacioni kishte zgjatur tri orë. Siç e kishte shkruar në raportin e tij ai tha se A2 kishte një refuzim të fortë të veshkës dhe se ata u detyruan ta operojnë atë edhe njëherë.

Kur A2 u kthye në Izrael ai kërkoi këshillë mjekësore nga mjeku atje. A2 nuk i besoi Y.S. kur ai tha se ishte një refuzim i veshkës. Ai tha se ajo kishte ndodhur vetëm një herë. A2 mendoi se diçka nuk ishte në rregull me grupin e gjakut të dhuruesit. Kur A2 arriti në Izrael ai e thirri A.S. dhe insistoi ta shihte grupin e gjakut të dhuruesit. A. ia dërgoi A2 grupin e gjakut të dhuruesit dhe ai i tha atij se e vërteta është se Y.S. gjatë operacionit e kishte lënduar veshkën e re dhe se kjo ishte arsyeja e refuzimit. Ai nuk ishte një refuzim i vërtetë por A2 kishte gjakderdhje të brendshme. Edhe tani veshka është e lënduar por ai është mirë. A. i tha atij se Profesor Z.SH. kishte thënë se ai ishte me fat që Y.S. e kishte operuar atë sepse po të ishte dikush tjetër ata nuk do të mund të menaxhonin me dëmtimin të cilin ata i shkaktuan kësaj veshke.

11. " T2". Ai dëshmoi përmes video lidhjes nga Izraeli me 19 Qershor 2012.

T2 kishte pasur disa probleme shëndetësore më herët dhe kishte një transplantim në 2003-2004. Ishte bërë jashtë Izraelit në Stamboll nga Y.S. Ajo ishte organizuar nga M. Operacioni atëherë kaloi shumë mirë. Çmimi i operacionit ishte 100.000 dollarë amerikan. Ai ia pagoi

shumën M. me para të gatshme. Pas operacionit ai filloi të kishte prapë probleme në 2007-2008. Mjeku i tha atij se atij i nevojitej një transplantim tjetër. Ai vuan nga një sëmundje që buron në familjen e tij. Ai nuk kishte kontrolluar nëse ishte i mundshëm ndonjë transplantim në Izrael pasi që i ishte thënë se duhej të priste për një kohë të gjatë. Deri tani atij nuk i është dashur të shkoj asnjëherë në dializë.

Për operacionin e dytë ai e kërkoi M. por nuk e gjeti atë . Në vend të tij ai vuri kontakt me A. Gjatë takimit të tyre të parë ata folën për procedurën për të vendosur nëse ai ishte në gjendje për të marrë pjesë në transplantim. Ai kishte një numër të analizave duke përfshirë analizën e gjakut, matjen e zembrës dhe një grup të analizave të mushkërive dhe zembrës dhe analizë të gjakut.

Përfundimisht ai ishte i pastruar dhe i gatshëm për operim. Në transplantimin e parë Doktor SH. ishte këshilltar i T2 dhe e kontaktoi M . Doktor SH. ishte i përfshirë në operim me Y.S. in në Stamboll. Në transplantimin e dytë, Doktor SH. ishte këshilltar në Izrael.

Pagesa tek A. ishte bërë pas vendimit se ai ishte në gjendje për ta përballuar operacionin. Ai e pagoi një pjesë përmes çekut dhe pjesa tjetër i është dërguar M.. Ai ia pagoi A. 30,000 Shekel. Ishin diku 56,000 euro tek M. përmes mandat pagesës. Shuma e përgjithshme e çmimit të operacionit ishte 90.000 euro. Pas pagesës së parave, A. e aranzhoi fluturimin.

Në fluturim ishte gruaja e T2, T2, një çift tjetër nga Izraeli i quajtur N. dhe E. dhe S. Fluturimi ishte dy ditë para operacionit, 25 ose 26 Shtator 2008. Ata arritën në Stamboll dhe e takuan M.. M. organizoi gjithçka për ata duke përfshirë ushqimin Kosher pasi që ishte e premtë mbrëma. Të nesërmen ata fluturuan pasdite.

Në aeroportin e Prishtinës ata kaluan si turist të rëndomtë. Atyre nuk iu është dhënë asgjë për ta paraqitur në doganë në Prishtinë. Ai iu tha doganës se ai ishte atje për qëllime turistike. Ai nuk i tregoi askujt se ai ishte atje për transplantim. Në aeroport vozitësi i priste ata dhe i dërgoi për në klinikë. Zgjati diku rreth 10 minuta.

Në klinikë T2 i kishin thënë të priste pasi që ishte i dyti për t'iu nënshtruar operacionit. Ai takoi një grup mjekësh dhe ata i thanë atij çdo gjë si do të ndodhte dhe atij ia dhanë disa dokumente për ti nënshkruar. Njëri nga mjekët fliste Anglisht. Atij nuk i kujtohet në detaje çfarë thanë ata lidhur me dokumentet dhe atij as që i bëhej vonë. Ai deshi ta kryej operacionin. Ai i lexoi dokumentet në përgjithësi dhe jo në detaje. Aty kishte shumë dokumente dhe operacioni ishte caktuar brenda një ore apo dy dhe kjo ishte në mbrëmje. Ai e takoi personin i cili e dhuroi organin dhe ata të dy shkuan në zyrën e njëjtë dhe mjekët kërkuan nga të dy që të nënshkruanin dokumentet e njëjta. Personi ishte mashkull i moshës rreth me shumë se tridhjetë vjeç nga Ukraina. Ata nuk folën.

Y.S. dhe djali i tij e përgatiten atë dhe ishin diku 4-5 persona të involvuar. Ai qëndroi në klinikë për gjashtë ditë. Gjatë rikuperimit ai e kishte për 24 orë infermieren andejpari dhe e kishte mjekun i cili i vizitonte së paku dy herë në ditë. Ai nuk ishte i vetëm në dhomë. Në anën tjetër të dhomës ishte dhuruesi. Dhuruesi ishte në anën tjetër të dhomës. T2 mendon se dhuruesi me siguri i ka marrë paratë për dhënien e veshkës së tij por ai nuk e di se sa para i ka marrë për veshkën. Ai nuk ishte i afërm i A2.

T2 morri një dokument me udhëzime për mjekët në Izrael nga Y.S. dhe detajet e operacionit të tij dhe gjendja e tij momentale dhe trajtimi që ai e mori. Ai mori një vërtetim nga Klinika.

Ishte në një zarf, dhe ishte së bashku me letrën e Y. Ai i pranoi dokumentet pasi që po lirohej, po dilte nga klinika.

Prokurori publik ia tregoi T2 disa fotografi. Ai e njohu Y.S. por ai nuk i njohu personat e tjerë përpos M..

Pas operacionit në vitin 2008, ai kishte ca problem me uretrën, dhe ajo ishte e bllokuar dhe atij i duhej ti nënshtrohej një operacioni tjetër për ta zhbllokuar. Përveç asaj çdo gjë tjetër ishte në rregull. Ai filloi të punonte pas dy muajve të operacionit. Po të mos i ishte nënshtuar operacionit ai do të kishte vdekur.

12. "T1" është gruaja e T2. Ajo dëshmoi përmes video lidhjes nga Izraeli me 19 Qershor 2012.

Bashkëshorti i saj kishte një transplantim në Stamboll në 2003- 2004. Mjeku i cili ishte i involvuar në transplantimin e parë ishte Y.S. të cilën ata e gjetën përmes SH. Transplantimi i parë kushtoi 80,000 dollarë amerikanë. Ata i morën paratë prapë përmes kompanisë së sigurimeve.

Bashkëshorti i saj ishte në gjendje të mirë deri rreth 2007/2008. Ai atëherë kërkoi këshillë nga SH. i cili i tha atij se atij i nevojitej një transplantim tjetër. Ai pastaj ishte lidhur me A. nga kompania Etgar e cila e ndihmoi lidhur me gjendjen. Transplantimi i dytë për bashkëshortin e saj nuk ishte i mundshëm në Izrael. Asaj nuk i kujtohet nëse ajo ose bashkëshorti i saj i bëri pagesat por pagesat ishin bërë. Ishin 130,000 euro. Pagesa i ishte bërë Etgarit përmes bankës. Ishte një transferim bankar në Izrael.

Fluturimi ishte aranzhuar nga Tel Aviv për në Stamboll. Në fluturim ishin ajo dhe bashkëshorti i saj dhe ishte një çift tjetër që quheshin N.V. dhe E.. Në Stamboll ata shkuan në hotel. Në hotel ata e takuan N. dhe E. dhe S. S. është një grua e cila i ka përcjellë ata gjithkund. Ajo ishte nga kompania Etgar. Të nesërmen ata fluturuan për në Prishtinë. Atyre nuk iu ishte dhënë asnjë dokument. Kur arritën në Kosovë në dogana nuk ndodhi asgjë. Ajo po udhëtonte me pasaportën e saj të Izraelit. Një kombi i mori ata nga aeroporti për në klinikë. Ata të gjithë hynë në kombi dhe pas 10-20 minutash arritën në klinikë.

Kur arritën në klinike T1 menjëherë shkoi në hotel. S. dhe E. qëndruan në hotel gjithashtu. Bashkëshorti i saj shkoi në klinikë. Operacioni ishte në ditën e njëjtë kur arritën ata. Ajo shkoi në klinikë të nesërmen. Bashkëshorti i saj ishte mirë. Ajo e takoi Y.S. - in i cili i tha se transplantimi ishte në rregull. Bashkëshorti i saj ishte në klinikë për pesë ditë.

Burri i cili ia dha organin bashkëshortit të saj ishte në dhomë të njëjtë. Ai ishte i ri dhe rreth 30 vjeçar. Ajo nuk kishte folur me të por ata thanë se ai ishte nga Ukraina. Ajo nuk e pa dhuruesin e organit për N. por ajo e ka ditur se dhuruesi ishte nga Izraeli. Ishte femër. Pas pesë ditësh ata u kthyen për në Izrael.

Prokurori Publik i tregoi T1 disa fotografi. T1 mendon se, këto ishin fotot e klinikës. Përveç kësaj, dëshmitari i njohu dy persona në foto; Y. dhe M.H. Ajo e njohu z. H. nga operacioni i parë. Në vitin 2003, M. ishte organizator. Ata i dhanë M. 80,000 dollarë.

Pas operacionit të dytë gjendja e bashkëshortit të saj ishte shumë e mirë; operacioni ishte i suksesshëm.

13. Y.K. Djali i marrësit R.K., tani i ndjerë. Ai dëshmoi përmes video lidhjes nga Shtetet e Bashkuara me datë 6 Shkurt 2012.

R.K., babai i dëshmitarit i cili jetonte në Izrael kishte shumë probleme shëndetësore. Ai filloi të ketë probleme me veshkët diku në vitin 2007, në fillim të vitit 2008. Gjendja e tij u përkeqësua në mënyrë të vazhdueshme dhe shpejt. Nga koha e problemit deri në transplantim ishte gati një vit.

Y.K. udhëtoi në Izrael diku në tetor 2008. Babai i tij ishte shumë i dobët. Ai po qëndronte në shtëpi dhe jo në spital. Y.K. i kaloi disa ditë në Izrael para se të udhëtonin në Stamboll. Aranzhimet e fluturimit ishin bërë nga babai i tij i cili po ashtu i pagoi biletat. Nëna e tij udhëtoi me ta gjithashtu. Në atë kohë babai i tij ishte 56 vjeçar dhe ishte shumë i sëmurë. Ata arritën në Stamboll dhe e kaluan një natë në hotel, duke pritur për fluturimin tjetër.

Të nesërmen ata fluturuan me Turkish Airlines për në Kosovë në fluturimin e mëngjesit. Kur ata arritën në Prishtinë, një taksi privat po i priste ata në aeroport dhe i dërgoi në hotel. Vozitësi ishte mashkull, përafërsisht 30 vjeçar. Ai liste një anglishte shumë të shtrembëruar. Ai nuk e prezantoi veten me emër. Në pasdite erdhi një taksi i mori dhe i dërgoi në qendrën mjekësore. Kur ata arritën, e takuan një infermiere, rreth të 30-ve ose në fund të 20-tave në uniformë të infermieres. Ishte një ndërtesë dy katëshe. Ajo e mori babanë e tij lart për në katin e dytë. Ata e panë babanë e tij të nesërmen rreth orës 9-9.30. Ai e kuptoi se babai i tij kishte marrë një transplantim veshkë.

Dëshmitarit iu janë prezantuar disa fotografi nga ana e prokurorit publik të cilat ai i identifikoi si klinikë.

Ai e vizitoi Klinikën Medicus çdo ditë për 6-7 ditë për disa minuta. Gjendja mjekësore e babait të tij pas marrjes së veshkës u përmirësua, i mori pakëz kohë por ai po përmirësohej. Ai e vlerësoi si të mire kualitetin e kujdesit mjekësor. Pas lëshimit nga klinika ata shkuan menjëherë në aeroport. Ata fluturuan me Turkish Airlines për Stamboll dhe priten disa orë për fluturimin për në Izrael.

Ai nuk e di se prej nga erdhi ajo veshkë. Ai nuk e di çmimin e trajtimit mjekësor. Ai nuk e di nëse familja e tij kishte bërë ndonjë kërkesë për sigurim sa i përket trajtimit mjekësor që babai i tij kishte marrë qoftë përmes ndonjë kompanie sigurimi në SHBA ose Izrael. Ai nuk e di se si familja e tij mori vesh lidhur me trajtimin mjekësor në Kosovë. Ai nuk e njeh askënd me emrin M.H. ose Y.S..

Y.K. është i vetëdijshëm se babai i tij nuk kishte pasur problem me veshkën pas transplantimit dhe pas operacionit babai i tij padyshim se kishte një kualitet më të mirë të jetës. Nga udhëtimi në Kosovë deri kur vdiq babi i tij ishte pak më shumë se 3 vjet. Shkaku i vdekjes ishte leukemia.

### **C. Rëndësia e dëshmisë së dhuruesve dhe marrësve**

Dëshmitë e këtyre shumë dëshmitarëve, duke qëndruar vetëm, janë plotësisht të mjaftueshme për gjykatën të përfundoj se janë kryer krimet e trafikimit të njerëzve, krimet të organizuar dhe lëndime të rënda trupore. Megjithatë, ekziston një pjesë e madhe e vërtetimit të dëshmive që forcon përfundimet e përcaktuara më poshtë menjëherë.



Para së gjithash ,dëshmia e dëshmitarit okular të dhuruesve dëshmoi se ka ekzistuar elementi i trafikimit të njerëzve dhe shfrytëzimit, siç përshkruhet në nenin 139 të KPK. Deklaratat përmbajtësore të viktimave e lejuan trupin gjykues të arrij në përfundim sipas situatave të tyre personale dëshpëruese që i bëri ata të marrin vendime të pakthyeshme dhe që ua ndryshojnë jetën atyre. Pas intervistimit të këtyre dëshmitarëve trupi gjykues ishte në gjendje të konstatonte përtej dyshimit të arsyeshem se secili nga ata ishte në pozitë të ndjeshme për shkak të vështirësive të mëdha financiare. Fakti që ata hulumtuan në internet tregon se sa të dëshpëruar ishin ata thjesht për mbijetesë. Të gjithë ata i gjetën rekrutët të cilët i ofruan atyre mundësinë për të dhuruar veshkën e tyre në shkëmbim të një shume të konsiderueshme të parave që do ti lehtësonte vështirësitë financiare.

Është me rëndësi të nënvizohet se ky intervenim kompleks kirurgjik-heqje e veshkës, iu kishte paraqitur atyre si një procedurë mjekësore rutinore, pa rrezik, pas së cilës ata mund të rifillojnë një jetë të shëndetshme pa ndonjë kufizim. Askush nuk ka qenë për ti informuar ata për rreziqet e mundshme të cilat mund të jenë serioze, as në Stamboll ku ata thjeshtë bënin analiza e as në Klinikën Medicus. Gjithashtu para operimit atyre nuk iu është dhënë kohë për të marrë vendim të vetëdijshëm dhe vullnetar për të dhuruar veshkën.

Pothuajse menjëherë pasi që ata arrinin në klinikë atyre iu kërkohet për të nënshkruar dokument të cilat ata mezi i kuptonin duke përfshirë të ashtuquajturën "Vepër e Dhurimit" duke deklaruar se ata po e dhuronin veshkën për arsye altruiste; apo ndonjë të afërmi që në të gjitha rastet ishte haptazi e pavërtetë.

Dokumentet ishin shkruar shpesh në gjuhën të cilën ata nuk e kuptonin mirë dhe të hartuara keq. Dokumentet përmbanin një deklaratë ligjore shumë të rëndësishme, duke pretenduar se transplantimet ishin kryer qoftë në mes të anëtarëve të familjes ose për arsye altruiste. "Pajtimi" i dhuruesve ishte bërë pasi që ata kinse shfaqeshin para një "komisioni etik" fals, jo ekzistent , që asgjë nuk kishte të bënte me etiken përveç emrit të tij.

Këto procedura të rreme ishin dizajnuar qartazi në një përpjekje për të mbrojtur kryerësit e veprave nga përgjegjësia penale. Pasi që këto dokumente janë nënshkruar, viktimat dërgoheshin me karrocë në sallën operuese, qetësoheshin dhe operoheshin edhe pse disa nga ata hamendeshin seriozisht. Ky skenar demonstroi një mënyrë tjetër në të cilën kryerësit e veprave kanë keqpërdorur pozitën e ndjeshme të viktimave.

Përveç kësaj ,dhuruesve iu ishte premtuar se do të marrin kompensim financiar për veprat e tyre "altruiste". Sidoqoftë disa nga ata ishin kompensuar vetëm pjesërisht. Dhe kjo gjë nuk i shpëtoi vëmendjes së trupit gjykues se njëri nga dhuruesit (PM) nuk e kishte marrë asnjë para duke e lënë në dëshpërim të plotë financiar. Vetëm për shkak të mirësjelljes së familjes së marrësve që ishin falënderues për shpëtimin e jetës së saj ai mori një bakshish në shumë prej 1000 Dollarëve amerikan. Gjithastu duket se A., i riu turk, nuk kishte marrë ndonjë kompensim gjithashtu. Sjelljes së tij qartazi iu vjen era mashtrim.

Mbi të gjitha, dhuruesit ishin mashtruar duke menduar se transplantimi i veshkëve është i lejueshem në Kosovë. Kjo ishte një bregë e rëndësishme e disa prej tyre pasi që ata nuk dëshironin të kryenin ndonjë vepër penale. Disa nga dhuruesit dhe marrësit kanë deklaruar se në disa raste ata i kanë pyetur "rregulluesit" lidhur me ligjshmërinë e operacioneve. Të gjithëve iu kishin thënë se është plotësisht ligjore.

Përveç kësaj, deklaratat e dhuruesve dhe të marrësve përshkruan shkallën ndërkombëtare të këtij rrethi kriminal, duke filluar me "rregulluesit" që rekrutuan viktime të ndjeshme më së shumti në vendet e varfëra të Evropës Lindore, pastaj duke vazhduar me ndërmjetësit në Stamboll të cilët kanë ndihmuar rregullimet logjistike dhe duke përfunduar me marrës të pasur të cilët ishin të gatshëm të paguanin mijëra euro/dollarë për transplantim të veshkës në Kosovën e largët. Sistemi dëshmoi të punonte mirë në mënyrë të befasishme dhe të gjithë dhuruesit dhe marrësit e pasur përfunduan në tryeza kirurgjike në teatrin operues në Klinikën Medicus e cila gjendet në skaj të Evropës. Me prova është dëshmuar se ky sistem ishte vënë në lëvizje nga fluksi i shumave të konsiderueshme të parave që ishin paguar ose me para të gatshme drejtpërdrejtë në klinikë, ose organizatorëve, ose përmes transferimit bankar nga klientët e dëshpëruar të cilët çmendurisht kërkonin një rreze shprese për jetë të shëndetshme.

Veç kësaj këto dëshmi të paçmueshme treguan se figurat më të rëndësishme në këtë skemë kriminale ishin Y.S. si udhëheqës, kirurg i aftë, M.H. rekrut i talentuar dhe organizator i cili e ka zhvilluar rrjetin e dallaveraxhinjve duke kërkuar për dhurues potencial; një grup qytetarëve izraelit, që për momentin janë duke u ballafaquar me përndjekje kriminale, të cilët i drejtuan marrësit potencial tek M.H.; dhe grupi vendor nga Prishtina që në fund e bënë këtë sistem operues. Është më se e qartë se pa këtë personel mjekësor dhe menaxherët e tij në Kosovë kjo përpjekje nuk do të funksiononte.

Siç u përmend më herët, trupi gjykues ka marrë në konsideratë të gjitha deklaratat e dhuruesve, marrësve dhe anëtarëve të tyre të familjes si tërësisht të besueshme dhe bindëse pasi që deklaratat janë në përputhje, të detajuara dhe pa mospërputhje domethënëse. Lidhur me këtë është e rëndësishme të përmendet se dëshmitarët ishin në të vërtetë të gjithë të huaj për njëri-tjetrin, kështu që nuk mund të ketë asnjë pretendim se ata në mënyrë kolektive kanë përgatitur dëshmi të rrejshme. Ky fakt i jep edhe më shumë besim dëshmive të tyre. Veç kësaj këto shpjegime janë në fakt plotësisht të vërtetuara me dëshmitë e tjera të qarta.

#### **D. Dëshmitë vërtetuese**

##### **1. Ekspertiza e mjekësisë ligjore e përgatitur nga C.B. lidhur me dhuruesit D.S. dhe A.K.**

E para në listën e dëshmive që vërteton dëshmitë e dëshmitarëve okular dhurues dhe marrës është Raporti i Mjekësisë Ligjore i përgatitur C.B. sa i përket dhuruesve të veshkëve D.S dhe A.K. Dëshmitari ekspert Doktor C.B. është e punësuar nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore të EULEX-it dhe është eksperte në Mjekësinë Ligjore. C.B. e dorëzoi CV-në e saj tek trupi gjykues dhe shpjegoi se ajo kishte diplomuar në mjekësi në vitin 1995 pas së cilës ajo kishte pasur specializim 4 vjeçar në mjekësinë ligjore. Pas 5 vitet tjera të përvojës ajo e kaloi provimin për t-u bërë eksperte e lartë e mjekësisë ligjore.

Ajo kishte punuar në fushën e mjekësisë ligjore për 15 vjet dhe ka kredenciale tjera të shumta. Ajo është anëtare e Akademisë Ndërkombëtare të Shkencës së Mjekësisë Ligjore dhe ka referenca brenda CV-së. Ajo është eksperte ndërkombëtare e EULEX-it.

Ajo i shkroi dy raporte. I pari është raporti i A.K. Eksperti e ekzaminoi këtë dëshmitar me 15 Prill 2011 me qëllimin të sjelljes së një vlerësimi mjekësor duke përfshirë ekzaminimin fizik, ultra zërin dhe CT për të përcaktuar nëse pacienti i ka të dy veshkat ose vetëm një. CT skenografia e pacientit (faqe 18) tregon pamjen e veshkës së djathtë por në anën e majtë nuk

ka asnjë veshkë. B. gjithashtu bëri skenografinë e abdomenit dhe komblikut dhe prapë nuk e ka gjetur veshkën e majtë. Në CT skenograf ishin vëzhguar disa kapëse metalike, njëra nga ato e vendosur pranë arteries së majtë që çonte kah veshka. Kjo do të thotë se arteria ishte këputur dhe kapësja ishte vendosur për qëllim të mbylljes. Gjithashtu mund të shihet në pjesën e poshtme të komblikut kapësja e dytë metalike do të thotë se uretra ishte po ashtu e shkëputur dhe larguar në mënyrë kirurgjike. Nuk kishte më asgjë tutje në skenografinë e CT dhe C.B. e përsëriti atë se nga CT është e mundur të vëzhgohet se veshka e majtë po mungon dhe aty janë dy kapëse metalike brenda trupit të pacientit që do të thotë se veshka ishte larguar në mënyrë kirurgjike.

Kështu që veshka e majtë mungon dhe aty janë dy kapëse metalike brenda trupit të pacientit që do të thotë se veshka është larguar në mënyrë kirurgjike.

E pyetur nëse kishte zbuluar ndonjë dëshmi tjetër të sëmundjes ose patologji që mund të sqarojë veshkën e majtë të humbur, C.B. tha se ajo nuk zbuloi asnjë shenjë të traumës ose sëmundjeje. Nga të gjitha ekzaminimet ajo nuk zbuloi ndonjë sëmundje që mund të kërkojë largimin e veshkës si trajtim. Mendimi mjekoligjor i C.B. sa i përket operacionit ishte se operacioni ishte kryer në mënyrë që të merret veshka e shëndoshë.

Sa i përket dëshmitarit D.S, dëshmitari ekspert i bëri atij analiza me datën 25 Korrik. Analizat e gjakut treguan se kreatinina ishte në nivel më të lartë. Kjo tregon se filtrimi i toksinave nuk është i drejtë saktësisht. C.B. gjithashtu kreu një skenografi CT të abdomenit dhe komblikut për ti mbuluar të gjitha sipërfaqet dhe skenografia CT tregon se veshka e majtë po mungon dhe se aty janë vendosur kapëse metalike. Nuk ka shenjë të patologjisë brenda abdomenit. Mendimi i ekspertit është se veshka është larguar në mënyrë kirurgjike pa ndonjë patologji për të arsyetuar largimin.

Gjithashtu të dy pacientët paraqitën qarjen tipike kirurgjike të lëkurës nga operimit i veshkës që forcoi konkluzionet e saj.

C.B. ishte pyetur nëse ekzaminimi fizik ishte në përputhje me veshkën e larguar për qëllim të transplantimit. Ajo shpjegoi se në të dy rastet veshka e shëndoshë është larguar në mënyrë kirurgjike pa kushtin mjekësor që supozon nevojën e trajtimit për kushtin mjekësor. Kur veshka e shëndoshë merret nga një person i shëndoshë, qëllimi është që ta transplantoj atë tek një person tjetër.

Gjithashtu për qëllime transplantimit si në rastin e A.K. dhe D.S. veshka e majtë është përdorur. Arteria e majtë dhe vena janë më të gjata dhe kjo i bën ato më të përshtatshme për transplantim.

C.B. ishte pyetur nëse ajo është në gjendje të përcaktoj kohën kur ishte kryer operimi për heqjen e veshkës, sa i përket A.K. dhe D.S. C.B. shpjegoi se ajo nuk mund të tregojë datën e caktuar , por ajo mund të thotë se kjo nuk është e mundur të jetë kryer 6 vite më parë. Kufiri i datës për operimin e A.K. dhe D.S. mund të përcaktohet përafërsisht duke i vlerësuar të qarat e tyre abdominale. Kufiri i kohës mund të jetë më shumë se 6 muaj dhe deri në 5 vite.

Kjo ekspertizë e mjekësisë ligjore është konsideruar nga trupi gjykues si shumë e besueshme pasi që ajo paraqet linjë të qartë të arsyeve mjekësore. Për më shumë, opinioni i ekspertit vërteton dëshminë e A.K. dhe D.S.

## **2. Raportet e mjekësisë ligjore të C.B. dhe D.SH. lidhur me Transplantimin e veshkës në Klinikën Medicus në vitin 2008.**

Me 29 Maj 2012, gjykata lëshoi urdhrin për ekspertizë mjekësore për C.B. dhe D.SH., të dy mjekë të mjekësisë ligjore në Departamentin e Mjekësisë Ligjore të EULEX-it me qëllim të vërtetimit të mëposhtmet, bazuar në të gjitha librat mjekësore, të gjitha shënimeve mjekësore dhe ndonjë dokument tjetër relevant:

- nëse është bërë ndonjë transplantim i veshkës në Klinikën Medicus, dhe të shpjegoj bazën për këtë mendim,
- nëse janë kryer transplantime të tilla, të tregoj sa, të identifikoj dhurues dhe marrës me emër dhe informata tjera identifikuese, si moshë, gjinia dhe kombësia,
- të caktoj datat e operacionit për dhuruesit dhe marrësit,
- të përcaktoj përputhjen për secilin dhurues dhe marrës,
- të përcaktoj rezultatin e operacioneve,
- të përcaktoj ilaçet e përdorura nga dy palët dhuruesit dhe marrësit, dhe të shpjegojë qëllimin,
- të identifikojë mjekët dhe personelin tjetër mjekësor të cilët morën pjesë në secilin operacion, dhe
- të përcaktoj procedurat që ata i kanë kryer.

Raportet e përgatitura nga doktorët në përgjigje të këtij urdhri janë në mes të raporteve më të rëndësishme në tërë rastin. C. B. morri përgjegjësinë për analizimin e të gjitha rasteve kirurgjike nga Marsi, Qershori, Gushti, Tetori dhe Nëntori 2008; derisa D.SH. morri përgjegjësinë për analizimin e të gjitha rasteve nga Maji, Korriku dhe Shtatori 2008. (Nuk kishte raste nga Prilli 2008.) Në kryerjen e analizave të tyre, ato rishikuan një sasi të madhe të materialit të dokumenteve të konfiskuara nga Klinika, duke përfshirë regjistrat e anestezionit, raportet mjekësore, raportet e laboratorit, dhe libra të ndryshëm të protokollit, po ashtu raporte policore, listë udhëtarësh të fluturimeve, prova gjykimi dhe burime tjera të informatave shënuar në fillim të raporteve të tyre.

Derisa të gjitha burimet e informatave ishin të dobishme, regjistrat e anestezionit ishin thesar i informatave të rëndësishme. Këto regjistra ishin të dhëna të mbajtura njëkohësisht nga anesteziologët në kohën reale gjatë procedurave të operacionit dhe ishte pjesë e përgjegjësisë zyrtare. Për këtë arsye trupi gjykues i jep një shkallë të lartë të saktësisë këtyre regjistrave. Këto regjistra ishin plotësuar për secilin pacient, dhe përfshinin përpos tjerave emrin e pacientëve, datën e operacionit, anesteziologët të cilët morën pjesë në operacion, kirurgët të cilët e kryen operacionin, dhe llojin e operacionit.

Pas analizës së të gjitha informatave, ekspertët mjekësor ishin në gjendje të përgatitnin profil për secilin pacient, të cilët përfshinin shënime të tilla si emra, datë të lindjes, data të ardhjes dhe largimit nga Klinika Medicus, datën e operacionit, kohën e anestezionit, kohën e



	R	X	X	X				X		X
20.06.2008	V	X	X					X	X	
	R	X	X		X			X		X
02.07.2008	V	X		X	X	X		X	X	
	R	?	?	?	?	?	?	?	?	?
03.07.2008	V	X		X		X		X	X	X
	R	?	?	?	?	?	?	?	?	?
22.07.2008	V	X	X	X				X	X	
	R	?	?	?	?	?	?	?	?	?
23.07.2008	V	?	?	?	?	?	?	?	?	?
	R	X	X	X	*			X	X	
24.07.2008	V	X		X				X		X
	R	X						X		X
29.07.2008	V	X		X				X		X
	R	?	?	?	?	?	?	?	?	?
18.08.2008	V	X	X	X				X	X	
	R	X						?	?	?
19.08.2008 I	V	X	X					X	X	
	R	X						?	?	?
19.08.2008 II	V	X	X	X				X	X	
	R	?	?	?	?	?	?	?	?	?
09.09.2008	V	X	X					X		X
	R	X	X					X		X
27.09.2008	V	X		X	X	X		X	X	
	R	X	X		X			X	X	
29.09.2008	V	X			X			X		X
	R	X			X			X	X	
21.10.2008	V	X			X	X		X	X	
	R	X			X			X		X
26.10.2008	V	X	X			X		X	X	
	R	X	X				X	X		X
31.10.2008	V	X		X				X	X	
	R	X	X		X			X		X
<b>GJITHSEJT:</b>	<b>46</b>	<b>38</b>	<b>16</b>	<b>16</b>	<b>13</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>36</b>	<b>33</b>	<b>21</b>

Shënime:

1. \* - Një "Dr. B." shfaqet- I paidentifikuar
2. - V – viktima, R – marrësi;
3. - X – kirurgu; X – anesteziologu; ? – I panjohur.

#### 4. Raportet e hyrjes dhe daljes së dhuruesve, marrësve , mjekëse të huaj dhe të tjerëve

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues ka siguruar informata nga Policia Kufitare e Kosovës për hyrjet dhe daljet e pacientëve të Medicusit, mjekëve ndërkombëtar të përfshirë në transplantime të veshkës, marrësit dhe në veçanti shënimet e M.H. dhe Y.S. I ashtuquajturit Raporti i Pisces është një pjesë thelbësore e provave që vërteton provat tjera dhe përkrahë pretendimet se në Klinikën Medicus janë bërë transplantime të veshkës në një shkallë të pa precedent dhe se dhuruesit ishin viktimat e trafikimit.

Datat e hyrjes dhe daljes për M.H., Y.S. dhe D. janë afërsisht identike në Raportin e Pisces. Raporti gjithashtu mbështetë provën e disa dhuruesve dhe marrësve lidhur me atë kur kanë ardhur dhe kur kanë shkuar, me kë ishin dhe pretendimin se Y.S. ishte kirurg në çdo operacion. Përveç kësaj, ky raport është provë e qartë e “ *tre ose më shumë personave duke vepruar së bashku*” dhe kështu mbështetë pikën e krimit të organizuar dhe trafikimin.

Krahasimi i të dhënave të hyrjeve dhe daljeve është prezantuar nga PSRK në formë grafike, që ia vlen të prezantohet edhe në aktgjykimin me shkrim.

Nr.	Emri	Kombësia	Data e hyrjes	Data e daljes	Vrojtimet
1	M.Y.	Izraelit	04.06.2008	10.06.2012 ?	Data e daljes 10.06.2008 sipas dosjes mjekësore (B. Rep)
2	A.O.	Izraelit	19.06.2008	24.06.2008	
3	F.E.	Turk	03.07.2008	07.07.2008	
			22.07.2008	03.08.2008	
			08.09.2008	14.09.2008	
			26.09.2008	04.10.2008	
4	A.G.	Turke	22.07.2008	27.07.2008	
5	E.M.	Izraelite	22.07.2008	27.07.2008	
6	A.R.	Moldave	24.07.2008	29.07.2008	
7	V.SH.	Ruse	24.07.2008	29.07.2008	
8	Y.C.	Turk	29.07.2008	02.08.2008	
9	A.A.	Ruse	18.08.2008	05.08.2008 25.08.2008	Data e hyrjes dhe data alternative e daljes sipas dosjeve mjekësore (B. Rep.)
10	V.V.	Rus	18.08.2008	23.08.2008	Data e hyrjes sipas dosjeve mjekësore (B. Rep.)
11	P.M.	Ukrainas	08.09.2008	12.09.2008	
12	L.P.	Izraelite	27.09.2008	29.09.2008	
13	M.G.	Ukrainas	27.09.2008	01.10.2008	Data e hyrjes sipas dosjeve

					mjekësore (Sch. Rep.)
14	D.SH.	Kazakistanez	21.10.2008	25.10.2008	
15	A.K.	Bjellorus	26.10.2008	31.10.2008	
16	Y.A.	Turk	30.10.2008	04.11.2008	
			Largimi i shtyrë	19.11.2008	
17	P.S.	Kosovar	01.04.2008		
18	A.G.	Turke	22.07.2008	27.07.2008	
19	J. S. "XH."	Nuk ka të dhëna	19.08.2008	Nuk ka të dhëna	Informatat nga dosjet mjekësore (B. Rep), nuk ka të dhëna nga PISCES
20	A.M.	Nuk ka të dhëna	19.06.2008	Nuk ka të dhëna	Informatat nga dosjet mjekësore (B. Rep), nuk ka të dhëna nga PISCES
21	O.R.	Ukrainase	07.03.2008	10.03.2008	
			10.05.2008	18.05.2008	
22	M.M.	Izraelit	04.06.2008	10.06.2008	
23	Y.D.	Izraelit	04.06.2008	12.06.2008	Rezultatet e datës së daljes nga dosjet mjekësore (B. Rep)
24	S.Y.	Izraelit	19.06.2008	26.06.2008	
25	E.K.	Turk	19.06.2008	25.06.2208	
26	L.SH.	Izraelit	02.07.2008	08.07.2008	
27	T.S.	Polak	22.07.2008	28.07.2008	
28	G.V.	Izraelit	22.07.2008	28.07.2008	
29	R.F.	Kanadez	24.07.2008	30.07.2008	
30	W.J.	Gjerman	24.07.2008	30.07.2008	
31	Y.D.	Izraelit	18.08.2008	26.08.2008	Informatat nga dosjet mjekësor (B. Rep.), Nuk ka hyrje në PISCES
32	D.E.	Nuk ka dosje në PISCES			
33	K. H. T.	Nuk ka të dhëna	19.08.2008	Nuk ka të dhëna	Informatat nga dosjet mjekësore (B. Rep), Nuk ka



					evidentim në PISCES
34	I. H. B.	Izraelite	08.09.2008	14.09.2008	
35	A.N.	Izraelit	27.09.2008	02.10.2008	Informatat nga dosjet mjekësore (SHC. Rep)
36	N.M.	Izraelite	27.09.2008	05.10.2008	
37	D.Z.	Izraelit	19.10.2008	27.10.2008	
38	R.K.	Izraelit	26.10.2008	02.11.2008	
39	B.SH.	Izraelite	30.10.2008	19.11.2008	
40	Y.F.	Nuk ka të dhëna			
	E.F.	Izraelit	02.07.2008	08.07.2008	
41	E.B.	Nuk ka të dhëna	29.07.2008	04.08.2008	Informatat nga dosjet mjekësore, nuk ka evidentim në PISCES
42	I.D.	Nuk ka të dhëna – shih Y. D. te 31 më lartë			
43	F. B. B.	Ukrainase	07.03.2008	10.03.2008	Informatat nga dosjet mjekësore (B.), nuk ka evidentim në PISCES
44	M.H.	Izraelit	24.07.2008	30.07.2008	
			?	23.08.2008	
			08.09.2008	09.09.2008	
			26.10.2008	27.10.2008	
			30.10.2008	?	
45	M.R.	Nuk ka të dhëna			
46	M.SH.	Izraelit	30.10.2008	12.12.2008	
47	E.SH.	Izraelite	30.10.2008	19.11.2008	
48	Y. E. S.	Turk	08.01.2008	10.01.2008	
			09.02.2008	10.02.2008	
			07.03.2008	?	
			12.03.2008	29.03.2008	
			10.05.2008	?	
			04.06.2008	11.06.2008	
			19.06.2008	26.06.2008	
			02.07.2008	06.07.2008	
			08.07.2008	10.07.2008	
			22.07.2008	03.08.2008	
			?	25.08.2008	
			08.09.2008	14.09.2008	
			26.09.2008	04.10.2008	
19.10.2008	23.10.2008				



	Korrik 2008																														
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	
V S																															
K D																															
"A"																															
S I																															
Daniobur																															
E E																															
M E																															
S T																															
A G																															
G V																															
V S																															
E R																															
R A																															
W I																															
R E																															
V C																															

	Gusht 2008																														
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	
V S																															
K D																															
A A																															
I D																															
I S																															
D E																															
V V																															
K T																															

	Shtator 2008																														
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	
V S																															
K D																															
P M																															
R H																															
M G																															
A N																															
"P"																															
N M																															

	Tetor 2008																														
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	
V																															
K																															
D																															
D																															
A																															
K																															
V																															
R																															

### Shpjegimi i ngjyrave:

- Qëndrimi në Kosovë i Y.S. – kirurg i përgjithshëm –
- Qëndrimi në Kosovë i K.D. – anesteziat –
- Qëndrimi në Kosovë i dhuruesit të organit –
- Qëndrimi në Kosovë i marrësit të organit –
- Qëndrimi i mundshëm në Kosovë i dhuruesit të organit –
- Qëndrimi i mundshëm në Kosovë i marrësit të organit –
- Data e operimit (sipas dosjeve mjekësore) –



Analiza përmbajtësore e Raportit Pisces e paraqitur në formë grafike është vendimtare për të kuptuar skemën kriminale të zhvilluar nga të gjithë aktorët kriminal në këtë aktivitet. Kjo tregon qartë se Y.S. ishte i pranishëm pothuajse në çdo operacion të veshkëve në Kosovë. E njëjta gjë vlen edhe për shumë raste për K. D. Modeli i saktë vërteton për së afërmi dëshmitë e dhuruesve dhe marrësve në klinikë që shpesh e njohën S. si kirurg i cili i kishte bërë ata operacion.

Raporti gjithashtu tregon qartë faktin se Y.S. dhe M.H. ishin shpesh në fluturimet e njëjta me pacientët që udhëtonin nga Stambolli për në Prishtinë. Trupi gjykues edhe njëherë rithekson se kjo tregon se aktivitetet kriminale ishte tejet mirë e organizuar, dhe se çdo aktor kriminal kishte kryer rolin e tij të caktuar në një mënyrë shumë të aftë.

## **5. Shkëmbimet e postës elektronike**

### **a. L. D. dhe Y.S.**

Një tjetër provë e rëndësishme është shkëmbimi i emailave ndërmjet dy aktorëve të rëndësishëm në skemën kriminale në fjalë, gjegjësisht Y.S. dhe L.D.. Kjo provë qartazi përshkruan origjinën e transplantimeve të veshkëve në Medicus dhe aranzhimet që kanë çuar kah trafikimi i njerëzve në përmasa ndërkombëtare.

Bazuar në urdhrin e gjyqtarit nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës, është urdhëruar përgjimi i telekomunikimeve dhe nëpërmjet kanaleve diplomatike kërkesa është transferuar në SHBA, pasi që serverët që përdoren për shkëmbimin e emailave si Google dhe Yahoo ndodhen në këtë shtet. Si rezultat trupi gjykues mori tërë shkëmbimin në formë elektronike. Emailat ishin dekoduar në një raport të përgatitur nga eksperti i Teknologjisë Informative K.U. i cili ka dëshmuar personalisht me 13 qershor 2012. Eksperti paraqiti raportin e tij i cili ishte pranuar në provat.

Këto emaila tregojnë përgatitjet e mëdha dhe bashkëpunimin në mes të Y. S. dhe L.D. lidhur me transplantimet e veshkëve në klinikën Medicus. Ato gjithashtu zbardhën rolin e S.H dhe të tjerëve.

Më 13 dhjetor Y.S. i dërgoi një email L.D. ku shkruante

*Përshëndetje, sikurse premtova unë iu dërgova të gjitha dokumentet (origjinale + në Anglisht nga noteri)... Shpresoj ta marr rezultatin së shpejti. Edhe një herë dua t'iu falënderojë për çdo gjë. Të gjitha të mirat. Y.S. PS: I dërgova në 2 emaila.*

Bashkëngjitur në email ishin këto dokumente: Informatat e letërnjoftimit; Certifikatat e shkollimit: Diploma e Universitetit (Mjekësi); Certifikata e Profesorit të Asociuar (Kirurgji e Përgjithshme); Certifikata e Specializimit – Kirurgji e Përgjithshme; Curriculum Vitae (duke përmendur se ndërmjet viteve 1986 dhe 2006 ai ka kryer më shumë se 2350 transplantime të veshkëve, nga të cilat 91 nga dhurues të vdekur).

Më 21 dhjetor 2007 L.D. duke u përgjigjur ia dërgoi një email Y.S.it ku thuhej

*“Përshëndetje nga Prishtina. A mundeni ju lutem të na dërgoni sa më parë këto dokumente: Licencën për ushtrimin e profesionit të Mjekut dhe Certifikatën se jeni duke punuar si mjek dhe ku jeni duke punuar. Me nderime, L. D.”*

Pastaj më 22 dhjetor 2007, Y.S. iu përgjigj L.D.:

*I nderuari L.D. , unë tani jam në Lituani dhe në Stamboll do të kthehem ditën e martë. Çfarë kuptova është se ju po kërkon "Kartelën time të Mjekut" nga Shoqata Mjekësore Turke. Kjo dëshmon se unë ushtroj profesionin e mjekut në Turqi. Ndërkohë unë do të përpiqem t'iu dërgoj një letër të cilën do të kërkojë nga noteri ta përkthejë në anglisht që dëshmon se unë punoj si mjek. Por, sikurse e dini unë punoja në një spital privat. Kështu që letërnjoftimi i mjekut dhe dokumenti nga Shoqata Mjekësore Turke do të mjaftojë për ju. Të gjitha këto do t'i bëj javën tjetër dhe do t'i dërgoj me email. Pacientët tashmë janë duke pritur për 20 janarin... Të gjitha të mirat Y.S.*

Më tej, më 25 dhjetor 2007 Y.S. shkroi

*I nderuari L.D., këtu janë të gjitha dokumentet që i keni kërkuar në gjuhën turke dhe të përkthyer në gjuhën angleze nga Noteri. Ju uroj më të mirat. Y.S.*

Këto dokumente ishin bashkëngjitur emailit: Certifikimi i anëtarësisë dhe praktikës i lëshuar nga Oda e Mjekësisë në Stamboll, Turqi; Certifikata e punësimit si Kirurg i Përgjithshëm, e lëshuar nga Spitali S., Stamboll, Turqi.

Bazuar në dëshminë dhe provat para gjykatës vetëm këto emaila sugjerojnë se kah fundi i vitit 2007 L.D. ishte në proces e sipër për ta sjellë Y.S. në Kosovë për të kryer procedura mjekësore. Y.S. ka qenë dhe është një praktikues i njohur i transplantimit të veshkëve. Më 30 janar 2008 ishte dërguar një faturë dhe listë e paketimit përfshirë "një makinë dialize, filtra për makinën e dializës", dhe më tej thuhej "transporti në ajër". Kjo faturë i është adresuar Klinikës Urologjike Medicus Kosovë; një faturë e kishte çmimin e transportit të këtyre mallrave në 7260 USD.

Një email i mëvonshëm po ashtu përmend S.H. Më 13 shkurt 2008 në orën 15:33 Y.S. i rekomandoi L.D. që S.H. si anesteziolog, të konsultohet sa i përket sigurimit të substancave të nevojshme për kryerjen e operimeve (SEVORANE, FORANE etj, të cilat të dyjat janë substanca anestezike që përdoren për pacientët):

*I nderuari L.D., unë kam harruar të diskutoj me ju një çështje tjetër: nëse ju kujtohet anesteziologu S.H. iu kishte treguar se nuk keni vaporizues SEVORANE, as medikamentin (...) A mund të kërkon nga S.H. nëse ai mund ta sjell makinën e dytë me FORANE apo nëse duhet unë ta sjell vaporizuesin FORANE për makinën Drager nga Turqia?*

L.D. pastaj u përgjigj më 15 shkurt 2008 në ora 20:32 kështu

*"I nderuari Y.S., për DRAPES do të flasim përsëri kur të vini në Kosovë. K.D. është i mirëpritur këtu. S.H. tha se i kemi dy makina të anestezionit por kemi vetëm një vaporizues FORANE për makinën Drager, kështu që mund ta sjellësh një vaporizues FORANE. Ju lutem më tregoni kur saktësisht do t'i kryejmë operacionet.*

Këto, emaila dëshmojnë se ka pasur një marrëveshje të gjatë ndërmjet L.D. dhe Y.S. për të kryer transplantimin e organeve njerëzore në Kosovë dhe kjo marrëveshje ka përfshirë ndarjen e shpenzimeve, burimet, pajisjet, personelin kirurgjik dhe të anestezisë.

Me 29 prill 2008 ora 13.33, L.D. i dërgon email Y.S. duke thënë;

*I nderuari Y.S. sipas komisionit çdo gjë është në rregull me Spitalin dhe licencën mund ta marrim pa asnjë problem. Tani vetëm jemi duke pritur që ministri i shëndetësisë ta nënshkruajë licencën. Me të mira, L.D.*

Dhe më 6 maj 2008 ora 13:14 nga L.D. te Y.S. , ku thuhet

*I nderuari Y.S., bordi ka vendosur të na jep licencën. Ne tashmë jemi duke pritur që ta marrim licencën deri në fund të javës. Me nderime, L.D.*

Kronologjia sugjeron se L.D. po fliste për licencën e kardiokirurgjisë të lëshuar nga ministria e shëndetësisë ditën e nesërme më 7 maj 2008.

Disa emaila ndërmjet L.D. dhe Y.S. it japin prova të fuqishme sa i përket përgatitjeve të duhura dhe aranzhimeve fillestare që ishin bërë me qëllim të kryerjes së operimeve të transplantimit të veshkëve, si dhe për dobinë pasurore që do të rezultonte nga këto operime.

Me 6 janar 2008 10:33, L.D. dërguar Y.S.it:

*Ne po ju presim për datën 20 janar. Mund të sillni çdo gjë që ju nevojitet. Mund të vazhdojmë sikurse kemi diskutuar. Me nderime, L.D.*

6 janar 2008 18:49, Y.S. për L.D.:

*Sikurse shihni unë qëndroj 1 ditë në Prishtinë... Pres ta marr licencën time dhe lejen për të kryer transplantime derisa të kthehem dhe to t'iu jap listën e pajisjeve. (...)*

Ky shkëmbim emailash tregon se transplantimet e veshkëve diskutoheshin shumë para ardhjes së marrësve apo viktimave të para. Ky ishte një plan që ishte menduar një kohë të gjatë.

Emailat e mëtutjeshëm më 20 janar 2008 (19:15), 21 janar 2008 (19:14), 22 janar 2008 (22:11), 23 janar 2008 (14:20), 30 janar 2008 (11:24), 12 shkurt 2008 (12:09), 13 shkurt 2008 (15:23) dhe tjerat paraqesin L.D. dhe Y.S. duke diskutuar lidhur me kushtet për marrjen (në Kosovë apo importim nga Turqia) e materialeve të domosdoshme për transplantim, përfshirë perde, përparëse, vaporizues, drita, tavolina operimi, makinë për hemodializë dhe pajisje tjera mjekësore. Më 30 janar 2008 (18:08), Y.S. i dërgoi L.D. një email së cilës ia bashkëngjiti faturat, dokumentet e doganave dhe transportit për pajisjet dhe substancat mjekësore që do të transportoheshin nga Turqia në Kosovë, për qëllime të operimeve të transplantimit.

Emailat lidhur me gjetjen e pacientëve (dhuruesve dhe marrësve të organeve) dhe përgatitja e dokumentacionit:

22 janar 2008 (22:11) Y.S. S. i shkruan L.D.:

*I nderuari L.D., nesër do të përpiqem që t'iu dërgoj të gjitha që të nevojiten. Ndërkohë, unë kam përgatitur numër të mjaftueshëm të pacientëve për disa javë : ) Me nderime, Y.S.*

23 janar 2008 (14:20) - Y.S. i shkruan L.D.:

(...) Unë planifikoj të vij këtë të hënë apo të martë për 1 ditë që të bisedojmë për herë të fundit para operimeve. Unë planifikoj t'i bëjë 2-3 operime me 7-8 apo 9 shkurt nëse ju pranoni. Pacientët janë të shëndoshë pa ndonjë problem serioz. Raste të lehta! Me vete unë planifikojë t'i sjellë disa medikamente dhe instrumente pa dokumente. Kështu që më duhet dikush të më pres në aeroport të më ndihmojë sepse mund të kem problem me kontrollin doganor. Për rastet e para me gjasë ne nuk do të kemi mbështetje për Hemodializë në spital, kështu që nëse na nevojitet duhet ta marrim këtë ndihmë jashtë spitalit. E kam fjalën, nëse pacientët kanë nevojë për hemodializë ata duhet të dërgohen në ndonjë qendër dialize në Prishtinë. (...)

5 shkurt 2008 - Y.S. i shkruan L.D.:

I nderuari L.D., e kam blerë biletën: ne vijmë këtë të shtunë 09.02.2008 atëherë në orën 14:15 në Prishtinë së bashku me teknikun. (...) Po ashtu, do të përpiqem të sjell më shumë instrumente dhe medikamente që do të na nevojiten në të ardhmen. Dje A. e kam porositur për disa gjëra që dëshiroj t'i blini për këto 2 raste. Sepse pasi të largohem pas disa ditësh, sikurse ju kam thënë, pres të kthehem edhe shumë herë tjera: )))

Unë po ashtu do t'i sjell disa dokumentet të cilat me gjasë duhet t'i përgatisim mes vete për pacientët. Gjithashtu, do të isha i lumtur të jem aty tri apo katër herë sikurse iu kam thënë shumë njerëzve këtë. Jam fatlum që kam takuar një person si JU me të cilin nuk kam nevojë as të flasë sepse ndjej se NE jemi shumë persona të ngjashëm dhe merremi veshë në mënyrë të PËRSOSUR pa folur fare. Të falënderoj për miqësinë L.D. Të gjitha të mirat, Y.S.

Të gjitha këto emaila dëshmojnë planifikimin që është bërë për këto transplantime, palët e përfshira, njohuria e tyre se çfarë do të ndërmerrej, dhe pjesëmarrja e plotë e tyre në këto plane. Nuk ka asnjë dyshim se A.D. dhe L.D. ishin shumë të vetëdijshëm se në çka ata ishin përfshirë.

13 shkurt 2008 (15:23) Y.S. i shkruan L.D.:

Një email që zbulon se operimet e transplantimeve kishin qenë të planifikuara me qëllim të përfitimit dhe ishte paraparë një zgjerim i mundshëm i aktivitetit për transplantimin e organeve tjera.

I nderuari L.D., 1. Pas diskutimit me shumë njerëz më në fund mora një ofertë të mirë nga një kompani Turke (...). 2. Dje K.D. erdhi në spitalin tim dhe folëm gjatë. Edhe ai dëshiron të vijë në operime si për rastet tona ashtu edhe për Kirurgji të Përgjithshme që nga fillimi. Unë i kam treguar atij për çfarë kemi folur unë dhe tij rreth parave. **Kështu që ai nuk do t'i prek paratë e tua por unë me K.D. do ta ndajmë pjesën time**. Mendoj se ai është i mirë sepse duke filluar nga fundi i shkurtit do të kemi vërtetë shumë pacientë dhe duhet të punojmë me 2 tavolina. Dhe sikurse ju kam treguar, dua të filloj edhe me MËLÇI! Kështu që më duhet një kirurg i përgjithshëm nëse më nevojitet ndihmë. Për këtë arsye më beso se është mirë. Pres emailin tënd që t'i planifikojë gjërat e mia. Me nderime. Y.S.

Nga emailat është tejet e qartë se paratë ishin aspekt kyç i kësaj marrëdhënieje dhe arsyeja e vërtetë që këta njerëz ishin përfshirë në këtë aktivitet të organizuar kriminal.

15 shkurt 2008 Y.S. i dërgon email L.D. lidhur me problemet sa i përket problemeve me gjetjen e pacientëve që përputhen ("çifte") të cilat prapë tregojnë njohurinë dhe pjesëmarrjen e A. në aktet e organizuara kriminale :

*I nderuari L.D., dua të dini se po bëj çmos që të vij sa më parë. Për momentin, problemi i im i vetëm janë “çiftet”! Sikurse e dini është mjaft vështirë çiftet të përputhen. Ka shumë pacientë dhe kur të fillojmë me të parin jam i sigurt se do të kemi me shumë së që është pritur! A ju kujtohet çfarë kam kërkuar nga ju? Ju më thatë se do të përpiqeni të gjeni... Na nevojitet kjo posaçërisht në të ardhmen! Unë vërtet doja të isha atje në ditën e PAVARËSISË suaj! Shpresoj do të festojmë edhe njëherë kur të vij. I kam dërguar disa mesazhe SMS A. por deri më tani nuk kam marrë asnjë përgjigje. A mund t’ia përkujtoni që t’i shikojë mesazhet. Dua që ai edhe njëherë të shikojë çfarë kemi dhe çfarë nuk kemi. Unë ia kam dërguar një listë atij. Me të mira. Y.S.*

Me 4 mars 2008 Y.S. i shkruan L.D. një email ka të bëjë me formalitetet tjera të domosdoshme për simulimin e legalitetit të aprovimit dhe për të siguruar mbrojtje kundër detyrimit, i ashtuquajtur “komisioni i etikës” .

*I nderuari L.D. më në fund jemi duke ardhur këtë të Premte. Për detajet të njoftoj më vonë. Por, sikurse të kam thënë më herët, unë do të qëndroj në spital si dhe tekniku K.... Ndoshta do të vjen edhe K.D.! Të lutem sikurse të kam treguar më përpara neve na nevojitet i ashtuquajtur “komisioni i etikës” që përbëhet nga së paku 3 persona. I avokat-noter, I nga spitali (mund të jetë A.) dhe i fundit singërisht e preferoj SH... ( S., kunatin e L.D., qartësimi është shtuar) iu kam treguar arsyen më herët. Por unë megjithatë iu respektoj si drejtor i spitalit, kështu që ju keni dhe duhet të keni “FJALËN E FUNDIT”! Me vete do ta sjell “vaporizuesin”, kemi folur me S.H.. Si dhe disa mE.amente tjera që na nevojiten (nuk janë të shtrenjta). Pra do të punojmë të premten dhe të shtunën! Apo mund të jetë 1 e shtunë dhe 1 e premte sipas performancës së ekipit.*

*Ju lutem mos harroni ta kyçni “ngrohjen” në katin e dytë dhe kujdesin intensiv madje që nga dita e mërkurë! Nuk dua që pacientët të ftohen: )*

*Me vete do ta sjell “shembullin” e mbulesave të operimit që do të kushtojnë më pak se 25 secila, besoj!*

*Ju uroj fat të gjithëve. Me nderime, Y.S.*

Trupi gjykues konstaton se emailat ndërmjet Y.S. dhe L.D. kanë vlerë të madhe dëshmuese lidhur me marrëdhënien ndërmjet këtyre dy njerëzve dhe planifikimin e tyre të gjerë për operacionet e transplantimit. Ato po ashtu tregojnë për njohurinë dhe involvimin aktiv që kishte A.D. dhe si ishin bërë përgatitjet për transplantimet shumë kohë para operimeve të para në mars të vitit 2008.

## **b. L. D. dhe M.B.**

Një grup tjetër emailash është i rëndësishëm në lidhje me komunikimet ndërmjet M.B. dhe L.D.

L.D. i dërgoi email M.B. lidhur me transplantimet e veshkëve (22 mars 2008, 14:42) – në gjuhën Gjermane (përkthim jozyrtar)

*Gjatë 2 javëve të kaluara kam folur me shumë kardiologë. Shpresoj se këtë jave do të fillojmë të punojmë. Desha të di çfarë tha T. Ne mund të fillojmë edhe me dializën. Unë kam diskutuar me njerëzit këtu në Kosovë dhe në Turqi. Kemi filluar të kryejmë transplantime të veshkëve. Rasti i parë tashmë është kryer. Një rast tjetër do të kryhet më datën 28 të këtij muaji. Nëse*



*dëshironi t'i shitni hiset tuaj, mund ta diskutojmë këtë. Për çdo gjë do t'iu kontaktojë javën e ardhshme. (është shtuar theksimi)*

*Urime Pashkët familjes tuaj.*

*L.D.*

Ky email specifik është provë e qartë për njohurinë që L.D. kishte rreth transplantimeve që po ndërmerreshin në mars të vitit 2008, dhe se ai ishte thellësisht i përfshirë në organizimin e transplantimeve. Ai e dinte kur ishin kryer transplantimet dhe kur do të bëheshin në të ardhmen. Është e qartë se pas një transplantimi të veshkës ai parashikoi të fitoj mjaft para që do ti mundësonin atij të blinte hisen e M.B. dhe të vazhdonte të mblidhte një profit të madh për vete.

Me 23 mars 2008 një email lidhur me problemet organizative dhe të licencës në klinikë dhe dorëheqja e T. ishte dërguar nga M.B. tek L.D. (23 mars 2008, 07:29) – në Gjermanisht (përkthim jozyrtar).

*Përshendetje L.D.*

*Sikurse jemi marrë vesh po ju dërgoj deklaratën e T. për të cilën kam pyetje specifike. Me sa duket ndërkohë klinika është mbyllur? A ka marrë klinika ndërkohë licencën për kardiologji? Ju lutem ma dërgoni një kopje me faks. Çfarë ka bërë A. konkretisht? Vlerësimet që ai i dërgonte ishin gjithnjë pas kërkesës sime dhe jo në mënyrë spontane sikurse jemi marrë vesh. Kurrë nuk duket se ka arsytetime të besueshme. Sa herë ka shkuar T. në Vushtrri? Për më tepër, do të isha mirënjohës nëse përgjigjeni në pyetje e mia të djeshme. Do të jem ende në Berlin të mërkurën dhe do të propozoja ta diskutojmë këtë më tej në telefon.*

*Përshëndetje*

*Urime Pashkët*

*M.B.*

(Mesazhi i përcjellë në vijim është në Anglisht):

*Nga: T.b. <[tb@yahoo.com](mailto:tb@yahoo.com)>*

*Data: E hënë, 10 mars 2008 16:14:30*

*Për: "M.B." <[mb@mobileemail.vodafone.de](mailto:mb@mobileemail.vodafone.de)>*

*Lënda: përgjigje: cardio Medicus*

*I nderuari Profesor,*

*Jo, nuk kam dashur dhe nuk kam pasur nevojë t'i shpjegojë arsyet.*

*Ju pyetët dhe unë kam obligim moral dhe kolegial të shpjegojë. Natyrisht, nëse dëshironi ta lexoni.*

*Kështu që, shpjegimin mund ta gjeni të bashkëngjitur. Nëse nuk jeni të interesuar, mos e hapni bashkëngjitjen.*

*Më vjen keq për vonesë! Thjeshtë, kam harruar!*

*Nderimet e mia,*

*T.B."*

Pjesa e bashkëngjitur përbëhet nga një letër e shkruar nga T.B. në të cilën ai shpjegon arsyet e veta personale për dorëheqje nga klinika Medicus dhe shpalos disa mangësi në kuptim të praktikës organizative dhe mjekësore në aktivitetin e klinikës.

Fragment (origjinali në Anglisht):

*Pajisjet janë të vjetra, dhomat janë të vjetërsuara dhe ekziston një sistem i prishur i kanalizimit (Para. 6)*

*Pavarësisht paralajmërimeve tona, L.D. me muaj ka lënë pas dore çështjen e aplikimit për licencim të institucionit dhe personelit. Ai ka reaguar ndaj kësaj vetëm pas vdekjes fatkeqe para tre muajsh (vdekja e pacientit të operuar në Medicus dhe “presioni” i mediave që pasoi).*

*Tashmë kemi një kornizë ligjorë për funksionimin e spitaleve private në Kosovë dhe besoj se ky “Medicus” ka nevojë për një reformim të plotë dhe të menjëhershëm, përndryshe do të fundoset (sa i përket kardiologjisë dhe kardio-kirurgjisë). Ne e kemi njoftuar L.D. për shqetësimet tona por nuk kemi mundur ta bindim të veprojë. Për këtë arsye shpesh e kam pyetur veten nëse L.D. është vërtet i përkushtuar Spitalit të tij Kardio-Kirurgjik apo e shikon vetëm si aneks të përkohshëm për Urologji. (Para. 11, 12)*

*(...) Ata kryen angiografinë e parë koronare të tyre (pacienti më jave kishte kërkuar fletë-lëshimin e tij pas procedurës). Procedura e dytë përfundoi në mënyrë fatale sepse pacienti vdiq në dhomën e kateterizimit. Kjo mund të ndodh, por çfarë nuk lejohet të ndodh është fshirja e regjistrimeve nga kompjuteri që është i lidhur me angiografin, që është një gabim i pafalshëm (posaçërisht nga aspekti ligjor). Kjo ka ndodhur në mungesën time, ditën që isha në ndërrimin 24 orësh në Qendrën Klinike Universitare. Kjo më ka zemëruar tej mase!*

Ky shkëmbim dhe komentet e T.B. tregojnë se L.D. ishte i vetëdijshëm për problemet e licencimit.

## **6. Nënshkrimet në Dokumente – Raportet e grafologut.**

Gjatë rrjedhës së hetimeve, prokuroria ka mbledhur dokumente të rëndësisë së madhe, kryesisht ftesa dhe garancione nga Klinika Medicus që kishin për qëllim mundësimin e dhuruesve dhe marrësve që të hyjnë në Kosovë. Përveç kësaj, nëpërmjet kanaleve ndërkombëtare të bashkëpunimit juridik në çështjet penale, trupi gjykues ka siguruar disa akte të dhurimit, dokumente të së ashtu-quajturit komitet të etikës, dhe dëftesa për pagesën me logo të Medicusit. Pasi që këto dokumente përmbanin nënshkrime me dorë të L.D. dhe A.D. trupi gjykues kërkoi ekspertizën e shkrimit me dorë dhe pastaj pranoi në prova mendimin e dëshmitarit ekspert për grafologji.

Dëshmitari ekspert M.T. përgatiti këto raporte në formë të shkruar i prezantoi ato gjatë shqyrtimit kryesor.

Raporti i parë i Z. T. ishte i datës 18 janar 2013. Nga eksperti ishte kërkuar t'i ekzaminojë dokumentet e kontestueshme dhe ta përcaktojë autorin e nënshkrimeve të bëra me dorë që ndodhen aty. Raporti paraqet këto konkludime:

a) Dokumentet e dorëzuara si provat 1 deri 6 (“RAPORTET MJEKËSORE” lidhur me Y.S., D.E., “LEJIM PËR TRANSPLANTIM TË VESHKËS” lidhur me Y.S., E.F., “AKTI I DHURIMIT” lidhur me Y.S., E.F.) nuk janë ekzaminuar për shkak se ato ishin tekst i shtypur nga faksi dhe shkrimi i dorës nuk kishte karakteristika të mjaftueshme për ta mbështetur një konkludim.

b) Sa i përket dokumentit të emërtuar “DEKLARATA” e datës 18 dhjetor 2007 (Deklarata lidhur me administrimin e taksave) dhe e dorëzuar si prova 7, eksperti përcaktoi se nënshkrimi në pjesën ku është përmendur “A.D.” ishte vënë nga A.D. (identifikimi vendimtar);

c) Sa i përket dokumentit të emërtuar “AUTORIZIM” të datës 14 shkurt 2005 (Autorizimi i dhënë nga M.B. avokatit F.B.) dhe e dorëzuar si prova 8, eksperti përcaktoi se nënshkrimi në pjesën ku përmendet “AVOKAT-LAWYER – F.B.” ishte vënë nga A.D. (identifikimi vendimtar).

d) Sa i përket dokumentit të emërtuar “KËRKESË” të datës 20.06.2005 (kërkesa drejtuar Bordit Licenses të Ministrisë së Shëndetësisë) dhe e dorëzuar si prova 9, eksperti përcaktoi se nënshkrimi në pjesën ku përmendet “. L.D.” ishte vënë nga L.D. (identifikimi vendimtar).

Në raportin e tij të dytë të datës 10 shkurt 2013, nga eksperti u kërkua t'i ekzaminonte 6 dokumente (të shënuara E#1 deri E#6) dhe ta përcaktojë autorin e nënshkrimeve me dorë që shfaqen aty. Eksperti konkludoi si në vijim:

a) Nënshkrimi në dokumentet e emërtuara “RAPORT MJEKËSOR” dhe “FORMULARI LEJUES PËR TRANSPLANTIM TË VESHKËS” (E#1 dhe E#2), të dyja që i referohen procedurave mjekësore për Y.S., të “ L.D.” mund të jetë vënë nga A.D. (konkludim pozitiv por i pasigurt); Në provën e njëjtë eksperti konkludoi se nënshkrimi në fjalë mund të mos jenë vënë nga L.D. (konkludim i probabilitetit negativ);

b) Dokumenti i emërtuar “RAPORTI MJEKËSOR” i datës 19.08.2008 lidhur me procedurat mjekësore për D.E. dhe i dorëzuar si prova 3 (E#3), nuk është ekzaminuar për shkak se kishte qenë e shtypur nga faksi. Shkrimi i dorës nuk kishte karakteristika të mjaftueshme për ta mbështetur një konkludim (pa konkludim);

c) Sa i përket nënshkrimeve në pjesën ku përmendet “F.B. – avokat” në dokumentet e emërtuara “FORMULARI LEJUES PËR TRANSPLANTIM TË VESHKËS” të datës 19.06.2008 lidhur me operacionin e transplantimit për Y.S. dhe e dorëzuar si prova 2 (E#2) dhe e datës 02.07.2008 lidhur me operacionin e transplantimit për D.E. e dorëzuar si prova 4 (E#4), eksperti përcaktoi se kishte tipare të pamjaftueshme identifikuese apo eliminuese për të rezultuar në formulimin e një konkludimi (pa konkludim);

d) Sa i përket nënshkrimeve në pjesën ku përmendet “SH.S. – Psikiatër” në dokumentet e emërtuara “FORMULARI LEJUES PËR TRANSPLANTIM TË VESHKËS” të datës 19.06.2008 lidhur me operimin e transplantimit të Y.S., e dorëzuar si prova 2 (E#2); dhe e datës 02.07.2008 lidhur me operimin e transplantimit të D.E., e dorëzuar si prova 4 (E#4), eksperti përcaktoi se ato nuk ishin vënë nga SH.S. (konkludim i sigurisë negative); Kjo demonstroi natyrën e pavërtetë të së ashtu-quajturit komitet etik.

e) Dokumenti i emërtuar “AKTI I DHURIMIT” të datës 02.07.2008 lidhur me pacientin E.F., i dorëzuar si prova 6 (E#6), sa i përket nënshkrimit pranë emrit R.R. – Noter avokat, nuk është ekzaminuar nga eksperti në mungesë të mostrave për krahasim.

Në raportin e tij të tretë dhe të fundit të datës 25 shkurt 2013, nga eksperti është kërkuar t'i ekzaminonjë 19 dokumente të shënuara #a deri #s, që paraqesin garancionet e lëshuara nga

klinika MEDICUS dhe dokumente tjera, dhe ta përcaktojë autorin e nënshkrimeve me dorë që ndodhen aty. Raporti nxori këto konkludime:

Lidhur me dokumentet e emërtuara “KËRKESË” të datës 20.06.2005 që paraqesin kërkesën dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe të dorëzuara si prova #h, eksperti përcaktoi se nënshkrimi në pjesën ku përmendet “L.D.” ishte vënë nga L.D. (identifikimi vendimtar);

Lidhur me dokumentin e emërtuar “GARANCION” të datës 20.10.2008 (për SH.D.) dhe të dorëzuar si prova #s, eksperti përcaktoi se nënshkrimi në pjesën ku përmendet “Dhënësi i garancionit” ishte vënë nga L.D. (identifikimi vendimtar);

Në lidhje me dokumentet e dorëzuara si prova #a deri #i dhe #j deri #r, gjegjësisht garancionet e lëshuara nga Klinika Medicus për pacientët (A.G., D.I., D.E., A.A., V.V., T.K., S.J., Y.A. - 2 dokumente, SH.B., A.K., R.F., A.R., J.W., V.SH.), eksperti përcaktoi se nënshkrimi në pjesën ku përmendet “Dhënësi i garancionit” apo “L.D.” ishte vënë nga A.D. (identifikimi vendimtar);

Konkludimet e nxjerra në raport si dhe metodat dhe pajisjet e përdorura në ekzaminimin e ekspertit u prezantuan para seancave gjyqësore. Nuk ka dyshime se eksperti dëshmitar ka kryer detyrën e vet në mënyrë shumë profesionale dhe me kujdes të duhur, duke përdorur metoda të pranuar shkencërisht. Konkludimet janë arsyetuar drejt dhe janë pranuar nga gjykata.

Trupi gjykues i ka dhënë rëndësi të konsiderueshme mendimit të këtij eksperti pasi që tregon qartë nëpërmjet nënshkrimeve të vërtetuara në dokumentet kritike përfshirjen e konsiderueshme të A.D. dhe L.D. në aktivitetet kriminale.

## **7. Dëshmitari tjetër me njohuri për Aktivitetet në Klinikën Medicus**

### **1. B.G. Ai dëshmoi më 20 dhe 25 tetor 2011 dhe me 8 mars 2013.**

Më 20 tetor 2011, B.G. dëshmoi se ai është infermier i licencuar. Ai ka punuar në Qendrën Klinike Universitare, dhe po ashtu ka punuar me gjysmë orari në Klinikën Medicus për një periudhë prej 5-6 muaj duke monitoruar pacientët pas kirurgjisë. Shefi i Klinikës Medicus ishte L.D.. Dëshmitari ishte në gjendje ta identifikojë atë në gjykatë. Ai nuk e dinte kush e udhëhiqte klinikën, por e dinte se A.D., i biri i L., punonte në Klinikë. Ai nuk kishte kontakt me A. dhe nuk kishte njohuri për detyrat e tij. B. punonte në njësinë e kujdesit intensiv në katin e parë. Ai nuk punonte në katin përdhësë. Ai punonte me ndërrime 12 orësh që përfshinin 7-8 infermier(e). Atyre nuk i është treguar, dhe nuk kanë pyetur, se çfarë operime kirurgjike ishin ato. Ai nuk ishte interesuar të dinte. Ai i dha policisë një deklaratë, por nuk e ka rishikuar para se të dëshmojë. Ai trajtonte pacientët nga shtetet e jashtme, por nuk e dinte nga cilat shtete. Komunikimet e tyre ishin në gjuhën Angleze. Njëri nga personat që monitoronte punën e tyre ishte Y.S. nga Turqia, i cili paraprakisht jepte udhëzime rreth terapisë dhe trajtimit, dhe iu thoshte të kujdesen me veçanti për pacientët e tij.

Totali i kohës reale që ai ka punuar në Klinikë gjatë pesë apo gjashtë muajve të punës me orar jo të plotë është rreth një muaj. Kur ai punonte gjatë ndërrimit të ditës ai herë pas here e shihte L.D. i cili ishte aty nga ora 3 deri në orën 5 të pas drekës. Ai e kishte parë atë lart por

nuk dinte se sa shpesh. Ai nuk kishte vërejtur ndonjë licencë të vendosur në mur dhe nuk ishte i njoftuar me librin e protokollit.

B.G. vazhdoi dëshminë e tij me datën 25 tetor 2011. Atij iu kujtua që kishte dhënë deklaratë për policinë me datën 4 nëntor 2008 dhe ai kishte disa minuta për të lexuar deklaratën e tij para se të dëshmonte. Ai qëndroi pas deklaratës së tij që i kishte dhënë policisë. Ai mund ta vërtetoj se ata ishin pacientë të huaj. Ai nuk e mohon se aty kishte transplantime të organeve mirëpo personelit nuk i ishte treguar për këtë. Policia e kishte pyetur se sa transplantime veshkash ishin bërë aty dhe ai nuk e kishte mohuar dhe u kishte thënë atyre se kishte pasur 3-4 raste dhe pacientët ishin të huaj. Ai ishte i paqartë për sa i takon burimit të këtij informacioni dhe dukej qartë se ai fliste me dykuptimësi në lidhje me njohurinë e tij për transplantime veshkash.

Ai ishte në gjendje të njohte L.D.; A.D. i cili ishte menaxher; S.H., anesteziolog i cili punonte në Medicus; I.B. , anesteziolog i cili punonte në Medicus; dhe S.D., gjithashtu anesteziolog i cili punonte në klinikë. Ai gjithashtu e njohu D., të cilin e kishte parë 2-3 herë në klinikë, përfshirë një herë kur ai kishte hyrë në sallën e operacionit i veshur me uniformën për kryerjen e operacionit derisa kryhej operacioni.

Infermieret nuk kishin përgjegjësi për pastrimin dhe trajtimin e plagëve të operacionit. Kjo kryhej nga Y.S., të cilin ai e kishte parë duke e bërë këtë 5-6 herë. Plagët e operacionit ishin në regjionin e barkut.

Trupi gjykues e konsideroi deklaratën e këtij dëshmitari si pjesërisht të besueshme. Dëshmitari kishte punuar në klinikë për një kohë të konsiderueshme dhe rregullisht , dhe si infermier mashkull ai kishte direkt kontakt me pacientët duke qenë përgjegjës për përkujdesjen ndaj tyre. Dihet mjaft mirë se trajtimi pas operacionit kërkon ndërrimin e fashës së plagës kështu që ai e dinte çfarë intervenimi kirurgjik ishte kryer te secili pacient për të cilin ai ishte përkujdesur. Përveç asaj, ai në mënyrë të drejtpërdrejtë ishte udhëzuar nga Y.S. se si të përkujdeset për pacientët dhe kështu dëshmitari e dinte se pacientët iu ishin nënshtruar intervenimeve kirurgjike në veshkë. Dëshmitari e dinte se këta ishin ndërkombëtar sepse ata nuk flisnin as shqip e as serbisht. Trupi gjykues nxori një konkluzion nga deklaratat e tij se ky dëshmitar ishte në dijeni se në Medicus bëheshin transplantimetë veshkëve. Arsyeja se pse ky dëshmitarë ishte aq i paqartë ishte se ai ishte i shqetësuar se ai do mund të ishte subjekt i ndjekjes penale për shkak të bashkëpunimit në kryerjen e këtyre veprave penale.

b. **SH.M.** Ajo dëshmoi me datën 10 nëntor 2011.

SH.M. ka qenë infermiere e regjistruar për dhjetë vite. Ajo ka filluar punën në Klinikën Medicus në periudhën 2004-05 ndërsa .L.D. ka qenë shefi i saj. T.P. ka qenë një mjek tjetër vendor që punonte në klinikë, në urologji në katin për dhese. L.D. ishte përgjegjës për Departamentin e Urologjisë. Në katin e parë ishte Reparti i Kardiologjisë i përbërë nga dy mjek gjerman të cilët vinin dhe shkonin dhe të cilët kryenin operacione të zemrës. Ajo nuk e dinte nëse pacientët ishin të huaj.

Ajo ka punuar në Klinikë derisa ajo u mbyll në vitin 2008 por nuk kishte punuar me orar të plotë. Ajo ka punuar vetëm 2-3 orë secilën herë dhe jo çdo ditë por vetëm kur kryheshin

operacionet. Puna e saj ishte të sterilizonte instrumentet e operacionit dhe gjatë kësaj pune ajo ka pasur punë me disa mjekë dhe personel të infermierisë. Ajo ishte në gjendje të njihte L.D. dhe A.D. në gjykatë. Ajo e kishte parë A. disa herë në klinikë por nuk e kishte ditur se çfarë bënte ai. Ajo gjithashtu ishte në gjendje të identifikonte mjekët: S., I. dhe S. si anesteziologë që punonin në klinikë. Ajo gjithashtu e njohu D., të cilin ajo e kishte parë disa herë duke ecur rreth klinikës.

Ajo nuk kishte punuar në klinikë ditën që kishte ardhur policia por kishte punuar gjatë fundit të tetorit. Ajo kishte qenë infermiere pjesëmarrëse gjatë operacionit por nuk e di nëse pacientët ishin të huaj. Ajo mban mend një mjek turk, Y.S., i cili ishte i dobët dhe tullac. Ajo kishte përgatitur instrumentet e tij për operacion. Ajo kishte punuar disa herë me të por nuk e dinte saktë se sa herë. Ai kryente operacione që kishin të bënin me sëmundjet e veshkëve por ajo nuk mbante mend nëse operacioni përfshinte edhe transplantim të veshkëve. Asaj asnjëherë nuk i ishte thënë të përgatiste instrumentet për transplantim të veshkëve.

Gjykata bëri një pushim dhe dëshmitares iu dha kohë të lexonte deklaratën e saj të datës 24 qershor 2010. Asaj pastaj iu kujtua se kishte punuar me Y.S. rreth 20 herë apo më shumë, në katin e parë. Asaj gjithashtu iu kujtuan mjekët e tjerë të cilët kishin punuar me Y.S., përfshirë doktorët L.D., S.H., S.D. dhe I.B. Y.S. kishte punuar me këta doktorët e tjerë gjatë operacionit disa herë; mund të ketë qenë 20 herë por asaj nuk iu kujtohej. L.D. ishte i pranishëm disa herë gjatë këtyre operacioneve —“në shumë prej tyre, në disa prej tyre, gati çdo herë.” K.D., i cili fliste turqisht, gjithashtu ishte aty disa herë. Anesteziologët që ajo i identifikoj ishin të vetmit të cilët punonin me Y.S. Operacionet gjithmonë kryheshin në katin e parë, në repartin e Kardiologjisë.

Ajo gjithashtu kishte parë D.J. të punonte me Y.S. 10-20 herë. Ajo përgatiste instrumentet. Ajo nuk dinte se nga ishin pacientët dhe as se kush ishte operuar nga doktorët Y.S. D.J. dhe L. D.

Ajo ishte e vetmja infermiere sterilizuese në klinikë, domethënë ajo kishte marrë pjesë në të gjitha operacionet. Asaj nuk i kujtohej rasti kur dy pacientë ishin në sallën e operacionit në të njëjtën kohë.

Asaj i kujtohej të kishte parë D.J. të veshur në uniformë të gjelbër e cila është e domosdoshme për të hyrë në sallën e operacionit. Ajo kishte qëndruar në sallën e operacionit gjithë kohën gjatë operacionit. Asaj nuk iu kujtohej të ketë ndihmuar D.J. të vendoste dorëzat dhe as t'i kishte dhënë atij asnjë instrument vetëm Y.S. dhe K.D. Ajo nuk kishte qenë në dijeni se aty kryheshin transplantime të veshkëve derisa i kishte parë lajmet në TV. Ajo nuk mund të jetë e sigurt se asnjëherë nuk i kishte parë dy pacientë në sallën e operacionit në të njëjtën kohë sepse kishte kaluar një kohë e gjatë që atëherë dhe ajo punon edhe në Klinikën e Prishtinës. Ajo e përsëriti se të gjithë të akuzuarit përveç A.D. dhe I.R.R. kanë marrë pjesë në operacionet me Y.S.

Deklarata e dëshmitares SH.M. është me rëndësi kyçe për këtë rast. Dëshmitarja ka ofruar deklaratat e dëshmitarit okular në lidhje me operacionet që ishin kryer në Klinikën Medicus, pasi që ajo ishte e vetmja infermiere sterilizuese përgjegjëse për përgatitjen e instrumenteve mjekësore. Është e drejtë të theksohet se ajo ka marrë pjesë pothuajse në çdo nxjerrje dhe transplantim të veshkëve në Medicus. Dëshmitarja i ka identifikuar të gjithë kirurgët dhe anesteziologët të cilët kanë operuar pacientët ndërkombëtar. Në këtë aspekt, trupi gjykues e ka konsideruar dëshminë e kësaj dëshmitareje, pasi që asaj iu është mundësia e rifreskimit të

memories së saj, si plotësisht të besueshme. Çfarëdo gënjeshtre paraprake nga ana e saj mund të sqarohet me dëshirën e saj t'i shmanget përgjegjësisë penale.

c. **T.P.** Ai ka dëshmuar me datën 15 nëntor 2011.

T.P. ka filluar të punoj në Klinikën Medicus si urolog në katin përdhes në vitin 2003. Ai ka investuar në Repartin e Urologjisë së bashku me L.D. afërsisht 40,000 Euro. Ai nuk di asgjë për katin e parë, repartin e Kardiologjisë. Ai ishte rekrutuar nga L.D. si urolog dhe kishte kryer detyrat normale të një urologu. L.D. ishte shefi i Klinikës dhe merrej me administratën në katin përdhes por ai nuk di asgjë për katin e parë. Ai nuk e di nëse L.D. është i kualifikuar për të kryer transplantime të veshkëve.

Ai e identifikoj A.D. detyrat e të cilit në Klinikë ishin për të mbajtur kontabilitetin, së paku në lidhje me katin përdhes. Ai e identifikoj S.H. i cili punonte si anesteziolog kurdo që paraqitej nevoja për intervenime kirurgjike si dhe D.J. dhe I.B. të cilët punonin si asistentët e S.H. Ata ishin anesteziologët e vetëm që punonin në Klinikë me sa e di ai, së paku për katin përdhes. Ai nuk ka dijeni për ndonjë aktivitet në katin e parë. Ai kishte një profit të vogël nga investimi i tij.

Ai nuk është në dijeni për doktorë të huaj që punojnë në katin e parë por doktorët gjerman kanë ardhur në katin e Kardiologjisë. Ai ka marrë rrogë ndërsa profiti është ndarë në mënyrë të barabartë—afërsisht 3-4 mijë në muaj. Edhe pse ai kishte interes financiar në klinikë, ai asnjëherë nuk kishte pyetur se çfarë po ndodhte lartë. Ai asnjëherë nuk kishte parë asnjë të huaj të shkonin në Klinikën e Kardiologjisë. Ai asnjëherë nuk e kishte takuar Y.S. -in dhe as nuk e kishte dëgjuar emrin e tij të përmendej në klinikë. Ai asnjëherë nuk kishte marrë pjesë në transplantime jashtë vendit në të cilën fushë ka specializuar këtu në Kosovës. Ai nuk e di se çfarë kërkohet. Në klinikën gjinekologjike ishte kryer një transplantim nga mjekët italian por urologët nuk ishin ftuar.

Dëshmia e dëshmitarit T.P. ishte konsideruar nga ky trup gjykues si e besueshme; së paku prokuroria nuk ka ofruar asnjë arsye për të nxjerr konkluzione tjera. Gjatë hetimit T.P. ka qenë subjekt i hetimit penal por akuzat ishin hedhur poshtë dhe hetimit kundër tij i ishte dhënë fund. Ky dëshmitar nuk ka ditur asgjë për transplantimin e veshkëve në klinikë pasi që ai nuk ka qenë i njoftuar me aktivitetet kriminale të partnerit të tij afarist L.D.

d. **D.I.** Ai dëshmoi personalisht me 11 shtator 2012.

D.I. i cili ishte infermier në Klinikën Medicus gjithashtu dëshmoi me datën 11 shtator 2012. Ai ka punuar në Spitalin Universitar dhe nga periudha 2006/2007 ai gjithashtu ka punuar me orar jo të plotë në Klinikën Medicus në katin e dytë që ai dëshmoi se ishte kati i Kardiografisë. Ai e ka parë L.D. në katin e dytë dhe ai gjithashtu e ka parë Y.S. aty. Megjithatë, ai vet nuk ka qenë i pranishëm në sallën e operacionit, sigurisht, atij nuk iu është lejuar të shkonte atje sepse ajo nuk bënte pjesë në fushëveprimin e punës së tij. Kur herë pas here pacientët i dorëzonin atij paratë për shërbimet e kryera nga D.G. ai ia dorëzonte ato para A.D. “sepse kur mbaronte ndërrimi më duhej të dorëzoja paratë”. Kjo dëshmi përsëri sugjeron tek fakti kyç se A. ishte person i rëndësishëm në Klinikën Medicus. A.D. merrej me që të dy aspektet, atë administrative dhe financiare të klinikës.

Si shumica e dëshmitarëve në këtë proces gjyqësor, dëshmitari ishte qëllimisht i paqartë kur i bëhej presion nga prokurori dhe gjyqtarët për të treguar në lidhje me atë se çfarë saktësisht

kishte ndodhur në klinikë. D.I. theksoj se si infermier ai nuk ka qenë në dijeni se cilave procedurave mjekësore iu ishin nënshtruar pacientët pasi që infermierët kanë ofruar vetëm trajtimin pas operacionit. Ishte e qartë nga dëshmia e I. se ai ishte i shqetësuar dhe pranoi se dinte vetëm për një operacion të veshkës i cili kishte ndodhur me Y.A.. Të sugjerohet se infermieret kanë mundur të ofrojnë trajtim post-operativ pa i ditur procedurat nëpër të cilat kanë kaluar pacientët është vështirë e besueshme. Pacientëve iu kishte dhënë anestezi i përgjithshëm dhe për disa orë iu nënshtrorshin operacionit të hapur. Pastaj ata rrinin në klinikë për disa ditë për tu shëruar dhe për ta kujdesej stafi mjekësor i klinikës. Infermierët duhet të dinin saktësisht se çfarë operacionesh po kryheshin.

**e. N.S.** Ai dëshmoi personalisht me 22 nëntor 2011

Dëshmitari N.S. dëshmoi me datën 22 nëntor 2011. Ai ishte teknik medicinal në Klinikën Medicus dhe ishte punësuar nga L.D. i cili ishte drejtor i Klinikës. Ai ka filluar punën në Klinikën Medicus kur ajo ishte hapur. Si teknik medicinal detyrat e tij përfshinin "injeksionet etj., detyrat siç janë ofrimi i asistencës për dy doktorët, L.D. dhe T.P. gjatë vizitave të tyre mjekësore". Ai gjithashtu dëshmoi se A.D. ishte kontabilist i klinikës. Ky dëshmitar gjithashtu theksoi se nuk dinte asgjë për operacionet në këtë katin e parë pasi që ai punonte vetëm në katin përdhese.

**f. A.A.** Ajo dëshmoi personalisht me 29 nëntor 2011

A.A. dëshmoi në gjykatë me datën 29 nëntor 2011. Ajo punonte si infermiere në Klinikën Medicus në katin përdhese. Ajo dëshmoi se I.B. ishte anesteziolog asistent. Gjithashtu ajo theksoi se pagesat bëheshin përmes fletëpagesave dhe këto çështje kryheshin nga A.D. dhe se L.D. ishte shefi i klinikës. Ajo gjithashtu theksoi qartë se edhe në katin përdhese (pasi që këtu ajo punonte dhe prandaj për këtë dëshmonte) L.D. ishte shef dhe jo T.P.

**g. I.A.** Ai dëshmoi personalisht me datën 29 nëntor 2011

I.A. dëshmoi në gjykatë më 29 nëntor 2011. Ai ka punuar si infermier në klinikën Medicus dhe ai dëshmoi se L.D. ishte shefi i klinikës dhe A.D. i kishte ofruar atij pozitën për të punuar në klinikën Medicus. Ai ka punuar lart në katin e parë në njësinë e kujdesit intensiv (NKI). Puna e tij përfshinte përcjelljen e "rasteve apo rastit pas operacionit". Ai ishte aty "për të monitoruar shenjat vitale të pacientëve si tensionin e gjakut, pulsën, këto lloj gjërash". Kjo kishte të bënte me trajtimin post-operativ. Disa prej pacientëve për të cilët ai ishte përkujdesur flisnin shqip dhe disa tjerë anglisht. Ai dëshmoi se deklarata e tij e mëparshme dhënë policisë ishte e saktë për sa i takon faktit "se dy pacientë nga vende të ndryshme zakonisht nga Turqia apo Izraeli gjithmonë vinin aty."

Çështja e dëshmitarëve që dëshmojnë me sinjeritet përsëri u ngrit me këtë dëshmitar. Z. A. qëndroi pas deklaratës së tij se "unë kam takuar katër pacientë të cilëve dyshohet se u janë hequr veshkat dhe u janë vendosur pacientëve të tjerë të cilët ishin nën kujdesin tonë për pesë ditë". Ai gjithashtu u pajtua se ai kishte parë Y.S. dhe dy mjekë të tjerë të huaj. Ai e ka parë Y.S. "mjaft shpesh" në klinikë. Edhe një herë u bë e qartë se dëshmitarët ishin shumë të shqetësuar në lidhje me thënien e së vërtetës para gjykatës. Z.A. dëshmoi se ai kishte për detyrë të trajtoj dhe pastroj plagët në fazën post-operative të kujdesit ndaj pacientëve sipas udhëzimeve të Y.S. Këto plagë ishin në anën e majtë të barkut. Në ditën kur policia mbërriti në klinikë, ai ishte në njësinë e kujdesit intensiv (NKI) duke u kujdesur për një pacient i cili "me sa duket kishte pasur një transplantim të veshkëve". I. A. dëshmoi se S.D. punonte në katin e parë në operacione përfshirë edhe ato me Y.S. siç kishin bërë edhe L.D. S.H. dhe I.B.



## **6. R.D.** Ai dëshmoi personalisht me 29 nëntor 2011

R.D. i cili është i biri i L.D. dhe vëllai i A.D. dëshmoi para gjykatës më 29 nëntor 2011. Ai dëshmoi se ai mbanë mend të ketë takuar Y.S. në Hotel Baci dhe se ai së pari e kishte takuar atë tre apo katër muaj më parë kur ai kishte shkuar në klinikën Medicus për t'u marrë me një problem kompjuterik dhe Y.S. e kishte prezantuar veten ", në katin e dytë në repartin e Kardilogjisë " si kirurg i ri nga Stambolli që punonte aty. Pas kësaj ai e kishte takuar atë në disa raste të tjera në klinikë para se ai ta takonte atë përsëri në Hotel Baci. R.D. vërtetoi se klinika ishte 'e babait të tij'. Pas mbërritjes së mediave në klinikë R. kishte marrë një telefonatë nga Y.S. i cili kërkonte nga ai të kthente një veturë me qira që ai e kishte. Y.S. ishte i frikësuar për këtë sepse ai ishte i përfshirë në transplantime ilegale të veshkëve në bashkëpunim me të akuzuarin në këtë rast.

### **i. T.B.** Ai dëshmoi personalisht me 29 nëntor 2011

T.B. dëshmoi personalisht më 29 nëntor 2011. Ai është një mjek kardiolog dhe ai kishte shfrytëzuar objektin në klinikën Medicus. Ai kishte komunikuar me që të dy M.B. dhe L.D. për të punuar atje dhe e kishte bërë këtë duke përdorur instrumentin e tyre të angiografisë. A.D. ishte drejtor në klinikë, me sa dinte ai, megjithatë ai kurrë nuk e kishte parë këtë në ndonjë dokument zyrtar. Ai gjithmonë ishte paguar me para të gatshme përmes njërit prej teknikëve dhe atij i ishte dhënë 33% e tarifës së paguar. Ai kishte kryer ekzaminimin e tij të fundit në klinikë më 16 shkurt 2008. T.B. kishte deklaruar se S.H. ishte shefi i Anesteziologjisë në klinikë. D.J. dhe I.B. të cilët ishin anesteziologë kishin ofruar "ndihmë" në NKI.

## **8. Regjistrimi i thirrjeve telefonike**

Gjatë fazës paraprake, prokurori i atëherëshëm mori një urdhër nga gjyqtari i procedurës paraprake për regjistrimin e thirrjeve telefonike që përfshinin L.D., A.D. dhe Y.S. Regjistrimi demonstroi se ka pasur kontakt të vazhdueshëm në mes dhe ndërmjet këtyre autorëve , dhe në veçanti ajo demonstroi përfshirjen e A.D. në aspektet logjistike të këtij rasti. Ai ishte në kontakt të vazhdueshëm me Y.S. , dhe ai ndoqi shumë nga detajet logjistike dhe operacionale, të tilla si transporti, planifikimi dhe marrja e furnizimeve të nevojshme .

## **9 . " Komisioni Etik "**

